Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

BOTIMI I DYTË

Fakte dhe Fabula për Rezolutën 1325

Përmbledhje rrëfimesh lidhur me nivelin e zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë

BOTIMI I DYTË

Fakte dhe Fabula për Rezolutën

1325

Përmbledhje rrëfimesh lidhur me nivelin e zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë

Rrjeti i Grave të Kosovës
Prishtinë, Kosovë
2022

E drejta e autorit © Rrjeti i Grave të Kosovës, 2022

Redaktore:
Nicole Farnsworth

Hulumtues dhe autorë:
Donjeta Murati
Amy Hillock
Sara Golden
Majlinda Behrami
José Carpintero Molina

Përktheu:
Arben Fetahu (botimi i parë, 2011)
Majlinda Behrami (botimi i dytë, 2022)

With funding from

Austrian
Development
Cooperation

Ky hulumtim është mbështetur pjesërisht nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht reflekton politikën zyrtare apo pozitën e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim.

Ky publikim mund të kopjohet pjesërisht apo tërësisht, nëse bëhet i ditur burimi.

Shtypur me materiale ekologjike nga Night Design në Prishtinë, Kosovë.

FALËNDERIMET

Ky publikim nuk do të mund të realizohej pa përkrahjen e vazhdueshme nga institucionet dhe individë të caktuar të cilët na kanë ofruar pa hezitim kohën, rrëfimet dhe qëndrimet e tyre.

Falënderojmë: Igballe Rogovën për vizionin, përkrahjen, rrëfimet frymëzuese dhe vullnetin e pashtershëm për të na treguar edhe një ngjarje më shumë në çdo kohë;

Agjencinë Austriake për Zhvillim dhe zyrën lokale në Prishtinë për mbështetjen e vazhdueshme të Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) në monitorimin e zbatimit të Rezolutës 1325 për më shumë se një dekadë;

Fondacionin Kvinna till Kvinna për mbështetjen e vazhdueshme dhe afatgjatë për paqen dhe sigurinë e grave dhe veçanërisht aktivistet për të drejtat e grave, si dhe financimin fleksibil që bëri të mundur finalizimin, përkthimin dhe redaktimin e këtij libri;

UN Women për mbështetjen e hulumtimit të RrGK-së mbi kontributet e grave për paqe dhe siguri në Kosovë, që siguroi burime për hulumtimin e këtij botimi të dytë;

Hulumtueset dhe përpilueset e botimit të parë Donjeta Murati, Amy Hillock, Sara Golden, Kaltrina Ademi, Danielle Gordon, dhe të botimit të dytë, Majlinda Behrami dhe José Carpintero Molina për netët e gjata të kaluara pa gjumë duke hulumtuar fakte të reja dhe duke rishkruar tekstin; Besarta Breznicën për realiziming e intervistave dhe konstributin në shkrimin fillestar; Lauren Hanna dhe Etleva Malushaj për kërkimin e të dhënave; David JJ Ryan për ekspertizën e tij ligjore të mirëpritur;

Anna Di Lellion për ekspertizën e saj redaktuese, për redaktimin e përpiktë dhe për përkrahjen morale në përpilimin e botimit të parë për të cilën i jemi shumë mirënjohëse;

Ada Shimën, Zana Rudin dhe Elmaze Gashin që na ndihmuan t'i anashkalojmë bllokadat informative në shkrimin e

botimit të parë; si dhe Donjeta Morinën dhe Ernera Dushicën për ndihmën e pakursyer në analizën dhe mbledhjen e të dhënave në botimin e dytë;

George Symondsin për humorin e tij frymëzues gjithnjë të mirëseardhur dhe për komentet e bëra; dhe

Lina Andeer, Eksperte për çështjet gjinore dhe gratë, paqen dhe sigurinë; Reyes Charle Cuellar, Këshilltare për Çështjet Gjinore për Përfaqësuesen Speciale të Bashkimit Evropian në Kosovë, Chiara Tagliani, Këshilltare për Çështjet Gjinore për EULEX Kosovë; dhe Biljana Nastovska, Këshilltare për Çështjet Gjinore e Misionit të OSBE-së në Kosovë për kohën dhe sygjerimet e tyre në rishikimin e botimit të dytë.

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT 4

HYRJE 7
Si nisi rrëfimi? 8
Rezoluta nuk ka "dhëmbë", por... 13
"Ishte një mision i madh dhe i koklavitur në fillim...".....18

PJESËMARRJA.....24

"NE e PËRDORËM REZOLUTËN NGA DITA E PARË..." 28
"Misionet janë ende në masë të madhe punë burrash".....39
Këshilltarët gjinorë "zbarkojnë" në Kosovë 47
Trajnimi i trupave 68

"ASNJË GRUA NË EKIPIN NEGOCIATOR" 74
Ekipi i unitetit negocion... (pa asnjë grua) 78
Ju lutem shumë, "madhëria juaj" z. Petersen? 82
Njerëzit që punonin me Ahtisaarin nuk i merrnin fare parasysh çështjet gjinore 84
"Ne e kemi Editën!" por... 91

"NGA MARGJINAT NË VIJË TË PARË" 97
Institucionet e Kosovës: integrimi direkt apo "indirekt" i gjinisë? 113
Siguria: "Kjo është botë e burrave".....120
Shmangia e "kokëdhimbjes" në ndërtimin e institucioneve të reja të sigurisë 131

SIGURIA.....140

DHUNA SEKSUALE GJATË LUFTËS.....143
Gjatë luftës, "gratë nuk ishin të mbrojtura nga dhuna as për një moment të vetëm" 143
"Aktakuzat janë vetëm fjalë në letër" 146
"Ne nuk duam lule. Ne duam drejtësi për të mbijetuarat e dhunës seksuale".....164

SIGURIA E GRUAS – OBJEKTIV PRIMAR PËR PAQERUAJTËSIT 174
Monitorimi dhe reagimi ndaj shkeljes së të drejtave 183

TRAFIKIMI: "DJEMTË DO MBESIN DJEM. EDUKONI VAJZAT TUAJA." 193

"KUJT I INTERESONTE PËR DHUNËN NË FAMILJE?" 208
Kush i mbronë gratë? 210
"Drejtësia është larg" 221

NJË KUPTIM MË GJITHËPËRFSHIRËS I SIGURISË 226
Sigurimi i edukimit 231
"Vrimë e zezë" për shëndetin 234
Sigurimi i jetesës së grave 246

KONKLUZIONET 259

PUNIMET E CITUARA 268

SHTOJCAT 285
Shtojca 1. Progresi i arritur kundrejt indikatorëve të propozuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së 285
Shtojca 2. Metodologjia 301
Shtojca 3. Pjesëmarrësit në hulumtim 304
Shtojca 4. Rezoluta 1325 (2000) 312

FUSNOTAT 319

SHKURTESAT

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
BE	Bashkimi Evropian
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese
CDF	Community Development Fund *[Fondi për zhvillimin e komunitetit]*
CEDAW	Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas
CIVPOL	Policia Civile e OKB-së
CSDP	Politika e Përbashkët Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes
DDR	Çarmatim, Demobilizim dhe Riintegrim
DPKO	Departamenti për Operacione Paqeruajtëse
EEAS	Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm
ESDP	Politika Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
EUSR	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë
FSK	Forca e Sigurisë e Kosovës
DHBGJ	Dhuna në baza gjinore
GENAD	Zyra e Këshilltarit Gjinor (KFOR)
GSG	Grupi i Sigurisë Gjinore
GjNP	Gjykata Ndërkombëtare Penale
GSGJ	Grupi i Sigurisë dhe Gjinisë
HRGO	Zyra për të Drejta të Njeriut dhe Çështje Gjinore (EULEX)
IAWP	Shoqata Ndërkombëtare e Grave në Polici
ICO	Zyra Ndërkombëtare Civile
ICTY	Tribunali Ndërkombëtar për Krime Lufte në ish-Jugosllavi
IOM	Zyra Ndërkombëtare për Migrim
KE	Komisioni Evropian
KFOR	Kosovo Force (NATO)
KIPRED	Instituti Kosovar për Kërkim dhe Zhvillim të Politikave
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KWI	Iniciativa e Grave të Kosovës

LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LMT	Ekipi për Ndërlidhje dhe Monitorim
MWAHR	Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut
NATO	Organizata e Paktit Veriatlantik
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OGA	Zyra e UNMIK-ut për çështje gjinore
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejta të Njeriut
OJQ	Organizatë joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OPDMK	Organizata për Personat me Distrofi Muskulare të Kosovës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PK	Policia e Kosovës
PSBE	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë
PPSM	Politika e Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes e Bashkimit Evropian
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovë
QKRMT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
QKSGJ	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
RRGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
RROGRAEK	Rrjeti i Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
RWL	Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UN Women	Entiteti i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave
UNDP	Programi për Zhvillim i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UNFPA	Fondi Popullor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Fëmijë

UNIFEM	Fondi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNSC	Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
VWS	Seksioni për viktima dhe dëshmitarë (i Tribunalit të Hagës)
ZSK	Zyra e Statistikave të Kosovës (më vonë Agjencia e Statistikave të Kosovës)

HYRJE

Si nisi rrëfimi?

"Dua që ky publikim të mos shihet thjeshtë si raport, por më shumë si diçka që do t'i bëjë njerëzit ta vënë buzën në gaz dhe të thonë: 'Si ka mundur të ndodhë kjo? Po ashtu, dua që ta vëmë në spikamë faktin se Rezoluta 1325 është po aq e rëndësishme sa edhe rezolutat tjera."

– Igballe [Igo] Rogova, Drejtore Ekzekutive, Rrjeti i Grave të Kosovës, 2011

"Gjithkund pas luftës ka rrezik nga përplasjet, dhe unë e hetova menjëherë se kjo po ndihej edhe këtu. Gratë ishin të frustruara. Më kujtohet në një takim që kisha me Igon kur ajo e mllefosur më tha: "kurrë më nuk do të marrë pjesë në konferenca që kanë të bëjnë me Rezolutën 1325; ajo ishte ngopur me to. Për këtë arsye, mendoj se në atë kohë ndjehej lodhje apo frustrim. Por, shpresoj se kjo është e kaluar. Ishte një kohë e pritjeve të mëdha pas luftës ...mbase gjërat nuk shkonin ashtu siç kishin shpresuar njerëzit."

- Sirpa Rautio, ish-Udhëheqëse e Zyrës për të Drejta të Njeriut dhe Çështje Gjinore, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), 2011

"Më kanë lodhur raportet," u thotë Igballe Rogova disa vajzave teksa po bisedonin e po pinin nga një gotë birrë një ditë pikniku në Prishtinë. "Po ashtu jam ngopur edhe me fjalë nga konferencat për Rezolutën 1325." Si Drejtore Ekzekutive e Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), ajo kishte marrë pjesë dhe

kishte folur në shumë konferenca të mbajtura lidhur me Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, të organizuara në Bruksel, Vjenë, Stokholm e gjetiu. Kjo Rezolutë e riafirmon rolin e rëndësishëm që kanë gratë në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, në negociata paqësore, në ruajtjen e paqes, në ofrimin e asistencës humanitare dhe në rindërtimin e vendit. Rezoluta bën thirrje për të garantuar pjesëmarrje të barabartë të grave në të gjitha përpjekjet për të avancuar paqen dhe sigurinë.

"Nuk do të shkoj kurrë më në konferenca ku diskutohet për Rezolutën. E dini pse? Sepse çdo diskutim po mbetet vetëm në fjalë. Flasim e flasim derisa përfaqësues të nivelit të lartë shtiren kinse dëgjojnë. Në fakt ata nuk ndërmarrin asgjë. Dy muaj më vonë shkojmë në një konferencë tjetër me të njëjtën temë dhe thjesht përsëritet i njëjti avaz. Jam lodhur duke u folur njerëzve që nuk duan të dëgjojnë. Dua të shoh që po ndërmerren aksione, veprime." Vajzat lëvizën kokat në shenjë përkrahjeje, teksa pinin birrën e ftohtë. Ishte verë e vitit 2011, dhe ato ishin takuar për të diskutuar lidhur me përpilimin e një raporti mbi zbatimin e Rezolutës 1325 në Kosovë gjatë dhjetë viteve të fundit.

Njëra nga pjesëmarrëset në këtë takim, e hutuar nga këto fjalë, pyeti: "Atëherë, përse do ta përpiloni këtë raport tani?"

"Nuk duam që puna që do ta bëjmë të shihet thjesht si një raport," thotë Rogova, "Unë dua që ajo t'ju bëjë t'a vëni buzën në gaz e të thoni 'Si mund të jetë kjo e vërtetë?' Gjithashtu, dua që t'ua përkujtoj njerëzve se Rezoluta 1325 është e rëndësishme, jo vetëm rezolutat simotra të saj."[1]

Pesë hulumtueset filluan të mbledhin rrëfime nga trupat e OKB-së, forcat ushtarake, institucionet kosovare dhe nga aktivistët. Në një intervistë, Nazlie Bala, aktiviste për të drejtat e grave, përmblodhi qartë përgjigjjen në pyetjet e shtruara: "Ne e kemi shfrytëzuar Rezolutën 1325 që nga viti 1999, madje edhe para se të ishte miratuar ajo". "Ndërsa pyetja që parashtrohet është se deri në çfarë mase është

zbatuar ajo nga ata që kanë përgjegjësi për zbatimin e saj. Puna ishte nisur nga Misioni i OKB-së, por sa është zbatuar rezoluta? Ne nuk e dimë. Të gjitha agjencitë tjera të OKB-së e kanë atë në dokumentet e tyre, por sa shfrytëzohet ajo? Nuk e dimë."

Hulumtueset e dinin nga përvoja se nuk do të ishte detyrë e lehtë për to që këtë Rezolutë disi vështirë të definuar ta zbërthenin në veprime të matshme. Megjithatë, atyre u doli në ndihmë fakti se Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së i propozoi treguesit për matjen e zbatueshmërisë së Rezolutës 1325, të cilët do t'u shërbenin si udhërrëfyes në punën e tyre.[2] Në bazë të këtyre treguesve, hulumtueset shkuan nga zyra në zyrë, në lokale e bare, pinë kafe dhe verë, shkruan shumë e shumë emaila dhe kërkuan informata nga institucione të ndryshme. Përpjekjet e tyre në fund u kurorëzuan me botimin e parë të këtij libri.

Gati një dekadë më vonë, në një mëngjes të ftohtë marsi, Rogova reflektoi për 20 Vjetorin e ardhshëm të Rezolutës 1325. "Shumë gjëra kanë ndodhur në 10 vitet e fundit," tha ajo. "Ka edhe shumë për të rrëfyer... Megjithatë duhet ti lavdërojmë ata që me të vërtetë bënë diçka dhe të identifikojmë ato fusha që ende kanë nevojë për përmirësim." Një ekip tjetër hulumtuesish u nisën në terren. Nuk i shkoi kujt në mend se vetëm disa ditë pasi filloi hulumtimi, pandemia COVID-19 do të ripërcaktonte jetën tonë të përditshme dhe qasjen e tyre ndaj këtij hulumtimi. Sidoqoftë, me maska dhe me pajisje të lidhura në internet, ata arritën të intervistojnë 36 institucione, organizata dhe aktivistë në vitin 2020, duke kërkuar që secili të reflektojë mbi ndryshimet që kanë ndodhur në dekadën e fundit drejt zbatimit të Rezolutës 1325.

Ky publikim reflekton zbatimin e Rezolutës 1325 në Kosovë nga miratimi i saj në vitin 2000 deri në vitin 2020, bazuar në rrëfimet e dëgjuara dhe të dhënat e mbledhura nga dy ekipet hulumtuese. Pas luftës së vitit 1999, Kosova ishte ndër vendet e para në botë ku Rezoluta e re në atë kohë ofroi mundësi të rëndësishme për zbatim, dhe ne ndjemë se përvoja

20-vjeçare e Kosovës me Rezolutën mund të ishte e përshtatshme për situata të tjera të konfliktit dhe pas konfliktit.

Ky publikim përmban "fakte": statistika, data, emra, vende dhe çështje që ndërlidhen me zbatimin e Rezolutës 1325 në Kosovë. Po kështu përfshihen edhe "fabula", të cilat sipas Merriam Webster përkufizohen si "tregime që kanë për qëllim forcimin e një të vërtete të dobishme".[3] Rrjedhimisht, edhe pse ne nuk pretendojmë se të gjitha rrëfimet e paraqitura këtu janë faktike, ne besojmë se ato janë tejet të rëndësishme për të ilustruar se si njerëzit e kuptojnë zbatimin e Rezolutës. Aty ku rrëfimet kanë kundërthënie mes vete, ato mund të identifikojnë keqkuptimet dhe pengesat në komunikim të cilat mund të kenë ngadalësuar bashkëpunimin dhe progresin në zbatimin e Rezolutës.

Edhe pse treguesit e Sekretarit të Përgjithshëm ishin të dobishëm si udhërrëfyes për hulumtimin tonë, kur filluam të përpilojmë tekstin, ata na kufizuan shpejt. Ata nuk na lejonin të trajtojmë tema që ndërlidhen mes vete dhe na kufizonin mundësinë e paraqitjes së përshkrimeve të gjera që rezultonin nga intervistat e realizuara. Rrëfimet nuk përputheshin me treguesit; në fakt, ato tejkalonin shtrirjen e treguesve. Për shembull, parandalimi i dhunës në familje kërkon mbrojtje ligjore por edhe pavarësi ekonomike, punësim të shtuar të grave në polici, dhe trajnime për policinë dhe gjyqtarët. Rrjedhimisht, të gjeturat tona në lidhje me treguesit e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së janë të thurura në të gjithë kapitujt dhe nuk janë të vendosura nëpër kategori përkatëse. Në rast se nuk arrini t'i gjeni rezultatet në fabulat e paraqitura, do t'i gjeni të gjitha të gjeturat të përmbledhura në shtojcën 1.

Ky kapitull hyrës përfshinë një shpjegim të Rezolutës 1325 si dhe një përmbledhje mbi atë se si pjesëmarrësit në hulumtim e kuptojnë Rezolutën. Në të janë shtjelluar qëndrimet e të gjithë aktorëve kyç në Kosovën e pasluftës. Pjesa e parë e këtij libri fokusohet në pjesëmarrjen e grave në organizata ndërkombëtare, negociata, politikë, dhe në institucionet tjera të Kosovës, siç janë Policia e Kosovës dhe Forcat e Sigurisë. Në

pjesën e dytë, ndërthuren në një vend 'shtyllat' e Sekretarit të Përgjithshëm, si parandalimi, mbrojtja, ndihma dhe rimëkëmbja në kapitujt që përqendrohen në ofrimin e sigurisë së grave. Këta kapituj trajtojnë çështjen e pasigurive të cilat përmenden nga pjesëmarrësit në hulumtim dhe të cilat janë identifikuar në hulumtimet tona të mëparshme, p.sh. dhuna seksuale gjatë luftës, parandalimi i konfliktit të mëtejmë, trafikimi, dhuna në familje, dhe kuptimi më i gjerë i sigurisë njerëzore. Në pjesën e fundit, do t'i përmbledhim të gjeturat kryesore në lidhje me nivelin e zbatimit të Rezolutës 1325, faktorët që kontribuojnë apo pengojnë zbatimin e saj dhe veprimet e sygjeruara për të ardhmen.

Rezoluta nuk ka "dhëmbë", por...

"Rezolutat e Këshillit të Sigurimit janë shpesh të shkurtra dhe tejet të përgjithësuara. Ato vështirë se mund të interpretohen në mënyrë konkrete, dhe kjo rezolutë nuk përbën ndonjë përjashtim nga ky rregull."

- Luciano Calestini, Fondi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF), 2011

"Në Rezolutën 1325 asgjë nuk është artikuluar si duhet. Na është hedhur vetëm pluhur syve tanë. Ajo përmban fjalë të mjegullta, që të sjellin para aktit të kryer dhe asgjë më shumë."

- Sevdije Ahmeti, aktiviste e të drejtave të grave, 2011

Ne pyetëm "Çka do të thotë për ju Rezoluta 1325?"

Derisa disa pjesëmarrës në hulumtim i kuptonin qartë disa aspekte kyçe të rezolutës në vitin 2011, të tjerët dukeshin pak konfuz. Dy prej tyre nuk kishin dëgjuar kurrë për të. "Sinqerisht, nuk kam shumë njohuri për këtë," na tha një përfaqësues i një institucioni në Kosovë. "E di që ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave të grave, por nuk di asgjë më shumë." Disa mendonin se dinin paksa – e në fakt nuk dinin.

"Ky është një ligj që nuk është zbatuar në Kosovë. Ekziston raporti, por ai kurrë nuk është diskutuar në publik," na tha një aktiviste për të drejtat e grave. Të tjerët kinse kërkonin diçka nëpër dokumentet e tyre, acaroheshin dhe nevrikoseshin me faktin që ne nuk u'a kishim dërguar pyetjet paraprakisht.

Asokohe, na duhej t'u shpjegonim ngadalë: Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nuk është ligj. Nuk është as raport. Sidoqoftë, ajo është trajtuar në konferenca, raporte dhe media në Kosovë për dhjetë vite me radhë.

Një dekadë më vonë, ishte radha jonë të bëhemi të hutuar; neve na duhej të ishim të kujdesshëm në mënyrën se si e formulonim këtë pyetje në mënyrë që të mos turpëroheshim para pjesëmarrësve të hulumtimit, të cilët tani dukej të kishin njohuri, vetëdijesim dhe përvojë të gjerë rreth Rezolutës.

Siç shpjegoi Osnat Lubrani, ish-Përfaqësuese Rezidente e Programit për Zhvillim të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP):

> Rezoluta 1325 është nocion tejet i gjerë, i adresohet aktorëve të shumtë, përfshirë Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe shtetet anëtare të OKB-së. Rezoluta 1325 është rezolutë kyçe për paraqitjen e brengave dhe perspektivave të grave para Këshillit të Sigurimit dhe për caktimin e parimeve kyçe për t'i adresuar të njëjtat .... Rezoluta 1325 bën thirrje për fuqizimin e rolit të grave në formësimin e proceseve për parandalimin e konflikteve dhe ndërtimin e paqes, por edhe në qeverisjen në përgjithësi. Megjithëse janë ndërmarrë disa masa për të shtuar pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, kur flitet për çështjet që kanë të bëjnë për paqen dhe sigurinë shpesh gratë nuk janë pjesë e forumeve ku merren vendimet. ... Në vitet e kaluara, Këshilli i Sigurimit i ka miratuar katër rezoluta përkrahëse të Rezolutës 1325: rezolutat 1820, 1888, 1889 dhe 1960, me të cilat trajtohen fusha specifike të përmendura në Rezolutën 1325, veçanërisht adresimi i dhunës seksuale ndaj grave dhe vajzave në situata të konfliktit. Këto rezoluta bëjnë thirrje për përcaktimin e treguesve dhe krijimin e sistemeve monitoruese në nivel global, për analizim dhe raportim mbi aranzhimet përkatëse të cilat do të sigurojnë ndërmarrjen e

> veprimeve të fuqishme drejt mbrojtjes më të mirë të grave nga dhuna dhe drejt ndalimit të pandëshkueshmërisë për këto vepra.[4]

Sipas pjesëmarrësve në hulumtim, njëzet vite pas miratimit të Rezolutës, ajo mbeti njësoj e rëndësishme.

Element kyç i Rezolutës 1325 është përfshirja e perspektivës gjinore, e cila u definua nga Fondi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë (UNIFEM) si:

> Strategji për t'i bërë brengat dhe përvojat e grave dhe burrave dimension përbërës në dizajnimin, zbatimin, monitorimin dhe evoluimin e politikave dhe programeve në të gjitha sferat politike, ekonomike dhe shoqërore, ashtu që gratë dhe burrat të mund të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe të mos ekzistojë pabarazia. Qëllimi përfundimtar i saj është arritja e barazisë gjinore.[5]

Duke aluduar në nocionin e integrimit të perspektivës gjinore, Nazlie Bala, asokohe nga UNDP, tha: "Rezoluta 1325 për mua paraqet një udhëzues për fuqizimin e grave në nivele të ndryshme në siguri, barazi gjinore dhe zhvillim ekonomik."[6] Këshilltarët për çështje gjinore janë të vetëdijshëm se Rezoluta kërkon pjesëmarrjen e grave dhe përfshirjen e tyre në vendimmarrje. Në selinë e Forcave të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) në Kosovë (KFOR), Elisabeth Schleicher thotë: "Gratë dhe vajzat nuk duhet parë vetëm si viktima por edhe si pjesëmarrëse aktive në të gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë."[7] Dhjetë vite më vonë, përfaqësuesit e KFOR-it shtjelluan qasjen e tyre ndaj integrimit gjinor:

> Perspektivë gjinore për ne në KFOR është njohja nëse dhe kur një operacion do të ketë ndikim të ndryshëm tek burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat për shkak të roleve të ndryshme që kanë në shoqëri. Me fjalë të tjera, zbatimi i një perspektive gjinore do të thotë që,

> me çdo operacion që bën KFOR-i, ne i bëjmë vetes pyetjen: Si ndikon kjo te burrat, gratë, djemtë dhe vajzat?[8]

Asokohe, në vitin 2010, mbase konfuzioni më i madh me të cilin u përballëm ishte mëdyshja nëse Rezoluta paraqiste një kërkesë të fuqishme, apo ishte thjeshtë një 'udhëzues'. Si rezolutë e OKB-së, karakterizohet me një gjuhë të zbehtë që i kontribuon kësaj mëdyshjeje. Edhe më keq, ky dokument që ndërlidhet me të drejtat e grave është i shkruar në gjuhë që i drejtohet vetëm një gjinie. "Sa mirë, ju doni të 'nxisni' dhe 'inkurajoni'," tha Clare Hutchinson, ish-Këshilltare për Çështje Gjinore në Misionin e Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK):

> Kur mbajmë trajnime, unë gjithmonë them, "Lexoni këtë. A ju bie diçka në sy?" I tërë dokumenti "inkurajon Sekretarin e Përgjithshëm që të kryejë punën e *tij,*" duke iu referuar vetëm punës së 'tij'. E unë mendohem, "A thua kurrë nuk do të kemi grua Sekretare të Përgjithshme? ... Kemi të bëjmë me një gjuhë fyese dhe denigruese për gratë, në një dokument që kërkon të kundërtën." Mesazhi që ipet është, "Ne e dimë se ju gratë ndiheni mirë kur uleni rreth tavolinës dhe mbani duart e shtrënguara me njëra-tjetrën, dhe ne inkurajojmë veprime të tilla." Gjuha është e një natyre të butë, në mënyrë që edhe interpretimi i saj të jetë më i butë. Rezoluta jo domosdoshmërisht do të trajtohet me respektin që e meriton. Unë mendoj se kjo paraqet pengesë.[9]

Rogova u pajtua me këto shqetësime, "Për të zbatuar me të vërtetë Rezolutën 1325, ajo do duhej të ishte më e rreptë: jo vetëm të thoshte, 'Nxisim shtetet'. Duhet të jetë e detyrueshme… Thënë sinqertë, të 'nxitësh' nuk do të thotë asgjë." Meqenëse Rezoluta 1325 nuk është konventë, shumica e pjesëmarrësve në hulumtim theksuan se ajo 'nuk ka dhëmbë',

respektivisht, nuk ka zbatueshmëri. Ndërsa studiueset kanë debatuar nëse Rezoluta 1325 është ligjërisht e detyrueshme,[10] ato priren të bien dakord se foljet si "nxitë", "mirëpret" dhe "u bën thirrje" nuk përfaqësojnë një status ligjërisht të detyrueshëm.[11]

Por… dhe ja ku vjen "por" i madh, mund të themi 10 vite më vonë, se Rezoluta 1325 megjithatë ka arritur të "nxisë" disa ndryshime pozitive, të cilat i diskutojmë më vonë.

Shumë kush ka besuar në frymën e Rezolutës për të nxitur ndryshim. Reyes Charle Cuellar, Këshilltare Gjinore e Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian (PSBE) në Kosovë, e konsideroi atë si "rezolutën në lidhje me barazinë gjinore të cilën po e prisnim të gjithë":

> Për mua kjo nënkuptonte një arritje të madhe. Ligjet në përgjithësi dhe Rezoluta, jo gjithmonë reflektojnë një realitet që ekziston. Unë gjithsesi besoj në fuqinë që Rezoluta mund të ketë në shoqëri dhe sesi këto mund të nxisin ndryshime dhe të hedhin në letër gjëra të dukshme, por jo të gjithë e dinin këtë. Ishte e qartë se kishte një konsensus në Rezolutë. Kjo nënkuptonte një mundësi shumë të mirë për të ndryshuar mentalitetet në të gjithë botën… gjatë konfliktit dhe në shoqëritë pas konfliktit, në procese të paqes ose pajtimit.[12]

Në të vërtetë, aktivistet e të drejtave të grave si dhe disa aktorë në organizatat ndërkombëtare dhe institucionet e Kosovës, kanë shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga Rezoluta "pa dhëmbë", duke e përdorur atë për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të avokuar për rëndësinë e përfshirjes së grave dhe avancimin e barazisë gjinore në konflikt dhe në shoqëritë pas luftës dhe konfliktit si Kosova.

“Ishte një mision i madh dhe i koklavitur në fillim...”

“Gjithçka filloi nga momenti kur erdhi EULEX-i në Kosovë, ndërsa UNMIK-u nuk shkoi. Të gjitha parasupozimet në të cilat i kishim bazuar planet ranë në ujë. Kështu që në fillim kishim një situatë të paqartë. Misioni ishte shumë i madh, me struktura tejet të fragmentuara, me komponentë të mëdhenj por të ndarë dhe me një mandat të ndërlikuar.

Më pastaj u kuptua se nuk kishte udhëzime të mjaftueshme. BE ishte një akter i ri në fushën e ndërtimit të paqes, kështu që nuk kishte memorie institucionale të cilën do ta përdorte. Kësisoj, së pari ... e kuptuam se njerëzit në fakt nuk dinin si të punojnë, se nuk kishim përcaktuar qartë prioritetet dhe se nuk kishim udhëzime të mjaftueshme, ... posaçërisht sa i përket monitorimit, në veçanti të policisë. Ata nuk e dinin se çfarë duhet të bëjnë. Policisë i duhen udhëzime tejet të qarta, ndërsa ata kishin marrë fare pak udhëzime në lidhje me të drejtat e njeriut dhe kurrfarë udhëzimesh në lidhje me çështjet gjinore.”

– Sirpa Rautio, ish-Udhëheqëse e Zyrës për të Drejtat e Njeriut dhe Çështjet Gjinore, EULEX, 2011

Që nga fundi i luftës, një kakofoni aktorësh, interesash dhe agjendash e kanë trajtuar Kosovën si shtëpinë e tyre. Misioni i Administratës së Përkohshme i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë u krijua në vitin 1999 në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit, dhe kishte mandat të hapur për qeverisjen e Kosovës, deri në zgjidhjen e statusit politik të saj. Me kalimin e kohës, UNMIK-u pati

reduktime, posaçërisht pas kalimit të kompetencave fillimisht tek Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, dhe më pas tek Qeveria e Republikës së Kosovës, pas shpalljes së pavarësisë në shkurt të vitit 2008.

Që nga viti 2000, UNMIK-u dhe organizatat tjera ndërkombëtare që kanë shërbyer nën ombrellën e këtij misioni kanë pasur përgjegjësi për implementimin e Rezolutës 1325. E tillë është edhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), përgjegjëse për 'demokratizim dhe ndërtim institucionesh' menjëherë pas luftës dhe Komisionari i Lartë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) që kishte për mandat ofrimin e asistencës humanitare. Sipas Frode Mouring, ish-Udhëheqës i UNDP-së, tërë administrata ndërkombëtare e udhëhequr nga OKB kishte për detyrë zbatimin e Rezolutës.[13] Duke qenë se mbante përgjegjësi për administrimin e Kosovës, OKB kishte për detyrë sigurimin e respektimit të marrëveshjeve ndërkombëtare. Fatkeqësisht, në vitin 2007 Mouring theksoi: "Jo të gjithë e kanë kuptuar këtë në të njëjtën mënyrë."

Që nga shpallja e pavarësisë, përgjegjësia për zbatimin e Rezolutës u bartë tek institucionet e Kosovës. Nëse më parë ka pasur paqartësi sa i përket përgjegjësisë, tani e njëjta u thellua edhe më shumë. Edhe pse konventat e OKB-së, siç është Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), janë shndërruar në ligje, Kuvendi i Kosovës nuk e ka miratuar ende Rezolutën 1325 si pjesë të ligjeve të vendit. Mosnjohja nga dy anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit, Rusia dhe Kina, ka bërë që Kosova ende të mos jetë pjesë e OKB-së, dhe rrjedhimisht nga ajo nuk mund të kërkohet përgjegjësi formale për zbatimin e dokumenteve të OKB-së. [14] Edhe në këto rrethana, përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës dhe aktivistet për të drejtat e grave duket se pajtohen se Kosova, si vend që ka kaluar nëpër konflikt dhe synon anëtarësimin në OKB, do të duhej t'a zbatojë Rezolutën. Siç theksuan përfaqësuesit e UNDP:

> Megjithëse Kosova nuk është ende anëtare e Kombeve të Bashkuara, ajo është e vendosur të përmbushë detyrimet që dalin nga Rezoluta, si në formën e përfshirjes dhe miratimit në legjislacionin vendas ashtu edhe në zbatimin e ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.[15]

Ndërsa Kosova ende duhet t'a miratojë Rezolutën zyrtarisht brenda ligjeve shtetërore , disa aspekte të Rezolutës adresohen përmes Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore, përfshirë barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e barabartë të grave.[16] Të gjitha institucionet e Kosovës ishin të detyruara të zbatonin këtë ligj, përfshirë forcat e sigurisë, Hysni Shala, nga Policia e Kosovës, theksoi: "Që nga viti 2010, nuk kemi pasur nevojë të përpilonim ndonjë strategji brenda Policisë së Kosovës [lidhur me Rezolutën 1325] sepse ishim të detyruar të zbatojmë politikat në nivelin kombëtar."

Për më tepër, Kosova kishte një Plan Kombëtar të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 për 2013-2015, i vlerësuar si shembullor në rajon.[17] Rreth 79 përqind e Planit u implementua, duke e bërë atë ndër planet më të zbatuara në Kosovë.[18] Pas skadimit të tij dhe një pauze pesë-vjeçare, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 përfshiu aspekte të Agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë.[19] Policia e Kosovës dhe Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK), të përkrahura nga UN Women dhe nga organizatat e grave, gjithashtu kanë nxjerrë politika të brendshme të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërlidhen me zbatimin e Rezolutës 1325. FSK-ja miratoi dy politika për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore, në vitet 2011 dhe 2019, të cilat kërkojnë pjesëmarrje të barabartë në pozitat vendimmarrëse brenda FSK-së sipas Rezolutës 1325.[20]

Në ndërkohë, institucionet e Kosovës nuk janë të vetme sa i përket kësaj përgjegjësie. Ato janë pjesë e një sistemi të ndërlikuar qeverisës të krijuar që nga viti 2008, duke qenë se pavarësia është shpallur në marrëveshje të negociuar

me fuqitë e mëdha perëndimore dhe nën kushtëzimin për mbikëqyrje të mëtejme ndërkombëtare.

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, EULEX, ka zbarkuar në Kosovë në shkurt të vitit 2008 për të 'monitoruar, mentoruar dhe këshilluar' autoritetet kosovare në sigurimin e sundimit të ligjit, duke u përqendruar në forcimin e policisë, gjyqësorit dhe doganave. Autorizimet e pakta ekzekutive të cilat vazhdoi t'i bartë EULEX-i kanë të bëjnë me mundësitë për të hetuar dhe përndjekur krimet e rënda dhe të ndjeshme, siç janë krimet e luftës, trafikimi, terrorizmi, korrupsioni dhe krimet e rënda financiare.[21] Me status neutral, misioni i EULEX-it ka funksionuar në bazë të Rezolutës 1244 të OKB-së të vitit 1999, nën udhëheqjen e BE-së. Deri në vitin 2012, Zyra Ndërkombëtare Civile (ICO) mbikëqyri mbrojtjen e pakicave dhe zbatimin e decentralizimit, nën udhëheqjen e një komiteti drejtues të përbërë nga 25 vende anëtare.

"Fillimi i paqartë dhe i parregullt" i EULEX-it, i cili u përmend nga Këshilltarja për Çështje Gjinore Sirpa Rautio, ishte mbase i pashmangshëm, duke marrë parasysh kompleksitetin e sistemit qeverisës në Kosovë. Po aq i pashmangshëm ishte konfuziteti lidhur me mandatin e EULEX-it në zbatimin e Rezolutës 1325. Një gjë që duhet theksuar është se Këshilli i Bashkimit Evropian ka bërë thirrje për zbatimin e Rezolutës 1325 në kontekst të Politikës së Përbashkët Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje (CSDP).[22] Duke qenë se EULEX-i është misioni më i madh i krijuar ndonjëherë nga CSDP, mandati i tij ngërtheu përgjegjësitë për zbatimin e Rezolutës 1325. Më gjerësisht, EULEX-i në Kosovë ka pasur për detyrë 'të sigurojë se të gjitha aktivitetet e tij respektojnë standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe çështjet gjinore."[23]

Në të njëjtën kohë, prania dhe ndikimi i Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë është rritur gjatë dekadës së fundit, veçanërisht në mes të synimit të Kosovës për t'iu bashkuar BE-së. Angazhimet e BE-së për zbatimin e Rezolutës 1325 përmes marrëdhënieve të saj të jashtme, dialogut politik dhe financimit të jashtëm janë pjekur me kohën. Në vitin 2008, BE miratoi

"Qasjen Gjithëpërfshirëse për zbatimin nga BE-ja të rezolutave 1325 dhe 1820 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë". Pastaj, në vitin 2018, BE-ja miratoi "Qasjen Strategjike të BE-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë". Për më tepër, planet e veprimit gjinor të BE-së dhe Strategjia për Barazinë Gjinore kanë përfshirë angazhime ndaj grave, agjendën e paqes dhe sigurisë, të gjitha të zbatueshme në angazhimin e BE-së dhe shteteve anëtare të saj në Kosovë.[24]

Rezoluta 1325 i bën thirrje edhe institucioneve përgjegjëse për siguri në Kosovë që të zbatojnë dispozitat e saj. Fillimisht, Organizata e Paktit Veriatlantik (NATO) mori përsipër përgjegjësinë për të krijuar kushte të sigurta, përmes 45,000 trupave nga anembanë botës të cilat zbarkuan në Kosovë në vitin 1999 si pjesë e Forcës së Kosovës (KFOR). UNMIK vendosi policinë civile të OKB-së (CIVPOL), të njohur edhe si Policia e UNMIK-ut. Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut dhe CIVPOL-i udhëhiqnin përpjekjet e përbashkëta për të siguruar "polici dhe drejtësi". Më pastaj, ato u përfshinë në trajnimin e Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK), që më vonë u shndërrua në Policinë e Kosovës përmes një procesi që filloi në vitin 2001 dhe kulmoi me themelimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme në vitin 2006.[25] Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), u çarmatos dhe u shndërrua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), një organizatë civile. Më pas, një pjesë e kësaj organizate iu bashkua Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), të themeluar zyrtarisht më 14 qershor 2009. Më vonë, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës u riorganizua në Ministri të Mbrojtjes në vitin 2014.

Në vitin 2010, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së krijoi një plan gjithëpërfshirës përmes të cilit krijoi treguesit për monitorimin dhe zbatimin e Rezolutës 1325; i cili specifikon përgjegjësitë përkatëse dhe treguesit e progresit të arritur drejt zbatimit të përgjegjësive. Sipas këtyre treguesve, përgjegjës për zbatimin e Rezolutës në Kosovë janë: Departamenti për Operacione Paqeruajtëse (DPKO) në Nju Jork, Përfaqësuesit e OKB-së, UNMIK-u, agjencitë tjera të OKB-së, OSBE, Qeveria e

Kosovës, Policia e Kosovës, FSK, BE-ja, EULEX-i, Zyra Ndërkombëtare Civile (ICO) dhe KFOR-i. Treguesit paraqesin një sqarim të domosdoshëm, për shkak se në mungesë të udhëzimeve të tilla të qarta, zbatimi i Rezolutës 1325 kishte mbetur peng i praktikave lokale dhe vullnetit politik. Numri i madh i aktorëve të përfshirë në Kosovë do të thotë se përgjegjësia për zbatimin e Rezolutës 1325 ndonjëhjerë kalohej me vullnet apo jo, tek pala tjetër.

PJESËMARRJA

"Pas luftës, ekzistonte tendenca e margjinalizimit të grave në politikë, përkundër faktit se gratë e Kosovës ishin pjesë e procesit të çlirimit, pavarësimit dhe ndërtimit të demokracisë."

– Edita Tahiri, ish-Zëvendëskryeministre për Punë të Jashtme dhe Siguri Kombëtare, 2011

"Tani, pas 10 vitesh në Kosovën e pavarur, ne [gratë nga Kosova] prisnim të kishim njohje publike për kontributin tonë në shtetndërtimin, qasje më të mirë në drejtësi, si gjysma tjetër e shoqërisë, burrat. [Në vend të kësaj,] ne u përballëm me injorancë dhe mohim total nga të gjitha qeveritë e pasluftës. Për ironi, ne u zëvendësuam nga përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve të qeverisjes vendore që morën rezultatet tona".

– Shukrije Gashi, Drejtore Ekzekutive, Partners Kosova, 2011

Më 8 mars 1998, në ditën ndërkombëtare të gruas, re të errëta kishin mbuluar Prishtinën. Moti i ligë nuk ndikonte në shpirtrat e 15,000 grave të përkushtuara të cilat ishin mbledhur para Zyrës Informative të SHBA-ve. Dëgjohej një gumëzhimë ndërsa gratë mbanin letra të bardha në duar, përmes të cilave simbolizonin mosrespektimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Përmes këtij spektakli vizuel, ato mundoheshin ta tërhiqnin vëmendjen e opinionit ndërkombëtar për dhunën ndaj civilëve e cila po ushtrohej nga regjimi i Millosheviqit në zonën rurale të Drenicës, më pak se 50 kilometra nga Prishtina.[1]

Demonstratat vazhduan edhe javët në vijim. Pesë ditë më vonë, u grumbullua një turmë mbresëlënëse prej rreth 50,000 grave, të cilat kërkonin që t'i jepet fund bllokadës serbe

në Drenicë, ku për javë të tëra nuk po lejohej as dërgimi i ndihmave humanitare për mijëra të zhvendosur e të plagosur.

Një demonstratë tjetër e organizuar më 16 mars 1998 nga grupet e grave dhe Forumi i Gruas i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) mblodhi mbi 12,000 gra, të cilat marshuan nga Prishtina drejt Drenicës në përpjekje për të siguruar "bukë për Drenicën". Me bukë në duar, radha e gjatë e grave filloi marshin në qetësi derisa arritën në Fushë Kosovë, në dalje të Prishtinës. Policia serbe i ndaloi ato për të marshuar më tej, duke i kërcënuar me intervenim në rast se do vazhdonin. Duke synuar të ruanin natyrën paqësore të marshit, kolona e grave vendosi të kthehej në drejtim të Zyrës së Kryqit të Kuq në Prishtinë. Me të arritur atje, ato si gjest simbolik kishin lënë në tokë mijëra bukë që kishin në duar, për popullatën e Drenicës.

Më pastaj, gratë vazhduan ecjen drejt zyrave të UNHCR-së. Edhe në këtë rast gratë nuk u lejuan të arrijnë deri tek caku i përcaktuar – ato u ndaluan nga policia serbe. Teksa qëndronin para kordonit serb, ato filluan të thërrasin me zë "bukë për Drenicën". Më pas, brohoritja e tyre sa shkonte e bëhej më e zëshme, "Bukë për Drenicën!". Zërat e tyre u përforcuan dhe u shndërruan në një ushtimë të fuqishme. Ishin me mijëra gra të cilat ngrisnin zërin, protestonin dhe merrnin pjesë aktivisht në aktivitete për ndaljen e dhunës dhe shkeljes së të drejtave të grave dhe qytetarëve nga ushtria dhe policia serbe.

"Do të thosha se gratë përbënin pjesën më vitale të lëvizjes për pavarësi, e cila udhëhiqej nga LDK," rikujton dymbëdhjetë vite më vonë Edita Tahiri. Teksa qëndronim në zyrën e saj të re, ku ajo shërbente si Zëvendëskryeministre për Politikë të Jashtme dhe Siguri Kombëtare, ne dëgjonim me kujdes ndërsa ajo rikujtonte atë kohë. Në vitet e 90-ta, gratë kishin marrë pjesë aktive në rezistencën e shqiptarëve të Kosovës ndaj politikave shtypëse dhe diskriminuese të Serbisë, dhe si pjesëtare të rezistencës së armatosur të udhëhequr nga UÇK-ja. Gratë luanin rol kyç në organizatat ndëretnike për të drejtat e njeriut në Kosovë dhe Serbi të cilat bënin thirrje për ndërprerje të luftës, dhunimeve dhe vrasjeve.

"Gratë ishin pjesë e politikës, diplomacisë, negociatave dhe fushëbetejës," thotë Tahiri. "Duke marrë parasysh këtë rol të rëndësishëm për ... çlirimin e vendit nga okupimi serb, i cili zgjati pothuajse dhjetë vjet, normalisht pritej që pas luftës gratë të përkrahen për të marrë pjesë në politikë."

Kjo nuk ndodhi. Ashtu siç ndodh shpesh pas luftërave, gratë u shtyn nga qendra në margjina. Sirpa Rautio kishte vëzhguar këtë tranzicion me kalimin e kohës:

> Në kohën e vrasjeve të para në fillim të luftës unë isha në Drenicë, pasi që atëherë punoja për Zyrën e Komisionarit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut në Sarajevë dhe isha dërguar përkohësisht për t'u ndihmuar kolegëve në Serbi dhe Kosovë, pasi që situata e sigurisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut u përkeqësua. I tërë vendi gjendej nën një situatë të tensionuar, por ishin gratë e Kosovës që po udhëhiqnin të gjitha punët. Nuk më kujtohen burrat të kenë qenë të përfshirë fare në punën që kryhej ... të gjitha punët kryheshin nga gratë. Ato ishin të mrekullueshme. Ishte tronditëse për mua kur u ktheva pas dhjetë viteve të shihja se sa ishin margjinalizuar gratë. Në njëfarë mënyre, në vitin 1998 gratë ishin më të përfshira.[2]

Përjashtimi i grave nga politika dhe proceset e vendimmarrjes menjëherë pas luftës do të kishte implikime për pjesëmarrjen e grave në dekadat që pasuan, siç diskuton pjesa në vazhdim.[3]

"NE E PËRDORËM REZOLUTËN NGA DITA E PARË..."

"Këtu dihet shumë pak për këtë rezolutë. Ishte e panjohur madje edhe nga vetë personeli i UNMIK-ut. As specialistët e çështjeve gjinore të cilët punonin në UNMIK nuk e promovonin atë. Është humbje e madhe nëse një mision i tillë aq i rëndësishëm nuk angazhohet në promovimin e njërës nga rezolutat e veta."

- Luljeta Vuniqi, ish-drejtore ekzekutive, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, 2011

Më 30 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1244,[4] e cila së bashku me marrëveshjen ushtarako-teknike mes forcës ndërkombëtare të sigurisë (KFOR) dhe qeverive të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë,[5] mund të konsiderohen si 'marrëveshje e paqes'. Këto dy dokumente i dhanë fund dhe e transformuan 'dukshëm' një 'konflikt të dhunshëm' në mënyrë që ai 'të adresohej në mënyrë më konstruktive' sipas treguesve të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.[6] Rezoluta 1244 nuk ka zgjidhur konfliktin mes Kosovës dhe Serbisë, duke e lënë këtë çështje për tu diskutuar në faza të mëvonshme. Përmes saj u pezullua sovraniteti i Serbisë mbi Kosovën dhe autorizime të gjera i'u kaluan misionit të administrimit ndërkombëtar të udhëhequr nga OKB-ja, për të qeverisur ish krahinën autonome deri në zgjidhjen përfundimtare të statusit politik të saj. Edhe pse Rezoluta 1244 nuk përfshinte 'dispozita specifike për

përmirësimin e sigurisë dhe statusit të grave dhe vajzave',[7] gratë lidere u entuziazmuan për faktin se përkohësisht në Kosovë do të qeveris OKB-ja.

"Ne e përshëndetëm vendimin për vënien e Kosovës nën administrim të OKB-së me shumë ngazëllim," kujton Rogova. [8] "OKB-ja për ne paraqiste një organizatë ndërkombëtare me renome, e cila sajonte dhe miratonte dokumente të rëndësishme të cilat rregullonin të drejtat e grave dhe promovonin integrimin e tyre në të gjitha nivelet e vendimmarrjes." Aktivistet për të drejtat e grave dhe politikanet pritnin që të kenë ndikim më të theksuar në proceset vendimmarrëse pas hyrjes së OKB-së. Fundja, OKB-ja kishte miratuar dokumentet si Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe kishte miratuar Deklaratën dhe Platformën Vepruese nga Konferenca e Katërt Botërore e Grave në Pekin në vitin 1995.

"Për mua, fakti se në Kosovë po vinin ndërkombëtarët ishte shumë pozitiv," kujton Veprore Shehu, Drejtore e Medica Kosova:

> Kur erdhën ndërkombëtarët, mendova se ata nuk do t'u përmbaheshin qëndrimeve dhe stereotipeve shoqërore që ne këtu i kemi për gratë. Unë kisha shumë shpresa dhe pritja shumë më tepër. Kishte disa të arritura, por shpresat e mija u shuan, dhe pritjet e mia nuk u realizuan.[9]

"Nuk e di as vetë pse isha ngazëllyer aq shumë atëherë," thotë Rogova. "Që nga dita e parë UNMIK-u nuk pranoi të komunikojë me organizatat e grave. Ata as që donin të komunikonin me gratë. Struktura e tyre ishte tërësisht patriarkale. 'Ne erdhëm në një shoqëri patriarkale, për këtë arsye jemi të gjithë burra,' thoshin ata. Isha e shokuar nga opinionet e tyre."[10]

Shoqëria e Kosovës i ka traditat e saj, siç i ka çdo shoqëri tjetër. Sidoqoftë, nën ndikimin e modernizimit të Jugosllavisë socialiste të pas luftës së dytë botërore, gratë

kishin pozita në qeveri, industri, shëndetësi, arsim dhe kulturë. Gjatë regjimit të Millosheviqit, gratë vepruan si lidere në lëvizjen e rezistencës. Trajtimi homogjen i shoqërisë së Kosovës si një botë patriarkale për të pasur gra lidere, injoronte historinë tonë të lavdishme dhe paraqiste një qasje krejtësisht të gabuar.

Rogova kishte shumë përjetime me të cilat na dëshmonte se si prezenca ndërkombëtare nuk ishte e përgatitur për t'u përballë me realitetin e Kosovës së pasluftës:

> Kur u kthyem nga kampet ku kishim qëndruar si refugjatë, ne tërë kohën detyroheshim t'i shtyjmë gjërat përpara. Fillimisht u desh të përballemi me PSSP-në (Përfaqësuesin Special të Sekretarit të përgjithshëm) e UNMIK-ut, Bernard Kouchner, i cili gratë i trajtonte si objekte.
>
> Në tetor të vitit 1999, menjëherë pas luftës, erdhi Kofi Annan, Sekretar i Përgjithshëm i OKB-së. Kofi Annan kishte planifikuar një takim me shoqërinë civile. Por, e dini çka ndodhi? Në këtë takim nuk u ftua asnjë grua ngase UNMIK-u dhe OSBE i thanë se Kosovarët janë "shoqëri patriarkale."
>
> Për fat, ne kishim një aleate – Lesley Abdela. Para se të vinte në Kosovë, ajo kishte marrë shumë informata për lëvizjen e grave. Kësisoj, kur erdhi në OSBE, ajo shkoi në takim me Hans Christian, Drejtor i Departamentit të Demokratizimit.
>
> Lesley e pyeti: "Ku janë gratë?"
>
> Hansi u përgjigj: "Lëre tani, ke harruar se gjendemi në një shoqëri patriarkale?"
>
> Ajo i tha: "Unë e di se këtu ka organizata të grave."
>
> Kur e kuptoi se në vizitë do të vinte Kofi Annan, Lesley shkoi tek kreu i Misionit të OSBE-së, Daan Everts, dhe tek Kouchneri dhe i pyeti: "Përse nuk janë të ftuara gratë?"

Ata i thanë: "Ftesat janë dërguar më herët dhe nuk ka kohë për të bërë ndryshime."

Pas kësaj, Lesley i dërgoi Kofi Annanitn një faks: "I nderuar z. Annan, e di se ju kujdeseni për perspektivën gjinore dhe ja si është situata: në takimin tuaj me shoqërinë civile në Kosovë nuk është ftuar asnjë grua."

Ai i ktheu përgjigjen: "Dua që atje të takoj edhe gra."

Ajo u shkroi grave dhe u tha, "Secila prej jush ka nga një minutë në dispozicion. Mendoni mirë se çfarë do të thoni. Nga një minutë secila."

Atë ditë Kouchneri dhe Evertsi u shokuan kur panë se në derë kishin ardhur tri gra të guximshme – Sevdije Ahmeti, Vjosa Dobruna dhe unë.

Kouchneri foli i pari. Mendja nuk ua merr se sa gjatë foli. Kofi Annani po e shikonte atë. Zot, sa më pëlqeu ai shikim. Ai po i thoshte 'pusho' me sytë e tij. Atëherë, Kouchneri tha: "Tani Sekretari i Përgjithshëm do të thotë diçka."

Annani tha: "Jo, jo, jo. Nuk jam këtu për të folur. Jam këtu për të dëgjuar."

A mund të imagjinoni?

Burrave të Kosovës u ishte thënë se vetëm do t'i shtrëngojnë duart me Kofi Annanin dhe nuk ishin të informuar se kishin të drejtë të flasin. Annani tha: "Jam këtu për të dëgjuar. Kush dëshiron ta marr fjalën?"

Ne i ngritëm duart. Sevdije Ahmeti përmendi sigurinë e grave. Vjosa Dobruna foli për fuqizimin ekonomik të grave.

Më pas, unë parashtrova pyetjen, "Përse nuk ka gra në Këshillin Tranzitor i cili do të ndihmojë në qeverisjen e Kosovës deri në organizimin e zgjedhjeve?"

Annan tha: "Ju premtoj se brenda jo më larg se tri javë do të ketë gra në atë Këshill."

> Pas kësaj, burrat na përgëzuan. Ata na thanë: "Oh zot! Ju gratë jeni më të organizuara dhe të guximshme!"
>
> Por, a e dini se çfarë ndodhi më pas? Të nesërmen Lesley-n e larguan nga puna. Në fakt, nuk e përjashtuan zyrtarisht por vetëm "u largua."[11]

Kontrata e Lesley Abdela u shkëput për shkak se ajo e kishte shkelur protokollin, pasi që e kishte informuar Kofi Annanin se gratë nuk ishin të ftuara për t'u takuar me të.

Edhe pse ato ishin të frustruara nga dështimi fillestar i OKB-së për t'i përfshirë në Këshillin Tranzitor të Kosovës dhe nga disa vendime të tjera, aktivistet u inkurajuan nga miratimi i Rezolutës 1325 nga Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, më 31 tetor 2000. Kjo rezolutë sinjalizonte përkushtim ndërkombëtar për sigurimin e pjesëmarrjes së grave në proceset paqësore, si dhe në proceset më të gjera vendimmarrëse. Rogova vazhdoi:

> Kur OKB nënshkroi këtë rezolutë, një mike që kishim në Komisionin e Grave për Gratë dhe Fëmijët Refugjatë, Maha Muna, na dërgoi këtë informatë sepse ne i kishim treguar që më parë Komisionit të Grave se çfarë po ndodhte në Kosovë: se si ata po i injoronin gratë.
>
> Ajo na këshilloi: "Shfrytëzojeni atë."
>
> Kësisoj, ne filluam t'a përdornim Rezolutën që nga dita e parë. Ne po i shkruanim letra UNMIK-ut dhe OKB-së në Nju Jork, duke u thënë, "Ju duhet t'a implementoni Rezolutën."[12]

Ekziston një konsensus në rritje e sipër mbi rëndësinë e prezencës së grave në vendimmarrje në mes të organizatave rajonale në fushën e paqeruajtjes dhe parandalimit të konfliktit. Sipas Sekretarit të Përgjithshëm, pjesëmarrja e grave mund të mundësojë zhvillimin e diplomacisë preventive e cila merr

parasysh nevojat dhe çështjet specifike të grave dhe vajzave.[13] Çka janë organizatat rajonale? Ja shpjegimi i dhënë:

Karta e OKB-së qëllimisht nuk jep përkufizim të saktë të aranzhimeve dhe agjencive rajonale, duke ofruar kësisoj fleksibilitet të dobishëm për veprimet nga një grup shtetesh që duan të merren me një çështje të caktuar, e cila do të mund t'i kontribuojë paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.[14]

Në të gjitha organizatat kryesore rajonale të përfshira në parandalimin e konfliktit, përkatësisht BE, NATO dhe OSBE, përfaqësimi i grave ka mbetur i ulët, megjithëse me disa përmirësime në dekadën e fundit, veçanërisht në BE (shih Tabelën 1).

Tabela 1. Numri dhe përqindja e grave të punësuara në Organizata Rajonale që punojnë në parandalim të konflikteve

Organizata Rajonale	2011		2020	
	Gra	Burra	Gra	Burra
Parlamenti Evropian	259 35%	477 65%	278 39.5%	426 60.5%
President i Parlamentit Evropian (prej 1952)	2 7.4%	25 93.6%	2 6.9%	27 93.1%
Komisioni Evropian	**2010-2014**		**2019-2024**	
	9 33.3%	18 66.7%	12 46.2%	14 53.9%
Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s (prej 1988)	0 0%	12 100%	0 0%	12 100%
Përfaqësuesit e përhershëm të NATO-s	1 3.7%	26 97.3%	7 23.3%	23 76.7%
Sekretarët e Përgjithshëm të OSBE (prej 1993)	0 0%	5 100%	1 14.3%	6 85.7%

"Edhe sot ne shohim më shumë burra sesa gra [në BE]," theksoi Vetone Veliu, Drejtore Ekzekutive e Shoqatës së Grave për të Drejtat e Njeriut në Mitrovicë (MWAHR), që ka avokuar në Bruksel që kjo të ndryshojë, së bashku me aktiviste të tjera për të drejtat e grave nga rajoni.[15]

Dy gra kanë mbajtur pozitën e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë: Catherine Ashton dhe Federica Mogherini. Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se ato kanë avancuar dukshëm prioritetet dhe nevojat e grave të Kosovës. Në vitin 2013, RrGK i shkroi një letër Catherine Ashton duke i thënë se Rezoluta 1325 nuk u zbatua gjatë bisedimeve midis Kosovës dhe Serbisë dhe se organizatat për të drejtat e grave nuk ishin përfshirë.[16] Ajo u përgjigj, duke pranuar kontributet e grave në "normalizimin e marrëdhënieve në jetën e përditshme" dhe angazhimin e BE-së për të drejtat e grave.[17] Përtej deklaratave të tilla të gjera, është bërë pak përpjekje e dukshme për të zbatuar Rezolutën 1325 në bisedimet e ndërmjetësuara nga BE midis Kosovës dhe Serbisë. "[Këto dy gra] kurrë nuk e kanë përmendur përdhunimin si një krim që ka ndodhur gjatë luftës," theksoi Feride Rushiti.[18] Yllka Soba pohoi: "Ashton dhe Mogherini janë gra, por ato po e bëjnë punën e tyre pa asnjë qasje të ndjeshme gjinore. Mënyra se si ato e kanë trajtuar Dialogun nuk ndryshonte nga asnjë burrë", tha ajo.[19] Ndërsa agjenda e Dialogut u përcaktua nga qeveritë e Kosovës dhe Serbisë, që gjithashtu zgjodhën përfaqësuesit e tyre, disa pjesëmarrës në hulumtim u pajtuan se BE mund të kishte bërë më shumë për të "nxitur" këto qeveri për të përfshirë gratë, siç diskutohet më vonë.

Përderisa gratë i mbajnë disa pozita ekzekutive në organizatat rajonale, ne gjetëm fare pak dëshmi se ato i kanë adresuar çështjet që janë me rëndësi për gratë dhe vajzat në Kosovë, në lidhje me parandalimin e konfliktit. Një përjashtim që duhet të përmendet është rasti i Ulrike Lunacek, deputete austriake në parlamentin Evropian dhe raportuese për Kosovën nga viti 2009 deri në vitin 2017. Pothuajse gjatë secilës vizitë në Kosovë, ajo u takua me grupe të grave formalisht dhe jo formalisht, për t'i dëgjuar brengat e tyre. Ajo parashtroi para Parlamentit Evropian disa çështje që ngritën gratë e Kosovës. Pasardhësi i saj, Igor Soltes (2014-2018), thuhet se nuk u takua kurrë me gratë udhëheqëse të shoqërisë civile. Sidoqoftë, Viola von Cramon e cila e pasoi atë (nga viti 2019)

mori pishtarin, takoi gratë udhëheqëse për të dëgjuar dhe vepruar në lidhje me shqetësimet e tyre, duke siguruar mbështetjen e BE-së për rritjen e angazhimit të grave në politikë përmes dialogut politik me udhëheqësit e Kosovës.

Parlamentarë të tjerë të BE-së kanë konsultuar grupet e të drejtave të grave në Kosovë më shpesh sesa në dekadën e kaluar, përfshirë për çështjet që variojnë nga dhuna me bazë gjinore, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në financimin e jashtëm të BE-së, perspektiva gjinore në raportet e progresit të Kosovës dhe financimi për grupet për të drejtat e grave. Më 23 janar 2019, Parlamenti Evropian miratoi një Rezolutë mbi të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë disa rekomandime të bëra nga RrGK, midis grupeve të tjera të të drejtave të grave në rajon.[20] Zyrtarët e tryezës në Komisionin Evropian takohen rregullisht me aktivistet për të diskutuar se si të integrohet më mirë një perspektivë gjinore në raportin vjetor të progresit të Kosovës në lidhje me procesin e pranimit në BE dhe cilat çështje duhet të ngriten me homologët e qeverisë së Kosovës gjatë dialogut politik. Mekanizmi rajonal i BE-së për Shoqërinë Civile gjithashtu ka filluar caktimin e fondeve për programe që kërkojnë më tej barazinë gjinore, duke u konsultuar me organizatat për të drejtat e grave lidhur me çështjet të cilat kërkojnë prioritet. Këto marrëdhënie dhe përpjekje janë rritur me kalimin e kohës me mbështetjen e palëkundur të Fondacionit Kvinna till Kvinna[21], veçanërisht përmes javës së përvitshme për avokim në Bruksel përmes së cilës ka mbështetur aktiviste nga Kosova, në mesin e aktivisteve nga rajoni, për të avokuar tek BE-ja për të përmirësuar vëmendjen ndaj barazisë gjinore.

Kështu, BE është përmirësuar dukshëm në zbatimin e Rezolutës 1325 me kalimin e kohës. Rogova rikujtoi:

> BE-ja ka bërë një ndryshim të madh, por kjo ishte për shkak të avokimit të organizatave për të drejtat e grave dhe [kjo përfshin Fondacionin] Kvinna till Kvinna, ndër të tjera, që avokuan së bashku me ne për shumë vite. Unë kam qenë pjesë [e këtij grupi], veçanërisht në

> Bruksel, ku kemi ndarë të njëjtin mendim. Në një moment, unë thashë: "Jam e lodhur nga e gjithë kjo. Nuk dua të marr pjesë më". Sepse ata vetëm diskutonin, por nuk kishte veprime. Që atëherë, ky ndryshim i madh ndodhi. Nuk ishte një moment; ishte diçka e ndërtuar ngadalë. Dhe, brenda Brukselit, njerëzit që erdhën në pozita të larta besuan në këtë. Këtu, dua të përmend Charlotte Isaksson, e cila erdhi nga NATO për të punuar në BE. Ajo bëri një punë të mahnitshme brenda NATO-s për zbatimin e Rezolutës 1325. Para se të vinte në BE, ajo ishte duke trajnuar trupat e NATO-s dhe kjo është arsyeja pse NATO ka bërë kaq shumë përparim në zbatimin e Rezolutës 1325. Ajo filloi lëvizjen e Rezolutës 1325 brenda NATO-s. Pra, BE u bashkua me njerëz që e dinin [rëndësinë] e Rezolutës 1325.[22]

Ndërsa BE-ja mund të ketë qenë fillimisht "e ngadaltë" në zbatimin e Rezolutës 1325, siç pohoi një zyrtar i BE-së, që atëherë ka bërë një përpjekje të qartë, të bashkërenduar për t'u përmirësuar. Përpjekjet në dekadën e fundit kanë përfshirë miratimin e politikave të lartpërmendura në lidhje me Rezolutën 1325 dhe rritjen e burimeve njerëzore të specializuara, duke përfshirë Ambasadoren e Shërbimit të Jashtëm Evropian të Veprimit (EEAS) dhe Këshilltaren Kryesore Gjinore Mara Marinaki, Këshilltare Gjinore në Shërbimin Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS) Charlotte Isaksson, dhe ekipin e ekspertëve gjinor në EEAS që tani përfshinë edhe Lina Andeer e cila erdhi nga Kvinna till Kvinna dhe shërbeu në Kosovë (do ta kujtoni më vonë). Ato takohen rregullisht me aktivistet për të drejtat e grave nga Kosova dhe më gjerë, duke përfaqësuar interesat dhe prioritetet e tyre para udhëheqjes së BE-së dhe duke mbështetur përpjekjet e tyre.

Në këtë mënyrë, një kombinim i angazhimeve të politikës së brendshme, vullnetit të zgjeruar politik dhe kapaciteteve të përmirësuara të burimeve njerëzore së bashku me një shtytje nga aktivistet dhe organizatat e të drejtave të

grave duket se kanë kontribuar në përmirësime në zbatimin e Rezolutës 1325 në lidhje me pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje nga ana e BE-së.

Përmirësime të ngjashme mund të vërehen në organizatat e tjera rajonale të sigurisë. Në Vjenë, "Sekretariati i OSBE-së zhvilloi një Strategji të Barazisë Gjinore, ku ekziston një korpus i madh i standardeve dhe kërkesave minimale" në lidhje me zbatimin e Rezolutës 1325, na tha Këshilltarja Gjinore e OSBE-së Biljana Nastovska.[23]

NATO ka bërë disa hapa përpara në dekadën e fundit. Për herë të parë, në vitin 2012, NATO krijoi një pozitë specifike për promovimin dhe zbatimin e Rezolutës 1325: Përfaqësuesen Speciale për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, të përfaqësuar nga Diplomatja Norvegjeze Mari Skåre,[24] kujton Rogova:

> Ne gratë në botë nxitëm, jo vetëm një plan veprimi [për Rezolutën 1325], por thamë: "Ju duhet një zyrë e veçantë, një person i veçantë për të nxitur zbatimin e këtij plani", sepse komandanti i NATO-s nuk do të thotë, "Mirë, djema, po e zbatojmë Rezolutën 1325?". Kështu [NATO] themeloi këtë zyrë. Dhe ky libër, *1325 Fakte dhe Fabula*, ndryshoi Përfaqësuesen e parë Speciale [Mari Skåre]. … Mbaj mend që UNIFEM kishte organizuar të takohej… në zyrën e saj në Bruksel kur ishim atje për t'u takuar [me përfaqësues të] shumë institucioneve. [Anëtarët e tjerë të delegacionit tonë] po flisnin dhe flisnin… për Ligjin për Barazinë Gjinore, policinë në Kosovë, dhe kur erdhi radha ime,… Unë vërejta që kjo grua nuk e kishte idenë se çfarë po bënte atje… Thashë, "E dini çfarë? Unë nuk do të flas për asgjë sepse sapo erdhe në zyrë. Ju ende keni nevojë për kohë për të organizuar gjëra, prandaj sugjeroj që t'ju jap këtë libër dhe kur ta lexoni këtë, atëherë ne mund të komunikojmë. Sepse ajo që do të ndaja është një pjesë e vogël e asaj që është në këtë libër, kështu që kurdo që të keni kohë shfletoni". Vizita e saj e parë pasi ajo u bë Përfaqësuese Speciale për Rezolutën

> 1325 ishte në Kosovë. Ajo na tha: "Unë e lexova librin për dy orë dhe duhet të them, kjo ishte pasaporta ime për pozitën që mbaj. Kjo më tregon qartë se cila duhet të jetë puna ime si Përfaqësuese Speciale për Rezolutën 1325."[25]

Pas kësaj, Mari Skåre krijoi një grup këshillmor, pasi e kuptoi nga leximi i botimit të parë të *1325 Fakte dhe Fabula* që i duhej të dëgjonte rregullisht nga organizatat e të drejtave të grave. Ajo ftoi Rogovën dhe 14 aktiviste të tjera nga rajoni për t'u bashkuar me Panelin Këshilldhënës të Shoqërisë Civile. Në baza vullnetare, ato mbështetën NATO-n në zhvillimin e një plani të veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 në të gjithë botën, i cili është zbatuar, sipas Rogovës. "NATO me të vërtetë ndryshoi shpejt," tha ajo:

> Ata e kanë përdorur Kosovën si shembull, si në themelimin e këshilltarëve gjinorë dhe konsultimin me organizatat për të drejtat e grave. … Për mua, është një histori suksesi. Globalisht, Kosova u mor si shembull kur diskutohej për Rezolutën 1325, duke u njohtuar përmes botimit të librit *Fakte dhe Fabula*. Pranova shumë mesazhe që thonin: "Uau, tani di si të luftoj për të në vendin tim", pasi lexuan *Fakte dhe Fabula*. Pra, ky libër ndryshoi shumë gjëra.

"Misionet janë ende në masë të madhe punë burrash"

"Asnjëherë nuk ka pasur asnjë grua udhëheqëse të këtyre [organizatave ndërkombëtare]. Për 20 vjet, nuk ka pasur asnjë grua shefe të misionit të UNMIK-ut. Në Mitrovicë, janë vetëm një grup burrash përgjegjës. OSBE-ja ka një grup burrash. Është vetëm një grup burrash që flasin me burra dhe ata në të vërtetë nuk duan të dëgjojnë..."

- Tijana Simiq LaValley, Zensko Pravo, 2020

Rezoluta 1325 bën thirrje për "përfaqësim të shtuar dhe pjesëmarrje kuptimplotë të grave në misionet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe misionet e tjera ndërkombëtare që kanë të bëjnë me paqen dhe sigurinë."[26] Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së "numri i pozitave të larta në misionet e OKB-së në terren që mbahen nga gratë" mund të shërbejë si "masë e përafërt për nivelin e adresimit të nevojave dhe interesave të grave në nivelet e larta të vendimmarrjes". Me gjithë këtë udhëzim, gratë nuk janë punësuar në misionet ndërkombëtare në Kosovë sa burrat. Gjithashtu, gratë nuk kanë mbajtur proporcionalisht pozita të larta të vendimmarrjes sa burrat (shih tabelën 2).

Tabela 2. Gratë në pozita të larta në Misionet në Kosovë

Pozita	2011		2020	
	Gra	Burra	Gra	Burra
PSSP të UNMIK-ut	0 0%	9 100%	0 0%	10 100%
Shefa të OSBE-së	0 0%	5 100%	0 0%	8 100%

Pozita	2011		2020	
	Gra	Burra	Gra	Burra
Shefa të Misionit të BE-së në Kosovë[27]	0 0%	4 100%	1 14.3%	6 85.7%
Shefa të ICO (përfundoi më 2012)	0 0%	1 100%		
Komandantë të KFOR-it	0 0%	16 100%	0 0%	23 100%

"Në fakt ata nuk e zbatuan as vetë," tregon aktivistja Ariana Qosaj-Mustafa. "Ata kishin standarde të dyfishta. Tërë këto vite që kishim mision të OKB-së asnjëherë nuk pamë ndonjë grua të emërohet PSSP dhe ta udhëheqë misionin në Kosovë."[28] Nga dhjetë PSSP-të e emëruar, asnjë nuk ishte grua.

"Ata ishin tejet patriarkal dhe tradicional," shton Flora Macula, e cila përfaqësonte Fondin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë (UNIFEM), në vitin 2007. "Ju nuk mund të gjeni gra brenda strukturave të UNMIK-ut. Flas për pozita të rëndësishme. Kurrë në UNMIK nuk ka pasur ndonjë grua në pozitë të lartë, dhe si mund të promovoni diçka nëse fillimisht vetë nuk shërbeni si model për të?[29] "Sa i përket vetë UNMIK-ut, numri i grave në pozita vendimmarrëse është skajshmërisht i ulët," u pajtua ish-këshilltarja e UNMIK-ut për çështje gjinore Clare Hutchinson, "Ne nuk kemi gra në nivele të larta."[30]

Përkundër faktit se misioni i EULEX-it përkrah Rezolutën 1325, edhe ai fillimisht ka vepruar me indiferencë ndaj pjesëmarrjes së grave. Edhe pse Misioni i EULEX-it mbetet i përkushtuar në zbatimin e Rezolutës 1325 dhe ka ndërmarrë hapa të caktuar procedural për t'u takuar me gra dy herë në vit, për të integruar perspektivën gjinore në trajnimet dhe politikat e veta dhe për të raportuar për zbatimin e Rezolutës 1325,[31] po ky mision, siç tha Luljeta Vuniqi, është i "dominuar nga burrat".[32] Në korrik të vitit 2011, gratë mbanin përafërsisht 23 për qind të pozitave në mision.[33] Pjesa më e madhe e pozitave më të larta mbuloheshin nga ish-ushtarakë. Fakti që "misioni civil po udhëhiqet nga njerëz me prapavija ushtarake

është i pakuptimtë," u shpreh Vuniqi në atë kohë. Më 2011, një ish-zyrtar i BE-së që preferoi të mbetej anonim, tha:

> EULEX-i është paraparë të jetë mision civil dhe natyrisht disa punonjës janë më civilë se sa të tjerët. Por, në përgjithësi mendoj se misionet në pozita kyçe joshin shumë ish-ushtarakë, edhe atë jo vetëm në pozita brenda policisë por edhe në funksione të tjera. Konotacioni i sigurisë bën që i tërë ky mjedis të shndërrohet në mjedis mashkullor. Dhe ju e dini se si këta njerëz nuk kanë fare konsideratë për çështjet gjinore. Në të shumtën e rasteve këto çështje nuk i marrin me seriozitet.
>
> E sa i përket mënyrës se si është planifikuar ky mision; mendoj se të drejtat e njeriut dhe çështjet gjinore u kanë rënë ndër mend tek më vonë, madje edhe në ata komponentë në të cilët do të duhej të angazhohen ekspertë përkatës, siç është rasti i policisë ku vetëm një person nga 2,500 punonjës, është ekspert i dhunës në familje. Siç shihet, ky problem perceptohej si problem margjinal.
>
> Nuk kishte fare gra. Nuk kishte ekspertë për t'u marrë me këtë çështje dhe në përgjithësi mendoj se qasja ishte e tipit, "Me gratë nuk kemi punë." Madje edhe ata që ishin më të ndjeshëm në kuptim të çështjeve gjinore mendonin se këto çështje ishin punë për të tjerët, jo për EULEX-in, i cili kishte prioritete të tjera. Ata thoshin, "Është shumë me rëndësi, por Komisioni Evropian është duke u marrë me çështje tjera." Kështu, bëhej e qartë se nuk e kishin prioritet. ... Misionet ende mbeten punë burrash, përkundër përpjekjeve të shumta dhe Rezolutës 1325.

"Nga perspektiva ime, e cila kryesisht ngërthen vlerësimin e EULEX-it dhe akterëve të tjerë ndërkombëtarë, sfida kryesore mbetet margjinalizimi i grave sa i përket pjesëmarrjes në vendimmarrje" na tha Sirpa Rautio në vitin

2011, e cila dikur udhëhiqte Zyrën për të Drejtat e Njeriut dhe Çështje Gjinore në EULEX. "Unë prita më shumë nga BE."[34]

E gjithë kjo filloi të ndryshojë me emërimin e Alexandra Papadopoulou si Shefe e EULEX-it, nga 2016 deri në 2019. Ajo rregullisht konsultohej me gratë lidere në Kosovë dhe punonte për të adresuar çështjet e ndryshme që ato sollën përpara. Sipas Qosaj-Mustafa, Drejtuese e Bordit të RrGK-së në vitin 2020:

> Ish-Shefja e EULEX-it, Znj. Papadopoulou, ishte shumë e ndjeshme ndaj çështjeve gjinore, kështu që ajo konsultohej vazhdimisht me shoqërinë civile. Ajo takohej me ne rregullisht dhe ishte shumë e interesuar të mos dëgjonte vetëm perspektivat e zyrtarëve. [Deri ku] ishte e mundur, [ajo gjithashtu shtyu përpara] më shumë politika të ndjeshme gjinore... Për shembull, përdhunimi: kishim shumë raste të përdhunimit [gjatë luftës] në Kosovë, dhe mbaj mend kur po i kujtonim këto çështje dy vite më parë, veçanërisht në botimin e parë të *Fakte dhe Fabula*, [adresimi i përdhunimit] ishte organizuar shumë dobët. EULEX-i nuk kishte burime për këtë; [ai] në thelb nuk ishte i përgatitur në aspekt logjistik për t'a trajtuar atë. Nuk kishte ekspertizë për të trajtuar këto raste. Kur arriti ajo, ndryshoi shumë gjëra. Ajo mblodhi shumë burime. U përpoq të kishte ekspertë mjekësorë në forenzikë, njerëz të zbatimit të ligjit të specializuar në këto çështje, [dhe] pika qendrore gjinore brenda zbatimit të ligjit. Dhe ata arritën shumë rezultate.

Rogova u pajtua, duke folur me admirim për znj. Papadopoulou:

> EULEX-i kurrë nuk bëri asgjë derisa erdhi një grua e fortë në një pozitë të nivelit të lartë. Ishte hera e parë që një grua të drejtojë EULEX-in. Papadopoulou nuk ishte thjesht një grua; ajo ishte një grua që ishte

> aktive! Dhe na takonte rregullisht për të diskutuar shumë gjëra… çfarë mendojmë për Mitrovicën? Çfarë mendojmë për Dialogun [me Serbinë]? Çfarë mendojmë për negociatat? Ajo nuk ulej me mua duke më thënë: "Le të flasim vetëm për dhunën ndaj grave". Ky është dallimi. Pra, ajo nuk foli vetëm për "çështjet e grave" si kolegët e saj. Folëm për të gjitha temat që diskutoi me udhëheqës të tjerë sepse donte të dëgjonte perspektivat e organizatave për të drejtat e grave, jo vetëm të udhëheqësve. … Ajo u largua, dhe personi [i cili e zëvendësoi atë] ishte krejtësisht jashtë realitetit, ishte suedez!! Imagjinoni, personi i emëruar… nuk u kujdes kurrë që t'i takonte organizatat për të drejtat e grave për të diskutuar për çështje që nuk janë vetëm "çështje të grave".[35]

Znj. Papadopoulou vërtetoi se gra të forta dhe të përkushtuara në pozita udhëheqëse mund të shtyjnë përpara çështjen e barazisë gjinore. Numri i grave në pozita udhëheqëse brenda EULEX-it gjithashtu është rritur në mënyrë eksponenciale me kalimin e kohës, duke arritur në më shumë se 25 përqind që nga dhjetori 2020, edhe pse gratë brenda Misionit ishin të nën përfaqësuara.[36]

Ndërkohë, në anën tjetër të qytetit, në Zyrën e BE-së dhe Përfaqësuesit Special të BE-së (PSBE) në Kosovë, ka qenë vetëm një grua Ambasadore, Natalia Apostolova. Sidoqoftë, përqindja e grave në pozita të tjera udhëheqëse brenda misionit është rritur ndjeshëm me kalimin e kohës, kujton këshilltarja për çështje gjinore Charle Cuellar:

> Nëse e shihni numrin në zyrat tona, duke përfshirë faktin që kemi një Shefe Misioni që katër vjet, në Zyrën tonë të përbashkët të BE-së, ne kemi më shumë gra sesa burra… gjithashtu në pozita menaxheriale. Ne jemi duke e zbatuar Rezolutën.[37]

Aktivistet e të drejtave të grave veçuan një burrë ambasador shembullor, Ambasadori Samuel Zhbogar (2012-2017) i cili synoi të zbatonte Rezolutën 1325, duke u takuar rregullisht me aktiviste të të drejtave të grave dhe politikane, duke dëgjuar prioritetet e tyre dhe duke e përdorur rëndësinë e BE-së ashtu që zërat e tyre të dëgjohen. Ai u takua disa herë me organizata për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe lidere për të diskutuar çështje të ndryshme politike sesa pasardhësja e tij, ambasadorja Apostolova.

Misionet e tjera ndërkombëtare kanë bërë pak përparim në rritjen e përfaqësimit të grave në nivelet më të larta të vendimmarrjes, siç përmblodhi Qosaj-Mustafa:

> Ka qenë e vështirë të shtyhet përpara [pjesëmarrja e grave në] vendimmarrje brenda organizatave ndërkombëtare dhe organizatave shumëpalëshe… siç janë OSBE-ja, EULEX-i dhe organet dhe agjencitë e tjera të BE-së që punojnë në Kosovë. UNMIK-u kurrë nuk pati një përfaqësuese speciale. EULEX-i gjithashtu. U deshtën vite që znj. Pappadopulos të emërohej si kryesuese dhe mendoj se ishte për shkak të lidhjeve dhe marrëdhënieve të saj vërtet të jashtëzakonshme diplomatike që ajo arriti të fitonte atë pozitë. Para kësaj kemi pasur një zëvendese në EULEX. Kohët e fundit kishim Përfaqësuesen Speciale të BE-së Natalia Apostolova. [Por] përsëri, vjen një burrë. … Nëse shikoni në nivele të ndryshme, në vendimmarrje, veçanërisht në vendimmarrje, Rezoluta 1325 është padyshim ende larg asaj që është premtuar.[38]

Ekzistojnë disa pengesa drejt përfshirjes së grave në nivele të larta të misioneve ndërkombëtare. Varësia nga delegimi i grave nga shtetet anëtare dhe perceptimi i Kosovës si një vend ku nuk shkohet me familje, kanë kontribuar në përfaqësim të kufizuar të grave. Hutchinson thekson se në UNMIK "ne nuk kemi gra në nivelet më të larta ... për shkak të shteteve anëtare."[39] Shtetet anëtare të OKB-së janë të obliguara që të

rekrutojnë dhe delegojnë gra në misionet e OKB-së, por kjo rrallë herë është trajtuar si prioritet. Misionet kanë shumë pak kontroll mbi atë se kush delegohet në to.

Më 2011, EULEX-i ishte përballur me probleme të ngjashme. Megjithëse EULEX-i kishte politikat rekrutuese përkatëse për zvogëlimin e disbalancit gjinor brenda misionit, shtetet anëtare të BE-së bartnin përgjegjësinë për të deleguar gra apo burra në EULEX kur bëhej fjalë për staf dytësor. Si e tillë, në atë kohë EULEX-i nuk kishte shumë mundësi manovrimi në rastet kur për pozita të caktuara nuk nominoheshin gra."[40] Që atëherë, zyra e burimeve njerëzore të EULEX-it ka bërë disa përpjekje për të dhënë rekomandime dhe mbështetur parimin e barazisë gjinore gjatë procesit të rekrutimit, si bërja e përshkrimeve të punës më tërheqëse për gratë, duke prioritizuar intervistimin e grave të kualifikuara, dhe duke përfshirë më shumë gra në panelin e rekrutimit.[41] Ndërkohë, disa vendime lidhur me rekrutimin janë ende në duart e autoriteteve në Bruksel.

Gjithashtu, për shkak të joqëndrueshmërisë së situatës së sigurisë, misionet në terren kanë pasur tendencë të mos i lejojnë (apo të mos i financojnë në raste kur kjo ka qenë e aplikueshme) sjelljen e familjeve të punonjësve në Kosovë. Duke marrë parasysh faktin se grave zakonisht u vihet barra e kujdesit për familjet e tyre, gjë që konfirmohet nga të dhënat e grumbulluara nga të gjitha vendet, e bën edhe më të vështirë punën e tyre në misione. Është vështirë të tërhiqen në misione ndërkombëtare gra të cilat nuk mund të sjellin me vete edhe familjet e tyre.

Edhe pse e rëndësishme, pozicionimi i grave në pozita vendimmarrëse jo domosdoshmërisht është i mjaftueshëm për t'i kontribuuar barazisë gjinore në misione ndërkombëtare. Një temë tjetër që u përsërit mes pjesëmarrësve në hulumtim ishte rëndësia e punës së përbashkët të grave dhe burrave drejt arritjes së barazisë gjinore. "Nëse vërtetë duam t'a sjellim zbatimin e Rezolutës 1325 në tjetër nivel, duhet të punojmë së bashku me burrat," tha Këshilltarja për Çështje Gjinore në KFOR Elisabeth Schleicher. "Kështu që do të kishte kuptim të

kemi nje Ekip Gjinor të përbërë jo vetëm nga gratë por edhe nga burrat."

Sigurisht, shembulli i udhëheqësve burra, të tillë si Ambasadori Zhbogar, që takonte vazhdimisht gratë dhe ngriste çështje të barazisë gjinore u identifikuan si praktika më e mirë, e denjë për t'u marrë shembull. Kjo thjesht varet nga vullneti politik i njerëzve për t'i dhënë përparësi zbatimit të Rezolutës 1325 në punën e tyre të përditshme.

Këshilltarët gjinorë "zbarkojnë" në Kosovë

"Më pëlqen të mendoj se kemi arritur diçka. Patjetër që ne u bëmë më shumë si një lojtar. Ishte planifikuar të margjinalizoheshim. Unë mendoj se kemi arritur të dalim nga kjo, dhe të shkojmë në pikën e planifikimit strategjik, të kalojmë te proceset dhe, duke vepruar kështu, të marrim pak më shumë ndikim".

- Sirpa Rautio, Këshilltare Gjinore, 2011

"Shumë shpesh, ky është 'mision i pamundur'".

- Pikë qendrore gjinore e misionit, 2021

Prania e këshilltarëve për çështje gjinore në nivelet më të larta brenda misioneve do të mund të ndihmojë në marrjen parasysh të nevojave dhe interesave të grave në proceset vendimmarrëse.[42] Pas miratimit të Rezolutës 1325, organizatat ndërkombëtare filluan emërimin e këshilltarëve gjinorë, megjithëse në nivele të ndryshme të vendimmarrjes. Më shumë këshilltarë të tillë janë emëruar në dekadën e fundit.

"Zyra për Çështje Gjinore (OGA) ishte e para zyrë e llojit të vet në misionet e Departamentit për Operacione Paqeruajtëse (DPKO)," na tha Philippe Tissot nga UNMIK-u. "Ishte një lloj pilotprojekti i njësive këshillëdhënëse për çështje gjinore, të cilat sot ekzistojnë në shumicën e 15 misioneve të DPKO-së." OGA është krijuar në vitin 1999, "si njësi këshillëdhënëse politike për çështje gjinore."[43] Brenda UNMIK-ut, OGA ka ekzistuar deri në vitin 2008, ndërsa tani në këtë mision mbeten vetëm pikat qendrore për çështje gjinore.

Mandati i OGA-s përfshinte kanalizimin e çështjeve gjinore në Misionin e OKB-së në Kosovë, do të thotë, sigurimin se perspektivat gjinore dhe barazia gjinore do të përfshihen si elemente kyçe në të gjitha aktivitetet. Ajo kishte për detyrë koordinimin e përpjekjeve drejt arritjes së barazisë gjinore brenda UNMIK-ut dhe nga UNMIK-u; ofrimin e mundësive organizatave të grave për të pasur rol më të madh në vendimmarrje; promovimin e interesave të grave nga pakicat; dhe fuqizimin e kapaciteteve qeveritare për të trajtuar çështjet që kanë ndikim tek gratë. Në fakt, detyrat ishin të shumta. Në fillim të mandatit, zyra funksiononte si pjesë e shtyllës së administratës civile.

"Nuk mendoj se kemi qenë shumë aktiv, për shkak të natyrës së vetë zyrës," na tha Hutchinson në vitin 2007:

> Mendoj se kishte probleme që nga fillimi ... sa i përket udhëheqjes së zyrës. ... mendoj se PSSP i fundit [Holkeri] dhe PSSP i tanishëm [Jessen-Petersen] ishin shumë të hapur për përfshirjen e çështjeve gjinore në agjendat e tyre, por mendoj se para tyre nuk ka pasur ndonjë lëvizje në këtë drejtim që është përkrahur. ... mendoj se vetë ideja e vendosjes së kësaj zyre në shtyllën e dytë, atë të administratës civile, dhe jo në zyrën e PSSP-së tregon diçka. Do të jem shumë e sinqertë, e vetmja arsye e kësaj [lëvizjeje] ishte sepse udhëheqësja e fundit e zyrës, Maddalena [Pizzoti], kërkonte me ngulm vendosjen në zyrën e PSSP-së. Por, ajo kishte të drejtë, sepse zyra do të duhej të gjendej në zyrën e PSSP-së. Ne nuk ishim këshilltarë të administratës civile. Ne ishim këshilltarë për misionin, dhe u zhvendosëm ... si rrjedhojë e përkushtimit të PSSP-së së fundit.[44]

Kur PSSP Søren Jessen-Peterson mori postin, Vuniqi deklaroi se "ai vërtetë e përkrahi atë dhe i dha autoritetin përkatës për ta kryer punën, gjë që nuk kishte ndodhur më herët. Më parë, ajo ishte një zyre e margjinalizuara pa kurrfarë kompetence. Ishte

në pozitë mjaft të ulët në strukturën e OKB-së. Ai e solli zyrën në nivelin më të lartë."[45]

Kritikët kanë vërejtur se vetë krijimi i postit të këshilltarëve për çështje gjinore nuk shpie domosdoshmërisht tek përmirësimi i çështjeve të barazisë gjinore apo promovimi i interesave dhe nevojave të grave. "Unë mendoj se ata duan të tregojnë se kanë parasysh çështjet gjinore dhe për këtë arsye krijojnë pozitën e quajtur 'Këshilltare për Çështje Gjinore', thotë Rogova.[46] "Unë mendoj se është e turpshme," deklaron Hutchinson në vitin 2007:

> Mua më ngjan si listë kontrolluese: "OK, kemi një grua. Shënjoje kutinë përkatëse. E kryem punën sa i përket çështjeve gjinore." Ose "Ne thjesht do të themi se i kemi integruar çështjet gjinore." OSBE nuk ka ndonjë person që merret enkas me çështjet gjinore, 'por është në rregull pasi që ata i kanë integruar çështjet gjinore në veprimtarinë e tyre. Shënjoje kutinë përkatëse." Kjo thjesht është thjeshtë e papranueshme.
>
> Mendoj se kemi të bëjmë me mungesë të kuptuarit, sepse vetëm pse e hapni një program dhe e vendosni brenda tij një grua, nuk do të thotë se jeni duke bërë diçka për çështjet gjinore. Kjo do të thotë se e keni përmirësuar pak baraspeshën gjinore brenda programit tuaj.

Zyrtarët mundoheshin që t'i ndanin çështjet, duke e konsideruar gjinine si pjesë të ndarë. Përfshirja dhe aplikimi i gjinise në të gjitha fushat e punës së misionit përfshinë kuptimin thelbësor e integrimit gjinor.

"Do të jem shumë e sinqertë," thotë Hutchinson, duke u munduar që të na shpjegojë se sa të vështirë e kishte që t'i bindë kolegët e saj se barazia gjinore duhet të përfshihet në të gjitha aspektet e punës së UNMIK-ut:

> Pakicat janë pakica dhe ne [si eksperte gjinore] shpesh jemi përjashtuar nga çështjet që kanë të bëjnë me

pakicat. E njëjta ndodhte me grupet punuese për ekonomi. ... Unë nuk jam ekonomiste, por do të isha tejet e interesuar në aspektin ekonomik të çdo gjëje, dhe gjithnjë kam kërkuar të jem në grupet punuese për standardet e ekonomisë.

"Oh, jo! Ne fillimisht duhet ta rregullojmë ekonominë e më pastaj do të flasim për çështjet gjinore."

E njëjta ndodhte edhe për të tjerat, "Fillimisht do të rregullojmë çështjen e refugjatëve, pakicave, personave të zhvendosur...më pastaj ju mund të më flisni për aspektin gjinor."

"A nuk ka nevojë që të dëgjohet zëri i 52 për qind të këtij populli?" pyesja unë. Pra, jemi duke punuar në këtë drejtim por sigurisht se ka pengesa.

Përkundër mandatit që kishte sipas Rezolutës 1325 për të përfshirë gratë në proceset vendimmarrëse, "në mënyrë që t'i paraqesin brengat e tyre dhe t'i artikulojnë propozimet për autoritetet më të larta të OKB-së,"[47] Zyra për Çështje Gjinore (OGA) e UNMIK-ut gjithashtu shpesh është përplasur me aktivistët. "Ne kemi pasur një marrëdhënie shumë të lëkundshme," pranoi Hutchinson. Siç tha Vuniqi në vitin 2007 "Zyra OGA ishte me të vërtet përvoja më e hidhur":

Ajo duhej të ishte zëri ynë. Ajo do të duhej të ishte partneri jonë, por kjo nuk ndodhi kurrë. E dinim se kohë pas kohe ata do të përzgjidhnin ndonjë organizatë për të punuar me të, por ky nuk ishte roli që ata do duhej ta luajnë. Kur e dini se çfarë roli kanë pasur dhe çka në fakt kanë bërë, ju mund ta kuptoni se sa të vogla dhe problematike ishin këto gjëra. ...

Nuk e di se si kanë arritur të mbajnë ata persona asisoj. Tërë kohën ata ndërroheshin dhe vinin njerëz me diapazon të ngushtë, me paragjykime, pa njohuri mbi vendin apo situatën në terren dhe pa vullnet për të kuptuar. Ata vinin dhe shkonin kurrë pa

> prekur në tokë. Kurrë pa qenë në Kosovë me mendjet dhe këmbët e tyre, më kuptoni? Ndonjëherë ndodhte të ndërroheshin brenda gjashtë muajsh.[48]

Në vitin 2011, "gratë të cilat e udhëhiqnin procesin [atje] nuk kishin ide se çfarë janë çështjet gjinore," tregon Arjeta Rexhaj, këshilltare politike e Edita Tahirit. "Nganjëherë ne fitonim bindjen se ata thjesht donin të vazhdonin punën e tyre në Kosovë për të marrë paga të majme dhe nuk ishin të interesuar për të biseduar për problemet tona. Rezoluta nuk po zbatohej madje as nga ata që e kishin përpiluar atë."[49]

Në vitin 2008, UNMIK-u iu nënshtrua një rikonfigurimi në të cilin OGA pushoi së ekzistuari, duke u zëvendësuar nga një Pikë Qendrore Gjinore.[50] Që nga ajo kohë, UNMIK-u raportoi se kishte ndryshuar rrënjësisht mënyrën e integrimit gjinor. Siç shpjegoi Javiera Thais Santa Cruz, Këshilltarja Gjinore e UNMIK-ut në vitin 2020:

> Para prezantimit të një strategjie specifike të UNMIK-ut, misioni udhëhiqej dhe zbatonte një politikë të përgjithshme të zyrave kryesore të OKB-së … Strategjia e parë [Kornizë] Gjinore e UNMIK-ut u zhvillua në vitin 2018 dhe ishte një moment i rëndësishëm në atë që ishte një strategji specifike e Kosovës për misionin. Strategjia [Kornizë Gjinore] ...mbikëqyret nga Task Forca Gjinore e UNMIK-ut, e cila kryesohet nga PSSP-ja, [dhe kjo] ka demonstruar se udhëheqja e përkushtuar është thelbësore në avancimin e Agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë.
>
> Ndër prioritetet strategjike të Strategjisë 2020-2021 janë pjesëmarrja përmbajtësore e grave në paqe dhe procese politike; adresimi i pengesave në qasjen e barabartë të grave në drejtësi; forcimi i përpjekjeve institucionale dhe shoqërore për të adresuar dhunën seksuale dhe me bazë gjinore; mbështetja e grave sipërmarrëse; shtrirja dhe bashkëpunimi me grupet e grave dhe partnerët; dhe integrimin sistematik të

analizës gjinore në sistemet e planifikimit, programimit dhe raportimit të UNMIK-ut. Ne kemi një linjë të veçantë buxhetore për aktivitete programatike me një fokus specifik për gratë, paqen dhe sigurinë dhe të gjitha projektet e tjera janë rishikuar nga Këshilltarja Gjinore për të siguruar që gjinia të përfshihet në tërësi.[51]

UNMIK gjithashtu krijoi një Plan të Zbatimit për Barazinë Gjinore në vitin 2018. Ndërsa pozita e lartë e PSSP-së së UNMIK-ut është mbajtur vazhdimisht nga burrat, deri në fund të shkurtit 2021, 41 përqind e personelit të misionit ishin gra. Mes stafit ndërkombëtar, i cili ka përqindjen më të madhe të rotacionit, gratë përbënin 45 përqind. Numër i barabartë i grave dhe burrave marrin pjesë në takimet e larta menaxhuese, përfshirë këtu Pikën Qendrore për Gratë, e cila ndihmon në rekrutimin e më shumë grave për të arritur barazi gjinore.[52] Në vitin 2019, PSSP i UNMIK-ut Zahir Tanin u krenua me faktin se gratë mbanin 40 përqind të pozitave drejtuese të misionit.[53] Me të drejtë, që kur ai arriti në mision si PSSP në vitin 2015, "ka pasur 119 rekrutime, 55 përqind e të cilave kanë qenë gra", tha Thais Santa Cruz.[54]

UNMIK ka zhvilluar trajnime dhe informime të detyrueshme për të gjithë stafin. Këto mbulojnë tema, të tilla si parandalimi i shfrytëzimit seksual dhe abuzimit; parandalimi i ngacmimeve dhe abuzimeve seksuale për personelin e OKB-së; dhe kurse hyrëse për stafin e OKB-së. Stafi merr pjesë në një mbledhje të detyrueshme për sjelljen dhe disiplinën, si dhe një mbledhje sigurie që përfshin çështje specifike gjinore.[55] Trajnimi jo i detyrueshëm për të gjithë stafin përfshin tema të tilla si integrimi gjinor dhe mbrojtja e përgjegjshme gjinore e civilëve.

UNMIK-u ka një prani veçanërisht të fortë në veri të Kosovës, ku, megjithë përmirësimet në ndërtimin e paqes,[56] rajoni mbetet i tronditur nga konflikti dhe përpjekjet për të promovuar paqen mbeten veçanërisht të rëndësishme. Me njerëz të grupeve të ndryshme etnike atje, akoma të

zhvendosur nga shtëpitë e tyre, me strukturat paralele të mbetura dhe duke përjetuar incidente të dhunës së përditshme, pak gra ndihen të qeta ose të sigurta.[57] Në këtë kontekst, aktivistja serbe për të drejtat e grave Tijana Simiq LaValley tha se UNMIK-u nuk ka arritur të përmbushë përgjegjësinë e vet për të dëgjuar në mënyrë adekuate nevojat e grave:

> Dhjetë vitet e para kishte me të vërtetë pak bisedime rreth [Rezolutës 1325]; ajo kishte mbetur në sirtar. 10 vitet e fundit kanë qenë vetëm ndërgjegjësim [në lidhje me Rezolutën]. Ne e shënojmë Rezolutën çdo vit me konferenca, etj. ... [Më kujtohet në maj të vitit 2019] ne po flisnim për viktimat e dhunës së bazuar në gjini, dhe ishte një person [Miroslav Jenča, Ndihmës Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së për Evropën, Azinë Qendrore dhe Amerikën] që duhej të takonim dhe ai u vonua. Ai arriti me tre burra të tjerë dhe u ulë në këtë tryezë të rrumbullakët. Ishte vetëm një grua, një Këshilltare Gjinore. Ndërsa ne gratë flisnim, burrat dukeshin sikur po thonin: "Le ta mbarojmë këtë dhe le të kthehemi në shtëpi". Ata më shikuan, ndoshta duke pritur që unë të flisja për çështje etnike. Gjithçka vetëm shpërtheu nga unë. Unë vetëm u kërkova atyre të provonin të zbatonin Rezolutën 1325 dhe CEDAW brenda UNMIK-ut. Ka shumë pak gra në misionin e UNMIK-ut në Mitrovicën Veriore; ato janë shumë të paarritshme dhe nuk dëgjojnë. Ne jemi të parëndësishme për ta.[58]

Kështu, në mesin e disa përmirësimeve brenda UNMIK-ut, disa aktiviste për të drejtat e grave ende mendonin se misioni nuk i dëgjonte nga afër nevojat e tyre.

Para shumë viteve, kur aktivistet dëgjuan se një Mision i ri Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) do ta zëvendësonte UNMIK-un, ato me ngut filluan t'i dokumentojnë mangësitë e mëhershme të UNMIK-ut dhe të inkurajojnë misionin e ri të

EULEX-it që të mos i përsërisnin gabimet e UNMIK-ut. Zyra për të Drejta të Njeriut dhe Çështje Gjinore (HRGO) ishte krijuar "si zyrë këshillëdhënëse dhe politike e cila ka funksion kryesisht parandalues, këshillues dhe koordinues në sigurimin e zhvillimit të të gjitha aktiviteteve të EULEX-it në Kosovë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe kanalizimit të çështjeve gjinore." Që nga hapja e këtij misioni në vitin 2008, kjo zyre ka punësuar dy ekspertë ndërkombëtarë për çështje gjinore dhe një ekspert vendor për çështje gjinore.[59]

Përkundër kësaj, në vitin 2011 ekzistonte një mendim i përgjithshëm se çështjet gjinore në EULEX "ishin planifikuar të margjinalizoheshin". Kur e pyetëm në vitin 2007 se çfarë mekanizmash kishte paraparë BE-ja nga selia e vet në Bruksel për të zbatuar Rezolutën 1325, Clare Hutchinson deklaroi:

> Mua më është thënë se [njerëzit në Bruksel] nuk e shohin të rëndësishme punësimin e dikujt për të këshilluar për çështjet gjinore, pasi që nuk do të kishte mjaft punë për një pozitë të tillë. ... Kështu që unë nuk besoj se në nivelet më të larta kjo çështje kuptohet si duhet. Mendoj se ata do të merren me termin "Rezoluta 1325" dhe do ta trajtojnë atë përmes "integrimit të çështjeve gjinore," "baraspeshës gjinore," etj. por ata nuk e kuptojnë si duhet se çfarë do të thotë ajo.
>
> Unë gjithashtu u thashë, "Nëse do të përdorni Rezolutën 1325, duhet të kuptoni se nga ju do të kërkohet përgjegjësi edhe për zbatimin e saj. Sepse ju nuk mund ta shfrytëzoni atë thjesht si term. Nga ju do të kërkohet të tregoni se në çfarë niveli po bëni zbatimin, dhe nëse ju në fakt ... do të tregoni përkushtim ndaj çështjeve gjinore. Nuk mund të thuhet se ka përkushtim nëse nuk e zbatoni atë, kështu që ju duhet të jeni të kujdesshëm dhe të kuptoni se çka dëshironi të bëni në këtë drejtim. Sepse, sa më përket mua, krijimi i një njësie për çështje gjinore, kafshë

> shtëpiake, ëmbëlsira apo ku ta di unë për çka, nuk dëshmon përkushtim ndaj Rezolutës 1325 apo ndaj sigurimit të një roli adekuat për gratë në Kosovë në të ardhmen."

Sa i përket zbatimit të Rezolutës 1325, EULEX-i në fillim nuk u tregua shumë më i mirë se UNMIK-u, gjë që ilustrohet me faktin se gratë nuk ishin mjaft të përfaqësuara dhe me kujdes të pamjaftueshëm kushtuar sigurisë së grave, gjë që përshkruhet në kapitujt vijues. Por më pas, disa zhvillime ndodhën brenda BE-së në Bruksel, siç u shpjegua më parë, duke filluar nga strategjitë deri te burimet strategjike.

Në vitin 2012, pozita e Këshilltares Gjinore u institucionalizua si pozitë e nivelit të lartë brenda EULEX-it, duke raportuar drejtpërdrejt te Shefi i Zyrës së Misionit. Kjo i ka mundësuar Këshilltares Gjinore të ofrojë këshilla strategjike dhe operacionale, veçanërisht për integrimin gjinor dhe koordinimin e "të gjitha veprimeve të brendshme dhe të jashtme të Misionit në lidhje me integrimin gjinor, promovimin e barazisë gjinore, si dhe zbatimin e Agjendës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë".[60] Chiara Tagliani, Këshilltare Gjinore në EULEX, shpjegoi rolin e saj:

> Këshilltarja [gjinore] ofron të dhëna për dokumentet dhe raportet e misionit, legjislacionin përkatës dhe mbështet mekanizmat e zbatimit në lidhje me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave në fushën e Sundimit të Ligjit. Për më tepër, Këshilltarja kryen kërkime dhe analiza, harton dhe ofron trajnime gjinore, dhe ndërlidhet me institucionet e Kosovës, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare. Këshilltarja Gjinore ndërlidhet rregullisht me të gjithë homologët përkatës dhe përfaqëson Misionin në tryezën e Grupit të Sigurisë dhe Gjinisë [të koordinuar nga Gratë e OKB-së] (GSGJ). Së bashku me këta homologë, Këshilltarja Gjinore identifikon fushat ku Misioni sjell vlerën e tij të shtuar ose me ndërhyrje të

drejtpërdrejtë ose përmes mbështetjes dhe ndihmës. Shembuj të kësaj janë fushatat e shumta për rritjen e ndërgjegjësimit (Shprehja me kohë, barazinë gjinore, luftën kundër dhunës me bazë gjinore) të implementuara nga Misioni në koordinim me homologët e tij (Instituti për Mjekësi Ligjore, RrGK, OJQ për të Drejtat e Grave), nënshkrimi i disa deklaratave të lëshuara nga GSGJ, si dhe trajnimet e shumta për ndërtimin e kapaciteteve të ofruara, i fundit prej të cilëve u përqëndrua në përgjigjen e parë ndaj dhunës në familje dhe zbatimin e disa projekteve afatgjata, sikur ai në mbështetje të Shoqatës së Grave në Shërbime Korrektuese.[61]

Tagliani gjithashtu shpjegoi se që nga viti 2015, EULEX-i ka krijuar "një rrjet të Pikës Qendrore Gjinore të përbërë nga anëtarë të stafit nga njësi dhe zyra të ndryshme të misionit, të caktuar për të ndihmuar Këshilltaren Gjinore në lehtësimin e integrimit gjinor dhe integrimin e perspektivës gjinore në punën e zyrave të tyre përkatëse."[62]

Në nëntor të vitit 2020, BE filloi Planin e Veprimit Gjinor III, "një agjendë ambicioze për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në shërbimin e veprimit të jashtëm të BE-së".[63] Sipas këtij plani të ri, si një mision i CSDP-së, EULEX-i dhe Zyra e BE-së do të duhet të zhvillojnë një plan zbatimi në nivel vendi dhe do të ketë mekanizma konsultues me aktivistet e grave dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të).[64]

Ndërkohë, PSBE në Kosovë u bë një nga misionet e para të jo-Politikës Evropiane të Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së në të gjithë botën në të cilën u krijua një pozitë me orar të plotë e Këshilltares Gjinore në vitin 2018. Emërimi erdhi pas viteve të lobimit nga aktivistet e të drejtave të grave së bashku me një shtytje të brendshme nga Pikat Kryesore Gjinore të BE-së dhe anëtarët e stafit të nivelit të lartë, në lidhje me nevojën për një pozitë të tillë. Sipas Këshilltares Gjinore të BE-së, Reyes Charle Cuellar, "[Fakti] i thjeshtë që ka një këshilltare gjinore në PSBE, tregon se BE-ja

në Kosovë është e shqetësuar për çështjet gjinore". Ajo reflektoi:

> Ka gjithnjë e më shumë njerëz [që punojnë në BE] që janë të vetëdijshëm se cfarë përfshinë barazia gjinore dhe gjithashtu rreth instrumenteve të ndryshme të BE-së për të zbatuar barazinë gjinore. Vetëdijesimi specifik rreth Rezolutës 1325 ndryshon. Megjithatë, shumë nga programet, projektet, dhe mundësitë e dialogut politik synuan hapjen e mendjeve të të gjithëve dhe ndikimin e qeverisë rreth rëndësisë së pranisë së grave. Numrat nuk mjaftojnë, por prania e grave është në thelb të Rezolutës si një minimum i domosdoshëm. Në vitin 2018, ngjarja e parë të cilën ndihmova të organizohej si Këshilltare Gjinore, ishte lansimi i *Analizës Gjinore të Kosovës*, e ndërmarrë nga RrGK dhe e financuar nga BE-ja. I ftuar ishte kryeministri i sapozgjedhur. Ishte dëshpëruese të shoh se si ai duhej t'i shpjegonte një dhome plot me gra të fuqishme dhe kompetente se ai kishte emëruar vetëm një numër të vogël të grave midis më shumë se 100 posteve të ministrave dhe zëvendëskryeministrave në qeverinë e tij. Sot situata është shumë ndryshe. Tashmë ka zëra që kërkojnë rezultate të mira zgjedhore dhe që gratë të pasqyrohen në përbërjen e qeverisë së re. Gjatë kohës që unë kam qenë Këshilltare Gjinore, ne jemi përpjekur të përfshijmë vëmendjen ndaj barazisë gjinore dhe rëndësisë së perspektivës dhe zërave të grave në pikat e takimeve në mes të Shefit të Misionit me zyrtarët qeveritarë. Ne duam të mendojmë se me shembullin dhe pjesëmarrjen e BE-së në veprime dhe aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me përfaqësimin gjinor në qeveri, ne kemi dhënë kontributin tonë modest.[65]

Ajo gjithashtu vuri re se mekanizmi i rishikimit ligjor të BE-së ka kontribuar në pasqyrimin e një perspektive gjinore brenda disa ligjeve dhe politikave, përfshirë Kodin Penal të

Kosovës, Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Ligjin e Punës, të gjitha bazuar në konsultime me aktivistë të të drejtave të grave dhe ekspertë të barazisë gjinore në Kosovë.

Pozita e Këshilltares Gjinore me orar të plotë i ka mundësuar BE-së të takohet më shumë me gratë në Kosovë në mënyrë që të kuptojë dhe adresojë më mirë nevojat e tyre. Për dymbëdhjetë muaj rresht BE-ja organizoi "Bisedat Gjinore", një seri të diskutimeve që përfshiu deri në 500 gra dhe burra në diskutime rreth barazisë gjinore, në lidhje me tema të ndryshme, si zgjedhjet, personat me aftësi të kufizuara, liria e shprehjes, politika dhe shëndetësia. Dita e Hapur Globale e organizuar së bashku me OKB-në në vitin 2019, u fokusua në implementimin e rezolutës 1325. PSBE-ja gjithashtu kishte programe për të fuqizuar angazhimin e grave në jetën politike dhe publike. Projekti i PSBE-së "Gratë në politikë. Guxim, Ndikim dhe Lidership Efektiv, duke siguruar dialog politik të përgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës gjinor" lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e Rezolutës 1325, pasiqë synoi avancimin e përfaqësimit të grave të Kosovës në politikë, vendimmarrje dhe negociata ndërkombëtare. Këshilltarja Gjinore angazhohet rregullisht në përgatitjen e pikave të takimeve dhe integrimin gjinor në politika dhe ligje, dhe kontribuon drejt sigurimit të një perspektive gjinore në të gjithë politikën, programet dhe politikat e BE-së.

Ndërkohë, Zyra e BE-së në Kosovë gjithashtu ka një Pikë Qendrore Gjinore në Seksionin e saj të Bashkëpunimit që nga viti 2015 dhe ka kontraktuar ekspertizë të jashtme nga RrGK për të mbështetur integrimin gjinor të të gjithë financimeve të saj të jashtme. Kjo ka pasur vlerën e shtuar të institucionalizimit të angazhimit të organizatave për të drejtat e grave në të gjithë planifikimin dhe programimin e BE-së, duke siguruar që ajo të konsiderojë një perspektivë gjinore që adreson nevojat e grave dhe vajzave. Duke filluar nga viti 2017, BE gjithashtu bëri të domosdoshëm trajnimin hyrës gjinor për të gjithë stafin dhe vuri në dispozicion këshillimin e përshtatur, të ofruar nga RrGK si një organizatë me përvojë për të drejtat e grave.

Historikisht, OSBE-ja, e cila ishte e ngarkuar me demokratizimin e vendit, këshilltarët për çështje gjinore u zëvendësuan me pika qendrore për çështje gjinore. Ariana Qosaj-Mustafa, e cila më parë kishte punuar për OSBE, na tha, "Pikat qendrore për çështje gjinore ishin individë që këtë shërbim e kryenin si punë shtesë, sepse kishin dijeni paksa më të mirë për të drejtat e grave."[66] Vetë natyra e punës shtesë, përkrah përgjegjësive të tjera, në momente të caktuara u shkaktonte kokëçarje. Pikat qendrore për çështje gjinore nuk kishin ndikimin që ushtronin këshilltarët që ishin me pozita të larta. "Unë kisha ndikim," na tha Theodora Krumova, ish-pikë qendrore për çështje gjinore në OSBE. "Por në të njëjtën kohë, kjo pozitë ma qartësoi se sa pak mund të bëj nga pozita ime, pozitë kjo e nivelit të mesëm."[67]

"Nëse nuk keni pozitë të lartë dhe nëse nuk jeni të përfshirë në nivelet më larta, atëherë nuk mund të fitoni shumë," tha Qosaj-Mustafa në vitin 2011:

> Pikat qendrore për çështje gjinore mbulojnë një sërë çështjesh dhe veprimtarish të ndryshme. Në mesin e vitit 2009, ata u munduan që ta trajtojnë këtë çështje duke emëruar zëvendësshefin e Misionit si pikë qendrore të tërë misionit për çështje gjinore. Zëvendësshefit të Misionit thjesht iu shtua edhe kjo detyrë, por në këtë rast kemi të bëjmë me diplomatë dhe me individë me përgatitje të ndryshme arsimore, kështu që ata nuk kanë shumë ekspertizë në çështjet gjinore. Besoj se rishtas e kanë ndryshuar këtë sistem dhe tani në fakt kanë një person tjetër që këshillon Zëvendësshefin e Misionit për çështjet gjinore. Megjithatë, prapë kemi të bëjmë me një kapacitet këshillimor dhe jo me ndonjë strategji të menaxhmentit për të siguruar buxhete të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore apo kanalizim të çështjeve gjinore. Në Vjenë ata e kanë një këshilltar të lartë për çështje gjinore, por me resurse tejet të limituara. Ata nuk mund të punojnë dhe të këshillojnë individualisht secilin mision

sepse edhe vetë kanë shumë çështje dhe aktivitete për të organizuar.

[Gjithashtu, në nivel të misionit] njerëzit nuk dinë si të punojnë. Nuk është se trajnohen edhe aq mirë gjatë trajnimit fillestar në Vjenë. Në fakt, e tëra që atje u mësohet përfshihet në një seancë prej 20 apo 30 minutash në të cilat mësojnë se si të dallojnë gjininë nga problematika gjinore; ata nuk mësojnë se përmes çfarë mjetesh bëhet kanalizimi i çështjeve gjinore.

Kjo është arsyeja përse "nevojiten këshilltarë për çështje gjinore në nivel të menaxhmentit të lartë dhe zyrtarë për programe gjinore, dhe jo vetëm pika qendrore për çështje gjinore," theksoi Këshilltarja e Lartë për Çështje Gjinore në UNDP Jocelyne Talbot në vitin 2011. "Ne duhet të kemi pozita të tilla në nivele të ndryshme. Kështu punohet – me pozita të përhershme." [68] Talbot theksoi rëndësinë e vendosjes së këshilltarëve të lartë për çështje gjinore në nivelin më të lartë, ku ata do të kenë mandat dhe mundësi që në tërë institucionin ta instalojnë një perspektivë gjinore.

Që nga viti 2011, OSBE ka ndërmarrë hapa për të adresuar këto çështje. Ata kanë krijuar nje pikë qendrore gjinore në pozitë më të lartë vendimmarrëse të misionit, që është Zëvendës Shefi i Misionit, dhe kanë emëruar këshilltarë dhe zyrtarë gjinorë për të mbështetur integrimin gjinor në Mision dhe për të monitoruar progresin.[69] Misioni organizon trajnime të vazhdueshme bazë dhe të avancuara për barazinë gjinore për pikat qendrore dhe punonjësit e tjerë. Për shembull, në vitin 2020 Misioni organizoi trajnime për integrimin gjinor dhe përfshirjen e vëmendjes ndaj dhunës me bazë gjinore në punë dhe programe. Pikat qendrore gjinore dhe menaxhmenti kanë tregues të detyrueshëm të performancës gjinore të përfshirë në vlerësimin e tyre vjetor të performancës. Biljana Nastovska, Këshilltare Gjinore në Misionin e OSBE-së në Kosovë elaboroi:

> Ne kemi një politikë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse, Planin tonë të Veprimit Gjinor, i cili është në internet. [Ai] ndahet në dy plane: përfshirja e barazisë gjinore brenda OSBE-së: politikat e burimeve njerëzore, menaxhimi, përfshirja, komunikimi, etj. [Dhe] pjesa e dytë: lidhet me gjithçka që po bëjmë me përfituesit tanë. Të gjitha programet tona… duhet të përfshijnë gjininë në zbatimin e përditshëm. [Ne] këshilltarët ose zyrtarët gjinorë… jemi ata që sigurojmë përbërësin kryesor [dhe] monitorojmë çdo gjashtë muaj progresin. Në fund të vitit, ne përpilojmë rezultatet dhe i analizojmë ato. Pastaj vendosim se çfarë do të ndodhë vitin e ardhshëm, duke krahasuar progresin. Për shembull, unë e kam ndryshuar plotësisht planin e veprimit gjinor dhe e kam ridizajnuar pas COVID-19.[70]

Me krijimin e pikave qendrore gjinore në nivelet më të larta, një këshilltare gjinore, dhe pika qendrore gjinore të tjera, OSBE-ja duket se është më mirë e pozicionuar tani sesa në vitin 2011 për të përfshirë çështjet gjinore në punën e misionit.

Në mesin e disa përmirësimeve të brendshme, në drejtim të marrëdhënieve të jashtme me grupet dhe mbrojtësit e të drejtave të grave, në mesin e aktivisteve ende ekzistonin disa shqetësime lidhur me qasjen dhe misionin e OSBE-së. Një aktiviste në anonimitet tha:

> OSBE po bën punën e organizatave për të drejtat e grave! OSBE e humbi plotësisht misionin e vet në Kosovë. Në vend që të punojnë për ato për të cilat janë mandatuar, për zgjedhjet e lira demokratike, ata po bëjnë [punën] e organizatave të shoqërisë civile dhe po garojnë për fondet e donatorëve për programet që duhet të bëjnë organizatat e të drejtave të grave. Pra, OSBE, për mendimin tim, nuk duhet të jetë as në Kosovë, ose ata duhet të kenë një zyrë dhe të punojnë veçanërisht me komunitetet pakicë. Tani kemi BE-në në Kosovë dhe nuk na duhet një institucion tjetër si

OSBE-ja që bën të njëjtat gjëra ose kopjon dhe imiton të tjerët. OSBE nuk e zbaton Rezolutën 1325.[71]

Për disa aktiviste, ndryshimet në politikën e brendshme ishin të pamjaftueshme, nëse të gjithë përfaqësuesit e OSBE-së nuk zbatuan objektivat e tjera të Rezolutës, si sigurimi i konsultimit me përfaqësimin e nevojave dhe prioriteteve të grave të Kosovës në punën e tyre. Ndërsa OSBE-ja ka trajtuar disa çështje të rëndësishme për gratë si të drejtat e pronës, dhuna me bazë gjinore dhe pjesëmarrja e grave në politikë, ndonjëherë këto përpjekje nuk janë planifikuar me konsultime të mjaftueshme me grupet e të drejtave të grave. Kështu, përpjekjet e OSBE-së ndonjëherë shkelën në gishtat e aktivistëve, minuan përpjekjet e tyre indigjene, për të adresuar nevojat e grave, dhe madje kontribuan në mbivendosje të panevojshme. Aktivistet dëshironin që OSBE t'i konsultojë ato më shumë në planifikimin të programeve, dhe jo vetëm pas tyre.

Në UNDP, në vitin 2011, u vërtetua se pozita e Këshilltares së Lartë Gjinore të UNDP-së e Jocelyne Talbot i ka mundësuar asaj që të përmirësojë nivelin e integrimit të çështjeve gjinore përbrenda UNDP-së; më mirë se që këtë punë e kryenin pikat qendrore për çështje gjinore të cilat ekzistonin në UNDP para emërimit të e saj. Ajo vuri në funksion aranzhime institucionale për përmirësimin e barazisë gjinore, përfshirë edhe zbatimin e Rezolutës 1325.[72] Pozita e saj e lartë i ofronte asaj mundësi që të ushtrojë ndikim mbi planifikimin e buxhetit, si dhe mbi procedurat e brendshme siç janë prokurimi dhe punësimi. Instalimi i masave vlerësuese për nivelin e kanalizimit të çështjeve gjinore në programet e UNDP-së paraqet një tregues të përparimit që ajo e ka arritur me kalimin e kohës.[73] Talbot më vonë u largua nga UNDP, dhe përgjegjësitë e barazisë gjinore u morën nga Koordinatori i Përhershëm/Përfaqësuesi i Përhershëm, në nivelin më të lartë, dhe u kryesuan nga Këshilltari i Programit Gjinor.[74]

Puna e UNDP dhe agjencive të tjera të OKB-së udhëhiqet nga Agjenda e OKB-së vitit 2030, e cila përbëhet nga

17 Qëllime të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) për njerëzit, planetin dhe prosperitetin. Dy qëllime janë direkt të rëndësishme për zbatimin e Rezolutës 1325: Qëllimi 5 për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave, dhe qëllimi 16 për promovimin e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Agjenda e vitit 2030 angazhohet të sigurojë pjesëmarrjen e plotë të grave në ndërtimin e paqes dhe ndërtimin e shtetit.[75] Për më tepër, UNDP ka një Strategji ndërkombëtare të Barazisë Gjinore 2018-2021, strategjia e tretë e tillë, e cila përmban disa angazhime, përfshirë ndihmën në zbatimin e Rezolutës 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe Rezolutën 2250 për Rininë, Paqen dhe Sigurinë duke lehtësuar përfshirjen e grave dhe grave të reja në negociata, ndërmjetësim dhe pozita vendimmarrëse.[76]

Disa agjenci të OKB-së kanë gjithashtu strategji dhe plane veprimi drejt barazisë gjinore të paktën në nivel ndërkombëtar.[77] Këto kanë çuar në disa programe drejt barazisë gjinore edhe në Kosovë.

Në planin ndërkombëtar, UN Women ka mandatin për të avancuar barazinë gjinore jo vetëm nga jashtë, por edhe brenda dhe midis agjencive të OKB-së.[78] Në Kosovë, kjo ka nënkuptuar përpjekjet për të krijuar një mekanizëm koordinues mes agjencive për barazinë gjinore, që bashkon të gjithë udhëheqësit e agjencive të OKB-së. Për më tepër, së bashku me RrGK-në dhe OSBE-në, UN Women ka koordinuar Grupin e Sigurisë Gjinore (GSGJ) që nga viti 2007, i cili bashkon institucionet e Kosovës, agjencitë e OKB-së, shoqërinë civile dhe organizata të tjera ndërkombëtare për të diskutuar çështje në lidhje me rritjen e sigurisë së grave dhe vajzave.[79] GSGJ ka për qëllim të përmirësojë koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit midis anëtarëve drejt rritjes së sigurisë dhe sigurisë së grave.[80]

Ndërkohë, krijimi i UN Women në vitin 2010 si një njësi e OKB-së që zëvendëson UNIFEM duket se ka pasur implikime

interesante për zbatimin e Rezolutës 1325 të agjencive të ndryshme të OKB-së, mes angazhimeve më të gjera për barazinë gjinore. Në praktikë, në disa raste disa agjenci të tjera të OKB-së mund t'a kenë përdorur transformimin e UN Women për të shmangur përgjegjësitë për zbatimin e Rezolutës 1325. Sipas Luljeta Demollit nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore, "UNIFEM dhe UN Women janë organizatat [e vetme] ndërkombëtare që kanë punuar për zbatimin e Rezolutës 1325". Kur ekipi hulumtues kontaktoi UNDP për një intervistë, një përfaqësues u përgjigj: "A e keni kontaktuar së pari UN Women për këtë? Kjo pasi që Agjencia kryesore e OKB-së që punon për zbatimin e Rezolutës 1325 është UN Women."[81] Ne i kujtuam atyre se ata gjithashtu janë përgjegjës për zbatimin e Rezolutës 1325, dhe pastaj ata pranuan të intervistohen. Sipas Rogovës:

> Agjencitë e OKB-së [në Kosovë] kanë ende shumë për të bërë, përveç natyrisht UN Women. Nuk e kuptoj këtë pjesë për agjencitë e OKB-së. Kurdoherë që bëhet fjalë për gjini ose Rezolutën 1325, ata thonë, "Ne kemi UN Women". Është gabim! Rezoluta 1325 duhet të adresohet nga të gjitha agjencitë. Nuk është vetëm UN Women që duhet ta zbatojë dhe avokojë për të. Duhet të jenë të gjitha.

Agjencitë e OKB-së ndërmorën disa iniciativa për ta ndryshuar këtë në vitin 2020, veçanërisht në shënimin e 20 vjetorit të Rezolutës 1325. UNDP, UN Women dhe të tjerët bashkëpunuan për të mbështetur disa përpjekje, përfshirë përfshirjen e grave të reja në proceset e paqes.

Si përmbledhje, misionet janë 'makineri të mëdha' të cilat drejtohen me vështirësi, tha Sirpa Rautio, e cila kishte punuar edhe për OKB-në dhe për BE-në:

> Dua të besoj se kemi arritur diçka. Ne definitivisht jemi bërë aktorë më të rëndësishëm. Ishte planifikuar [që çështjet gjinore] të jenë të margjinalizuara. Besoj se i'a

kemi dalur të jemi larg asaj dhe të arrijmë tek pika e planifikimit strategjik, të arrijmë tek proceset dhe kështu, të kemi më shumë ndikim. Por, kjo na u vështirësua pa nevojë për shkak të dobësisë së mandatit në të drejta të njeriut dhe çështje gjinore, pozitës dhe numrit.

Përkrah disa të arriturave që vlen të përmenden, mes këshilltarëve për çështje gjinore në Kosovë dukej se mbizotëronte ndjenja e margjinalizimit dhe pafuqisë gjatë dekadës së parë të zbatimit të Rezolutës 1325. Hutchinson bëri një përmbledhje të situatës, "Mendoj se ka ndarje të tipit: 'ah, çështjet gjinore... bëni atë që duhet bërë, ndërsa ne do të kryejmë punët e rëndësishme, punët e vërteta. Ne do të luajmë me ju për shkak se obligohemi të luajmë me ju, por në fund nuk do t'ju marrim seriozisht.' Mendoj se kjo paraqet pengesën më të madhe për ne.

Përjashtim në atë kohë përbënte Talbot, e cila në UNDP mbante post të lartë dhe rrjedhimisht ishte në gjendje që të ushtrojë ndikim në ndryshimet politike të mëtuara. Duke ndjekur shembullin dhe mbase bazuar në mësimet e marra, deri në vitin 2020, shumica e të gjitha misioneve ndërkombëtare në Kosovë kishin këshilltarë gjinor me orar të plotë. Kjo, vunë në dukje ata, kontribuoi në disa përmirësime në integrimin gjinor brenda organizatave të tyre përkatëse dhe kështu, gjithashtu, duke çuar më tej zbatimin e Rezolutës 1325.

Aftësia e këshilltarëve për çështje gjinore që të sigurojnë përfaqësim të denjë të interesave të grave duket se varet nga niveli i pozitës që ata mbajnë dhe nga fuqia që gëzojnë brenda misioneve të tyre; njohuria e tyre mbi rezolutën dhe përkushtimi për ta zbatuar atë, përfshirë përkushtimin për angazhimin e grave udhëheqëse lokale; vullneti i eprorëve për t'iu përmbajtur rekomandimeve të tyre. Aftësia e tyre për të arritur përparime sa i përket barazisë gjinore mund të zvogëlohet për shkak të rezistencës së brendshme, frikës nga humbja e vendeve të punës, mungesa e ekspertizës, të dhënat jocilësore të natyrës gjinore, mandatet e shkurtra dhe ndërrimi

i përhershëm i stafit, të cilat paraqesin sfida të përhershme sepse ju bëjnë "që të filloni gjithmonë nga fillimi punët që veç i keni kryer." Këto pengesa, të përmendura në vitin 2011, me sa duket janë zbehur me kalimin e kohës, ndërsa institucionet u mësuan me këshilltarët gjinorë dhe panë përfitimet që ata mund të sillnin. Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e avancimit të barazisë gjinore në vetë zbatimin e misioneve të tyre, të sjella shpesh nga këshilltarët gjinor dhe politikat që kërkojnë trajnim, kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit brenda misioneve dhe në këtë mënyrë në përmirësimin e zbatimit të Rezolutës 1325.

Përkundër përmirësimeve, shumica e këshilltareve dhe pikave qendrore për çështjet gjinore në Kosovë ende raportojnë se ndihen të vetmuara, me mungesë mbështetjeje dhe me burime të pamjaftueshme. Në disa raste, ato kishin përgjegjësi të gjera për integrimin e brendshëm dhe të jashtëm gjinor që u shtri në misione të mëdha me qindra punonjës. Siç komentoi njëra, "Shumë shpesh, ky është 'mision i pamundur'".[82]

Mes hapave të konsiderueshëm përpara, disa norma shoqërore shekullore ende kërkojnë kohë për t'u ndryshuar, dhe për këtë, përtej këshilltarëve gjinorë, lidershipi duhet të angazhohet në mënyrë aktive, siç vuri re një këshilltare gjinore:

> Strukturat gjinore janë kudo, kështu që gjithmonë do të ketë pengesa. Ato janë gjithashtu të pranishme në institucionet ndërkombëtare, gjë që paraqet pengesë për zbatimin e Rezolutës 1325. Akoma ekziston nevoja për ndryshim institucional. Edhe me gjithë presionin politik për zbatimin e kësaj Agjende, kërkohet shumë kohë. Është sikur të bindim personalisht të gjithë, që është një pozicion i vështirë në të cilin i vendosim këshilltarët gjinorë. Ne rrisim pritshmëritë që ata të ndryshojnë sjelljen e njerëzve dhe qëndrimet shoqërore të ngulitura me shekuj, por si mund ta bëni këtë? Është e pamundur. Mënyra më e mirë, mendoj, është të jesh pragmatik në atë që mund të

ndryshojmë. Është roli i udhëheqjes së lartë të kontribuojë në këto ndryshime më të gjera. Ne mund të shohim disa lëvizje aty, por strukturat gjinore vazhdojnë.

Trajnimi i trupave

"Ky ishte një proces i të mësuarit duke bërë."

- Tilly Stroosnijder, Këshilltar Gjinor i Policisë së UNMIK-ut, 2011

Duket se edhe KFOR-i me vonesë ka filluar të institucionalizojë perspektivën gjinore në Kosovë. Shtetet përkatëse që kontribuonin me trupa kishin përgjegjësi për ofrimin e trajnimeve para dërgimit të tyre, në pajtim me Rezolutën 1325. Megjithatë, aktivistet për të drejtat e grave vlerësuan se nevojiteshin trajnime shtesë. Rogova rikujton se si përpiqej në vitin 2007 që ta inkurajojë KFOR-in për të ofruar trajnime përkatëse:

> Në vitin 2005, Kvinna till Kvinna organizoi një takim në Swebat, në kampin e KFOR-it suedez. Ne atje mbajtëm një ligjëratë lidhur me pozitën e grave në Kosovë, Rezolutën 1325 dhe kulturën tonë. Kjo ishte e tëra. Ne donim të vazhdonim me ligjërata të tilla, por ato nuk po organizoheshin.
>
> Në vitin 2007 u ftova në një takim në Suedi ku një nga folësit ishte [Emisari Special i OKB-së për negociatat për statusin e Kosovës] Martti Ahtisaari. Ata kërkuan nga unë që të flas për statusin e Kosovës. Në takim ishin të ftuar vendimmarrës të nivelit të lartë, përfshirë mes tjerësh edhe ambasadorët e Serbisë dhe Rusisë në Suedi. Pas fjalimit tim, Carl Henrik Assargard [ish Këshilltar Politik në Selinë e Forcës Shumëkombëshe të KFOR-it] mu afrua, sepse i kishte lënë mbresa ajo që unë kisha prezantuar aty. Ai më pyeti "A mund të takohemi?"

> Kur u kthyem në Kosovë, erdhi në zyrë. Ne biseduam gjatë dhe pas tri orësh, më pyeti, "OK, çfarë dëshiron RRGK nga KFOR-i?"
>
> Unë ia shpjegova, "Që nga viti 1999 ne kemi qenë të gatshme për të shkuar nëpër baza rregullisht dhe për të bashkëbiseduar për traditën, kulturën pozitën e grave dhe Rezolutën 1325." Pas kësaj bisede, ai na organizoi takime të tilla.

Gjatë vitit 2007, aktivistet për të drejtat e grave mbajtën dy fjalime në bazat e KFOR-it suedez, finlandez dhe irlandez.[83] Megjithatë, me të përfunduar misioni i Carl Henrik Assargard, u ndërprenë edhe trajnimet që mbaheshin nga aktivistet për të drejtat e grave. Pasardhësi i tij nuk e vazhdoi programin e nisur. Disa baza, siç është baza ushtarake e Shteteve të Bashkuara, nuk pranuan fare të jenë pjesë e këtij programi. "SHBA-ve nuk u nevojiten ato, apo jo?" tha Luljeta Vuniqi dhe shtoi:

> Është viti 2007, kështu që mund ta kuptoni qartë se sa vëmendje na kushtojnë ata. Ata erdhën në vitin 1999 dhe tetë vjet më pas vendosën që të dëgjojnë për vetëm dy orë se çfarë do të thotë perspektiva gjinore. Mua më vjen mirë që morën këtë vendim, por shumë kohë është humbur. Gjërat kanë mundur të zhvillohen ndryshe dhe ne kemi mundur të kemi ndikim më të theksuar.
>
> Ata me të vërtetë as që donin t'ia dinin për çështjet gjinore. E vërteta që unë di për KFOR-in ishte se ata bënin reklama të çuditshme në TV dhe vendosnin pano të mëdha reklamuese anembanë Kosovës, me mesazhe që ndjellnin frikë. Për shembull, në panotë e KFOR-it mund të shihej një grua që kishte në duar një pite dhe thotë "Edhe unë jam Kosovë." Do të duhej të kishte kuptim të tipit "Edhe unë jam këtu, edhe unë duhet të jem pjesë e proceseve," ndërsa që në vend të kësaj vendoseshin pano në të cilat

> paraqiteshin foto tradicionale që përkrahin stereotipet e krijuara, të tipit "Mos i harroni gratë sepse ato na bëjnë pite." A thua nuk ju ka rënë ndër mend ndonjë fotografi tjetër, për shembull e një biznesmeneje, ndonjë doktoreshe apo gruaje të punësuar në zyrë. Imazhi i një gruaje me pite, ku thuhej "Edhe unë jam Kosovë," ishte fyes, lëndues dhe paragjykues.[84]

Anëtaret e RrGK reaguan kundër prezantimeve të stereotipeve të grave dhe burrave në Kosovë, përmes një letre që i dërguan KFOR-it në vitin 2010. Rogova kujtoi:

> Në fillim KFOR-i erdhi me një pano të një burri pa këmishë dhe me një mesazh "KFOR-i është i fortë". Ne reaguam. [Kur] ne i dërguam medias një artikull që kritikonte KFOR-in, Shefi i atëhershëm gjerman i KFOR-it [Markus Bentler] na thirri për t'u takuar. [Ai] ishte shumë i shqetësuar. Ai tha: "Nuk e kuptoj pse u desh të shkoni në media. Mund të vinit tek unë." Dhe unë i thashë, "Sepse nuk do të na ftonit derisa të shkonim në media dhe unë e di këtë nga përvoja." [Ai] ishte me të vërtetë i sinqertë dhe tha, "Ok, më trego çfarë të bëj." Unë thashë, "Ok, numër 1, duhet të keni një Këshilltar Gjinor në misionin tuaj. Numër 2, këshillohuni me ne para se të publikoni fushatat tuaja të kontaktit, në mënyrë që të mund t'ju këshillojmë për përmbajtjen dhe mënyrën e qasjes."

Aktivistet morën një përgjigje të menjëhershme nga KFOR-i. "Ata menjëherë i ndryshuan reklamat," thotë Belgjyzare Muharremi,[85] ish-Kryesuese e Bordit të RrGK-së, "dhe më pas konsultoheshin me ne sa herë që shfaqej ndonjë gjë e re; na pyesnin 'a janë përfaqësuar si duhet gratë dhe burrat?'" RRGK që atëherë kishte filluar të kryente vlerësimin e ndjeshmërisë gjinore të materialeve që KFOR-i përdor për komunikim me opinionin publik.

Për më tepër, siç kujtoi Rogova, "Unë nuk po bëj shaka, jo shumë kohë pas takimit tonë, një Këshilltare Gjinor erdhi në mision." Në të vërtetë, vendimi i NATO-s për ta krijuar postin e këshilltares për çështje gjinore në KFOR erdhi në të njëjtin vit, ndërsa këshilltarja e parë e tillë u punësua në nëntor të vitit 2010.[86] Procesi i krijimit të kësaj pozite kishte filluar në dhjetor të vitit 2007, dhe bazohej në një politikë formale të nxjerrë nga ana e Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik të NATO-s për zbatimin e Rezolutës 1325, por krijimi i kësaj pozite në KFOR u bë pas një kohe. Këshilltarja Gjinore e dytë e KFOR-it, Elisabeth Schleicher, inkurajoi punësimin e grave në KFOR, përfshirë punësimin e tyre në ekipet për ndërlidhje dhe monitorim, të cilat janë në kontakt të drejtpërdrejtë me popullatën në Kosovë.[87] Ajo gjithashtu punoi në kanalizimin e perspektivave gjinore në operacionet e KFOR-it, përmes edukimit dhe trajnimit të stafit.

"Që nga ajo kohë, bashkëpunimi ynë ka vazhduar," tha Rogova. RrGK filloi të marrë pjesë në takime të rregullta me KFOR-in, duke këshilluar për fushatat e tjera mediatike. Për disa vjet, RrGK trajnoi secilën gjeneratë të re të trupave të KFOR-it kur ata arritën në Kosovë. Çdo gjashtë muaj, trupat diskutuan me RrGK-në situatën e grave në Kosovë, iniciativat e vazhdueshme të RrGK-së dhe mënyrën se si trupat e KFOR-it mund të zbatojnë Rezolutën 1325.

Në dekadën e fundit, KFOR-i ka pësuar disa ndryshime dhe përmirësime që kur Zyra e Këshilltarit Gjinor (zyra GENAD) u krijua në vitin 2010. Zyra e GENAD ka vazhduar të zhvillojë programe trajnimi për audienca dhe nivele specifike brenda KFOR-it; gjinia e integruar në Ekipin e Monitorimit dhe Ndërlidhjes (LMT) ku ushtarët lidhen me popullatën lokale; dhe përfshiu vëmendjen ndaj barazisë gjinore brenda projekteve të bashkëpunimit civil-ushtarak. Për shembull, ekipet e KFOR LMT dhuruan materiale për strehimoren e dhunës në familje në Ferizaj, mallra gjatë pandemisë COVID-19 dhe pajisje për organizatën *Jeta*, e cila mbështet dhe trajnon gratë që të bëhen të pavarura ekonomikisht.

Kjo zyrë bashkëpunon me grupet e të drejtave të grave, UNMIK-un, zyrën e BE-së/PPSM-në, EULEX-in, OSBE-në, dhe me institucione të tilla si Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës.[88] Këto përpjekje kanë kërkuar të sigurojnë më tej sigurinë, sipas konceptit të sigurisë njerëzore, sipas përfaqësuesve të KFOR-it.

Në vitin 2017, KFOR-i organizoi "Ditën e Perspektivës Gjinore", duke ftuar aktivistët e RrGK-së të flasin.[89] Më pas, duke sinjalizuar bashkëpunimin e vazhdueshëm të RrGGK-së dhe KFOR-it, sipas kërkesës së RrGK-së, KFOR-i organizoi një konferencë për të shënuar 20 vjetorin e Rezolutës 1325 në vitin 2020. "Nuk kam dëgjuar kurrë që një bazë ushtarake të mbajë një konferencë për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave brenda bazës. Kjo ishte hera e parë," vuri në dukje Rogova.[90] Në të vërtetë, përvoja e KFOR-it në zbatimin e Rezolutës 1325 në Kosovë është shfaqur brenda NATO-s dhe ka informuar operacionet paqeruajtëse globale.

Ndërkohë, në Policinë e UNMIK-ut, Tilly Stroosnijder ka shërbyer si këshilltare gjinore për Policinë e UNMIK-ut dhe ishte këshilltarja e parë gjinore në të gjitha misionet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në botë, si pjesë e një iniciative 'provuese' në vitin 2003. Në atë kohë, ajo kishte probleme me strukturën burokratike të OKB-së:

> Për OKB-në ky ishte një proces i tipit 'mëso duke punuar'. Në botën e këshilltarëve për çështje gjinore, emërimi im u perceptua si kërcënim i drejtpërdrejtë për Zyrën për Çështje Gjinore [të UNMIK-ut]. Brenda UNMIK-ut nuk kuptohej si duhet se si funksionon policia, si komunikojnë ata apo si mund të respektohen perspektivat gjinore brenda sektorit të sigurisë. Kjo ngadalësonte progresin e kësaj pune dyshtresore të cilën e kryeja, që ngërthente kanalizimin e brendshëm dhe të jashtëm të çështjeve gjinore në sferën e policisë, brenda misionit dhe në Shërbimin Policor të Kosovës. Së dyti, unë isha e izoluar nga këshilltari gjinor i misionit të UNMIK-ut dhe isha e përjashtuar

> dhe nuk kuptohej në mënyrë të mirëfilltë puna që kryeja. Unë isha e përjashtuar edhe nga sistemi i raportimit dhe nga takimet e OKB-së dhe DPKO-së.

Stroosnijder tha se ajo u desh të 'luftojë' për të përcaktuar kushtin për trajnim për çështje gjinore dhe dhunë në familje për stafin e ri policor, kusht ky që nuk ekzistonte deri në vitin 2004.[91] Ky trajnim trajtonte çështjet e dhunës në familje, trafikimit, keqtrajtimit të fëmijëve dhe mostolerimit të frekuentimit të bareve ku besohej se kryhej trafikim seksual nga policia e UNMIK-ut. Megjithëse ajo vërejti ndryshime pozitive me kalimin e kohës, vlerësoi se do duhej bërë shumë punë:

> Tani OKB-ja ka emëruar këshilltarë gjinorë në trupat policore dhe ushtarake të DPKO-së. Ky paraqet një hap të rëndësishëm përpara, por sipas meje, të pamjaftueshëm. Pas 12 vitesh në misione në nivel operativ, unë e shoh se ata e kuptojnë konceptin e çështjeve gjinore, e kuptojnë 'çka', por vërtetë u mungon të kuptuarit mbi procesin, d.m.th. të kuptuarit lidhur me atë se 'si' të zhvillohet puna në nivel operativ. Zbatimi i konceptit gjinor brenda policisë dallon me zbatimin e tij në ushtri, ndërsa që dallon edhe zbatimi i tij mes forcave të ndryshme policore. Ne duhet ta pranojmë këtë fakt nëse duam të kemi sukses në punën tonë. Ne duhet t'i përshtatemi misionit dhe realitetit gjinor në shtetin mikpritës. Shërbimi përkrah palëve homologe të vendit paraqet faktor kyç për progres në zbatimin e perspektivave gjinore dhe sigurimin se autoritetet vendore do të ndjejnë se kanë 'pronësi' mbi proceset e zhvilluara!

"ASNJË GRUA NË EKIPIN NEGOCIATOR"

"Këshilli i Sigurimit duhet të ndryshojë qëndrimin e tij lidhur me Rezolutën […] sepse kur erdhi misioni i tyre në Kosovë, delegacioni i tyre kishte vetëm një grua nga Anglia në cilësi të ambasadores; të gjithë të tjerët ishin burra. Hapi i parë për zbatimin e Rezolutës duhet të nis nga vetë OKB-ja; ata duhet t'u japin grave më shumë mundësi pjesëmarrjeje."

- Gjylnaze Syla, Deputete, 2007

Ishte viti 2001 dhe përfaqësues të UNMIK-ut përgatitën rendin e ditës për vizitën e parë të delegacionit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së në Kosovë. Ambasadori Anwarul K. Chowdhury nga Bangladeshi, i cili udhëhiqte delegacionin, shprehu dëshirën për t'u takuar me grupet e grave. Mirëpo, përfaqësuesit e UNMIK-ut thanë, "Rendi i ditës së delegacionit veç është finalizuar." Ambasadori Chowdhury, avokues i pasusit të parë të Rezolutës 1325, nguli këmbë për t'u takuar me gra. Ai kërkoi orarin e takimeve të caktuara.

"Takime keni nga ora 08:00 në mëngjes e deri në orën 09:30 në mbrëmje" u përgjigj UNMIK-u.
Ambasadori Chowdhury kërkoi takim me grupet e grave në ora 9:30 në mbrëmje në hotelin ku qëndronte.

Ndonëse gratë lidere menduan se ishte zhvlerësim që të takohen vonë në mbrëmje në një hotel, edhe atë jozyrtarisht, ato megjithatë u pajtuan për shkak të këmbënguljes dhe përkushtimit të Ambasadorit Chowdhury.

Gratë politikane dhe aktiviste shkuan në hotel së bashku. Ato u befasuan për të mirë kur e takuan delegacionin e Ambasadorit Chowdhury. Përfaqësuesit e UNMIK-ut

gjithashtu morën pjesë, duke përfshirë edhe Zëvendësshefin e UNMIK-ut, Tom Kennings, i cili kishte qenë në Kosovë për gati dy vite dhe kurrë nuk kishte kërkuar takim me gratë, siç thanë aktivistët për të drejtat e grave.

Nisma e Ambasadorit Chowdhury për t'u takuar me gratë vendosi një shembull pozitiv në angazhimet për të "rritur pjesëmarrjen e grave dhe organizatave të grave në aktivitetet për parandalimin, menaxhimin, zgjidhjen dhe reagimin ndaj konflikteve dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave," siç edhe këshillon Rezoluta 1325.[92] Megjithatë, ky ishte një konsultim që u realizua më shumë falë vullnetit të tij politik se sa për shkak të udhëzimeve të dhëna nga Këshilli i Sigurimit, gjë që do dëshmohej më vonë nga misionet tjera që do ta vizitojnë Kosovën. "Për mua, ai ishte hero," thotë Rogova.

Në dhjetor 2002, në Kosovë arriti delegacioni i dytë i Këshillit të Sigurimit të OKB-së, i udhëhequr nga Ambasadori Norvegjez, Ole Peter Kolby. Përsëri, UNMIK-u në rendin e ditës nuk kishte paraparë takim me gratë. Përsëri gratë lobuan që të takohen me delegacionin dhe përsëri u takuan pas orëve të rregullta të punës. Kur hyri në sallë delegacioni i Këshillit të Sigurimit, gratë kosovare vërejtën se nga 15 anëtarë të delegacionit ishte vetëm një grua.[93] Rogova kujton:

> Pra, ne u ulëm së bashku, jo vetëm gra shqiptare por edhe serbe, boshnjake, turke, rome. Të gjitha po flisnim për statusin special të Kosovës dhe për Rezolutën 1244. Na ndërpreu Ambasadori Kolby, "Statusi është çështje për partitë politike. Le të flasim për çështje të grave, le të flasim për shembull për Rezolutën 1325."
>
> U befasuam nga një qëndrim i tillë injorues. Ndiheshim të fyera dhe të befasuara me faktin që Ambasadori nuk e dinte se në pajtim me Rezolutën 1325, gratë duhet të përfshihen në negociatat për statusin përfundimtar politik të Kosovës. Ne e pyetëm, "A nuk mendon se statusi është një çështje që prek

gratë? Kjo shprehimisht kërkohet me Rezolutën 1325."[94]

Më pas i thamë, "Pasi që po flasim për Rezolutën 1325, si ndodhë që delegacioni përfaqësohet vetëm me një grua?" Ai u vu në siklet dhe tha, "Më falni, por kam një takim tjetër" dhe iku papritur.

Disa vite më vonë, Kosovën e vizitoi një përfaqësues tjetër skandinav, vazhdon Rogova:

Kai Eide nuk deshi fare të takohej me gratë, ndërkohë që misioni i tij ishte tejet i rëndësishëm: kishte të bënte me zgjidhjen e statusit politik të Kosovës. Kai Eide ishte Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në vitin 2005. Ai po monitoronte zbatimin e 'Standardeve për Kosovën' [dhe po vlerësonte "nëse ishin plotësuar kushtet për t'iu qasur procesit politik që do të shpinte drejt përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës"]. [95] Edhe pse vizitonte Kosovën dhe Serbinë ai nuk takohej me gra.

Pas kërkimit tonë me këmbëngulje që të takohemi me të, ai eventualisht tha "Në rregull".

Kur u takuam me të, filluam të flasim për statusin, por ai na preu shkurt: "Mos më flisni si burrat, le të flasim për çështje të grave."

Ne thamë vet me vete 'shih, shih', ndërsa atij i thamë "Rezoluta 1325 na jep të drejtën që të flasim për statusin."

Ai na tha: "Kërkoj falje..." sepse kurrë nuk kishte dëgjuar për rezolutën në fjalë, më pas u kthye nga asistenti i tij dhe e pyeti, "Çka thotë kjo Rezolutë?" Më pas, ai heshti. Ai e mbylli gojën dhe nuk foli më asnjë fjalë, pasi që nuk ishte në dijeni për Rezolutën.

Do të thotë mungesa e vullnetit politik dhe e dijenisë paraqesin dy arsyet kryesore për moszbatimin e saj.

Duhet theksuar se raporti përfundimtar i Ambasadorit Kai Eide në lidhje me nivelin e përgatitjes së Kosovës për të filluar negociatat për statusin, në asnjë rast nuk përmendi gratë.[96]

Tre në katër raporte të shkruara nga misionet monitoruese të Këshillit të Sigurimit të OKB-së që vizitonin Kosovën nuk përmendnin fare gratë apo vajzat.[97] I vetmi raport që përmendte ato ishte ai në të cilin thuhej se Kreu i një Misioni të dërguar në Kosovë, Ambasadori Ole Peter Kolby, u takua me gratë në vitin 2002. Aty thuhej: "Përfaqësuesit e shoqërisë civile theksuan se gratë e etnive të ndryshme po punonin së bashku në projekte për ndërtimin e paqes, por se nuk po gëzonin përkrahjen e duhur nga UNMIK-u apo OSBE-ja". [98] Ky raport citonte Rezolutën 1325 dhe 'nënvizonte' se si "edhe gratë duhet të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë civile dhe të luajnë një rol të rëndësishëm në pajtimin e komuniteteve." [99] Megjithatë, në këtë raport nuk përmendej fakti se gratë po përballeshin me shkelje të të drejtave njerëzore të grave. Në krahasim me çështjet e tjera të trajtuara në raport, çështjet e grave përmendeshin tejet sipërfaqësisht.

Ekipi i unitetit negocion... (pa asnjë grua)

"Gratë nuk janë pjesë e diskutimeve mbi statusin final të Kosovës."

- Arjeta Rexhaj, Këshilltare Politike e Zëvendëskryeministres Edita Tahiri, 2011

"Në vitet 2005 dhe 2006, Kosova po përgatitej për një tjetër fazë të bisedimeve paqësore me Serbinë," na tha Edita Tahiri, "dhe ndërsa po lansoheshin idetë e asaj se çfarë duhet diskutuar me Serbinë, me ndërmjetësimin e OKB-së dhe Ahtisaarit, ne gratë deshëm që të përfaqësohemi në tryezën e bisedimeve për paqe dhe zgjidhje të statusit politik të Kosovës. Ne kishim punuar shumë për këtë çështje në mënyra të ndryshme. Fillimisht ne, gratë në politikë dhe gratë udhëheqëse në shoqërinë civile u organizuam që të lobojmë së bashku dhe individualisht për të pasur përfaqësim të grave në bisedimet në Vjenë.

Rogova kujton nga ajo kohë:

> Ishte një periudhë kur kishte shumë ndasi mes partive politike. Ish-Presidenti Rugova, së bashku me përfaqësuesit e OKB-së, kishin vendosur të krijojnë këtë forum politik në shtator të vitit 2005, për të siguruar unitetin e të gjitha partive. Ish-PSSP Søren Jessen-Petersen dhe Rugova biseduan, dhe vendosën ta krijojnë "Ekipin e Unitetit."
>
> Kush ishte pjesëtar i këtij Ekipi të Unitetit? Liderë të partive politike të cilët kishin fituar ulëse në Parlament, Kryetari i Parlamentit dhe Kryeministri. Dhe kur filluan negociatat, ishin këta njerëz ata që

udhëhoqën delegacionin. E dini çfarë arsyetimi na dhanë?

Ne i pyetëm "përse nuk ka në grupin tuaj asnjë grua; ne kemi dy parti politike që udhëhiqen nga gratë?"

"Asnjëra nga to nuk ka fituar ulëse në parlament" thanë ata. "Kjo është arsyeja e mospërfshirjes së tyre në ekip."

Ne nuk mund ta pranonim këtë; ky arsyetim i tyre ishte thjeshtë i pabazë.

Më pastaj, ekipit negociator iu shtua edhe një ulëse për shoqërinë civile. Pa kurrfarë konsultimi, ata vendosën që shoqërinë civile ta përfaqësojë Blerim Shala – kryeredaktor i gazetës Zëri. Në fakt Blerimi nuk ishte zgjedhur nga shoqëria civile por nga udhëheqësit partiak. Kësisoj, kishte ende mundësi që ekipit t'i shtohet dikush nga shoqëria civile, ndonjë grua e fuqishme. Por, jo, ata vendosnin për çdo gjë vetë, pa e konsultuar askënd.

Kështu që na u thamë "Nëse nuk do të kemi asnjë grua në ekipin negociator, ne duhet të kemi gra në grupet punuese." Kësisoj, ne luftuam që të kemi që nga fillimi përfaqësim të grave në grupet punuese.[100]

Përkundër pengesave me të cilat ndesheshin, gratë e Kosovës ishin të përkushtuara që të kontribuojnë në këto negociata.

"Ishte kjo periudha kur e kishim krijuar Koalicionin e Grave për Paqe," shton Rogova.[101] "RRGK dhe Rrjeti i Grave në të Zeza vendosën ta krijojnë këtë koalicion pikërisht për shkakun se në ekipet negociatore nuk përfaqësoheshin fare gratë. Po, ata kishin një grua [nga Serbia] në ekipin e tyre, por ajo nuk po përfaqësonte gratë nga Serbia, kështu që edhe ato ndiheshin sikur të mos kishin fare përfaqësim të grave."

Koalicioni i Grave për Paqe ripërtëriu lidhjet e vjetra mes aktivisteve të rajonit nga koha e ish-Jugosllavisë. Gjatë viteve të 90-ta, Gratë në të Zeza nga Beogradi kishin shërbyes

si epiqendër regjionale e grave që bënin organizime për paqe dhe kundër luftës në Bosnjë dhe Kosovë. RrGK dhe Rrjeti i Grave në të Zeza i bashkuan fuqitë e tyre dhe filluan avokimin për shtimin e përfaqësimit të grave në negociata.

Në vitin 2006 u krijua edhe Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore (LRG). Në këtë organizëm ishin mbledhur gra prominente nga shoqëria civile dhe politika e të gjitha vendeve të ish-Jugosllavisë, për të avokuar për çështje dhe brenga të përbashkëta. Edhe Koalicioni edhe Lobi lobonin për përfshirjen e grave në negociata. Veprimtaria e tyre ishte e rëndësishme ngase edhe gratë nga Serbia edhe ato nga Kosova, përkrah grave të tjera nga rajoni, publikisht përkrahnin pavarësinë e Kosovës. Edita Tahiri, e cila më vonë e udhëhoqi LRG-në rikujton:

> Ne e shfrytëzuam LRG-në edhe për të lobuar për përfshirjen e grave në negociatat e Vjenës [gjë që ndodhi në shkurt të vitit 2006]. Ne lobuam pranë partive politike, institucioneve qeverisëse të Kosovës, në parlament dhe tek Presidenti. Ne gjithashtu lobuam tek zyrtarët e UNMIK-ut. Ne madje lobuam edhe drejtpërsëdrejti tek Ahtisaari, me të cilin u takuam dhe të cilit i dërguam letra ... ne lobuam edhe pranë Këshillit të Sigurimit.
>
> Edhe përfaqësueset e shoqërisë civile, Igo Rogova, Lule Vuniqi dhe Flora Macula u takuan me delegacionin e Këshillit të Sigurimit në Kosovë për të lobuar në këtë drejtim. Megjithatë, edhe pas tërë këtij lobimi, bisedimet në Vjenë morën fund pa praninë e përfaqësueseve të gjinisë femërore, gjë që ne konsideruam se paraqet mungesë demokracie dhe vizioni. Kjo përbënte edhe një mosrespektim të grave të Kosovës, të cilat ishin të gatshme që t'i sakrifikojnë jetët e tyre dhe të marrin pozitat më të larta shtetërore gjatë okupimit. Përveç kësaj, gratë kanë kapacitet për të siguruar funksionimin e paqes. Gratë e Kosovës

kanë merita të mëdha edhe në këtë drejtim. Sidoqoftë, tërë kjo nuk u mor parasysh.

Bisedimet në Vjenë u mbajtën pa asnjë grua në tryezën e bisedimeve, dhe unë konsideroj se kjo paraqet një dështim, por jo dështim i yni si gra sepse ne ishim proaktive. Ne konsiderojmë se ky paraqet dështim të burrave. Edhe pse nuk më pëlqen të kem qëndrime kundër burrave, mendoj se partneriteti mes gjinive mund të jetë i dobishëm, por ky ishte një rast kur mentaliteti mashkullor dominoi dhe gratë u lanë anash. Kjo nuk u bë vetëm nga burrat kosovarë por edhe nga ndërkombëtarët.

Ju lutem shumë, "madhëria juaj" z. Petersen?

"Rezoluta 1325 parimisht i dedikohet trupave ndërkombëtare që dërgohen në misione: si do të duhej të trajtohen gratë, si do të duhej të përkrahen gratë në institucione ndërkombëtare. Kjo është arsyeja përse u krijua Rezoluta 1325. Por, kur fillon një luftë, OKB ulet pranë palëve në konflikt dhe atyre kurrë nuk u bien ndër mend gratë. Kjo është arsyeja përse Rezoluta 'kërkon' që gratë të ulen në tryezën e bisedimeve, por nuk parashtron kurrfarë detyrimi për askënd."

- Igballe Rogova, Drejtore Ekzekutive, RrGK, 2007

Të inkurajuara nga kujdesi i PSSP Søren Jessen-Petersen për çështjet e barazisë gjinore, gratë iu drejtuan atij dhe kërkuan që ato të përfshihen në bisedimet për statusin final politik të Kosovës. "Z. Petersen ne kishim shpresuar se OKB do të ndryshonte dhe se do të fillonte ta zbatojë Rezolutën," i kishte thënë Rogova:

> Por, kur filloi procesi negociues dhe ne e kuptuam se në ekipin negociator nuk kishte asnjë grua, ... shkuam prapë tek PSSP dhe i thamë: "Ju duhet të kërkoni nga ekipi negociator që në këtë ekip të përfshihet së paku një grua."
>
> E ai na tha se nuk mund të bënte asgjë në këtë drejtim.
>
> Por, kjo është habitshme. Do t'ju them përse – sepse ai mund ta bënte këtë! Dihej se çfarëdo që ai i referonte qeverisë sonë – realizohej.[102]

Por, për dallim nga PSSP-të tjerë, "Unë mendoj se Z. Petersen vërtetë mundohej dhe shtynte gjërat përpara," thotë Vuniqi:

> Megjithë që ai përpiqej dhe po na dëgjonte me vëmendje, mendoj se nuk bëri atë që mundi. Më kuptoni, PSSP në Kosovë ishte person me shumë autoritet. Ai mund të vendoste çfarë të donte. Brenda 25 orëve shkarkoi Kryetarin e Kuvendit [z. Daci] dhe Kryeministrin [z. Kosumi]. Pra, nëse [PSSP] mund t'i shkarkojë brenda vetëm 25 orëve dy persona në pozita aq të larta, si mund të ndodhte që ai dhe pasardhësit e tij të mos mund të bëjnë asgjë për ta ndryshuar ekipin negociator? Kjo detyrë ishte më e lehtë se sa shkarkimi i këtyre dy personaliteteve.
>
> Por, edhe Søren Jessen-Petersen ishte i frustruar me situatën. Ai dëshmoi ndjeshmëri të lartë sa i përket çështjeve të grave. Në takimin lamtumirës që kishim me të para se të largohej nga Kosova, ai tha, "Unë kam dështuar. Nuk kam arritur t'i bind që ta krijojnë një ekip ku përfaqësohen edhe gratë." Zakonisht, kur burrat dështojnë, ata nuk e pranojnë dështimin kaq lehtë, por ky e pranoi. Disi, kjo shkonte me pozitën që kishte. Ai ishte Mbret i Kosovës. Ai mund të zëvendësonte kryeministrat dhe ministrat, por megjithatë pranoi me shumë lehtësi dështimin. Ai kishte takime të rregullta me grupe të grave dhe pajtohej me to, por duke marrë parasysh të gjitha problemet me të cilat duhej të ballafaqohej, çështjet tona i kishte si pjatë anësore dhe jo kryesore.[103]

Njerëzit që punonin me Ahtisaarin nuk i merrnin fare parasysh çështjet gjinore

"Gratë nuk ishin fare të pranishme në procesin e negociatave edhe pse ato kishin kontribuar shumë para dhe pas luftës."

- Ariana Qosaj-Mustafa, aktiviste e të drejtave të grave, 2011

Procesit të negocimit të 'statusit final' po i afrohej fundit. Shumë shpresonin se ai do të rezultonte me një marrëveshje të re me të cilën do të zëvendësohej Rezoluta 1244. Këtë herë, gratë menduan se ky pergamenë që do të nënshkruhej do të përfshinte qëndrimet e grave. Këtë radhë, negociatorët do të ishin përgjegjës për të siguruar përfshirjen e grave në negociata; ata do të duhej të siguronin këtë sepse ashtu thoshte Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.[104] Ky proces u udhëhoq nga ish-Presidenti Finlandez dhe Emisari Special për negociatat e statusit të Kosovës, Martti Ahtisaari.

"Z. Ahtisaari ishte i brengosur me përfshirjen e vazhdueshme të grave dhe lidereve përgjatë tërë procesit të definimi të statusit," tha Philippe Tissot, nga zyra për punë të jashtme e UNMIK-ut, e cila i organizonte takimet. "Ai gjatë çdo vizite theksonte se donte të takohej me përfaqësues të shoqërisë civile, përfshirë lideret e gjinisë femërore."

Aktivistet nuk pajtoheshin me këtë.

"Ajo që më irritonte," tha Shehu, "ishte se kur ne pyetëm 'përse nuk është bërë asgjë për të përfshirë gratë në ekipin negociator?' ai na paraqiti [tradicionalizmin shqiptar] si

një nga pengesat, duke thënë 'nuk duam ta shkelim traditën.' Mund ta paramendoni se çfarë argumentimi ishte ky!"[105]

"Ne gjithmonë detyroheshim të kërkonim takime," thotë Rogova. Përkundër përgjegjësisë që negociatorët ndërkombëtarë kishin sipas Rezolutës 1325:

> Me Martti Ahtisaarin ne kërkuam takim përmes Lobit Rajonal të Grave. Ai na dëgjoi me vëmendje dhe ne menduam se do të bënte diçka lidhur me implementimin e Rezolutës , por as ai nuk e zbatoi atë. Ai ka mundur ta bëjë këtë. Ai udhëhiqte negociatat dhe ka mundur të thotë: "Në pajtim me Rezolutën 1325, dua që në ekipet negociatore të ketë edhe gra." Megjithatë nuk e bëri këtë. Mendoj se brenga kryesore e tij ishte që të sillte serbët dhe shqiptarët në tryezën e bisedimeve; preokupim tjetër nuk kishte."[106]

"Ne vërtetë kërkuam, avokuam dhe dërguam letra për të kërkuar zbatimin e pjesës së Rezolutës 1325 e cila në mënyrë shprehimore kërkon përfshirjen e grave në proceset e negocimit të paqes," thotë Vuniqi.[107]

"Ne fillimisht provuam dërgimin e letrave," shton Rogova. Por, kur ato nuk patën sukses, "Ne mbajtëm një protestë në rrugë, së bashku me Gratë në të Zeza, të cilat ishin pjesë e Koalicionit të Grave për Paqe. Ne organizuam dy protesta, në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën kohë; një në Prishtinë dhe një në Beograd."

"Nuk duam lule! Duam fuqizim!" shkruante në pankartat që mbanim në duar në protestën e datës 8 mars të vitit 2006 në Prishtinë. Gratë u grumbulluan për ta refuzuar traditën e dhënies së luleve dhe kërkuan që t'u sigurohet një ulëse në tryezën e bisedimeve.

"Temperatura ishte minus 20 gradë [celsius]," kujton Rogova, "dhe ne kishim organizuar një protestë në qendër të qytetit me shfaqje dhe me këngë. Ne gjithashtu kishim vendosur një pano të madhe në të cilën shkruante 'Rezoluta 1325 na jep të drejtë që të jemi në ekipin negociator'. Panoja

qëndroi e ngjitur në muret e ndërtesës së Kuvendit për 6 apo 7 muaj; ata nuk po e hiqnin atë, por as nuk po u shkonte ndërmend të përfshinin gra në ekipin negociator."[108]

Kur u pa se nuk do të mund të siguronim ulëse për gratë në tryezën negocuese, Lobi Rajonal i Grave dhe Koalicioni i Grave për Paqe u mundua që të ndikojë në negociata përmes letrave avokuese në lidhje me ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe gjetjen e një zgjidhje të drejtë dhe afatgjatë për Kosovën.[109] Kjo e fundit i vuri në rrezik aktivistet nga Serbia; zyra e Grave në të Zeza u bastis ndërsa aktivistet e kësaj lëvizjeje u kërcënuan.

Në fund, gratë morën pjesë në grupet punuese. Në atë kohë Rogova thotë, "Ne ishim të lumtura që angazhoheshim në grupet punuese, por nuk ishte e njëjta gjë."

Teksa afrohej fundi i negociatave të ndërmjetësuara nga Ahtisaari, në fund të vitit 2007, Lobi Rajonal i Grave i dha një shtytje përfundimtare çështjes, duke paraqitur qëndrimin e disa grave nga rajoni se Kosova do të duhej të jetë shtet i pavarur dhe se Rezoluta 1325 duhet të merret parasysh në lidhjen e të gjitha marrëveshjeve paqësore. Letra e tij në përkrahje të shpalljes së pavarësisë ishte nënshkruar nga politikane e aktiviste të shquara nga tërë Evropa Juglindore, përfshirë edhe përfaqësuese nga shtetet të cilat nuk e kanë pranuar pavarësinë e shpallur nga Kosova.

Në po të njëjtën kohë, Këshilli i Sigurimit i OKB-së dërgoi në Kosovë një mision treditor faktmbledhës, para marrjes së vendimit përfundimtar mbi statusin. Ai arriti në Kosovë në vitin 2007 dhe udhëhiqej nga ambasadori belg Jonan Verbeke.[110] Ky mision përbëhej nga 12 ambasadorë nga Këshilli i Sigurimit, të cilët kishin për detyrë të grumbullojnë të dhëna mbi gjendjen në Kosovë dhe Serbi. Agjenda e këtij misioni përfshinte takime me liderët politikë nga Kosova, Serbia dhe Shqipëria. "Ne deshëm t'i përfshijmë gratë në këto takime. Këtë edhe e arritëm, me ndihmën e disa miqve ... ngase i përfshimë shtatë gra në pritjen që u organizua por jo edhe në agjendën formale," kujton Flora Macula, nga UNIFEM-i në atë kohë. Mes atyre që u takuan me delegacionin ishin anëtaret e Lobit

Rajonal të Grave, përfshirë deputeten Teuta Sahatqija, ministren e drejtësisë në atë kohë Nekibe Kelmendi, dhe aktivistet Rogova, Vuniqi dhe Natasha Kandiq dhe Sonja Biserko nga Serbia.

"Lobi dërgoi shkresa me të cilat kërkohej njohja e pavarësisë së Kosovës," kujtoi Teuta Sahatqija. [N]jerëzit si Sonja Biserko dhe Natasha Kandiq, [Ambasadorja e SHBA] Tina Kajdanov dhe të tjera […] na kanë ndihmuar në shpërndarjen e deklaratave për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Kërkesat tona janë paraqitur edhe në mediat e çdo vendi të regjionit, dhe kanë arritur deri në Nju Jork."[111]

Macula rikujton përpjekjet e grave për të lobuar pranë delegacionit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së:

> Ne u takuam para pritjes së organizuar për ta përgatitur strategjinë e veprimit, "Si mund të lobojnë gratë dhe t'ia dorëzojnë këtë deklaratë të gjithë anëtarëve të Këshillit të Sigurimit?" ... E deklarata kishte të bëjë me përkrahjen e pavarësisë së Kosovës, natyrisht duke kërkuar respektimin e të drejtave të pakicave. Ajo ishte nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Lobit Rajonal të Grave.
>
> Kësisoj, gratë u përgatitën. Ne kishim deklaratat me vete. Teuta dhe Nekibja gjendeshin brenda Kuvendit. Ato u takuan [me anëtarët e delegacionit të Këshillit të Sigurimit] dhe u dhanë atyre deklaratat e Lobit Rajonal të Grave.
>
> Atë natë ne shkuam së bashku në pritje dhe po prisnim [delegacionin e Këshillit të Sigurimit] të cilët po vinin me autobus. Kur arritën në oborrin e parlamentit dhe kur rreth tyre filluan që të grumbulloheshin njerëz të shumtë, gratë u zhgënjyen. Menduam 'Dështuam. Nuk do të mund t'u qasemi."
>
> Kështu, ne kërkuam ndihmë nga Kryeministri dhe dy ministra për t'iu qasur atyre [ambasadorëve të Këshillit të Sigurimit]. Unë vëzhgoja se cilët ambasadorë ishin të lirë për të folur, ndërsa në këtë punë na ndihmoi

> shumë edhe Tina Kajdanov. Ajo mori në dorë deklaratën dhe nisi shpërndarjen e saj. Pasi që ia dha disa ambasadorëve të Këshillit të Sigurimit, ne filluam të flasim me ta. Unë po dëgjoja diskutimet e [Ambasadorit të Rusisë pranë Këshillit të Sigurimit Vitaly] Churkinit, Kandiqit dhe Biserkos.
>
> [Sonja Biserko dhe Natasha Kandiq, aktiviste për të drejtat e njeriut, thanë se Këshilli i Sigurimit] "do të duhej të marrë parasysh të drejtat e njeriut."
>
> Churkini na tha: "Lëreni tani, për disa edhe territori është i rëndësishëm; jo vetëm të drejtat e njeriut." ...
>
> Ato ia dhanë atij deklaratën, ndërsa ai tha, "Jo, nuk dua të pranoj kurrfarë dokumenti. Nëse doni, dërgojeni në hotel." Ato ia dërguan dokumentin në Hotel Victory. Ai ishte tejet i vrazhdë dhe pasi i tha këto fjalë – u zhduk. Pas 15 minutash diskutimesh ai iku nga pritja. Përfaqësuesi i Afrikës së Jugut na tha "Nuk dua të flas, dua të ha."[112]

Një ambasador tjetër u ndje shumë i zhgënjyer nga pyetjet tona," shtoi Vuniqi. "[Ai] tha, 'nuk kam ardhur këtu për të diskutuar për të drejtat e grave.' Ai u shqetësua që ne nuk morëm qëndrimin e viktimave në këto negociata, siç kishte pritur ai."

"Ndërkaq Qeveria në fund konstatoi se vetëm gratë po lobonin [për Kosovën gjatë asaj pritjeje], askush tjetër," shtoi në fund Macula:

> Që në atë moment, Kryeministri dhe të tjerët e kuptuan fuqinë e lobimit nga gratë. Rezultat i kësaj ishte se në Rezolutën e re për Kosovën ata e përmendën edhe Rezolutën 1325. ... Ishte një paragraf që i referohej zbatimit të Rezolutës 1325 dhe përfshirjes së grave në negociata paqësore. Ishte kjo rrjedhojë e drejtpërdrejt e atij takimi ... kështu që diçka u arrit. Rezoluta e re [që do ta njihte pavarësinë e Kosovës] madje as që u

vu në votim në Këshill të Sigurimit, pasi që Rusia deklaroi se do ta përdorte fuqinë e vetos kundër saj.

Pasi që Këshilli i Sigurimit i OKB-së nuk pati mundësi ta miratojë një rezolutë të re për pavarësinë e Kosovës, nuk u arrit kurrfarë marrëveshje e re paqësore që do ta zëvendësonte Rezolutën 1244. Rrjedhimisht, deri tani nuk kemi pasur asnjë marrëveshje paqësore për Kosovën që do të përfshinte shprehimisht "dispozita për përmirësimin e statusit të sigurisë për gratë dhe vajzat në Kosovë". [113] As Propozimi Gjithëpërfshirës i Ahtisaarit për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës nuk përmend në asnjë rast Rezolutën 1325 apo fjalën vajzat. "Gratë" përmenden një herë në referencën që ky propozim i bën CEDAW.[114]

"Rezoluta kërkon fuqimisht përfshirjen e grave në vendimmarrje, e në veçanti në negociata paqësore," vazhdon Rogova. "Liderët [e nivelit] vendor dhe ndërkombëtar, nuk duan ta paraqesin këtë. Ose, ata nuk duan që t'u japin grave hapësirë për të mbajtur pozita të tilla sepse thonë, 'kjo është detyrë e jona. Bisedimet për paqe janë detyrë e burrave." Rrjedhimisht, as ekipi ndërmjetësues e as delegacionet nuk kanë pasur fare këshilltarë gjinorë. Grave nuk u është ofruar apo dhënë as edhe status zyrtar për vëzhgimin e bisedimeve.[115] Arjeta Rexhaj bëri një përmbledhje:

> Që nga fundi i luftës, e veçanërisht gjatë periudhës kyçe të shtetformimit, kur filloi procesi i përcaktimit të së ardhmes së Kosovës, kërkesa kryesore e grave të Kosovës ishte ajo për pjesëmarrje në dialog dhe negociata. ... Gratë nuk ishin pjesë e diskutimeve për statusin final të Kosovës në Vjenë në vitin 2006. Më pastaj, në vitin 2007, Rrjeti i Grave të Kosovës dhe Lobi i Grave të Kosovës avokuan për përfaqësimin e grave në bisedimet për statusin final të Kosovës, siç parashihej me Rezolutën 1325. Propozimi i tyre që një politikane e njohur të përfshihet në ekipin negociator të Kosovës u injorua. Si rezultat i kësaj, dokumenti

përfundimtar për zgjidhjen e statusit të Kosovës u negociua mes përfaqësuesve të partive kryesore politike, duke lënë gratë jashtë këtij procesi. Ky dokument politik tejet i rëndësishëm rregullon sferat kryesore të shtetformimit dhe strukturat e institucioneve të Kosovës dhe të misioneve ndërkombëtare në Kosovë.[116]

“Ne e kemi Editën!” por...

“Pra, kjo është fitorja jonë. Ne punuam shumë për bisedimet e Vjenës, ndërsa e fituam dialogun e Brukselit.”

- Edita Tahiri, Zëvendëskryeministre për Politikë të Jashtme dhe Siguri Kombëtare dhe Udhëheqëse e Dialogut Teknik me Serbinë

“Dialogu Kosovë-Serbi nuk siguroi përfshirjen e perspektivës gjinore. Si proces negociator, ai nuk i’u përmbajt Rezolutës 1325 të OKB-së, pavarësisht se ajo u ndërmjetësua nga BE-ja. Nuk u sigurua as përfaqësimi i barabartë i grave në tryezën e negociatave. As organizatat e grave nuk u konsultuan për temat që duhet të jenë pjesë e procesit [siç janë] dhuna seksuale në konflikt, dëmshpërblimet, personat e zhdukur, drejtësia. Për më tepër, biseda se si do të ndikonte marrëveshja tek gratë dhe burrat, nuk u zhvillua kurrë.”

- Jeta Krasniqi, Menaxhere e Programit, Instituti Demokratik i Kosovës, 2020

“[Rezoluta 1325] ka të bëjë me njohjen e rolit dhe ndikimin që gratë kanë në zgjidhjen e konflikteve, [por] praktikisht është vetëm një copë letër. Në të vërtetë nuk është zbatuar kurrë! Është e margjinalizuar midis rezolutave të OKB-së.”

- Tijana Simiq LaValley, Zensko Pravo, 2020

"Ja ku e kemi sot Editën", thotë Rogova, "ne kemi lobuar aq shumë për të. Gjatë negociatave [të vitit 2006] ne dilnim në rrugë dhe brohorisnim 'Ne e kemi Editën! Pse nuk po e merrni atë?"[117] Edita Tahiri kishte përvojë në negociata që nga Konferenca e Marrëveshjes së Rambujesë në vitin 1999, si dhe nga angazhimi i saj në politikë të jashtme, në Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) gjatë viteve të 90-ta. Por, ajo mori postin e parë zyrtar diplomatik në Kosovën e pasluftës tek në vitin 2011, si Udhëheqëse e Dialogut Teknik me Serbinë. Pas pothuajse një dekade përpjekjesh të grave për të fituar një ulëse në tryezën e bisedimeve, ky mund u shpagua. Emërimi i Tahirit si udhëheqëse e Dialogut Teknik në vitin 2011 paraqiste një hap të fuqishëm drejt implementimit të Rezolutës 1325.

"Më duhet të them sot, në rrethanat aktuale, se gratë kanë bërë shumë progres, jo vetëm në Kosovë por anembanë botës," reflekton Tahiri në vitin 2011:

> Mendoj se kjo është një fitore falë punës sonë, ngase ishim të afta që t'ia dëshmojmë shoqërisë se gratë në Kosovë kanë kapacitet për të udhëhequr po aq sa edhe burrat. Nuk do të duhej të ketë kurrfarë diskriminimi në strukturat udhëheqëse [të shtetit]. Kjo është fitorja jonë. Ne punuam shumë për bisedimet e Vjenës. Ne fituam dialogun e Brukselit.

Deri tani, dialogu është zhvilluar në lidhje me 'çështje praktike' të cilat mund të 'përmirësojnë jetët e njerëzve', thotë Tahiri:

> Ne kemi filluar bisedat për lëvizjen e lirë, tregtinë e lirë, energjinë, telekomunikacionin. Më tej, po flasim për kthimin e dokumenteve të cilat Serbia i ka marrë nga Kosova gjatë luftës, siç janë regjistrat civilë dhe kadastri; dëmtimi gjatë luftës i monumenteve të trashëgimisë kulturore të Kosovës; çështja e personave të pagjetur, etj. Ne do të flasim edhe për transportin dhe çështjet tjera teknike.

"Deri në çfarë mase jeni në gjendje që të trajtoni çështje që kanë ndikim specifikisht tek gratë dhe vajzat brenda këtyre negociatave?" pyetëm ne në vitin 2011. Tahiri tha:

> Shikoni, kjo nuk ka qenë temë më vete, por jam e sigurt se në momentin e duhur do të shfaqet tema e dëmeve të luftës dhe ne do ta fillojmë këtë diskutim. ... Unë jam e përqendruar në dialogun, interesat dhe çështjet e ndryshme, por ndonjëherë unë mund të mos e kem parasysh se cilët janë interesat e grave. ... Ato do t'i kem parasysh gjatë bisedimeve për personat e pagjetur dhe dëmet e luftës; atëherë duhet të përqendrohemi në çështje të grave.[118]

Por koha për të "punuar për çështjen e grave", ose më saktë çështjet që gratë i konsiderojnë prioritet, nuk erdhi kurrë. Për më tepër, nuk ishte marrë mjaftueshëm në konsideratë fakti që dëmet nga lufta dhe personat e zhdukur e kanë afektuar jetën e grave dhe burrave ndryshe. Ndërsa Tahiri do të vazhdonte të drejtonte Dialogun Teknik me Serbinë deri në vitin 2017, koha do të tregonte që Tahiri rrallë ishte në gjendje të përdorte pozitën e saj për të mbrojtur çështje të rëndësishme për gratë. Edi Gusia, Kryeshefe Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGJ) në Zyrën e Kryeministrit theksoi në vitin 2020:

> Nëse shohim rajonin në përgjithësi, Kosova është në një farë mënyre lidere në lidhje me praninë e grave në proceset e paqes, si Edita Tahiri. Por ishte e rëndësishme që në atë proces negociatash të diskutohej çështja e të mbijetuarve të dhunës seksuale. Gjithashtu, çështja e personave të zhdukur është e rëndësishme, duke mbetur një nga pikat kryesore për t'u diskutuar në Dialog. Këto çështje duhet të ngrihen sepse ua kemi borxh burrave dhe grave të Kosovës.[119]

Një pjesë e problemit për Rogovën, ndër aktivistët e tjerë të intervistuar, ishte se Tahiri nuk u këshillua sa duhet me gra të ndryshme dhe grupe të të drejtave të grave për të dëgjuar shqetësimet e tyre dhe më pas të shtynte që ato çështje të diskutoheshin gjatë Dialogut. "Edita ishte duke e udhëhequr procesin, por ajo në fakt nuk po përfaqësonte nevojat e grave të Kosovës apo perspektivën feministe në Dialog", tha Zana Hoxha, Drejtore Ekzekutive e Artpolis.[120]

Ndërkohë, disa pjesëmarrës vunë re se natyra e Dialogut e bëri të vështirë për Tahirin të ngrinte çështje të rëndësishme për gratë. "Po, ne e kishim Edita Tahirin, por atëherë pyetja ishte ngritur [për përfshirjen e çështjeve të tjera], dhe sepse [Dialogu] u konsiderua në një nivel teknik,… ishte pak e vështirë të përfshiheshin interesat e grave," tha Yllka Soba.[121] Tahiri shpjegoi në vitin 2020:

> Në fillim të bisedimeve, para se të caktohej agjenda, si Kosovë, ne i paraqitëm kërkesat tona Bashkimit Evropian dhe Serbia gjithashtu paraqiti kërkesat e saj. Këto kërkesa përfshinin dëmshpërblimet e luftës brenda kornizës së të cilave ishin gratë e zhdukura, të dhunuara, dëmshpërblimet për vrasjet, dëmtimet fizike dhe dëmet shpirtërore dhe kulturore të Kosovës dhe popullatës shqiptare. Këto i prezantova në Bruksel. Kur u pajtuam se cilat kërkesa do të futeshin në rendin e ditës, duhej të pajtoheshin nga palët, sepse kërkesa e njërës palë nuk u bë agjendë [pikë] pa pëlqimin e palës tjetër. Është e njëjta gjë: Serbia gjithashtu kishte një lloj kërkese, por asnjë agjendë nuk u bë sepse ne nuk e pranuam atë. Ne u pajtuam për çështjet e të zhdukurve. Ne biseduam në një raund bisedimesh. Kisha me vete delegacionin shtetëror për të zhdukurit. Vetëm një herë u diskutua për këtë çështje. Kurrë më. Ne kërkuam hapjen e arkivave ushtarake shtetërore të Serbisë për të nxjerrë emrat e mbetur sepse atëherë, në vitin 2011, kishte 1.800 deri 1.900 [persona] të zhdukur. Kur kërkuam të dhëna, Serbia kurrë nuk i

> paraqiti ato. Gjithmonë shmangu prezantimin e saj, dhe kur Bashkimi Evropian nuk arriti ta detyronte atë në një farë mënyre, kjo temë u anashkalua. [Kur] pyetëm BE-në, ajo tha, "Serbia nuk po bashkëpunon dhe ne nuk mund ta detyrojmë atë". Sepse BE nuk kishte mekanizma të fortë siç kishte NATO në Rambuje. BE ka ndërmarrë masa të buta, të tilla si kushtëzimi i integrimit [në BE]. Por mos bashkëpunimi i Serbisë për çështje të rëndësishme ka bërë që kosovarët të kërkojnë krijimin e kapitullit të 35-të. Secili vend ka 34 [kapituj për t'u bashkuar me BE-në, por Serbia ka 35 kapituj. Ky kapitull [i fundit] merret me moszbatimin e asaj pjese të marrëveshjes [me Kosovën, përfshirë] çështjen e të zhdukurve.[122]

Kështu, Tahiri tha se ajo ngriti çështje të rëndësishme për gratë, siç është zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur, por që këto nuk janë adresuar ende. Ndërkohë, fakti që të dy palët duhej të binin dakord për pikat e rendit të ditës do të thoshte që disa çështje të rëndësishme për gratë, si dëmshpërblimet për të mbijetuarit e dhunës seksuale, nuk u diskutuan.

Në vitin 2017, mandati i Tahirit përfundoi dhe asnjë grua nuk përfaqësohej drejtpërdrejt në Dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Për më tepër, përqindja e grave në grupet e punës ka qenë mjaft e ulët. Nga 90 persona të angazhuar në grupe pune midis viteve 2011 dhe 2017, vetëm 16 përqind ishin gra.[123] Kjo u theksua në mënyrë të përsëritur në intervista si një dështim për të zbatuar Rezolutën 1325. Siç pasqyroi Thais Santa Cruz:

> Gjëja e parë që më vjen në mendje është delegacioni krejt mashkullor që u krijua për të drejtuar procesin e Dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në dhjetor 2018. Nëntë burra dhe asnjë grua e vetme! Ndërsa ka pasur disa raste emblematike në të cilat gratë kanë qenë në qendër të negociatave, të tilla si Edita Tahiri,

> ky mbetet përjashtim dhe jo rregull. Dhe gratë në Kosovë vazhdojnë të përjashtohen kur bëhet fjalë për proceset e negociatave të nivelit të lartë. Dhe tani kthehemi në 4 shtator 2020, kur angazhimet ekonomike "për të ecur përpara me normalizimin ekonomik" u nënshkruan midis Prishtinës dhe Beogradit në prani të Presidentit të SHBA [Trump]. Asnjë grua e vetme nuk ishte e pranishme. As rolet e grave në ndërtimin e paqes nuk u adresuan në dokumentin me dy faqe.[124]

Charle Cuellar kishte një këndvështrim të ngjashëm:

> Unë do të thoja që përfaqësimi i grave, përfshirë përfaqësimin e grave në negociatat ndërkombëtare për Kosovën nuk është me të vërtetë një rrefim suksesi. Fakti që çdo mundësi të vetme që Kosova ka pasur që të përfaqësohet ndërkombëtarisht ose të formojë Qeverinë, [Qeveria] ka dështuar të përfaqësojë gratë. Kosova është përplot me gra kompetente, të përgatitura, profesionale, të gatshme të luftojnë për një vend në vedimmarrje, por nuk janë lejuar. Përkundër ligjeve dhe politikave premtuese, nuk e arritëm atë që do të dëshironim të shihnim në Kosovë për sa i përket përfaqësimit të grave.[125]

"NGA MARGJINAT NË VIJË TË PARË"

"Ky margjinalizim na pengoi neve grave, në veçanti neve që ishim në politikë dhe lidereve të shoqërisë civile. Kësisoj, ne natyrisht filluam të krijojmë strategji për të sjellë gratë nga margjinat në plan të parë."

- Edita Tahiri, Zëvendëskryeministre për Politikë të Jashtme dhe Siguri Kombëtare, 2011

"Mund t'ua tregoj një ngjarje se si e fituam kuotën," rrëfen Tahiri duke iu referuar faktit se ligji për zgjedhje i Kosovës rezervon 30 për qind të ulëseve në parlament dhe në kuvende komunale për gjininë e nën reprezentuar, gra apo burra:

> Pas luftës, ekzistonte një tendencë e margjinalizimit të grave nga politika, përkundër faktit se gratë e Kosovës ishin të përfshira në të gjitha proceset, përfshirë ato të çlirimit, pavarësimit dhe forcimit të demokracisë. Ky margjinalizim na pengoi neve grave, në veçanti neve që ishim në politikë dhe lidereve të shoqërisë civile. Kësisoj, ne filluam të krijojmë strategji për të sjellë gratë nga margjinat në plan të parë. Dhe filluam avokimin për kuotën e përfaqësimit të grave. Gratë politikane dhe ato nga shoqëria civile kishin të njëjtin synim: fuqizimin e grave, duke filluar me fuqizimin në parlament.
>
> Synimi ynë u arrit në mënyrë shumë të çuditshme. Ne po prisnim të bisedojmë me partitë

politike të Kosovës, por edhe me UNMIK-un që udhëhiqte administratën ndërkombëtare në Kosovë, sepse ata nuk kishin paraparë ndonjë model për përfshirjen e grave në vendimmarrje. Fundja shumica prej tyre ishin vetë burra.

Deri në mbajtjen e zgjedhjeve të para vendore, ekzistonin struktura udhëheqëse komunale. Megjithatë, këto struktura ishin vetemëruar dhe nuk kishin kaluar nëpër ndonjë procedurë. Kështu që në Komunën e Prishtinës unë iniciova procedurën që ta zgjedhim një Kryetar deri në organizimin e zgjedhjeve. Unë propozova që Këshilli i Partive Politike, që përfshinte degët e lidershipit qendror të partive politike, të takohen dhe të votojnë për një Kryetar. Nuk ishte mënyra më demokratike por ishte më e mirë se sa të kemi një Kryetar Komune të vetemëruar. Në këtë formulë, të cilën arrita ta bind UNMIK-un që ta zbatojë në Prishtinë, unë isha kandidati i LDK-së. Kishte edhe kandidatë të tjerë nga partitë tjera politike, si për shembull, nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Unë fitova.

Por, shefi i UNMIK-ut, Kouchner, nuk ishte i gatshëm ta zbatojë këtë votim. Arsyeja e kësaj ishte konkurrenca mes LDK-së dhe forcave politike që përfaqësonin krahun e rezistencës së armatosur [që më vonë u bë PDK]. E pasi që LDK kishte fituar, ai tha "Nuk mund ta zbatoj këtë vendim sepse nëse ish-UÇK apo PDK nevrikoset me këtë, ata mund të vendosin të mos marrin fare pjesë në zgjedhje." Në vend të kësaj, Kouchneri propozoi formulën e kompromisit me dy kryetarë komunash: një nga LDK dhe një nga PDK. Unë e refuzova këtë propozim si absurd dhe jodemokratik. Pra, për shkak të stabilitetit, Kouchneri nuk deshi të më emërojë si Kryetare e Komunës së Prishtinës, megjithëse e kisha fituar përkrahjen e shumicës së partive politike. ...

Për këtë arsye, gratë e kritikuan Kouchnerin. Ai madje nuk mundi as të paraqitej në publik për disa ditë. Kurdo që ai mbante fjalime apo debate publike, ai kritikohej nga gratë. Një ditë erdhi dhe më tha, "Nuk mund ta duroj më këtë presion që po më bëhet nga gratë e Kosovës."

Unë i thashë, "Mendoj se gratë dinë të bëjnë gjëra të arsyeshme."

Pas kësaj një ditë më tha, "Çka mund të bëjë unë për gratë, në mënyrë që të lidh paqe me gratë e Kosovës dhe të mos kritikohem tërë kohën?"

Unë i thashë, "Ke rastin që të përkrahësh përcaktimin e kuotës së përfaqësimit të grave në institucione, duke ndarë për to 30 për qind të ulëseve në kuvende komunale dhe parlament. Nëse UNMIK-u e përkrah atë, edhe partitë politike do ta bëjnë të njëjtën gjë. Dhe me këtë fituam kuotën e përfaqësimit të grave fillimisht në kuvendet komunale e më pas edhe në Parlament."

Më pas, ne u pajtuam që ta organizojmë një konferencë ndërkombëtare në Kosovë, ku Kouchner dhe unë ishim folësit kryesorë. Kjo konferencë kishte për temë gratë në politikë. Konferenca u mbajt dhe morën pjesë gratë nga organizatat e ndryshme politike dhe nga shoqëria civile. Konkluzion kryesor i kësaj konference ishte përkrahja për kuotën e përfaqësimit të grave, në nivel prej 30 për qind.

Pas këtyre konkluzioneve, Kouchner ishte shumë aktiv dhe bëri që kjo kuotë të mishërohet në ligj. Në atë kohë, UNMIK-u ishte autoriteti që nxirrte ligjet në vend.

Për mua, kjo është një ngjarje tejet interesante. ... Sepse Kouchneri na dëmtoi në Komunën e Prishtinës duke kundërshtuar emërimin tim, por më pas deshi ta kompensonte këtë apo tu tregonte grave të Kosovës se ai nuk ishte kundër pjesëmarrjes së grave përmes kuotës.

> Më duhet të shtoj se ka pasur shumë keqinterpretime lidhur me atë se kush e ka lansuar kuotën. Ka ekzistuar edhe qëndrimi se kuota është sjellë si ide nga ndërkombëtarët. Më duhet të them se kuota ishte ide e jona sepse ne po kërkonim mënyra për të ikur nga margjinat e për tu kthyer në plan të parë.[126]

Kuota rregullon që së paku 30 për qind të kandidatëve në listat e partisë politike të jenë gra. Në përpjekje për të siguruar barazi gjinore, ajo gjithashtu kërkon që së paku 30 për qind të kandidatëve të jenë burra. Kuota u ka mundësuar grave që të sigurojnë 30 për qind të ulëseve në kuvende komunale dhe në parlament.[127] Ndikimi pozitiv i kësaj mase në 'përfaqësimin e shtuar dhe pjesëmarrjen adekuate të grave në qeverisje lokale dhe kombëtare' ishte evident.[128] Gratë siguruan vetëm 8 për qind të ulëseve në zgjedhjet e para komunale në vitin 2000, por kuota atyre u garantonte 30 për qind të tyre në zgjedhjet vijuese.[129] Më vonë, Ligji për Barazi Gjinore (i vitit 2004) do të kërkonte që meshkujt dhe femrat të mbajnë jo më pak se 40 për qind të pozitave në të gjitha nivelet vendimmarrëse por kjo nuk është zbatuar në praktikë.

Rritja e pjesëmarrjes së grave në të gjitha nivelet politike është çështje kyçe, por e pamjaftueshmne për demokraci dhe përfshirje të zërave të grave në vendimmarrje. Lobi i Grave të Kosovës, një grup *ad hoc* në të cilin u mblodhen gratë nga shoqëritë civile dhe politika për të diskutuar mbi brengat e përbashkëta, iu bashkua një koalicioni më të gjerë të quajtur Reforma 2004, për të kërkuar ndryshimin e sistemit zgjedhor në vitin 2003.[130] Ata kishin për qëllim adresimin e një sërë kritikash që po shfaqeshin në lidhje me kuotat dhe mënyrën 'se si ato mund të rezultojnë me numra por jo edhe cilësi'. Ne u tregonim se ky sistem do t'u mundësonte votuesve që të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar, shton Tahiri.[131] Ata besonin se një sistem me lista të hapura zgjedhore, në të cilin votuesit mund të përzgjedhin kandidatët dhe jo vetëm

partinë politike, do t'i mundësonte qytetarëve që të zgjedhin kandidatet gra dhe të kërkojnë përgjegjësi nga to. Edhe pse këto përpjekje nuk arritën suksesin e duhur me kohë për zgjedhjet e vitit 2004, sistemi i listave të hapura zgjedhore filloi së zbatuari në vitin 2007. Ky sistem mundësoi matjen e nivelit në të cilin qytetarët votuan për gratë përmes emrit dhe performancës, apo nëse gratë po fitonin ulëset falë kuotës së përcaktuar. Në vitin 2007, 43 për qind të grave në kuvend ishin zgjedhur individualisht, ndërsa në vitin 2010 në atë mënyrë janë zgjedhur 37 për qind.[132]

Në vitin 2011, kuota u rrezikua nga presioni që po bënte Komisioni Evropian (KE). Përfaqësuesi i KE-së në Komisionin Qendror Zgjedhor të Kosovës tha se kuota ishte 'jodemokratike'. Si përgjigjje, aktivistet për të drejta të grave pyetën nëse një parlament i dominuar nga burrat do të ishte demokratik. "Unë mendoj se liderët politik në Kosovë nuk do t'u jepnin grave hapësirë po të mos ishte kuota", theksoi Rogova:

> Në takimin e fundit kur e diskutuam sistemin zgjedhor, disa deputete na thanë: "Nuk na duhen kuotat." Ato nuk e kuptonin se sa të lehtë e kishin hyrjen në parlament përmes kuotës. Unë u thashë "Po të mos ishte kuota, ju nuk do të mund ta shkelnit as pragun e Kuvendit."[133]

Kuota ka përkrahës edhe mes burrave. Ish-Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, që tani ishte deputet, Behar Selimi pohoi: "Kuota është e domosdoshme deri sa të mos ndryshojë mentaliteti dhe ta kuptojmë se neve na nevojitet përfaqësim i mirëfilltë i grave."[134]

Në vitin 2015, Ligji i ri për Barazi Gjinore përcaktoi pjesëmarrjen e barabartë me përfaqësim 50 përqind të grave dhe burrave në të gjitha pozitat vendimmarrëse. Sidoqoftë, ligjet zgjedhore kanë mbetur të pandryshuara, duke mbajtur kuotën prej 30 përqind. Fatkeqësisht, partitë politike kanë zgjedhur t'a ndjekin Ligjin për Zgjedhje më shumë sesa Ligjin

për Barazi Gjinore. Kështu, sipas treguesve të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për pjesëmarrjen e grave si kandidate në zgjedhje,[135] në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010, gratë përbënin vetëm 33.6 përqind të kandidatëve,[136] dhe kjo ra në 34 përqind të kandidatëve në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017,[137] dhe vetëm 32 përqind në vitin 2019.[138] Ndërkohë, me përjashtim të zgjedhjeve lokale të vitit 2013, përqindja e votuesve gra mbetët vazhdimisht më e ulët se për burra (shih Grafikun 1).[139]

Grafiku 1. Përqindja e grave votuese 2009-2019



Megjithatë, kuota e grave e marrë veçmas si e tillë nuk u ka garantuar grave 'pjesëmarrje kuptimplotë' në nivele të ndryshme të vendimmarrjes.[140] Deri më 2020, vetëm një grua ka mbajtur pozitë të kryetares së komunës. Përkundër procesit të decentralizimit, rrjeti i 'djemve të vjetër' pranon direktivat drejtpërdrejt nga liderët e partive politike nga Prishtina. Partitë politike kanë tendencë të jenë ende të dominuara nga burrat dhe të centralizuara.[141] Sipas aktivistes për të drejtat e grave Sevdije Ahmeti, liderët e partive politike luajnë rolin e mjeshtrit të kukullave brenda procesit të vendimmarrjes. "Gratë janë të martuara me partitë politike. Ato vallëzojnë ashtu si e tërheq mbajtësen lideri i partisë politike. Askush nuk e vlerësoi të

domosdoshme implementimin e Rezolutës 1325 apo të CEDAW."[142] Ajo besonte se gratë po shfrytëzoheshin vetëm si kukulla me penj, si instrumente përmes të cilave paraqiten qëndrimet e burrave.

Madje edhe nëse jo të gjitha gratë parlamentare ishin të tilla, ato kishin vështirësi në sigurimin se sa do të dëgjohej zëri i tyre. Donika Kadaj, nga radhët e AAK-së, rikujton:

> [Gjatë një takimi me kolegët mi,] teshtiva, e pasi që askush nuk më tha 'shëndet', unë në mahi i thash vetes: "Shëndet."
>
> Kolegu im mu përgjigj, "Ti je grua, ti duhet të teshtish tri herë për të të thënë dikush shëndet". Kjo konfirmonte atë që ne po thoshim tërë kohës: ne duhet të punojmë dhe të kemi rezultate tri herë më të fuqishme për t'u konsideruar si të barabarta.[143]

Deputetja Teuta Sahatqija, ish-udhëheqëse e partisë Ora dhe deputete për tre mandate, pajtohet me këtë:

> Nëse brenda strukturës [së partisë] nuk ka asnjë grua të fortë, atëherë pa masa afirmative ato nuk mund të garojnë në kushte të barabarta me burrat. Pikënisjen nuk e kanë të njëjtë. Kjo është sikur po të kërkohej që burrat të nisen drejt majës së një ndërtese nga kati i njëzetë ndërsa gratë të nisen nga kati përdhesë.
>
> Parimisht, kur një grua flet, dy deri në tri herë më shumë vëmendje i kushtohet pamjes e veshjes se sa fjalëve të saj. Burrat gjithnjë do të buzëqeshin me sarkazëm. Thënë shkurt, në fillim gratë duhet të jenë shumë të forta në kuptim të të shprehurit në lidhje me një temë të caktuar, ndërsa burrat mund të flasin çfarë të donë.[144]

Fakti që gratë përballen me sfida të shtuara krahasuar me burrat për të hyrë në politikë ishte një temë e përsëritur midis grave politikane të intervistuara në vitin 2020. Kjo përfshinte

kërcënime dhe sulme. Mimoza Kusari-Lila, e vetmja grua kryetare e Komunës në Kosovë, tha këtë për kohën kur po kandidonte për pozitën e Kryetares së Komunës së Gjakovës: "Unë madje mbaj mend [politikanë burra] duke thënë që ne [do ta] frikësojmë [atë] me një fishekzjarr! Argumenti i forcës zakonisht vjen në diskutim."[145] Parlamentarja dhe më vonë Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani Sadriu, theksoi se gratë politikane duhet të mbijetojnë mes një "mentaliteti të muskujve":

> Të qenurit në pozita vendimmarrëse në vendin tonë, por edhe në të gjithë rajonin ku dominon mentaliteti patriarkal, vazhdon të mbetet sfiduese. Gratë në pozita vendimmarrëse përballen me shumë paragjykime, sulme dhe pengesa, si personalisht ashtu edhe profesionalisht. As unë nuk jam e përjashtuar nga pengesa e sulmeve të tilla, dhe fatkeqësisht kjo vlen edhe për koleget e tjera në pozitat vendimmarrëse. Unë nuk do të specifikoj një rast, sepse secili rast ka peshë të barabartë, për sa kohë që ndodh si rezultat i një mentaliteti muskulor. Sulmet dhe sfidat e tilla kanë qëllimin e vetëm të denigrimit dhe nënshtrimit të grave. Ajo që nuk duhet të lejojmë kurrë është të mos mbetemi pa mbështur njëra-tjetren në këtë betejë, ndërsa punojmë paralelisht për ndërgjegjësimin dhe emancipimin e shoqërisë në tërësi.

Fakti që shumica e vendimeve edhe më tej merren brenda partive politike dhe se partitë priren të udhëhiqen nga burrat, e ka kufizuar pjesëmarrjen 'kuptimplotë' të grave në proceset vendimmarrëse.[146] Siç theksoi aktivistja për të drejtat e grave:

> Partitë politike në Kosovë dhe lidershipi në përgjithësi janë akoma patriarkal në mënyrën se si qeverisin. Partitë politike nuk janë demokratizuar mjaftueshëm

> dhe kjo ka lejuar që patriarkia të hyjë në institucione. Kjo është pengesa [kryesore].[147]

Kuota nuk e ka siguruar domosdoshmërisht "përfaqësimin" e interesave të ndryshëm të grave në proceset vendimmarrëse. Për shembull, interesat e grave rome janë lënë anash, sipas aktivistes për të drejtat e grave rome Shpresa Agushi nga Rrjeti i Grave Rome, Ashkalike, Egjiptase (RROGRAEK):

> Pjesëmarrja e pabarabartë dhe pamjaftueshme e grave rome në pozita vendimmarrëse në nivel lokal dhe qendror ka pasur ndikim në mostrajtimin e çështjeve me të cilat përballeshin gratë rome në Kosovë, në kuptim të ligjeve dhe zhvillimeve politike, ekonomike dhe sociale. Kjo ndodh sepse qeveria e Kosovës dhe institucionet ndërkombëtare në Kosovë nuk i përfshijnë gratë e të gjitha grupeve etnike në Kosovë, e veçanërisht lënë anash gratë rome. ... Nuk ka marrëdhënie bashkëpunimi mes OJQ-ve të grave rome dhe Kuvendit, ministrive të Kosovës dhe UNMIK-ut në lidhje me paraqitjen e brengave dhe propozimeve të grave dhe vajzave rome.[148]

Aktivistja malazeze për të drejtat e grave Snezhana Karaxhiq tha se gratë nga pakicat etnike përballen në përgjithësi me pengesa të shumta në kuptim të pjesëmarrjes në proceset vendimmarrëse.[149] "Unë kam shumë pengesa," thotë ajo. "Pak a shumë ne të gjitha jemi të vetme."

Ndërkohë, Resmije Rrahmani një aktiviste për të drejtat e grave me aftësi të kufizuara nga Organizata për Personat me Distrofi Muskulare të Kosovës (OPDMK) vuri në dukje se kuota ofron pak ndihmë për gratë, aq më pak për gratë me aftësi të kufizuara, që të përfshihen, veçanërisht në një mjedis të dominuar nga burrat:

> [Ne] kemi parë shumë hezitim për t'u përfshirë në politikë ose vendimmarrje dhe [për] të lobuar për gra të tjera. Ka shumë dyshime. Ne e dimë që numri i grave në politikë është tashmë i ulët dhe ne jemi të vetëdijshme për pengesat me të cilat përballen dhe mungesën e mbështetjes që marrin nga kolegët e tyre burra. Për më tepër, ato janë larg mbështetjes së njëra-tjetres. Kjo është arsyeja pse shumë gra dhe vajza me aftësi të kufizuara madje refuzojnë të përfshihen në politikë.[150]

Nuk është identifikuar asnjë rast i ndonjë gruaje me aftësi të kufizuar të ketë pasur ulëse në kuvend.

Përveç kësaj, "Nuk domethënë që të gjitha gratë të jenë në gjendje t'i përfaqësojnë të drejtat e grave," na tha Theodora Krumova, ish-pikë qendrore për çështje gjinore në OSBE.

"Kishte raste kur gratë nuk bënin dallim mes qëndrimit të partisë së tyre dhe qëndrimit të tyre si gra," pranoi Teuta Sahatqija.[151] "Kjo do të thotë se asokohe partia ishte prioritet ngase ishte koha e shtetndërtimit dhe [punës drejt] pavarësisë së Kosovës." Shtetësia konsiderohej si fokus primar ndërsa barazia gjinore si çështje e ndarë dhe sekondare, dhe nuk trajtohej në tërë procesin e shtetndërtimit të Kosovës. Një kritikë që vazhdon të shfaqet, posaçërisht në vitin 2011, është masa deri në të cilën gratë paraqesin brengat e grave të zhvilluara në debatet politike.

"Në fillim," Macula, ish pjesëtare e UN Women, kujton, "kur filluam të punojmë me gratë politikane për t'i bërë ato më të drejtpërdrejta dhe për t'i trajnuar, disa prej tyre thoshin: 'Ne kemi miq në parti. Ata nuk do të na zhgënjejnë!'"[152] Gratë kishin tendencë të besonin se burrat në partinë e tyre do të mbronin interesat e grave. Vetëm me kalimin e kohës ato filluan të shtyjnë përpara çështje në lidhje me prioritetet e grave.

Arritja e përfshirjes së një numri të konsiderueshëm të grave në vendimmarrje mund të jetë e rëndësishme për të

arritur tek ndryshimet, konstaton Osnat Lubrani, ish-Përfaqësuese Rezidente e UNDP-së:

> Kur gratë gjenden në numër më të vogël mes burrave, ato ndihen nën presion për ta ndarë të njëjtën perspektivë apo qasje me shumicën. Në vendet si Norvegjia, ku gratë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme në qarqet vendimmarrëse, ato janë më të përkushtuara drejt mbrojtjes së mirëfilltë të çështjeve gjinore dhe çështjeve të tjera me interes për gratë. Krijimi i një baraspeshe mes perspektivave të grave dhe burrave është e një rëndësie të veçantë.[153]

Përfshirja e një numri të konsiderueshëm të grave në vendimmarrje është e rëndësishme për t'u siguruar se zërat e grave do të dëgjohen në proceset vendimmarrëse.

Në këtë drejtim, deputetet janë angazhuar për t'a rijetësuar grupin joformal parlamentar të grave. Ky grup fillimisht është themeluar në vitin 2005, por ndonjëherë gratë parlamentare janë ndeshur mes veti për shkak të interesave të partive politike të tyre. Konkurrenca mes grave gjithashtu ka penguar avokimin e përbashkët. "Gjëja më e shëmtuar është fakti se gratë ende dëmtojnë njëra-tjetrën," thotë Shpresa Agushi.[154] "Ne jemi duke e censuruar vetveten." Rexhaj pajtohet me të, "Gratë shpesh sulmohen nga vetë gratë."[155]

Gratë i kanë lënë anash dallimet e tyre, janë bashkuar në fillim të vitit 2011 dhe i kanë dhënë grupit parlamentar të grave një emër të ri: Grupi i Grave Deputete të Kosovës. Ka shpresë se tani, në vitin 2011, gratë do t'i tejkalojnë kufizimet partiake për të adresuar çështje që paraqesin brengën përbashkët për të gjitha gratë. "Uniteti jonë është arma jonë," komentoi deputetja Kadaj. "Ne jemi grupi më i madh në Kuvend. Ne ftuam gratë që të jenë pjesë e këtij grupi, dhe ato na janë bashkangjitur pa dallim partiak apo etnik. ... Tema jonë kryesore dhe fokusi i agjendës sonë qëndron në krijimin e një pakoje legjislative për çështjet gjinore dhe të hapësirës

adekuate për trajtimin e tyre."[156] Gjatë dekadës së fundit, ato kanë vazhduar punën drejt këtyre qëllimeve të përbashkëta.[157]

Grupi i Grave Deputete ka krijuar një plan që përbëhet nga tema të ndryshme dhe nga një strategji, sipas së cilës, në secilën seancë parlamentare ndonjëra nga deputetet duhet të ngrisë çështje që ndikojnë tek gratë.[158] Deri tani gratë kanë ngritur çështje si përfshirja e grave në Radio Televizionin e Kosovës (RTK), qasja e vajzave në arsim, ligji i punës, mbrojtja nga kanceri, numri i pamjaftueshëm i ambasadoreve të emëruara, dhe shfrytëzimi i emrave mashkullor për emërimin e shkollave dhe rrugëve, njohja e të mbijetuarave të dhunës seksuale, kriminalizimi i dhunës me bazë gjinore dhe përfshirja e vëmendjes ndaj barazisë gjinore brenda kodit civil.[159]

Gratë kanë pasur ndikim, sipas Donika Kadajt "Shumë grupe parlamentare kryesohen nga burrat, të cilët edhe flasin zyrtarisht para mediave, është krijuar bindja se kjo është kryesisht punë e burrave," tha ajo. "Megjithatë, nëse lexoni transkriptet e punës së kryer në komitete do të kuptoni se një pjesë e madhe e punës cilësore kryhet nga gratë."

Ndoshta votuesit e kanë pranuar këtë, pasi numri i grave të zgjedhura drejtpërdrejt në Kuvendin e Kosovës gjithashtu është rritur viteve të fundit. Gratë që fillimisht fituan vende falë kuotës, më vonë morën votat e nevojshme nga populli. Në zgjedhjet e vitit 2019, 26 nga 39 (67 përqind) gra në Kuvendin e Kosovës hynë pa kuota, krahasuar me vetëm 16 nga 37 në 2007 (35 përqind).[160] Siç theksoi Osmani Sadriu gjatë Javës vjetore të Grave të organizuar nga Instituti Demokratik Kombëtar:

> Ne si gra duhet ta kuptojmë se të gjitha ne që kemi këto vende në vendimmarrje nuk është diçka që mjafton. Nuk ka të bëjë vetëm me të qenit i pranishëm. Ka të bëjë me sigurimin që zëri ynë të dëgjohet, kështu që nuk jemi thjesht një numër diku. Është shumë e rëndësishme që ne ta përdorim atë mundësi për të zgjidhur problemet me të cilat merren qytetarët tanë. Dhe unë mendoj se gratë në Kosovë, në Kuvend dhe

gjetkë dhe në zyrën e Presidentit po tregojnë saktësisht se, ne sjellim cilësi, ne zgjidhim probleme, ne kontribuojmë në zgjidhjen e çështjeve që merren me jetën e përditshme të qytetarëve në një cilësi shumë më të lartë se shumë burra të tjerë në politikë. Kjo duhet të njihet dhe duhet ta themi me zë të lartë, sepse vetëm kështu ndërtojmë rrugën për gratë e tjera që do të vijnë në pozita udhëheqëse në të ardhmen dhe do të bëjnë punë të jashtëzakonshme.[161]

Një faktor tjetër që kontribuon në fuqizimin e pjesëmarrjes së grave në kuvend, si dhe në asambletë komunale, ka qenë Lobi i Kosovës për Barazi Gjinore dhe disa fushata të hapura të ndërmarra nga gratë në shoqërinë civile, duke inkurajuar zgjedhjen e më shumë grave në politikë. Rogova kujtoi se kur filloi Lobi, "Gratë e reja në partitë politike refuzuan të shkonin në debate. Kishte gra deputete që nuk thanë asnjë fjalë. "Me mbështetjen dhe fuqizimin nga gratë e tjera, shumë gra janë bërë avokate të zëshme brenda asambleve komunale, dhe disa kanë kandiduar për pozita në kuvend. Siç kujtoi Kusari-Lila kohët e fundit: "Unë fillova udhëtimin e parë drejt barazisë gjinore me ftesën e Igballe Rogovës (Igo), dy dekada më parë, në vitin 2002."[162] Fuqizimi i prapaskenave të grave në thirrjet telefonike të natës vonë, mesazhet në mediat sociale dhe solidariteti në zgjidhjen e problemeve rrallëherë shihen dhe shpesh nuk tregohen, përveç rezultateve shumë publike të pjesëmarrjes së shtuar të grave në nivele të shumta të politikës.

Në vitin 2011, Atifete Jahjaga u zgjodh Presidentja e parë e Kosovës, duke tejkaluar kësisoj të gjitha stereotipet dhe duke 'paraqitur një shembull për rajonin.' Mbajtja e postit të Presidentes nga Atifete Jahjaga është shembull i progresit sa i përket pjesëmarrjes së grave në politikë. [163] "Tani kemi Presidente, dhe jemi të parët në rajon. Kemi dy zëvendëskryeministre. Kemi tri gra në ... kabinetin e ministrave," numëron Qosaj-Mustafa të arriturat e grave sa i

përket mbajtjes së pozitave vendimmarrëse në vitin 2011 (shih tabelën 3).[164]

Tabela 3. Gratë në pozita vendimmarrëse në Kosovë

Posti	2011		2020	
	Gra	Burra	Gra	Burra
Presidentë	1 17%	5 83%	2 29%	5 81%
Kryeministra	0 0%	6 100%	0 0%	9 100%
Zëvendëskryeministra	2 33%	4 67%	5 20%	20 80%
Ministra	2 11%	17 89%	16 15%	91 85%
Zyra e Kryeministrit	46[165] 31%	102 69%	43 27%	117[166] 73%
Zëvendësministra	0 0%	33 100%		
Misione jashtë vendit	13 18%	59 72%	274 26%	797 74%
Të gjitha institucionet (2007)	6,013 37%	10,711 63%		

Megjithëse Presidentja shërbente si një imazh pozitiv i një gruaje në pozitë udhëheqëse, aftësia e saj për t'u siguruar se nevojat dhe interesat e grave të Kosovës do të merren parasysh ishte kufizuar nga sistemi politik i vendit, tha Qosaj-Mustafa, e cila shërbeu si Këshilltare Politike e Presidentes për Çështje Juridike. "Presidenca varet nga mandati që i jepet, do të thotë nga sistemi parlamentar," komentoi ajo. "Kjo do të thotë se veprimet tona janë të kufizuara në kuptim të sigurimit të funksionimit të institucioneve dhe shpalljes së ligjeve. Të gjitha ligjet që ne nuk i miratojmë mund të vazhdojnë të zbatohen edhe pa pëlqimin tonë. Ndërsa dega ekzekutive vuan nga nënpërfaqësimi i grave. Deri sa të mos kemi një ndryshim të filozofisë të mënyrës së të menduarit tek liderët politik, nuk do të mund të ndryshojmë shumë," tha ajo në përfundim.

Presidentja Jahjaga e përdori mandatin e saj për të ngritur dhe adresuar nevojat e të mbijetuarave të dhunës seksuale të kryer gjatë luftës. Ajo ka punuar ngushtë me grupet e të drejtave të grave që kanë ekspertizë për këtë çështje për të krijuar Këshillin Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës, i cili mbështeste miratimin e Ligjit që njeh dhe cakton përfitime shtetërore për të mbijetuarit. Ajo gjithashtu nisi krijimin e Komisionit Kombëtar për Verifikimin dhe Njohjen e Statusit së Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës dhe e kishte mbështetur këtë çështje ndërkombëtarisht.[167]

Në përgjithësi, gratë vazhduan të lëvizin nga margjinat kah qendra, me më shumë gra që merrnin pjesë në procese vendimmarrëse në vitin 2020 se sa në vitin 2011, ose në vitin 2000. Vënia e kuotës, zgjedhja e Presidentes, pozicionimi i Edita Tahirit si kryenegociatore, angazhimi i Vjosa Osmani Sadriut si Presidente në detyrë (më vonë Presidente), mbajtja e disa pozitave tjera të larta, dhe ndryshimi i ngadaltë i perceptimit mbi gratë politikane janë të gjitha shenja të një ndryshimi pozitiv. Ripërtrirja i Grupit të Grave Deputete paraqet një hap tjetër pozitiv drejt përfaqësimit të çështjeve me rëndësi për gratë brenda proceseve të vendimmarrjes. Ato kanë kontribuar në zbatimin e Rezolutës 1325 përmes lobimit dhe përkushtimit të palëkundur për të jetësuar këtë dokument të shkruar. Siç reflektoi Tahiri më 2020:

> Nëse i rishikojmë 20 vitet e fundit të zbatimit të Rezolutës 1325, mund të them se ka pasur arritje në disa fusha dhe në disa nivele të zbatimit, por mendoj se ka qenë një proces shumë i ngadaltë, dhe, më e rëndësishmja, nuk ka qenë thelbësore në kuptimin e sigurimit të fuqizimit të qëndrueshëm për gratë. Ne kemi parë fuqizim. Sidoqoftë, ka pasur tendenca në rritje dhe rënie. Kjo ka ndodhur posaçërisht në fushën e qeverisjes. Ne kemi arritur të sjellim gratë në Kuvend përmes kuotës. Edhe pse një mekanizëm artificial, ne u kemi ofruar mundësinë atyre që të fitojnë përvojë

politike, kapacitet politik, i cili po sjell më shumë gra në qeveri. Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për qeverisjen, problemi kryesor ka qenë gjithmonë paqëndrueshmëria.[168]

Institucionet e Kosovës: integrimi direkt apo "indirekt" i gjinisë?

"Në përgjithësi, ka mungesë të gatishmërisë qeveritare dhe politike. Edhe pse ata kanë ABGJ-në, ata nuk e integrojnë gjininë direkt [por më tepër] indirekt."

- Ariana Qosaj-Mustafa, 2020

Kushtetuta e Kosovës e konsideron barazinë gjinore si një nga vlerat fundamentale, ndërsa pjesëmarrja paraqet një nga manifestimet më evidente të saj. Ajo përfshinë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). Ligji për Barazi Gjinore, i miratuar në vitin 2004 bëri thirrje për 'mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e femrave dhe meshkujve në sferën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat tjera të jetës shoqërore.'[169] Kësisoj, Kuvendi i Kosovës, shërbimi civil, Këshilli Gjyqësor dhe Gjykata Kushtetuese, mes tjerash, duhet të sigurojnë respektimin e parimeve të barazisë gjinore. Temat e trajtuara në Ligjin fillestar për Barazinë Gjinore ishin të gjera, gjë që ka bërë që shumë individë ta shohin atë më shumë si një listë dëshirash se sa një ligj të zbatueshëm.

Ligji konsideroi se kushti i barazisë gjinore plotësohet në rast se pjesëmarrja e burrave dhe grave në të gjitha institucionet dhe të gjitha nivelet e autoritetit arrin 40 për qind.[170] Dyzet kundër gjashtëdhjetë nuk është se mund të konsiderohet si barazi. Megjithatë, ky cak është mjaft mbresëlënës, duke pasur parasysh faktin se vendet anëtare të BE-së që kanë kuota të cilat në përgjithësi janë në nivel mes 30 dhe 50 për qind.[171] Ky ligj përcakton se barazia gjinore

duhet të merret parasysh gjatë emërimeve në institucione dhe ndërmarrje publike dhe gjatë emërtimit të rrugëve.[172] Ai kërkoi nga të gjitha institucionet publike dhe private që të ofrojnë mundësi të barabarta punësimi për gratë dhe burrat. Pas avokimit të gjerë në emër të aktivistëve për të drejtat e grave, Ligji gjithashtu krijoi Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ) brenda Zyrës së Kryeministrit, që në aspektin teorik do të thotë – në nivelin më të lartë të mundshëm.

ABGJ-ja është krijuar në vitin 2005 me qëllim të zbatimit dhe monitorimit të zbatimit të Ligjit për Barazinë Gjinore, promovimit të politikave për arritjen e barazisë gjinore, propozimit të hulumtimeve në çështje që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe angazhimit për ta përmirësuar nivelin e vetëdijes për barazinë gjinore, etj.[173] Mehdi Geci përshkuan detyrat e tij në ABGJ:

> Unë duhet të marr pjesë në të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore. Ne marrim pjesë në grupe punuese; përgatisim komentare, sygjerime dhe rekomandime. Ne jemi të obliguar edhe të marrim pjesë në të gjitha komisionet parlamentare dhe të jemi aktiv duke dhënë sugjerime dhe rekomandime për ligjet në fjalë.[174]

Megjithatë, ai u përball me sfida. ABGJ nuk ka pasur burime të mjaftueshme. "Pengesa e parë ishte numri i vogël i njerëzve të punësuar në Agjenci". Ne tani përballemi me mungesë kapacitetesh." Këto mangësi ishin të ditura qysh në vitin 2007 për Arjeta Rexhajn: "Ne kemi pritur shumë nga ky institucion, por aty nuk kishte njerëz të kualifikuar." Ajo shtoi, "Zyrtarët për barazi gjinore në Prishtinë nuk bashkëpunojnë me ne sa duhet. Ne kemi njëfarë bashkëpunimi, por ata nuk marrin iniciativa për zbatimin e Rezolutës apo ligjeve."[175] Në vitin 2007 Vuniqi pajtohej:

> Është e pabesueshme: ata nuk e kuptojnë rolin e tyre dhe rolin e shoqërisë civile. Për shembull ata

organizojnë tryeza të rrumbullakëta dhe aktivitete të cilat do të duhej organizuar nga organizatat e grave. Ata do duhej të krijojnë politika, tu ndihmojnë organizatave të grave në punën e tyre, dhe të monitorojnë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, Ligjit Kundër Diskriminimit, etj. ... E kuptoj se ata nuk kanë shumë autoritet, se kanë pak përkrahje, buxhet, staf dhe mungesë kapacitetesh.[176]

Më 2007, pjesëmarrësit në hulumtim shprehën brengat e tyre lidhur me faktin se kjo agjenci do duhej të jetë e pavarur, por mbetej e ndikuar ndaj ndërhyrjeve politike. Për emërimin e Kryeshefit Ekzekutiv me kontratë të përhershme u deshën gjashtë vite. Kandidati që u zgjedh më në fund në vitin 2011, ishte i afërm i një politikani, ishte i ri dhe i papërvojë për të bërë presion për zbatimin e Ligjit ambicioz Kundër Diskriminimit, theksuan aktivistet. Zyrtarët komunal për barazi gjinore dhe pikat qendrore për çështje gjinore të emëruara nëpër ministri dhe komuna gjithashtu duket të kenë mungesë njohurish, financim të pamjaftueshëm dhe janë nën ndikim politik, gjë që bën që të mos jenë në gjendje që të avancojnë barazinë gjinore.[177]

"Ishte gabim i madh që u mendua se barazia gjinore do të arrihej vetëm me krijimin e Agjencisë për Barazi Gjinore," shton Besim M. Kajtazi, Drejtor i Departamentit për të Drejtat e Njeriut në zyrën e Kryeministrit, më 2011. Rautio u pajtua me këtë, "Shpresoj se e tërë makineria gjinore do të forcohet sepse për momentin nuk po funksionon si duhet. Ajo është e fragmentuar dhe duket e margjinalizuar."

Përkundër një liste të gjatë kritikash të dëgjuara në vitin 2011, lista e ABGJ-së me të arritura është rritur me kalimin e kohës. Në vitet e fundit, këto kanë korresponduar me emërimin e një Kryeshefeje Ekzekutive të ditur dhe të aftë, Edi Gusia. Disa nga përpjekjet e shumta të ABGJ-së kanë përfshirë bashkëpunimin me RrGK-në për të kryer hulumtime dhe monitorime të rregullta mbi dhunën në familje në vitin 2008 (gjithashtu me UNDP), në vitet 2015 dhe 2020. Shfrytëzimi i

këtyre provave dhe përfshirja e një grupi të larmishëm palësh të interesuara, përfshirë ekspertë të shoqërisë civile në grupe pune për hartimin e Ligjit të ri për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe dy strategji dhe plane veprimi kombëtar për të adresuar dhunën në familje. Së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, ata krijuan një mekanizëm monitorimi, Koordinatorin Kombëtar për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Së bashku me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ABGJ-ja prezantoi një masë lehtësuese duke i liruar bashkëshortët nga pagesa shtesë nëse regjistronin pronën në emër të të dy bashkëshortëve. ABGJ ka bashkëpunuar me Zyrën e Statistikave të Kosovës (ZSK), më vonë Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe ka financuar hulumtime për përdorimin e armëve të lehta në Kosovë.

Në vitin 2015, ABGJ udhëhoqi procesin e ndryshimit të Ligjit për Barazi Gjinore, i cili përfshiu një proces konsultativ bazuar në mësimet e nxjerra nga Ligji i parë. Ligji i ri kërkon integrimin gjinor të të gjitha politikave, dokumenteve dhe legjislacionit; buxhetimin e përgjegjshëm gjinor; dhe se proceset e përzgjedhjes, rekrutimit dhe emërimit, përfshirë pozitat drejtuese, sigurojnë përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave, të përcaktuar si 50 përqind.[178] ABGJ ka udhëhequr hartimin e Programeve për Barazi Gjinore dhe planet e veprimit bazuar në kornizën ligjore dhe duke përfshirë procese shumë konsultative.

Lidhur posaçërisht me zbatimin e Rezolutës 1325, Gusia kujtoi:

> Në vitin 2013, ABGJ me mbështetjen e UN Women hartoi Planin e parë të Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Ishte një plan veprimi dy-vjeçar. Janë zhvilluar dy raporte monitorimi, dhe për herë të parë një strategji që synon avancimin e barazisë gjinore është financuar nga Qeveria e Kosovës në nivelin 51 përqind. Gjithashtu, niveli i zbatimit të aktiviteteve të këtij plani veprimi ka arritur 79 për qind… që është një arritje e madhe.

> Prandaj, ne mund ta konsiderojmë atë si diçka pozitive në ndërtimin e shtetit të Kosovës pas vitit 2008. Për më tepër, parimet e Rezolutës 1325 janë inkorporuar, gjë që dëshmon vullnetin e institucioneve për të zbatuar vazhdimisht Rezolutën 1325.[179]

Ndërsa Plani i Veprimit për Rezolutën 1325 skadoi në vitin 2015, Rezoluta 1325 u përmend në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore.[180]

Në vitin 2020, ABGJ shënoi 15 vjetorin, gjatë së cilit Rogova vlerësoi punën e saj: "ABGJ është një nga tre faktorët kryesorë në bashkëpunimin drejt arritjes së barazisë gjinore në Kosovë, së bashku me donatorët dhe organizatat e grave".[181]

Mes shumë arritjeve, disa aktivistë shprehën shqetësimin se qeveria ende nuk e konsideron barazinë gjinore si një prioritet dhe nuk ka caktuar financimin e duhur për zbatimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore. Siç vërejti Qosaj-Mustafa më 2020:

> OJQ-të e grave janë duke e shtyrë shumë dhe e kanë shfrytëzuar Rezolutën 1325. Dhe unë e kam parë atë edhe në qeveri. Ne kemi ABGJ-në por kjo nuk është ndjekur domosdoshmërisht me zbatim. Dhe sfida në dekadën e fundit në Kosovë ka qenë, mendoj, tendenca për të hartuar shumë plane veprimi por duke mos i ndjekur me veprime dhe buxhet ... Jo se tani kemi një plan veprimi për Rezolutën 1325, që mendoj se është një boshllëk i madh për Kosovën akoma. Ne kemi një kapitull për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Unë kam qenë konsulente lokale me ABGJ-në për ta hartuar atë si pjesë të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, … që është reflektuese deri diku në Rezolutën 1325, dhe ne përdorëm Rezolutën 1325 kur hartuam skemën e Programit. Por do të na duhej një plan veprimi gjithashtu për Rezolutën 1325 sepse do të ishte më specifik dhe më i saktë.

> Në përgjithësi, ka mungesë të gatishmërisë së qeverisë dhe politikës. Edhe pse kanë ABGJ-në, ata nuk e integrojnë direkt [por përkundrazi] indirekt gjininë. ABGJ është atje. Ata do të hartojnë këtë plan veprimi. Ata do të… mbikëqyrin monitorimin. Por kur nuk i vendosni burimet atje për t'a zbatuar [nuk do të zbatohet] ... dhe mendoj se problemi i përgjithshëm zakonisht mbështetet te donatorët. Unë mendoj se atëherë, patjetër, ne nuk po tregojmë se ekziston një gatishmëri politike për të shtyrë përpara zbatimin. Gjithashtu, unë mendoj se ndonjëherë ekziston edhe kjo ide se Kosova ende nuk është pjesë e OKB-së, dhe ata thonë, "Po pse duhet të shqetësohemi për Rezolutën 1325? Sepse ky është një dokument i OKB-së, dhe Kosova ende nuk është pjesë e OKB-së."[182]

Kështu, ndarja joadekuate e buxhetit për implementim të Rezolutës 1325, shtyrja përpara e barazisë gjinore në përgjithësi dhe mungesa e vullnetit politik të ndërlidhur do të mbesin sfida kryesore.

Sidoqoftë, fakti që ABGJ-ja ekziston, në nivelin më të lartë të mundshëm të vendimmarrjes brenda Zyrës së Kryeministrit, dhe përgjatë kohës ka fituar fuqi, ishte një sukses i përmendur në mënyrë të përsëritur. Siç Cuellar përmblodhi:

> Edhe pse nuk mund të themi se Qeveria e Kosovës e ka zbatimin e Rezolutës 1325 si prioritet në agjendën e tyre politike, diqka është bërë. Agjencia për Barazi Gjinore është e vendosur brenda Zyrës së Kryeministrit, në përputhje me praktikat ndërkombëtare. Ne gjithashtu kemi zyrtarë për çështje gjinore në ministri dhe komuna të ndryshme. Struktura e makinerisë gjinore nuk është vënë në pyetje nga asnjë prej qeverive. Kjo tregon se i është kushtuar rëndësi avancimit të barazisë gjinore. Megjithatë, kur vie momenti të merren vendime për transformime gjinore në përputhje me Rezolutën, qeveritë e kaluara

të Kosovës duhej të shtyheshin, shumicën e kohës nga organizatat e shoqërisë civile të grave dhe/ose organizatat ndërkombëtare. Meritat [e qeverisë] mbi për zbatimin e Rezolutës janë të diskutueshme.[183]

Siguria: "Kjo është botë e burrave"

"Sistemi i sigurisë është sistem i dominuar nga burrat. Kërkimi i përfshirjes së grave, respektivisht Editës, në Këshillin Kombëtar të Sigurimit për mua paraqet një proces të vazhdueshëm. Unë për këtë kam punuar tri vjet. Madje as nga komuniteti ndërkombëtar nuk më është dhënë ndonjë përgjigje e qartë. Kur fillova të flas në lidhje me legjislacionin që do të rregullonte sigurinë kombëtare, askush nuk donte të fliste me mua sepse kjo është 'punë burrash', siç thotë ajo kënga It's a man's world".

- Arjeta Rexhaj, Këshilltare politike e Zëvendëskryeministres Edita Tahiri, 2011

Policët po pështpëritnin mes vete në gardërobë. Atifete Jahjaga posa ishte promovuar në rangun e Gjeneral-Majores. Ajo ishte gruaja e parë në Kosovë që mbante një pozitë të atij rangu në Policinë e Kosovës. Kolegët e saj shprehnin pakënaqësi dhe nuk merrnin parasysh një dekadë të tërë shërbimi në polici, faktin se i kishte kaluar të gjitha testet dhe se ishte ngjitur në shkallën e oficeres nga majorja në kolonel dhe më pas në Gjeneral Majore.

"Nuk kisha ide për çështjen e implementimit të perspektivës gjinore," komentoi disa vite më vonë ish-Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës Behar Selimi: "Këto dy gra, [Flora Macula dhe Igballe Rogova], ma shpjeguan këtë gjë dhe më pastaj filluam të punojmë së bashku për një barazi më të theksuar gjinore dhe për integrimin e çështjeve gjinore brenda policisë." Duke shfrytëzuar këtë njohuri të fituar, Selimi më pas kërkoi nga kolegët e tij në polici që ta promovojnë një grua e

cila posedon të njëjtin nivel të dijenisë. "Ajo i kaloi të gjitha provimet," Selimi u tha kolegëve të tij, "Ajo është punëtore e madhe. Përse të mos e ketë të njëjtën gradë me mua?"

Dikur zyrtarët policorë u tërhoqën sepse nuk kishte kurrfarë arsyetimi logjik për të kërkuar çfarëdo tjetër. Por pështpërimat në gardërobë vazhdonin, ndërsa policët mundoheshin ta kuptojnë përse një grua të promovohej në një gradë të tillë.

E Gjeneral Majore Atifete Jahjaga jo vetëm që do të përpilonte strategjinë e parë pesëvjeçare të Policisë së Kosovës, përkrah me kolegen e saj Togeren Tahire Haxholli, por më vonë do t'i shërbente vendit të saj si Presidentja e parë e Kosovës, por edhe si presidentja e parë në tërë rajonin.

Pjesëmarrja e barabartë e grave në sektorin e drejtësisë, sigurisë dhe shërbimit të jashtëm është kyçe për përforcimin e sigurisë fizike dhe sigurisë së grave dhe vajzave. [184] Përfshirja e grave në këta sektorë, siç thotë Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, mund të shërbejë si "mënyrë për të siguruar se sektorët e sigurisë, drejtësisë dhe shërbimit të jashtëm marrin parasysh brengat e grave." Pjesëmarrja e barabartë nuk ngërthen në vete vetëm mundësitë e barabarta për gra të kualifikuara për pozita të caktuara, por edhe nxjerrjen e rezultateve më të mira të mundshme nga angazhimi i tyre. Numri më i madh i grave mundëson integrimin më të mirë të brengave gjinore. Në disa raste, gratë mund të sigurojnë një mjedis të sigurt për gratë tjera të cilat duhet të flasin për vepra të caktuara penale. Hysni Shala, Toger i Policisë së Kosovës dhe Koordinator për të Drejtat e Njeriut në vitin 2011 na tha:

> Qytetarët e Kosovës kanë kërkesa të ndryshme, varësisht nga gjinia e tyre. Kur viktima është e gjinisë femërore, ne presim që edhe personi që e trajton rastin në fjalë të jetë femër. Ne kemi pasur raste kur policet kanë marrë informata të cilat kurrë nuk do t'i jepeshin një polici të gjinisë mashkullore. Edhe fëmijët më me lehtësi komunikojnë me gra se sa me burra.[185]

Prania e grave në sektorin e sigurisë i jep atij një element të ndjeshmërisë, pasi që gratë janë në gjendje që të 'bashkëndjejnë me viktimën," tha ai. Punësimi i grave në sektorin e sigurisë dështmohet i paçmueshëm në reagimin ndaj disa nevojave specifike të grave dhe vajzave dhe në sigurimin e trajtimit adekuat të tyre. Gratë janë në gjendje të zgjerojnë të kuptuarit e ngushtë të çështjeve gjinore dhe t'ua sqarojnë grave shumë çështje dhe brenga që ndërlidhen me sigurinë, duke u mundësuar kësisoj atyre pjesëmarrje më të barabartë në shoqëri nga gratë dhe vajzat.

Megjithatë, institucionet nuk kanë arritur të sigurojnë pjesëmarrje të barabartë të grave në sektorë që tradicionalisht konsiderohen si 'botë e burrave.' "Profesioni i policit perceptohet si profesion mashkullor që kërkon më shumë forcë se sa dijeni," tha Hysni Shala në vitin 2011, Këshilltar Gjinor në Policinë e Kosovës. "Ky mentalitet nuk është i pranishëm vetëm në Kosovë, po kudo [në botë]."[186]

Në fakt, disa pjesëmarrës në hulumtim e fajësonin stafin e UNMIK-ut se kishin sjellë nga shtetet e ndryshme shembuj të këqij të përfshirjes së grave në forcat e sigurisë. Ish-Drejtori i Përgjithshëm, Selimi, kujtonte se si policët po argumentonin kundërshtimin e tyre ndaj politikave të propozuara për arritje të barazisë gjinore, duke thënë "as UNMIK-u nuk ka kaq shumë gra".[187] Behar Selimi ndau me ne përvojën e vet:

> Të gjitha pengesat për zbatimin e Rezolutës 1325 kishin origjinën në kulturën e rezistencës mashkullore, jo vetëm lokale por edhe ndërkombëtare. [Kjo është] një kulturë mashkullore që reziston ndaj pjesëmarrjes së grave në poste në sektorin e sigurisë apo në shërbimet e sigurisë: ushtri, polici dhe agjenci tjera që zbatojnë rendin dhe ligjin. Kjo kulturë mua nuk më bënte shumë përshtypje. Unë kisha mendimin tim lidhur me ndërkombëtarët. Unë kurrë nuk kam menduar se ata përfaqësonin njerëzit më të kualifikuar

> në botë, megjithatë, kam pritur që të jenë më bashkëpunues, më të përkushtuar ndaj ndërtimit të filozofisë së barazisë gjinore, e në veçanti ndaj zbatimit të Rezolutës 1325. Duke qenë se ishin të punësuar në Kosovë, ata ishin të obliguar që ta zbatojnë këtë rezolutë, pasi që ajo i adresohet misioneve ndërkombëtare paqeruajtëse. Kjo paraqiste një pengesë pasi që ne prisnim se policia ndërkombëtare do të na jepte një shembull të mirë të zbatimit të Rezolutës 1325. Ne nuk arritëm të gjejmë asnjë shembull të mirë. Ende sot e kësaj dite në forcën policore të tyre nuk ka gra në pozita strategjike. Kjo është një pengesë sepse ne nuk kishim një shembull për ta përcjellë me forcën tonë policore të re. Ndërkohë, ne nuk e kishim as legjislacionin që do ta bënte këtë Rezolutë obligative.
>
> E stafi ndërkombëtar nuk e dinte se çka përfaqëson Rezoluta 1325. ... vetëm komisionari aktual e dinte këtë, sepse ai kishte punuar më parë në një panel shqyrtues për misionet paqësore anembanë botës. ... Ne u munduam që tu sugjerojmë të gjithëve që nga PSSP i UNMIK-ut e me radhë, që të fillojmë me trajnimin e stafit, shefave të policisë, shefave ushtarak në lidhje me Rezolutën 1325 dhe me mekanizmat për sigurimin e rendit dhe ligjit. Por, ata u zunë në befasi të plotë, "Çka është kjo Rezoluta 1325?", "Çka ka ky Behari që po insiston për këtë çështje?". Madje edhe ndërkombëtarët u befasuan me faktin se po e kryeja këtë punë në emër të barazisë.

Përpjekjet e Selimit, Shalës, Jahjagës, Haxhollit dhe avokuesve të tjerë për barazi gjinore shpien drejt progresit brenda Policisë së Kosovës, përfshirë vënien e masave për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave.[188] Kjo përfshinte krijimin e postit të Këshilltarit për Çështje Gjinore brenda strukturës së tyre, Komisionit për Barazi Gjinore me 100 këshilltarë regjionalë për çështje gjinore, të planit të veprimit

për përfshirjen e çështjeve gjinore në të gjitha fushat, njësive të specializuara rajonale kundër trafikimit dhe dhunës në familje, procedurave standarde operative për rastet e trafikimit dhe dhunës në familje dhe politikave për përmirësimin e pjesëmarrjes së grave në të gjitha nivelet/gradat.[189]

Pas përpjekjeve të tyre, bashkë me mbështetjen nga UNIFEM dhe OSBE për të rekrutuar më shumë gra në Polici, përqindja e grave në grada të ndryshme policore është rritur me kalimin kohës, përfshirë gradat kolonele, majore, zyrtare të sigurisë dhe të staf civil. Në vitin 2011, gratë shërbyen si komandante rajonale, si kolonele, si udhëheqëse të departamentit të rekrutimit dhe si shefe të drejtorive.[190]
"Ne nuk jemi të diskriminuar [në aspektin e renditjes]", tha Haxholli në vitin 2020:

> Ka rregulla brenda policisë dhe ka shumë dokumente që krijojnë kushte për ngritje në detyrë. Thirrja për aplikim hapet dhe ata aplikantë që plotësojnë kriteret hyjnë në teste, dhe kështu gratë po e promovojnë veten në grada më të larta. … Kishte pak hezitim [nga gratë] por ne i shtymë ato të aplikojnë për ngritje në detyrë dhe i ndihmuam ato gjatë procesit. Rezultati ka qenë shumë i mirë dhe numri i grave që kanë aplikuar është rritur në të gjitha gradat.[191]

Vlora Tuzi Nushi, Udhëheqëse e UN Women në Kosovë, konsideroi se Policia e Kosovës kishte bërë disa nga arritjet më të mëdha në zbatimin e Rezolutës 1325 në Kosovë.

> Unë u befasova pozitivisht që po zbatohej një masë afirmative në Polici përmes një kuote për të pranuar të paktën 30 përqind të aplikimeve për t'u bërë kadete nga gratë aplikuese. Programet mësimore të tyre janë gjithashtu në përputhje me Rezolutën 1325 dhe avancimin e barazisë gjinore brenda policisë.[192]

Aktivistja për të drejtat e grave, Demolli, theksoi në mënyrë të ngjashme:

> Përfshirja e grave në polici ka qenë prioritet,… dhe ne kemi qenë shembull në rajon. [Sidoqoftë] sa i përket zbatimit të Rezolutës 1325, ne ishim më mirë në 10 vitet e para sesa tani. Për shembull, në polici dhe TMK, kishte më shumë gra më parë. Gatishmëria e grave për t'u përfshirë në këtë sektor nuk është siç ishte më parë. Gratë hezitojnë të jenë pjesë e sektorëve të njohur zakonisht për burrat. [Në të kaluarën] përfshirja e grave në sektorin e sigurisë u promovua më shumë se tani.[193]

Në të vërtetë, duket se policia ka pasur probleme me mbajtjen e grave në punë. Aty ku gratë dikur përbënin 20.6 përqind të Policisë së Kosovës në vitin 1999, kjo përqindje ka rënë në 14.7 në vitin 2011 dhe në 12.8 përqind në 2020.[194] Në të gjitha gradat, përjashtuar stafin civil, gratë përbënin 15 apo më pak përqind të forcës. Kështu, Policia e Kosovës ka mbetur larg arritjes së barazisë gjinore dhe situata është përkeqësuar me kalimin e kohës.

Rënia e nivelit të pjesëmarrjes së grave në Policinë e Kosovës ka qenë rezultat i të ardhurave të ulëta, ndryshimit të statusit martesor dhe kushteve të punës dhe qasjes së dobët në informacionin mbi të drejtat e zyrtarëve.[195] Fakti se puna në polici kërkon udhëtime dhe gratë kanë më shumë përgjegjësi kujdesi shtëpiak nënkuptonte se këto gra apo familjet e tyre nuk e shihnin si të përshtatshëm profesionin e polices.[196] Tahire Haxholli na shpjegoi në vitin 2011:

> Shumica e policeve kanë qenë të pamartuara. Me t'u martuar, ato detyrohen të largohen nga puna për shkak të shtatzënive, sepse pushimi i lehonisë është tejet i shkurtër. ... Disa mbase martohen jashtë Kosovës apo me një person që nuk e pëlqen këtë profesion apo të cilit fare nuk i pëlqen ideja e punësimit

> të grave. Ose, burrit mund të mos i pëlqejnë detyrat që duhet të kryhen nga një police, pasi që edhe nëse ajo është nënë apo bashkëshorte ajo do të duhet të punojë në patrullim gjatë natës.
>
> Por, për këtë çështje kemi miratuar një politikë: kur një grua mbetet shtatzënë, ne e transferojmë atë në detyra më të lehta siç janë puna në administratë apo në zyra. Policet që kanë fëmijë më të vegjël se një vit nuk obligohen të punojnë në ndërrim të natës, por pas një viti, ajo prapë do duhet të dalë në patrulla të natës. E nëse ajo ka bashkëshort xheloz, ai kërkon nga ajo që të heqë dorë nga puna.[197]

Rrjedhimisht, është duke u punuar për të mbajtur gratë në punë.[198] Policia e Kosovës ka nxjerrë rregulla përmes të cilave grave gjatë shtatzënisë u sigurohen detyra kryesisht më të lehta, u sigurohet transferi në poste më afër vendbanimit të tyre dhe u mundësohet që të shkojnë në shtëpi më shpesh gjatë javës, të gjitha me qëllim të lehtësimit të punës për to.[199] Fatkeqësisht, Shala vuri re se gratë zyrtare nuk dinin gjithmonë për këto të drejta:

> Në një hulumtim që kam kryer brenda Policisë, doli që një numër i madh i grave dha dorëheqjen sepse nuk kishin informata për normat [dhe] të drejtat. Ato nuk e kuptuan nëse pushimi i lehonisë është një e drejtë, nëse ekziston e drejta për pushim në rast të sëmundjes, dhe kjo ka krijuar konfuzion. Për shembull, ka pasur raste kur një zyrtare policore nga Prishtina u martua [dhe u zhvendos] në Mitrovicë dhe tha që po udhëtonte nga Mitrovica në Prishtinë ... dhe dha dorëheqje [sepse ishte tepër shumë]. Ajo nuk e kuptonte që i duhej vetëm të kërkonte një transferim. … Gjatë këtij studimi e pashë që shpesh kjo ndodh për shkak të mungesës së njohurive për të drejtat e tyre. [Kështu që në vitin 2010] ne përpiluam një përmbledhje të ligjeve dhe neneve, të cilat informonin

> gratë brenda Policisë së Kosovës për të drejtat e tyre. Kur ato dëshironin të gjenin diçka, ato mund të gjenin të gjitha informacionet në atë dokument në Intranet. Kjo ka ndihmuar këdo që kishte konfuzion ... Tani është kuptuar nga menaxherët që kur të ndryshoni vendbanimin mund të transferoheni. Kështu, niveli i dorëheqjeve ka rënë shumë ...

Në të kaluarën, Policia e Kosovës gjithashtu zhvilloi komunikim me komunitetin, duke u përpjekur të bindë më shumë gra dhe familjet e tyre se gratë kanë një rol të rëndësishëm për të avancuar sigurinë. Gratë inkurajoheshin që të aplikojnë për punë përmes broshurave, artikujve, fletushkave dhe vizitave të njësive policore në zona rurale. "Ne jemi takuar me prindër të vajzave të cilat ishin kandidate të forta dhe ua kemi shpjeguar atyre se çfarë kontributi do të mund të jepnin ato në mbrojtjen e vendit," tha Haxholli.

Një përpjekje tjetër për të fuqizuar dhe mbajtur gratë zyrtare ka qenë krijimi i një Shoqate të Grave. Shala kujtoi: "Atëherë, në vitin 2005 ose 2006, ishte ideja e Igo [Rogovës] dhe Flora [Maculës] për të themeluar Shoqatën e Grave në Policinë e Kosovës."[200] Jahjaga, mes grave të tjera police të angazhuara, kujton:

> Në vitin 2006 dhe 2007 ne filluam [të punojmë] drejt idesë së themelimit të Shoqatës së Grave Police të Kosovës… Në atë kohë, ne u përballëm me refuzim të madh nga policët burra në Policinë e Kosovës, por unë gjithashtu kisha mbështetje të fortë nga Ambasada Amerikane, dhe kam pasur mbështetje të fortë nga mekanizmat ndërkombëtarë: UNMIK dhe EULEX, të cilët ndihmuan në themelimin e Shoqatës. Procesi zgjati shumë dhe unë nuk isha pjesë e Policisë [më] kur u krijua Shoqata. [Ajo] kishte një qëllim kryesor: të garantonte pjesëmarrjen e qëndrueshme të grave në Policinë e Kosovës dhe fuqizimin e grave në vendimmarrje brenda Policisë së Kosovës. Në atë kohë,

> ne mund të llogarisnim nga njëra anë numrin e grave në pozitat vendimmarrëse në Policinë e Kosovës. Kuota prej 15 përqind nuk u zbatua në të gjitha gradat, për të mos përmendur rolin [pothuajse inekzistent] të grave në departamentet "elitë" brenda Policisë së Kosovës, [me eprorë burra] duke u thënë atyre: "Pse do të shkonit në Njësi Speciale, Njësi të Drogës, apo diçka tjetër?" Kjo përqindje u aplikua vetëm në pozitat tradicionale: administratë, hetime të brendshme, por kurrë në ato zona që përfshijnë përgjegjësi të tilla. Qëllimi i Shoqatës ka qenë që disa çështje [që kemi filluar do të] vazhdojnë përtej individëve. Për shembull, është një individ që ka luftuar për disa të drejta, por ai individ shkon, dhe pastaj vjen një tjetër që mund të mos ketë të njëjtën qasje ose nuk ka kohë të merret me të njëjtat çështje. Qëllimi ishte që të ketë mekanizma të tjerë institucionalë që garantojnë fuqizimin e grave brenda Policisë së Kosovës.[201]

Kështu, në vitin 2012, UNIFEM (më vonë UN Women) dhe gratë në pozita të larta brenda Policisë së Kosovës filluan takimin dhe diskutimin e hapave drejt themelimit të Shoqatës.[202] Pas disa punëtorish dhe diskutimesh, Shoqata miratoi Statutin e saj më 23 korrik 2013.[203] Macula, atëherë shefe e UNIFEM, që mbështeti themelimin e Shoqatës që nga fillimi, e konsideroi atë si një nga shembujt më të mirë të zbatimit të Rezolutës 1325 në Kosovë:

> Kam punuar me policinë dhe ndihmova për të integruar Rezolutën 1325 në Polici. Si rezultat, u formua Bordi i Barazisë Gjinore, u krijua Zyra për Barazi Gjinore, dhe ne krijuam një rrjet të policisë, UNIFEM, RrGK dhe organizatave të tjera. Në atë kohë, ne synonim të rrisnim numrin e grave në polici sepse gratë do të ndiheshin më të sigurta në Kosovë. Në fund, ndihmova në themelimin e Shoqatës së Grave Police në Kosovë. Brenda një viti e gjysmë, ato ishin tashmë të pavarura.

> Sot, ato janë shumë aktive dhe janë një shembull i shkëlqyeshëm.[204]

Jahjaga theksoi me krenari në vitin 2020:

> [Që nga viti 2014, Shoqata] është pjesë e Shoqatës Ndërkombëtare të Grave në Polici (IAWP) - Rajoni 13, i cili është i vendosur në Austri dhe përfshin rajonin e Evropës Juglindore dhe Evropës Qendrore. Duke qenë se nuk ishim një vend anëtar, duhet të ishim pjesë e disa organizatave ndërkombëtare [dhe nuk ishim], por në atë kohë kaluam nëpër të gjitha këto sfida dhe e bëmë Kosovën anëtare të IAWP. Dhe tani kemi një zyrtare policie [grua] të Kosovës e cila është anëtare e bordit të IAWP.

Me mbështetjen e UN Women, anëtarët e Shoqatës kanë vazhduar përpjekjet për të inkurajuar gratë për t'iu bashkuar policicë dhe kanë rritur dukshmërinë e grave në polici përmes broshurave, spoteve televizive, posterëve dhe mediave sociale.[205]

EULEX-i dhe OSBE-ja gjithashtu kanë investuar duke trajnuar dhe mentoruar policinë për të adresuar dhunën në familje dhe trafikimin, mes tjerash. Policia e Kosovës gjithashtu ka kërkuar të përmirësojë qasjen e policisë, përmes trajnimit të detyrueshëm për barazinë gjinore. Shala kujtoi:

> Jo vetëm këtë dekadë, por për 20 vjet, kishte paragjykime kur organizova takime, seminare dhe punëtori për çështje gjinore në përgjithësi. Unë mund të shihja nga pyetjet [e kolegëve të mi] që ata nuk ishin ende të gatshëm ose nuk ishin në dijeni të mjaftueshme pas trajnimeve që unë i organizova. Kam marrë komente nga zyrtarë burra të policisë si: "Pse [pasi je burrë] po organizon trajnime mbi tema për gratë?"[206]

Sidoqoftë, duke ndjekur përpjekjet e tij dhe të të tjerëve, ai ka dëshmuar përmirësime në dekadën e fundit:

> Sot, kur bëhet fjalë për çështjet gjinore, përshtypja se ato kanë të bëjnë me gratë tashmë ka filluar të zbehet. [Është e njohur mirë] kur bëhet fjalë për çështje gjinore që të dy gjinitë duhet të merren parasysh. Nuk ka më ndarje, edhe pse në vendin tonë merrej kështu. Tani nuk është kështu! Tani kur flasim për barazinë gjinore, kemi parasysh të drejtat e barabarta për burrat dhe gratë. [Për më tepër, tani] çdo menaxher e ka kuptuar që edhe gratë duhet të jenë në pozita menaxheriale. Ata nuk e kontestojnë atë, dhe kjo tregon se ndërgjegjësimi mes tyre është rritur.
>
> Ndërgjegjësimi në mesin e zyrtarëve të policisë për Rezolutën 1325 është rritur. Në fillim, për shembull, kur fillova të promovoj këtë Rezolutë brenda Policisë së Kosovës, në shumicën e strukturave… kishte një pakënaqësi me këtë Rezolutë. [Unë] në shumicën e trajnimeve që janë mbajtur 10 vite më parë, Rezoluta 1325, të cilën ne tani e kemi inkorporuar në Akademinë e Policisë, nuk ishte përfshirë. Si trajnimi bazë ashtu edhe ai i avancuar nuk kishin përfshirje në kurrikulën e trajnimit. Që nga ajo kohë, … ne kemi organizuar trajnime të veçanta ... për të drejtat e njeriut ose barazinë gjinore [dhe tani] një pjesë të tyre ia kushtojmë legjislacionit ndërkombëtar [dhe] hapësirë specifike i kushtohet Rezolutës 1325.

Shmangia e "kokëdhimbjes" në ndërtimin e institucioneve të reja të sigurisë

"Shpesh në situata pas konfliktit tentohet rikrijimi i strukturave të njëjta të sigurisë të cilat ende nuk janë kthjellur nga ajo që kanë bërë gjatë konfliktit. Kësisoj, shpesh ndodhë që deri në një masë të hiqet dorë nga e vjetra dhe të tentohet të krijohet diçka e re. Ju jeni duke u përpjekur që t'i tejkaloni këto stereotipe dhe këto probleme."

- Christos Theodoropoulos, Zyrtar i Lartë i Mbrojtjes, UNHCR, 2011

Duke marrë parasysh se sa imazhe, memoriale dhe statuja të burrave me armë në dorë kanë qarkulluar në Kosovë dhe në mediat ndërkombëtare, është vështirë që të paramendohet se gjatë luftës armët i kanë mbajtur në dorë edhe gratë. Megjithatë, 857 gra kanë qenë pjesë e luftëtareve të regjistruara të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.[207] Çka ndodhë me ushtarët pas përfundimit të luftës?

Programet për çarmatim, demobilizim dhe reintegrim (DDR) kanë për synim çarmatosjen e ish-luftëtarëve, duke kërkuar nga ta që të 'heqin dorë nga armët dhe të bëjnë jetë normale." Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së vë në spikamë nevojat specifike të sigurisë dhe nevojat tjera të ish-luftëtareve dhe pjesëtareve të sektorit të sigurisë.[208] Ai propozoi vlerësimin e masës së përfshirjes së grave dhe vajzave në programe të reparacioneve, duke ekzaminuar përqindjen e përfitimeve që ato pranojnë.

Menjëherë pas luftës, programe të ndryshme kanë ofruar asistencë humanitare dhe të natyrave të tjera për luftëtarët e UÇK-së. Kanë ekzistuar së paku dy programe të mëdha DDR, por nuk kanë përditësuar të dhënat monetare që kanë pranuar gratë dhe vajzat, gjë që propozohet nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së. Ngjashëm me këtë, nuk është bërë ndonjë përpjekje për të "tejkaluar faktorët që u pamundësojnë grave dhe vajzave qasjen në reparacione apo përfitime nga programet e DDR".

Për programin e parë DDR, UNMIK-u dhe KFOR-i kontraktuan Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM) për t'a realizuar demilitarizimin dhe reintegrimin e ish-luftëtarëve të UÇK-së në vitin 1999, siç kërkohej nga Rezoluta 1244. Përfaqësuesit e IOM vizituan të gjitha regjionet e Kosovës dhe zhvilluan një fushatë të madhe për regjistrimin e të gjithë pjesëtarëve të UÇK-së. IOM nuk ka kryer ndonjë vlerësim specifik të nevojave të ish-luftëtareve. Mandati i tyre përfshinte ofrimin e trajnimeve dhe ndihmesa në gjetjen e vendeve të punës për të gjithë ish-luftëtarët, pa marrë parasysh gjininë. Në përgjithësi, ata kishin regjistruar 25,723 ish-luftëtarë të UÇK-së, përfshirë 857 të gjinisë femërore (3.3 për qind). Nuk ka regjistër të çfarëdo përfitimi të veçantë për gratë. Në përgjithësi, 1,961 ish-luftëtarë janë referuar në punësim afatshkurtër, 2,881 në punësim afatgjatë ndërsa 4,552 u kyçën në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK).[209]

Duke qenë se vetëm 17.7 për qind të ish-luftëtarëve iu bashkuan TMK-së, shumë të tjerë u deshën të sigurojnë jetesën e tyre gjetiu. Në vitin 2009, programi i transferimit të TMK-së i UNDP-së u ndihmoi 1,462 grave dhe burrave në kalimin në jetën civile.[210] Ky program u ndihmoi 42 grave, që përbëjnë 2.9 për qind të të gjithë përfituesve të ndihmuar. UNDP kishte ofruar këshillime për pjesëmarrësit e këtij procesi dhe 'lehtësoi kalimin e tyre të vështirë nga jeta në uniformë si anëtarë të TMK-së në jetë civile.'[211] "Pjesa më e madhe e tyre tani janë në rrugë të mirë drejt reintegrimit," raportonte UNDP.

Me kalimin e kohës dhe me rënien e nivelit të ndihmave ndërkombëtare, veteranët u përballën me kushte gjithherë e

më të vështira ekonomike. "Ata që sakrifikuan veten dhe ishin të burgosur me dekada të tëra kurrë nuk morën shpërblime apo mirënjohje publike," tregon Shukrije Gashi nga *Partners Kosova*.[212] "Atyre nuk u janë dhënë ndihmë apo beneficione nga shteti, siç janë pensionet apo sigurimi shëndetësor." Megjithëse personat me nevoja speciale dhe të moshuarit kanë të drejtë për beneficione të tilla, veteranët nuk e gëzojnë atë të drejtë që nga viti 2011. "Nuk kemi asgjë," thotë Muharrem Xhemajli, Kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në atë kohë.[213] "Veteranët e asnjërës gjini nuk kanë kurrfarë beneficioni apo përfitimi institucional." Kjo ishte çështja kyçe për disa veteranë të cilët për 61 ditë qëndruan në tenda para Parlamentit në vitin 2011, duke kërkuar nga Qeveria që ta shqyrtojë kërkesën e tyre.[214] Protesta e tyre u shndërrua në grevë urie, ndërsa kërkonin miratimin e Ligjit për 'vlerat e UÇK-së', i cili do t'ju mundësonte të gëzojnë përfitime të ngjashme me ato të invalidëve të luftës dhe familjeve të dëshmorëve të luftës.[215]

Në dhjetor 2011, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile të Luftës dhe familjeve të tyre.[216] Një ligj i veçantë për Veteranët e UÇK-së rregullonte qasjen e veteranëve në përfitimet shtetërore.[217] Ky ligj u siguroi veteranëve të drejta për një kompensim mujor të paktën të barabartë me pagën minimale në Kosovë, si dhe shërbime shëndetësore falas, transport urban falas dhe arsim profesional, ndër përfitimet e tjera. Anëtarët e familjes së tyre gjithashtu morën të drejtën për 70 përqind të dëmshpërblimit të tyre pas vdekjes së veteranit.[218]

Që nga shtatori i vitit 2020, numri i veteranëve të UÇK-së ishte 36,161 persona.[219] Numri i përgjithshëm i përfituesve, përfshirë veteranët e luftës ose familjet e tyre, ishte 38,156 persona, përfshirë 3,076 gra.[220] Meqenëse gratë përfituese përfshijnë anëtarët e familjes së veteranëve, nuk ishte e mundur të përcaktohet numri i grave ish-luftëtare që marrin këto përfitime. "Rastet nuk u trajtuan siç duhej të ishin trajtuar!

Ato nuk renditen as sipas numrit," tha për RrGK kur u pyet me telefon një përfaqësues i Zyrës për Çështjet e Kategorive që rrjedhin nga Lufta. Një çështje tjetër, tha ai, ishte se arkivat ishin nën hetim nga Zyra e Prokurorit Special dhe nuk mund të qaseshin.[221] ndërkohë, sipas një artikulli të botuar nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) në vitin 2013, UÇK kishte 632 pjesëtare gra.[222]

Ata veteranë që i'u bashkuan TMK-së punuan si pjesë e kësaj organizate civile të sigurisë, e cila funksionoi mes viteve 1999 dhe 2009. Gratë përbënin 3.5 të tërë TMK-së dhe gjendeshin në pothuajse të gjitha pozitat brenda kësaj force.[223] Pjesëmarrja e pabarabartë e grave iu atribua konkurseve të pamjaftueshme. "Ne nuk kemi gra me gradë gjenerali," na tha në vitin 2007 Pika Qendrore për Çështje Gjinore në TMK Fahri Sadriu. "Ne kemi menduar që grave tu japim më shumë mundësi pasi që ato i meritojnë mundësitë e tilla. Ne do ta zgjidhnim një grua me gradë gjenerale, por nuk ka mjaft vende. Nëse do të kishim vende të mjaftueshme, ne do të bënim diçka më shumë në këtë drejtim."[224] Më vonë, ata emëruan një grua në gradën kolonele. "Por jo për shkak se ajo ishte grua," theksoi Koloneli Safet Syla, "po për shkak se e meritonte."[225]

Në vitin 2008 TMK u transformua në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), që kishte për mandat 'pjesëmarrjen në operacione të reagimit ndaj krizave, përfshirë operacionet e përkrahjes paqësore, dhe ndihmimin e autoriteteve civile në reagimin ndaj katastrofave natyrore dhe të tjera dhe ndaj emergjencave, si dhe në largimin e eksplozivëve.'[226] Gratë përbëjnë jo më shumë se 6.4 për qind të Forcës. "Ne ende nuk jemi tërësisht të kënaqur me numrin e grave në Forcën e Sigurisë së Kosovës," tha Halime Morina, Koordinatore e Njësisë për të Drejta të Njeriut në FSK. "Por, situata është përmirësuar dhe po përmirësohet vazhdimisht," tha ajo.[227] Ata kanë zhvilluar fushata të rekrutimit në të cilat janë angazhuar ekipet mobile, për të inkurajuar qytetarët, e në veçanti gratë, që të konkurrojnë. "Unë jam grua, jam pjesë e FSK-së dhe nuk diskriminohem," na thanë pjesëtaret e FSK-së gjatë takimeve

publike ku mëtonin të rekrutojnë më shumë gra. "Të drejtat e mia respektohen." Pas këtyre takimeve, mbi 100 gra u pranuan në FSK.[228]

Përfshirja e grave në FSK është rritur nga 8.2 përqind në 2011 në 11 përqind në 2020.[229] Për më tepër, një grua ishte ngritur në gradën e Gjeneralit brenda FSK-së. Edhe pse FSK-së ende i mungon një baraspeshim gjinor, Morina beson se pikëpamjet e socializuara të ushtrisë si "punë e burrave" janë zbehur gjithnjë e më shumë, dhe të tjerët pajtohen.[230] Ajo tha se çdo pozitë që gratë mbajnë sot brenda FSK-së është sepse ato kanë punuar shumë dhe ato e meritojnë atë.

Që nga viti 2011, Ministria e Forcës së Sigurisë të Kosovës mbikëqyri dhe inspektoi të gjitha aktivitetet e forcës së sigurisë. Ajo ishte përgjegjëse edhe për sajimin dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve, si dhe për propozimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të forcës së sigurisë.[231] Si çdo ministri tjetër, ajo kishte njësi për të drejtat e njeriut dhe zyrtar për çështje gjinore. Ministria ka bashkëpunuar me ekspertë drejt hartimit të një plani të veprimit për avancimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore brenda Ministrisë dhe brenda FSK-së, i cili është miratuar në shtator të vitit 2011.[232] Në të përcaktohen 'synimet dhe veprimet që duhet ndërmarrë për të avancuar barazinë gjinore dhe zbatuar Rezolutën 1325," na tha Morina.[233]

Në vitin 2014, kjo Ministri u shndërrua në Ministri të Mbrojtjes, dhe FSK-ja u bë Forcat e Armatosura të Kosovës në vitin 2019. Që atëherë, sipas Begaj, ata bashkëpunuan me grupet e të drejtave të grave, por edhe me ekspertë ndërkombëtarë për gjininë dhe këshilltarët e NATO-s për të inkorporuar më mirë Rezolutën 1325 në politikat dhe strategjitë e tyre.[234] Ajo ka përfshirë trajnimin për Rezolutën 1325 në programet mësimore për rekrutët e rinj, "ku 30 minuta të trajnimit bazë i kushtohen barazisë gjinore", tha Morina.[235]

Gjithsej, 37 gra të punësuara në Ministri përbëjnë 32.7 për qind të fuqisë punëtore të angazhuar aty në vitin 2011. Disa gra kishin pozita vendimmarrëse, përfshirë shtatë togere dhe pesë kolonele, tri nga të cilat udhëheqin departamente të

ndryshme. Edhe pse gratë ishin të përfaqësuara më mirë se sa në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, ato ende mbeten më pak të përfaqësuara se burrat. Për më tepër, përfaqësimi i grave ka rënë me kalimin e kohës. Nga 123 veta të personelit civil në Ministrinë e Mbrojtjes në vitin 2019, vetëm 33 ishin gra (26.8 përqind).[236] Për më tepër, nuk kishte asnjë grua kolonele dhe vetëm tri gra togere, kështu që gratë përbënin vetëm 7 përqind të pozitave vendimmarrëse.[237] Kështu, gratë nuk mbajnë 50 për qind të pozitave të Ministrisë në të gjitha nivelet, siç parashikohet me Ligjin për Barazi Gjinore, theksoi Morina:

> Tani kjo shifër tregon se ne nuk kemi arritur të respektojmë Ligjin për Barazi Gjinore që na siguron neve (grave) në Ministri të jemi 50 përqind. Kjo shifër tregon se ne nuk kemi arritur ta ngremë atë në një nivel të duhur ose në përputhje me Ligjin që ne vetë kemi aprovuar në Ministrinë e Mbrojtjes.[238]

Këshilli i Sigurisë i Kosovës i themeluar në vitin 2009 fillimisht nuk kishte asnjë femër, gjë që ndikonte në mënyrën se si trajtoheshin nevojat e grave nga prizmi i politikave të sigurisë. Aktivistet për të drejtat e grave vlerësuan se Këshilli kohë më parë do duhej të siguronte trajtimin e nevojave specifike të grave dhe vajzave që ndërlidhen me sigurinë, tha Qosaj-Mustafa:

> Ku kemi të bëjmë me marrjen e vendimeve të rëndësisë së madhe dhe me përcaktimin e prioriteteve, fatkeqësisht nuk janë të përfshira shumë gra. Edhe në rastet kur hartohet ndonjë strategji kombëtare e sigurisë, ato nuk ngërthejnë shumë çështje të sigurisë me rëndësi për gratë, por vetëm përmendin trafikimin me qenie njerëzore, pa ofruar kurrfarë përcjellje konkrete të kësaj dhe pa përcaktuar aktivitetet në drejtim të luftimit të tij dhe buxhetin përkatës për to.

Strategjia Kombëtare e Sigurisë e cila është duke u hartuar do të duhej të merr parasysh nevojat e grave dhe vajzave në kuptim të sigurisë, ashtu siç kërkohet në udhëzimet e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.[239] Sidoqoftë, vetëm një u angazhua për përfshirjen e një perspektive gjinore, krahas etnisë, në sektorin e sigurisë përmes politikave të rekrutimit, mbajtjes dhe promovimit. [240] Përndryshe, kryesisht mungonte një perspektivë gjinore. Në vitin 2020, Strategjia e re e Sigurisë ishte nën konsultim publik, por gjithashtu i mungonte një perspektivë gjinore.[241]

Gratë janë të nënpërfaqësuara edhe në Shërbimin e Jashtëm të Kosovës, i cili u krijua në vitin 2008. Fillimisht në këtë shërbim nuk ishte emëruar asnjë ambasadore.[242] Në vitin 2008, gratë përbënin jo më shumë se 15 për qind të diplomatëve (tri gra) në misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. Mes viteve 2009 – 2011 kjo shifër është shtuar pak dhe ka arritur në 18 për qind (13 gra). Ky avancim mund t'i atribuohet thirrjeve të vazhdueshme të grave parlamentare dhe RrGK të cilat kërkuan që gratë të kenë pozita vendimmarrëse brenda këtij shërbimi.

Në vitin 2011 vetëm dy nga 18 ambasadorë ishin gra,[243] dhe propozimet e reja për kandidatë për vitin 2012 nuk përfshinë asnjë grua, gjë që nxiti reagime nga deputetet.[244] Në vitin 2020, deputetja e atëhershme e Kuvendit, Osmani Sadriu kujtoi:

> Ne kemi pasur disa raste kur të gjitha gratë deputete në Kuvendin e Kosovës janë bashkuar përkundër dallimeve politike. Në vitet 2012-2013, 40 gra kërkuan nga Ministria e Punëve të Jashtme të respektojnë Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Rezolutën 1325 në përfaqësimin e grave në misionet diplomatike. Në moment, kur 40 gra të etnive të ndryshme dhe parti të ndryshme u bashkuan të gjitha në Konferencën për shtyp, media na ngacmoi me këngën [popullore] "Jena motra kallabllak". Pra, nuk kishim mbështetje mediatike. Sidoqoftë, ne nuk u ndalëm. Në atë grup,

unë isha përgjegjëse për përgatitjen e pjesës ligjore të kërkesave tona dhe i dërguam letra Sekretares së atëhershme të Shtetit Znj. Klinton, Kancelares Merkel dhe shumë udhëheqësve të tjerë mbi këtë çështje, dhe rreth disa përpjekjeve që partitë tona politike… të heqin kuotën gjinore nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme. Pra, për këto dy tema ne kemi shkruar dhe kërkuar zbatimin e kësaj Rezolute [1325], por edhe të Ligjit tonë për Barazi Gjinore, për të pasur të paktën 40 përqind gra [në misionet diplomatike]. Ne morëm përgjigje pozitive nga shumica dërrmuese e udhëheqësve ndërkombëtarë të cilëve u kemi shkruar. Dhe më pas, në atë kohë, Ministri Hoxha na shkroi një letër dhe na tha "Mirë, jam dakord me ju, dhe ne do të kemi të paktën 40 përqind gra." Pra, fillimisht ishte një listë e plotë e burrave të nominuar, dhe ai pastaj e ktheu listën dhe emëroi ... gra, dhe ato gra sot janë diplomate karriere që shërbejnë si ambasadore. Pra, ato po shërbejnë për më shumë se tetë vjet në shërbimin tonë diplomatik.[245]

Ndërsa përqindja e grave që shëbejnë në shërbimin diplomatik të Kosovës nuk ka arritur barazinë gjinore, ajo qartë është rritur me kalimin e kohës nga 15 përqind në 2008 në 18 përqind në 2011 në 35 përqind në 2019 (shih Tabelën 4).[246]

Sa i përket sistemit të drejtësisë, Gjykata Supreme e Kosovës kishte shtatë gjyqtare dhe katër gjyqtarë në vitin 2011. Në vitin 2020, kjo u ul në vetëm pesë gra dhe 11 burra.[247] Në përgjithësi, në vitin 2011, 28 për qind të 244 gjyqtarëve në të

Tabela 4. Numri i grave dhe burrave në misione jashtë vendit

Viti	Gra	Burra	Gra
2008	3	17	15%
2009	13	59	18%
2010	13	59	18%
2011	13	59	18%
2012	-	-	-
2013	-	-	-
2014	27	95	22%
2015	27	83	25%
2016	40	91	31%
2017	42	92	31%
2018	46	112	27%
2019	50	130	35%

gjitha gjykatat ishin gra; si dhe 30 për qind të 88 prokurorëve.[248] Që atëherë, që nga viti 2020, përqindja e grave gjyqtare ishte rritur pak, duke arritur në 33 përqind, ndërsa gratë përbënin 42 përqind të 190 prokurorëve.[249] Gratë kishin 50 përqind të pozitave të stafit administrativ, por vetëm 23 përqind të posteve vendimmarrëse në gjykatat e Kosovës.[250]

Në Këshillin Gjyqësor të Kosovës 39 për qind të punonjësve janë gra, megjithëse 10 nga 12 postet vendimmarrëse mbaheshin nga burrat në vitin 2011. Në vitin 2020, kjo u rrit në 47 përqind, megjithëse vetëm tri nga nëntë pozitat e vendimmarrjes u mbajtën nga gratë (25 përqind).[251] Që nga viti 2020, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ende nuk ka ndërmarrë ndonjë strategji të veçantë për të rekrutuar apo punësuar gratë.[252]

Në përgjithësi, përkundër disa shembujve pozitivë, gratë mbesin të nënpërfaqësuara në të gjitha institucionet e Kosovës. Për më tepër, përfaqësimi i grave në disa organe sigurie madje ka rënë në dekadën e fundit. Një sfidë e madhe që e kanë hasur institucionet gjatë rekrutimit dhe mbajtjes në punë të grave, ka qenë ajo që nga pjesëmarrësit në hulumtim tonë u quajt 'mentaliteti patriarkal', i cili ende është i pranishëm edhe në Kosovë edhe në kontekst ndërkombëtar, e i cili pretendon se sektori i sigurisë është kryesisht 'botë e burrave.' Ndërsa është bërë njëfarë progresi, tejkalimi i këtij mentaliteti akoma të pranishëm dhe rekrutimi i një numri më të madh të grave në të gjitha nivelet dhe institucionet do të jenë të një rëndësie të jashtëzakonshme për tu siguruar se nevojat specifike të grave dhe vajzave sa i përket sigurisë do të merren parasysh dhe do të trajtohen në mënyrë adekuate.

SIGURIA

"Siguria si koncept ka të bëjë me të gjithë dhe duhet t'u ofrohet të gjithëve. Nëse siguria i ofrohet vetëm një pjese të shoqërisë pjesa tjetër do të ndihet e pasigurt. Siguria nuk e ka domethënien e njëjtë për burra sikurse për gratë. Në Kosovë e kemi një situatë të pasluftës, në të cilën pothuajse të gjithë janë ndier të pasigurt. Por mendoj se është duke u krijuar një kornizë e re sociale në të cilën siguria do të luajë një rol të rëndësishëm."

- Behar Selimi, ish Drejtor i Përgjithshëm, Policia e Kosovës

"Këndvështrimi im për sigurinë e grave në Kosovë nuk është i mirë," tha Fahri Sadriu në vitin 2007 kur shërbente si Koordinator i Bordit për Barazi Gjinore në Trupat Mbrojtëse të Kosovës.[1] "Siguria përfshin shume gjëra, si sigurimin personal, shëndetësor, dhe [atë] ekonomik," tha ai.

Kjo pjesë shqyrton aspektet e ndryshme të sigurisë së gruas, bazuar në Rezolutën 1325, duke përfshirë masën deri në të cilën gratë dhe vajzat *ndihen* të sigurta në Kosovë.[2] Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së kërkon që "të garantohet siguria fizike dhe mendore e grave dhe vajzave, siguria ekonomike e tyre, si dhe të respektohen të drejtat e tyre të njeriut."[3] Shteti i Kosovës dhe subjektet e OKB-së kanë përgjegjësi për parandalimin e shkeljeve të të drejtave të grave dhe vajzave dhe mbrojtjen e tyre, bazuar në Rezolutën 1325.

Qeveria e Kosovës ende nuk ka përcaktuar indekset për monitorimin e sigurisë së grave dhe vajzave dhe identifikimin e shqetësimeve të tyre.[4] Prandaj, secili kapitull në vijim hulumton një fushë të cilën Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së e vë në spikamë në ndërlidhje me sigurinë e grave dhe vajzave: parandalimin e dhunës seksuale gjatë kohës së luftës; sigurimin e mbrojtjes pas-konfliktit, edhe përmes sistemeve për paralajmërimin e hershëm të dhunës së mundshme të

përtërirë; parandalimin e trafikut; ruajtjen e grave dhe vajzave nga dhuna në familje; dhe, më gjerësisht, ofrimin e sigurisë njerëzore për ta.

DHUNA SEKSUALE GJATË LUFTËS

Gjatë luftës, "gratë nuk ishin të mbrojtura nga dhuna as për një moment të vetëm"

"Gratë nuk kanë qenë të mbrojtura nga dhuna as për një moment të vetëm. Në Kosovë, thuhet se ka mijëra gra të dhunuara, por asgjë nuk është e sigurtë."

- Nora Ahmetaj, Drejtore, Qendra për Hulumtim Dokumentim dhe Publikim

Ata kishin veshur rroba ushtarake dhe mbanin shami të zeza në kokat e tyre. E morën kunatën time në dhomën e ndejës. E godisnin dhe i bërtisnin që t'a mbyllë gojën. Fëmijët ulërinin, pastaj ata u bërtisnin edhe fëmijëve. Ajo qëndroi me paramilitarët për gjysmë ore. Ajo rezistonte dhe ata e rrahnin, ndërsa fëmijët i dëgjonin ulërimat e saj. Unë vetëm dëgjoja se çka po ndodhte. I dëgjoja ata gjersa e goditisnin me shuplaka. Fëmijët nuk e kuptonin se ata po e përdhunonin. Më pas, e vendosën në një vijë me ne dhe e qëlluan për vdekje.[5]

Kjo deklaratë e një dëshmitareje okulare nga Peja, e incizuar nga Human Rights Watch, është një nga raportimet e

shumta të krimeve të kryera ndaj grave dhe vajzave gjatë luftës 1998-1999. Dhuna e kryer nga paramilitarët serbë dhe policia serbe gjatë kësaj periudhe është dokumentuar mirë. Raportet e gjithanshme të dhunës seksuale bënë që Human Rights Watch të konstatojë se në Kosovë përdhunimi është përdorur si armë e "pastrimit etnik". "Përdhunimet nuk ishin akte të rralla dhe të izoluara të kryera nga individët, por në fakt ato janë përdorur me qëllim si instrument për terrorizimin e popullatës civile, zhvatjen e parave nga familjet, si dhe për të detyruar njerëzit që t'i braktisin shtëpitë e tyre," shkruan Human Rights Watch.

Duke i marrë parasysh aktet e tmerrshme të dhunës ndaj grave gjatë luftërave të ish Jugosllavisë, Statuti i Romës i vitit 1998 që themeloi Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) thekson se "përdhunimi, skllavëria seksuale, prostitucioni i detyruar, shtatzënësia e dhunshme, sterilizimi i detyruar, apo format tjera të dhunës seksuale" janë "krime ndaj njerëzimit" kur ato "kryhen si pjesë sulmeve të gjithanshme apo sistematike të drejtuara ndaj popullatës civile."[6] Tribunali Ndërkombëtar për Krime të ish Jugosllavisë (ICTY) përfshinë përdhunimin dhe "aktet tjera jonjerëzore" si krime ndaj njerëzimit."[7] Rezoluta 1325 u "bën thirrje të gjitha palëve në konflikt të armatosur që të ndërmarrin masa speciale për t'i mbrojtur gratë dhe vajzat nga dhuna në baza gjinore, posaçërisht nga përdhunimi dhe format tjera të abuzimit seksual." [8] Fatkeqësisht, Rezoluta erdhi shumë vonë për Kosovën.

"Kryesisht i mblidhnin vajzat nga fshatrat dhe qytezat. Ushtarët i çonin grupet e 5 deri 30 grave në vende të panjohura me kamionë apo i mbanin të mbyllura në shtëpitë ku jetonin ushtarët," shkruan psikologja D. Serrano Fitamant për Fondin për Popullsinë të Kombeve të Bashkuara (UNFPA) në maj 1999.[9] Ajo vazhdoi:

> Çdo rezistencë përballej me kërcënime të djegies për së gjalli. Gjakova, Peja dhe Drenica shpeshherë janë cekur si vende ku janë bërë kidnapime [*sic*] dhe

> përdhunime kolektive. Gratë janë përdhunuar individualisht nga shumë paramilitarë, gjatë disa orëve, por disa herë edhe për ditë me radhë. [Në Berlenitz,] ata më pas u prisnin stomakun e shumë grave shtatzëna dhe fusnin fetusin në majat e thikave të tyre. […] Në po këtë qytet një grup prej 30 vajzash të reja është detyruar që t'i përcjellin ushtarët deri në një shtëpi gjersa nënat pritnin jashtë. Për dy orë të tëra nënat dëgjonin britmat e viktimave të reja të cilat pastaj dilnin jashtë një nga një. Disa ishin të mbuluara në gjak, të tjerat qanin gjersa dilnin me koka të varura te poshtë.

"Këto nuk janë incidente të rastit të kryera nga disa ushtarë të çmendur," shkruan Regan Ralph nga Human Rights Watch. "Përdhunimi është përdorur si instrument lufte në Kosovë dhe duhet të ndëshkohet si i tillë. Ata që kanë kryer krime të tilla të rënda duhet të sillen para drejtësisë."[10] Human Rights Watch ka dokumentuar 96 përdhunime që janë kryer gjatë luftës në Kosovë. Vlerësimet sugjerojnë se gjatë luftës janë përdhunuar ndërmjet 10 dhe 45 mijë gra dhe vajza..[11] "Gratë në Kosovë po presin për drejtësi dhe deri më tani në Kosovë nuk është ngritur asnjë aktakuzë për krime seksuale," dëshmon Regan Ralph në vitin 2000. "Sa më shpejtë që të ketë hetime dhe ndjekje penale, aq më shpejtë këto gra do të mund ta rindërtojnë jetën e tyre."[12]

"Aktakuzat janë vetëm fjalë në letër"

"Të shpërfillura nga UNMIK-u, të shpërfillura nga EULEX-i, nuk është për t'u habitur fakti që pak të mbijetuara kanë besim në sistemin e drejtësisë të vetë Kosovës."

- Amnesty International, *Plagë që të djegin Shpirtin,* 2017

Që nga përfundimi i luftës në Kosovë, tri gjykata të ndara kanë mbajtur gjykime në lidhje me krimet e kryera në Kosovë gjatë konfliktit: Tribunali Ndërkombëtar për Krime në ish Jugosllavi (ICTY), Dhoma e Posaçme e Krimeve të Luftës në Beograd në Serbi dhe gjykatat e Kosovës.[13]

Si institucioni i vetëm formal i drejtësisë tranzicionale që ka të bëjë me luftën në Kosovë, ICTY është përgjegjës për zbatimin e Rezolutës 1325 duke siguruar se "proceset e drejtësisë tranzicionale, pajtimit dhe rindërtimit përfshijnë aspektin gjinor."[14] Megjithatë, mandati i ICTY[15] nuk është posaçërisht përfillës ndaj nevojave specifike të grave. Statuti i ICTY prej 79 faqeve përmend "gratë" në vetëm dy raste, që të dy herët në lidhje me Bosnje dhe Hercegovinën. Vajzat nuk u përmenden asnjëherë; sikurse që nuk u përmenden krimet e kryera ndaj grave në Kosovë.[16] Raporti i rezultatit të ICTY ka cekur Kosovën por jo edhe dhunën në baza gjinore. Raportet e tyre vjetore përmendnin vetëm dhunën me bazë gjinore në rekomandimet për gjykatat e krimeve të luftës, drejt zhvillimit të kornizave që "siguronin përgjegjësi më të madhe për krimet me bazë gjinore".[17]

Duke filluar nga viti 2003, ICTY ka pasur të themeluar njësi gjinore që nga 2003, përgjegjëse për të shtyrë përpara barazinë gjinore në ICTY.[18] Këshilltari gjinor ishte i vendosur në Zyrën e Prokurorit, duke punuar në kanalizimin e ekspertizës

gjinore në tërë ICTY dhe për të nxitur qasje të ndjeshme në hetimin dhe ndjekjen e krimeve në baza gjinore.[19] Në vitin 1995 është themeluar ekipi për hetime të dhunës seksuale për të trajnuar policinë për hetime të tilla; më vonë është shpërbërë pasi thuhet se u rrit niveli i vetëdijesimit.

Siç është diskutuar në pjesën e fundit, pjesëmarrja e gruas në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë mund të ndikojë në masën në të cilën këto institucione marrin parasysh interesat dhe nevojat specifike të grave dhe vajzave. Që nga viti 2011, gratë përbënin afërsisht gjysmën e numrit të përgjithshëm të punonjësve në tribunal, ndonëse në pozitat vendimmarrëse burrat ishin më të pranishëm. Një muaj para mbylljes së tribunalit, gratë përbënin 62 përqind (shih Tabelën 5).[20] Megjithatë, deri në fund të mandatit më 2017, nuk ishte asnjë grua gjykatëse në tribunal.[21] Ky i fundit ka pasur dy gra dhe dy burra që shërbyen si prokurorë.[22] Për sa i përket numrit të grave kosovare që kanë dhënë dëshmi në tribunal, statistikat "nuk ishin konfiguruar për të dhënë të dhëna të kësaj natyre".[23]

Tabela 5. Stafi në Tribunal sipas gjinisë dhe pozitës në vitin 2011 dhe 2011-2017

	Deri më 2011		*Deri më 2017*	
Pozita	Gra	Burra	Gra	Burra
Stafi i përgjithshëm i tribunalit	448 50%	456 50%	264 62%	161 38%
Kryetarët	1 14%	6 86%	1 14%	6 86%
Nënkryetarët	2 33%	4 67%	2 22%	7 78%
Gjyqtarë aktualë të përhershëm	2 13%	14 88%	0 0%	8 100%
Gjyqtarë të mëhershëm të përhershëm	6 19%	25 81%	9 21%	34 79%
Gjyqtarë Ad Litem	4 44%	5 56%	14 40%	21 60%
Prokurorë (të gjithë)	2 50%	2 50%	2 50%	2 50%
Zëvendës prokurorë (të gjithë)	0 0%	3 100%	0 0%	3 100%

Në pajtim me Rezolutën 1325, Prishtina, Sarajeva, Zagrebi, dhe Beogradi kanë zyra në terren të ICTY që kanë mandat lehtësimin e aktiviteteve në komunitete dhe angazhimin e grupeve lokale.[24] Këto zyra kishin për qëllim që njerëzve në ish Jugosllavi t'iu komunikojnë rëndësinë e llogaridhënies së individëve që kanë shkelur të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe rëndësinë e ndarjes së drejtësisë për viktimat." Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së inkurajon organet siç është ICTY që të mbajnë seanca dhe takime me grupe të grave.[25] Megjithatë, nëse këto takime janë mbajtur, grupet e grave në Kosovë nuk kanë dëgjuar për to. Gjersa grave në Bosnjë dhe Hercegovinë ju është kushtuar vëmendje e posaçme, në Kosovë ICTY nuk ka zhvilluar asnjë fushatë që do t'u kushtohej enkas grave. Në vend të kësaj, në Kosovë duket se viktimat nuk janë njohur dhe janë injoruar në masë të madhe nga procesi zyrtar i drejtësisë tranzicionale në ICTY.

Që nga 2011, akuzat që përfshijnë akte të dhunës seksuale që pohohen të jenë kryer në Kosovë janë paraqitur vetëm në katër raste në ICTY: *Milošević, Milutinović et al, Đjorđjević* dhe *Haradinaj et al.* [26] Gjersa Haradinaj dhe Millutinoviq janë liruar nga akuzat, ndërsa Millosheviqi ndërroi jetë gjatë gjykimit, Vllastimir Gjorgjeviq është dënuar për persekutime në baza politike, racore apo fetare, deportim, si dhe zhvendosje të dhunshme. Ai është dënuar me 27 vjet burgim për "inkurajimin" apo "mbështetjen: e forcave që kanë: "deportuar dhunshëm rreth 800,000 shqiptarë civilë të Kosovës" dhe "kanë vrarë qindra civilë shqiptarë të Kosovës dhe persona të tjerë që nuk kanë marrë pjesë aktive në armiqësi dhe kanë sulmuar seksualisht shqiptarë të Kosovës, veçanërisht gra."[27] Megjithatë, ai nuk është dënuar për akuzat që kishin të bënin me dhunën seksuale:

> Përderisa Dhoma ka konstatuar se incidentet e sulmeve seksuale kanë ndodhur, nuk është paraqitur asnjë dëshmi se kryerësit kanë vepruar me qëllim të

diskriminimit. Qëllimi për diskriminim është element esencial i cili duhet të dëshmohet. Prandaj, nuk është konstatuar akuza e persekutimit përmes sulmit seksual.[28]

Në fund të fundit tribunali identifikoi katër individë si përgjegjës për dhunën seksuale në Kosovë, megjithëse vetëm dy, Neobojsha Pavkoviq[29] dhe Vllastimir Gjordeviq,[30] u dënuan. Nikolla Shainoviq dhe Sreten Llukiq fillimisht u liruan nga akuzat për persekutim përmes dhunës seksuale në 2009.[31] Në apel, lirimet e tyre u ndryshuan, por nuk u vendosën dënime të reja.[32] Kështu, nga qindra, me siguri edhe mijëra raste të dhunës së pretenduar seksuale, tribunali ka dënuar shumë pak kryerës të dhunës seksuale në Kosovë. Sipas treguesve të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, "shkalla në të cilën shkeljet e të drejtave të grave dhe vajzave janë trajtuar sipas modeleve të njohura të shkeljeve të kohës së luftës" ka qenë jo e rëndësishme.[33]

Në Dhomën e Posaçme të Krimeve të Luftës në Beograd, sipas Amnesty International, "Serbia dështoi të vinte para drejtësisë policinë, paramilitarët dhe anëtarët e Ushtrisë Jugosllave serbe, pavarësisht provave për përgjegjësinë e tyre penale për përdhunim, torturë dhe krime të tjera që lidhen me dhunës seksuale".[34] Nga katër çështje të lidhura me dhunën seksuale të sjella në Gjykatën Speciale në Beograd që nga viti 2017, vetëm një aktakuzë u ngrit kundër një serbi dhe tri të tjera kundër ish-anëtarëve të UÇK-së. Që nga ajo kohë, vetëm një kishte rezultuar në një dënim.[35] Sipas Qendrës për të Drejtën Humanitare dhe Human Rights Watch, zyrtarët e rangut të lartë ushtarak nuk kishin gjasa të paditeshin, për shkak të "klimës së mosndëshkimit në Serbi".[36]

Në Kosovë, gjykatat proceduan vetëm tri raste që kishin të bënin me dhunë seksuale gjatë luftës, dhe të gjitha ato "rezultuan në një pafajësi pas apelimit", duke pasur parasysh provat e pamjaftueshme të dhëna, sipas Amnesty International.[37] Siç vërejti BIRN në Kosovë:

> Shqetësues është fakti se në Kosovë, deri më tani janë zhvilluar vetëm tri gjykime mbi akuzat për përdhunim të grave gjatë luftës, të gjitha këto kanë përfunduar në pafajësi, pasi gjykatat kanë arritur në përfundimin se provat ishin të pamjaftueshme për të identifikuar agresorët e dyshuar. Ndër këto raste është rasti i Vasfije Krasniqit.[38]

Cili mund të jetë shkaku i ngadalësimit të procesit të drejtësisë? Aktivistet e të drejtave të grave në Kosovë theksojnë se sigurimi i dëshmive të mjaftueshme për t'i akuzuar kryerësit e pohuar është dëshmuar të jetë mjaft sfidues për shkak të procesit të gjerë të hetimit. Aktivistja e të drejtave të grave Sevdije Ahmeti shpjegon:

> Të dhënat janë shumë të rëndësishme. Nëse gratë kishin një datë se kur është kryer krimi, unë e hulumtoja arkivin e policisë jugosllave dhe gjeja se kush ishte aty në atë datë. Ishte puna më e rrezikshme që e kam bërë. … Unë i dërgoja hetuesit e ICTY në këto vende të ndjeshme. Pastaj hetuesit duhet t'i kontaktonin gratë, por intervistat ishin shumë të gjata dhe të mundimshme. Duheshin orë dhe ditë të tëra. Secila pjesë kërkonte disa orë për t'u shpjeguar, dhe nuk mund të shmangeshin as detajet më të vogla. … Viktimat duhet të mbanin në mend vendin, numrin e kryerësve, uniformat e kryerësve, emrin e komandantit... të gjitha këto hollësi bënin që gratë të mos jenë kandidate të mira për dëshmitare. … Ishte si një lloj "provimi," gjersa në ndërkohë disa viktima kishin nevojë për mjekë, gjinekologë, abortime. Pas "provimit" disa kandidate "kalonin" si "dëshmitare të mira."[39]

Ndonëse ato kishin qenë viktima të krimeve të tmerrshme, shumë gra kishin vështirësi t'i mbanin në mend të gjitha

hollësitë e nevojshme në mënyrë që të kualifikohen "dëshmitarë të mirë."

Edhe kushtet që u ofroheshin grave të Kosovës që dëshmonin ishin më pak se të kënaqshme, shton Sevdije Ahmeti. Për ato pak gratë që e "kalonin provimin" dhe mund të dëshmonin në tribunal "pasojat ishin shumë të mëdha," tregon ajo. "Sipas të drejtës ndërkombëtare i akuzuari ka të drejtë ta dijë emrin e dëshmitarit që e akuzon atë." Në këtë mënyrë, Millosheviqi, për shembull, mund t'i ndante emrat e dëshmitarëve me kolegët të tij në Beograd, duke bërë që dëshmitarët të ndodhen në rrezik, tha Ahmeti.

Tribunali ofroi mbrojtje të dëshmitarëve për t'i ikur "stigmës që shpeshherë i ndjek viktimat e dhunës seksuale [dhe] paraqet një pengesë të vërtetë në përpjekjet e tyre për risocializim dhe për të vazhduar me jetët e tyre."[40] Njësia e tribunalit për mbrojtjen e dëshmitarëve ofroi masa që përfshinin zhvendosjen dhe ndërrimin e identitetit. Këtë mbështetje tribunali e ofroi përmes Njësisë së Viktimave dhe Dëshmitarëve (NJVD):

> Sipas nevojës, NJVD ofron këshillime psikologjike që duhet të lehtësojnë traumën e mundshme të dëshmimit. Stafi me përvojë përforcon mekanizmat e dëshmitarëve për t'i bërë ballë përvojës, si dhe siguron se ata mbajnë në kontroll të plotë dëshminë e tyre dhe ushtrimin e së drejtave gjatë procedurave gjyqësore. Veç kësaj, stafi i NJVD duhet të bëjë monitorimin e paraqitjes në gjykatë, duke siguruar gjatë tërë kohës se dëshmitarët nuk i ekspozohen tensioneve të papërballueshme. Pas dhënies së dëshmisë, zyrtarët e NJVD ndihmojnë dëshmitarët që të pasqyrojnë përvojën e tyre në gjykatë dhe mundohen që të ju ndihmojnë të kenë në një lloj mbylljeje të këtij kapitulli.[41]

Ndërsa shërbimet e tribunalit për mbrojtjen e dëshmitarëve tingëllojnë të thukëta, aktivistet për të drejtat e

grave në Kosovë mendojnë se mbrojtja e dëshmitarëve dhe këshillimet psikologjike ishin të pamjaftueshme. Sevdije Ahmeti shpjegon:

> Mbrojtja e dëshmitarëve fillon në ditën që ata hynë në tribunal dhe përfundon menjëherë pasi që të kenë dhënë dëshminë. Tani ku mund të shkojnë viktimat? Shumë shpesh kryerësit nuk janë gjetur, identifikuar apo burgosur. Ende ka frikë se familja e viktimës do të vritet, apo se ajo do të vritet.

Në rastet kur është ofruar mbrojtja e dëshmitarëve, disa herë ofrohej me vonesë, sipas Veprore Shehut nga organizata medica Kosova, e cila i ka ndihmuar dy dëshmitare:

> Gjatë luftës dëshmitarja është përdhunuar në grup për dy javë dhe babai i saj, motra dhe vëllai i janë vrarë para syve. Ajo ishte dëshmitare e dyfishtë në tribunal më 2002-2003.
>
> Pasi që ajo shkoi në ICTY për herë të parë, fqinjët e pyetën lidhur me dëshminë. Ajo tha se po dëshmonte për vrasjen e familjes së saj. Por, kjo çështje është transmetuar drejtpërsëdrejti në televizion. Ajo u mor në pyetje një herë për të dyja krimet për t'i kursyer kohë gjykatës. Kjo seancë ishte e mbyllur dhe nuk u transmetua në televizion, mirëpo fqinjët megjithatë e kuptuan.
>
> Më pas ajo e kishte një seancë të dytë dëgjimi për të dhënë dëshminë e fundit. Ajo refuzoi. Ajo nuk dëshironte të kthehej në Kosovë. Ajo veçse ishte kthyer pas seancës së parë dëgjimore edhe pse nuk dëshironte. Ajo e kishte një djalë dhe dëshironte që tribunali t'iu garantonte zhvendosje në një shtet të tretë. Ata thanë po, prandaj edhe ajo u kthye në ICTY dhe tani jeton [gjetiu].
>
> Mbrojtje e tillë nuk ofrohet në të gjitha rastet. Rrethanat e pasigurta dhe mosofrimi i sigurisë nga ana

> e qeverisë për këto gra bën që pandëshkueshmëria të vazhdojë.[42]

Meqë Kosova është shtet i vogël me lidhje të forta familjare dhe rrjete shoqërore, është vështirë që të sigurohen anonimiteti dhe konfidencialiteti. "Njerëzit e njohin njëri-tjetrin," komentoi Nora Ahmetaj. "Edhe me mbrojtje të dëshmitarëve, dikush mund të ta njohë zërin tënd."[43] Shehu pajtohet:

> Mungesa e garancive bëjnë që gratë të hezitojnë dhe të mos duan të dëshmojnë. Këto gjykime është dashur të fillojnë shumë kohë më parë. Sa më shumë që kalon koha, aq më e vështirë do të jetë. Disa prej tyre janë martuar. Si mund të prisni që ato të kthehen prapa? […] Si mund të kemi zbatim të Rezolutës 1325 nëse grave nuk u ofrohet siguri e tillë?

Ngurrimi për t'iu rikthyer të kaluarës traumatike, anonimiteti i pamjaftueshëm, si dhe frika nga kryerësit që ende sillen të lirë kanë penguar gratë të dëshmojnë rastet e dhunimit.

Megjithatë, përvoja e ekspertëve dhe aktivisteve për të drejtat e grave sugjeron se disa gra janë të gatshme për të dëshmuar kur të jenë krijuar kushtet e duhura. Ndryshe nga raportimet e tjera, Fitamant shkruan:

> U befasova nga gatishmëria e tyre për të folur, meqë shumë njerëz më kishin thënë se ato nuk do të ishin të gatshme për të folur për përvojat të cilat komunitetet e tyre i konsiderojnë si të turpshme. Megjithatë, zbulova se gratë kishin dëshirë të madhe të flisnin dhe se nuk e kanë pasur këtë mundësi për shkak se nuk ishte asnjë vend i përshtatshëm që ta bëjnë këtë më herët.[44]

Ndoshta disa aktivistë të të drejtave të grave dhe hetues kanë nxituar të supozojnë se "stigma dhe turpi" do të parandalonin

gratë për të folur hapur. Megjithatë, bisedimet e fundit me aktiviste bëjnë të ditur se sikur të jenë bërë përpjekje më të mëdha për të siguruar një mjedis të përshtatshëm në të cilin mund të flisnin lirshëm gratë, viktimat e përdhunimeve ndoshta do të kishin qenë të gatshme për të dëshmuar.

Përveç ICTY, UNMIK-u ishte përgjegjës për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e luftës të cilat kishin përfshirë dhunë seksuale, por të dhënat e grumbulluara nuk kishin bërë referencë të veçantë sa i përket dhunës seksuale, prandaj dhe ishte e pamundur që të nxirren të dhëna mbi të.[45] Zyrtarë të OKB-së dhe BE-së thanë për RrGK se UNMIK-u kishte lënë prapa vetes shkresa të "shthurura" të dosjeve të cilat EULEX është dashur t'i rregullojë.

"Në janar të vitit 2009, EULEX trashëgoi nga UNMIK raportet e pranuara nga viti 1999 të më se 1,187 veprave të dyshuara të luftës për të cilat UNMIK beson se kishin mungesë të provave të mjaftueshme për t'u dërguar në prokurori për ndjekje penale, si dhe 50 të tjera të cilat janë dërguar në Divizionin Penal të UNMIK-ut për ngritje të aktakuzës," raporton Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së.[46] Në kuadër të mandatit të tij, kompetencat ekzekutive të atëhershme të EULEX-it përfshinin "sigurimin se rastet e krimeve të luftës [... hetohen, ndiqen penalisht, gjykohen dhe ekzekutohen, sipas ligjeve në fuqi."[47] EULEX themeloi Njësinë për Hetime të Krimeve të Luftës e cila ishte e ngarkuar me hetimin e personave të zhdukur, gjetjen e vendvarrimeve, si dhe grumbullimin e dëshmive.

Deri në gusht të vitit 2009, EULEX kishte filluar hetimin e 50 rasteve, por 1,009 raste vazhduan të jenë joaktive, duke përfshirë 158 raste të hedhura poshtë për shkak të mungesës së provave dhe arsyeve tjera.[48] Numri i rasteve të tilla që përfshinin dhunë seksuale nuk ishte në dispozicion. Nga viti 2010, asnjëri nga më se 40 gjyqtarë ndërkombëtarë të EULEX nuk merreshin ekskluzivisht me krime të luftës dhe vetëm dy nga 20 prokurorë ishin të dedikuar për krimet e luftës.[49] Deri në fund të vitit 2009, EULEX kishte gjykuar katër raste të krimeve të luftës që përfshinin tetë të pandehur;[50] shtatë ishin

dënuar dhe një kishte vdekur. Nga shtatë shkresat e lëndës të EULEX që përfshinin akuza të krimeve të luftës ndaj civilëve, asnjëra nuk përfshinte dhunë seksuale. Vetëm një rast përfshinte një viktimë femër, një shqiptare të Kosovës të cilën e kishte qëlluar për vdekje pjesëtari i UÇK-së Idriz Gashi në pyllin afër Vranocit të Pejës më 12 gusht 1998.[51] Gashi ishte dënuar me vetëm 14 vite burgim. Duket se nuk ka ekzistuar asnjë rast i vetëm që përfshinte dhunë seksuale të kryer ndaj grave nga forcat serbe.

Fillimisht dhuna seksuale e kryer ndaj grave gjatë luftës nuk dukej se ishte prioritet për EULEX-in, thanë aktivistet për të drejtat e grave. Lina Andeer, atëherë nga fondacioni *Kvinna till Kvinna* tha në vitin 2011 se EULEX-i nuk kishte ndonjë strategji për të identifikuar dhe adresuar rastet e dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore. Përkundrazi, ata dukeshin skeptikë për hetimin e rasteve të tilla, për shkak të sfidave të shumta të përfshira në hetime të tilla. Ajo shtoi:

> Ata nuk janë duke ndërmarrë asnjë masë speciale për t'i zbuluar përdhunimet. Janë raportuar pesë raste, por ne kemi vërejtur se është dashur të ketë shumë më shumë. Ka mungesë të vullnetit, koordinimit dhe kapacitetit, e ka madje edhe problem me tërë qasjen dhe aftësinë e tyre.[52]

Përfaqësuesit e EULEX thanë se rastet nuk janë përcjellë tutje sepse kishte kaluar kohë e gjatë, identifikimi i dëshmitarëve të gatshëm për të dëshmuar ishte i vështirë dhe mungonin provat.[53]

Nga viti 2011, rrjedhat filluan të ndryshojnë ngadalë dhe EULEX-i filloi t'i hetojë rastet e dhunës seksuale. Përfaqësues të EULEX-it u takuan edhe me organizata të grave për të diskutuar për procesin dhe potencialin për bashkëpunim. Ky ndryshim në qasje ndoshta mund t'i atribuohet presionit të palëkundur të aktivistëve të të drejtave të grave në EULEX; vëmendja gjithnjë më e madhe ndërkombëtare ndaj Rezolutës 1325, siç pasqyrohet në dokumentet e politikës së

lartpërmendur të BE; dhe këmbëngulja e hetueses Nina Pelkonen brenda ekipit të hetimit të krimeve të luftës të EULEX-it, e cila punoi ngushtë me organizatat për të drejtat e grave. Më vonë, një grua e fortë Shefe e Misionit filloi nga 2016 dhe punësimi i të njëjtës Lina Andeer për të shërbyer si Këshilltare Gjinore shumë e përkushtuar duke filluar nga 2015, përforcoi rolin e EULEX-it në adresimin e dhunës seksuale. EULEX-i filloi hetimet e para në rastet ku përdhunimi u akuzua si krim lufte. EULEX në bashkëpunim me UN Women gjithashtu kontribuuan në ndërtimin e kapaciteteve të investiguesve dhe prokurorëve lokal të krimeve të luftës, përfshirë organizimin e trajnimeve në teknikat e intervistimit për të mbijetuarat dhe dëshmitarët e dhunës seksuale në konflikt.[54]

EULEX filloi të bashkëpunojë më ngushtë me organizatat për të drejtat e grave që kishin ndihmuar gratë e mbijetuara në një përpjekje për të sjellë drejtësi. Edhe kështu, Shehu e përshkroi procesin si shumë të vështirë:

> Kur EULEX filloi hetimin e krimeve të dhunës seksuale, ne siguruam burime teknike, logjistike. Gratë nuk pranuan të hyjnë në ndërtesën e EULEX-it me prova […] Shumë prej tyre dëshmuan në fshehtësi, pa u treguar familjeve dhe bashkëshortëve të tyre. Gjatë gjithë kohës, ato ishin të frikësuara se dikush mund t'i shihte ato dhe të aludonin se po dëshmonin për dhunën seksuale. Kjo është arsyeja pse ato nuk pranuan të hyjnë në ndërtesën e EULEX-it.
>
> Por gjetëm një mënyrë alternative: sigurimin e një hapësire në zyrën tonë ku u zhvilluan intervistat. Policia hetimore erdhi këtu dhe mori provat, dhe kjo përfshiu disa faza, ku kërkoheshin intervista të shumta. Nuk ishte një proces i lehtë pasi [të mbijetuarat] u pyetën për detaje për dokumentim dhe nuk ishte e lehtë për to që të ktheheshin pas dhe t'i përshkruanin ato ngjarje në detaje. Ishte një proces shumë traumatik, por fakti që intervistat u zhvilluan në zyrën tonë ishte një avantazh sepse kishte psikologë të

> pranishëm dhe kishte mundësi për pushime gjatë intervistave.

Duke pasur parasysh stigmën sociale lidhur me publikimin e ngjarjes së tyre, Shehu tha se ato përdorën një "strategji të veçantë", për të cilën morën mbështetje nga BE në vitet 2013-2015:

> Ne… adresuam promovimin e barazisë gjinore përmes grave në moshë, mosha 65-70 vjeç, pasi ato preken nga tradita më shumë sesa të rinjtë, dhe [ne u përpoqëm t'i bindnim ato] që të fillonin të mbështesnin viktimat e dhunës seksuale. Kishte aktivitete të kombinuara me seanca të ndryshme duke përfshirë terapi arti dhe seanca të përbashkëta me viktima të dhunës. Patëm një të mbijetuar që erdhi me vjehrrën e saj, e cila e inkurajoi atë: "Shkoni në medica për seanca, dhe unë gjithashtu dua të vij sepse jam e traumatizuar që djali im u vra". Kur vjehrra ishte… në një aktivitet, e mbijetuara veçmas dha dëshminë e saj [konfidenciale]. Ne përdorëm strategji të ndryshme për të përballuar këto pengesa patriarkale.[55]

Ende sot, shumë gra kanë frikë të shprehen për t'u qasur në drejtësi ose për të kërkuar ndihmë, që të mos zbulohet identiteti i tyre, raportoi BIRN në Kosovë:

> Dëshmitarët e mbrojtur të cilët janë anonimë po deklarojnë se nuk mund të fillojnë padi civile për shkak të frikës nga ekspozimi i tyre. Edhe viktimat që u është dashur të mbajnë identitetin e tyre të fshehur tashmë nuk kanë qenë në gjendje të kërkojnë dëmshpërblim në procedurat civile, për faktin se për të ndjekur këtë çështje në procedurat civile, Ligji nuk garanton fshehjen e identitetit të tyre dhe si kusht për të ngritur një proces gjyqësor ato do të kenë nevojë për të

> zbuluar identitetin e tyre, gjë që mund të rrezikojë jetën e tyre.[56]

Mes këtyre vështirësive, gratë nuk kanë parë rezultate pasi kanë dhënë dëshmitë e tyre. Shehu vazhdoi:

> Çfarë ndodhi? U lëshuan urdhër-arreste dhe deri në vitin 2015 ato urdhër-arreste mbetën në letër. Kryesit e krimit vazhdojnë të jenë të lirë. Këto raste ishin nga koha kur filloi gjyqi kundër Millosheviqit, në 2002, 2004, 2005. Në këtë kohë, [gratë] morën pjesë në gjykatë, ndërsa në EULEX periudha ishte 2012-2015. Qasja në drejtësi është një nga fushat më të rëndësishme në kontekstin e Rezolutës, e cila ka shumë pengesa. Nuk ka progres në këtë fushë.[57]

Në të vërtetë, nga 1,200 raste të trashëguara nga UNMIK në vitin 2008, në vitin 2017 EULEX procedoi në gjykatë "dy raste të përdhunimit të pretenduar nga të cilët vetëm një, që rezultoi në një pafajësi, u përfundua", sipas Amnesty International.[58] Sipas tyre, rasti tjetër ishte "braktisur para se të përfundonte gjykimi".[59] Kështu, disa konsiderojnë se EULEX ka dështuar në vendosjen e drejtësisë për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Për më tepër, i gjithë kredibiliteti i tyre është vënë në dyshim. Shehu vazhdoi:

> Në një program televiziv, një përfaqësues i EULEX deklaroi se dosjet e dhunës seksuale që EULEX i mori nga dëshmitarët u dorëzuan në Serbi! Tani lind pyetja: pse u dorëzuan ato pa u konsultuar me palën që ishte një pjesë e rëndësishme e procesit? Pse nuk u informuan gratë për këtë? U shpall urdhri i arrestit, dhe pastaj çfarë ndodhi? Çfarë ka ndodhur me shumë dosje të tjera që janë marrë nga kaq shumë [gra]? Si është e mundur t'i dorëzohen Serbisë? Transparenca ... kjo është një pjesë shumë e rëndësishme dhe transparenca [ende] mungon.

Si rezultat, ajo vazhdoi:

> Gratë kanë humbur besimin ... Gratë janë mjaft të demotivuara sepse nuk ka rezultate konkrete, dhe ne si OJQ nuk jemi përpjekur as t'i inkurajojmë ato t'i qasen drejtësisë. [Sepse] pa rregulluar ekstradimin e kriminelëve [nga Serbia dhe vendet e tjera], këto padi janë thjesht fjalë në letër. Dhe mungesa e vullnetit për të kapur kriminelët shkakton edhe më shumë pasoja për mirëqenien emocionale dhe psikologjike të grave. Kjo është arsyeja pse ne jemi duke pritur që Dialogu [ndërmjet Kosovës dhe Serbisë] të marrë parasysh këto çështje. Ndoshta ato do të krijojnë disa mekanizma midis dy vendeve sepse gratë nuk kanë guximin të dëshmojnë para gjykatave speciale.

Që nga viti 2020, Dialogu Kosovë-Serbi nuk kishte rezultuar në ndonjë marrëveshje për ekstradimin e kriminelëve për drejtësi. Ndërkohë, derisa EULEX-i kishte filluar referimin e rasteve të reja tek autoritetet e Kosovës më 2014,[60] mandati ekzekutiv i EULEX-it u reduktua më tej në vitin 2018[61] dhe përgjegjësia për të siguruar drejtësi për të mbijetuarit e dhunës seksuale u kalua në sistemin e drejtësisë penale të Kosovës. Ndërkohë, i gjithë procesi i kujtimit dhe ndarjes së serishme të rrefimeve të tyre ka hapur plotësisht plagë të vjetra të grave, duke kontribuar potencialisht në ritraumatizim. Kjo i la disa aktivistë të pyesnin veten nëse i'a ka vlejtur në fund, sië u shpreh njëra:

> Unë personalisht mendoj se nuk i kemi përmbushur pritjet që u ngritën. Të gjitha me qëllime të mira, por në fund të ditës, nuk ka shumë rezultat. E gjithë lufta për qasje në drejtësi duhet të ndiqet nga mekanizma të tjerë mbështetës [si] këshillimi psikologjik. … Ekziston një vijë e hollë midis sigurimit të drejtësisë dhe ekspozimit të grave ndaj më shumë traumave.

Pas presionit ndërkombëtar për t'u marrë me krimet e luftës më 3 gusht 2015, u krijuan Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar.[62] Ato kishin mandatin dhe juridiksionin mbi krimet kundër njerëzimit që ndodhën në Kosovë "midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000 nga ose kundër qytetarëve të Kosovës ose Republikës Federale të Jugosllavisë".[63] Sidoqoftë, deri më sot, ato janë përqendruar kryesisht në ndjekjen penale të shqiptarëve për pretendime të krimeve të luftës. Aida Dërguti, ish-deputetja që nisi debatin parlamentar për të mbijetuarit e dhunës seksuale në luftë, shprehu zhgënjimin e saj me qasjen ndërkombëtare ndaj drejtësisë:

> Ndjekja penale e krimeve të luftës në përgjithësi, dhe ato që prekin gratë në veçanti, deri më tani ka qenë një dështim total dhe ka lënë për të dëshiruar. Edhe pse krimet e luftës kanë qenë kompetencë ekskluzive e bashkësisë ndërkombëtare për dekada, ata duket se janë përqendruar dhe kanë bërë pjesën më të madhe të punës së tyre ndaj palëve ndërluftuese, me Kosovën që përndiqet si agresor në vend të viktimës. Provat e kësaj qëndrojnë në proceset gjyqësore të vazhdueshme kundër anëtarëve të UÇK-së në gjykata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare të drejtësisë, ndërsa ne nuk kemi një rast të vetëm [të] dënimit për krime të dhunës seksuale ndaj grave dhe vajzave në Kosovë. Rezoluta 1325 është e pamjaftueshme si një instrument për të sjellë drejtësi për krimet e kryera ndaj grave gjatë luftës. OKB mund të bëjë shumë më tepër, pasi që shumica dërrmuese e shteteve janë anëtare nën ombrellën e saj. Ai duhet të gjejë mënyra për të krijuar mekanizma dhe për të bërë presion mbi shtetet anëtare për të arritur drejtësinë për gratë dhe dëmshpërblimet e luftës.[64]

Shehu u pajtua:

> Kjo gjykatë, që nga themelimi i saj, filloi me padi kundër krimeve të pretenduara të ushtarëve të UÇK-së Megjithatë, ajo duhet të merret jo vetëm me një grup etnik, por edhe me krimet e kryera nga ushtria dhe policia paramilitare [serbe] në Kosovë. Unë nuk do të pranoj amnistinë nga askush; një krim është një krim, dhe ata që kanë kryer krime duhet të dënohen.[65]

Në të vërtetë, e drejta ndërkombëtare nuk lejon amnisti në rastin e krimeve të luftës, përfshirë dhunën seksuale të kryer ndaj grave. Kjo theksohet në Rezolutën 1325 dhe madje përforcohet nga rezolutat e tjera të fundit të tilla si Rezoluta 2467 (2019), e cila shprehë qartë "nevojën për përjashtimin e krimeve të dhunës seksuale nga dispozitat e amnistisë dhe imunitetit në kontekst të proceseve për zgjidhjen e konfliktit".[66]

Të frustruara nga mungesa e drejtësisë dhe vëmendja e pamjaftueshme ndaj të mbijetuarave të dhunës seksuale nga nisma më të gjera të drejtësisë tranzicionale në rajon, organizatat e të drejtave të grave ndërmorën një iniciativë drejt drejtësisë tranzicionale sipas kushteve të grave: Gjykatën e Grave. Një iniciativë e përbashkët e RrGK-së nga Kosova, Gratë në të Zeza nga Serbia dhe Lëvizja e Nënave të enklavave të Srebrenicës dhe Zhepës nga Bosnja dhe Hercegovina, e cila mblodhi së bashku organizata për të drejtat e grave nga e gjithë ish-Jugosllavia. Sipas RrGK:

> Gjykata nuk përfshiu as autorë e as gjyqtarë. Ajo ofroi një qasje feministe dhe jo ligjore ndaj drejtësisë. Gjykata u përpoq të krijonte një hapësirë të sigurt që do të fuqizonte gratë nga e gjithë ish-Jugosllavia për të treguar historitë e tyre të vuajtjes, guximit dhe rezistencës.[67]

Pas disa takimeve përgatitore, rreth 500 gra nga e gjithë ish-Jugosllavia u mblodhën në Sarajevë. Për katër ditë, gratë ndanë të vërtetat dhe përvojat e tyre nga vitet 1990, duke përfshirë histori të torturave, përdhunimeve dhe humbjes së

njerëzve të dashur.[68] Sipas Kvinna till Kvinna, gratë treguan një "vendosje për paqe dhe drejtësi, jo hakmarrje. Për dëmshpërblim, siguri, për të ardhmen e mirë të tyre dhe fëmijëve të tyre dhe për solidaritet me të gjitha gratë, përtej të gjithë kufijve të mundshëm". [69] Duke njohur të kaluarën, Gjykata e Grave u përpoq të mbështeste gratë në ndërtimin e një të ardhmeje paqësore së bashku.[70]

Ndërkohë, gratë e grupeve të ndryshme etnike kanë qenë të ekspozuara ndaj dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Ndërsa askush nuk e ka parë drejtësinë, madje edhe më pak kanë marrë mbështetje nga publiku dhe shoqëria civile, sipas Shpresa Agushit:

> Një vit më parë u publikua në mediat sociale se ajo [e mbijetuar Rome e dhunës seksuale] raportoi rastin e saj, dhe ajo ishte dëshmitare në gjykata për një krim që i ndodhi asaj gjatë luftës. Dhe OJQ-të që merren me këto çështje kishin njohuri dhe askush nuk e mbështeste atë. Fatkeqësisht, në momentin që e pashë në rrjetet sociale, dëgjova për këtë sepse OJQ-të që merren me këto çështje kanë thënë se ata e kanë ndjekur rastin e saj, por nuk mund të merren me të gjitha gratë. ... Sidoqoftë, ajo ishte e guximshme dhe ka shkuar aq larg saqë ka qenë në Beograd. Të shkohet atje për të folur për këtë në Serbi nuk është e lehtë. Megjithatë ajo nuk pati sukses. Djali i saj e bëri publike [çfarë i ndodhi asaj] pas vdekjes së saj. Ajo vdiq dhe nuk e fitoi të drejtën e saj [për drejtësi]. Doli që ajo ishte gruaja e parë kosovare që kishte guximin të fliste për përdhunimin e bërë kundër saj gjatë luftës nga pjesëtarët e forcave serbe. Kjo është shumë diskriminuese nga institucionet dhe OJQ-të që merren me këto gra [dhe] të cilat nuk e mbështetën [atë]. Edhe pse ajo luftoi shumë për të drejtat e saj, ajo nuk kishte mbështetjen dhe mirëkuptimin e institucioneve dhe OJQ-ve. Kjo i bën gratë e tjera të humbin besimin.[71]

Siç përmbylli Vjosa Osmani Sadriu, atëherë Presidente në detyrë e Kosovës:

> Akoma 20 vite pas luftës, drejtësia për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë nuk është vendosur ende. Deri më sot, dënimet e merituara për krimet e kryera gjatë luftës së fundit në vendin tonë nuk janë shqiptuar. Në këtë drejtim, nuk ka pasur drejtësi as për gratë, dhe për më tepër ato janë stigmatizuar dhe janë bërë viktima të paragjykimeve të shumta që i ndjekin ato në periudhën e pasluftës.[72]

“Ne nuk duam lule. Ne duam drejtësi për të mbijetuarat e dhunës seksuale”

“Ndërsa ishim në prag të 8 Marsit, datë në të cilën RrGK gjithmonë protestonte për tema të ndryshme në lidhje me të drejtat e grave, u vendos që motoja e 8 marsit 2012 të ishte” Ne nuk duam lule. Ne duam drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës.”

- Aida Dërguti, ish-deputete, 2020

Nxitja e grave për të kërkuar drejtësi, apo thjeshtë për të jetuar në mënyrë më paqësore brenda komuniteteve të tyre kërkon transformimin e normave sociale. Pas mbulimit të tepërt medial të viktimave menjëherë pas luftës, të cilin aktivistet e të drejtave të grave e quajtën “përdhunim të serishëm” të grave, këtë çështje e mbuloi heshtja. Si rezultat, pak gra që pësuan dhunë seksuale ishin të gatshme të paraqiten për të kërkuar drejtësi ose mbështetje.

Ndryshe nga Bosnja ku politikanët publikisht e pranuan dhe fuqimisht e dënuan dhunën seksuale të kryer ndaj grave dhe vajzave, në Kosovë nuk është bërë asnjë pranim i tillë publik, përkundër kërkesave të aktivisteve për të drejtat e gruas për një gjë të tillë. “Anëtarët e qeverisë do të vazhdojnë t’i injorojnë gratë nëse nuk ka njohje publike,” vëren Rogova në vitin 2011.[73] Në atë kohë, Shehu shtoi:, “Duhet të ekzistojë diçka në ligj, diçka publike, ashtu që njerëzit ta dinë se sa e rëndësishme është kjo gjë dhe që gratë nuk donin që një gjë të tillë të ndodh. Ajo ka mundur t’i ndodhë edhe një gruaje që ata e njohin.” Ajo vazhdoi:

> Mendoj se pranimi publik është diçka që ngushëllon. Një klienteje i është bërë me gisht në autobus. Ajo kishte mbijetuar përdhunimin. Pas kësaj, tash e tutje, ajo ka vendosur që të ecë në këmbë për në punë dhe anasjelltas. Një ditë të ftohtë u detyrua të hyjë sërish në autobus, dhe një person bëri me gisht në drejtim të saj dhe e pyeti nëse ajo ishte vajza që ishte përdhunuar, ndërsa ajo u përgjigj, "Po, por unë nuk e kam kërkuar një gjë të tillë." Disa njerëz mendojnë se gratë e kanë kërkuar vetë këtë, ndërsa në fakt gratë kanë qenë më të rrezikuara sepse atyre u duhej të shkonin për të marrë ushqim dhe furnizime për shtëpitë e tyre, meqë gjatë luftës burrat fshiheshin në bodrume.

Shehu beson se janë të nevojshme më shumë fushata sensibilizuese ashtu që njerëzit të bëhen "më të ndjeshëm dhe më të vëmendshëm për këto çështje."

Me qëllim të nxitjes së një reagimi institucional, organizata Medica Kosova, së bashku me organizatat e tjera për të drejtat e grave, ka bërë përpjekje për ndryshimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjeve të tyre, fillimisht ky Ligj nuk u dha të drejtë në beneficion apo pensione viktimave të dhunës seksuale.[74] Pranimi dhe asistenca sociale për mbrojtjen e mirëqenies së viktimave është thelbësore për thyerjen e heshtjes dhe shmangien e perceptimit të pabazuar të fajësisë së grave të cilat kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës. Duke pasur parasysh rezistencën fillestare të zyrtarëve ndaj idesë, aktivistët e të drejtave të grave e dinin se duhej të bënin diçka që do të tërhiqte vëmendjen për këtë çështje.

Më 8 mars 2012, aktivistët u mblodhën për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Grave në qendër të Prishtinës. Pankartat e tyre kërkonin drejtësi për gratë. Së bashku ato kënduan një këngë tronditëse duke kërkuar "drejtësi për gratë" në melodinë e himnit të të drejtave civile "Ne do t'ia dalim".

Përfaqësuesit e qeverisë më vonë do t'u tregonin aktivisteve se ata ishin "prekur me lot", ndërsa kënga jehoi nëpër sheshin përndryshe të heshtur dhe ndërtesën e qeverisë, si "zërat e engjëjve" që kërkonin drejtësi. Kjo shënoi herën e parë që gjendja e të mbijetuarave të dhunës seksuale u diskutua publikisht në Kosovë.

Të nesërmen, për herë të parë, Kuvendi i Kosovës diskutoi për dhunën seksuale të kryer në luftë, iniciuar nga ish-deputetja dhe më pas Nënkryetarja e partisë politike Vetëvendosje, Aida Dërguti. Ajo kërkoi që statusi i të mbijetuarave të dhunës seksuale të kryer gjatë luftës të njihet dhe që ato të kenë qasje në mbështetje financiare nga shteti. Ajo kujtoi:

> Gjithçka filloi brenda Vetëvendosjes, si një diskutim midis meje, si Nënkryetare e partisë dhe Nazlie Balaj. Pasi kjo ide u miratua nga kryesuesit e partisë, në prag të 8 marsit 2012, ne u takuam me Igballe [Igo] Rogovën dhe së bashku filluam të planifikojmë hapat e ardhshëm. … Ndërsa ishim në prag të 8 Marsit, datë në të cilën RrGK protestoi për tema të ndryshme në lidhje me të drejtat e grave, u vendos që motoja e 8 marsit 2012 të ishte "Ne nuk duam lule! Ne duam drejtësi për gratë e dhunuara gjatë luftës."
>
> [Së bashku] ne organizuam diskutime publike për të informuar publikun mbi këtë temë. Shanset që [partitë më të mëdha politike] të mbështesin një iniciativë të ardhur nga një parti e vogël dhe shumë polarizuese e opozitës ishin mjaft të ulëta. Prandaj, Igo Rogova së bashku me RrGK morën rolin e ndërmjetësit midis grave deputete. Tryezat me dyer të mbyllura midis grave në politikë dhe shoqëri civile, të organizuara nga RrGK, kishin për qëllim sigurimin e votave për këtë ligj nga gratë deputete nga partitë e tjera në parlament. Përfundimisht, projektligji u hartua në Lëvizjen Vetëvendosje nga pesë gra: Dejona Mihali, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Nazlie Bala dhe unë. Ky

projektligj është përpunuar në Kuvendin e Kosovës në emër të Lëvizjes Vetëvendosje.[75]

Projektligji nuk arriti të siguronte mjaft vota disa herët e para që u paraqit para parlamentit. Në të vërtetë, siç druhej Dërguti, partitë politike të shumicës ngulnin këmbë, duke mos dashur të pranonin një ligj të paraqitur nga Vetëvendosje. Disa politikanë burra bënë deklarata të egra publike se përdhunimi nuk ishte aq i përhapur. Ndërsa të tjerët shprehën shqetësim në lidhje me implikimet e buxhetit, veçanërisht pasi Qeveria nuk kishte një vlerësim të saktë të numrit të grave që i kishin mbijetuar përdhunimit.

Gratë në politikë, gratë në shoqërinë civile dhe aleatët ndërkombëtarë morën pjesë në lobim aktiv, duke theksuar se ekzistojnë prova të pavarura të verifikueshme të përdhunimit nga organizata të respektuara, të tilla si Human Rights Watch, dhe që, për fat të keq, jo të gjitha gratë do të rrëfeheshin; nuk do të falimentonte shteti. Rogova u takua personalisht me liderët politikë në të gjithë spektrin e partive, duke theksuar se dështimi i tyre për të njohur gjendjen e grave dhe për t'i mbështetur ato ishte turp i vërtetë.

Pas lobimit të vazhdueshëm nga një sërë aleatësh, përfundimisht, dy vjet më vonë, në mars 2014, të drejtat e të mbijetuarve për kompensim u njohën përfundimisht përmes ndryshimit të ligjit ekzistues për të drejtat e luftëtarëve dhe viktimave civile të luftës.[76] Përveç mbështetjes financiare, kjo u siguroi të mbijetuarve përfitime, të tilla si shërbimet shëndetësore jashtë vendit në rast se kishin nevojë për trajtim si pasojë e luftës; qasja prioritare në punësim në sektorin publik dhe privat; lirimi nga taksat e pronës; dhe qasja me prioritet në banim familjar qeveritar nëse janë në kushte të vështira ekonomike.[77]

Miratimi i këtij ligji të ndryshuar u paralajmërua në mënyrë të përsëritur si një arritje kryesore në dekadën e fundit drejt zbatimit të Rezolutës 1325. Siç kujton Osmani Sadriu:

> Një nga arritjet më të mëdha në zbatimin e Rezolutës 1325 në Kosovë ishte padyshim njohja ligjore dhe kompensimi i viktimave. Më kujtohet sa shumë unë dhe kolegët e mi deputetë duhet të punonim për të siguruar numrin e votave që na duheshin për të miratuar ligjin. Edhe pas miratimit të tij në vitin 2014, ne duhet të punojmë çdo vit për të alokuar buxhetin e nevojshëm, për të luftuar stigmën dhe për të ndihmuar gratë dhe burrat të mbijetuar të dhunës seksuale që të paraqiten dhe të aplikojnë për statusin e të mbijetuarit.[78]

Feride Rushiti, Drejtore Ekzekutive e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), gjithashtu kujtoi nismën fillestare për të siguruar fonde për të mbijetuarit:

> Lajmi u bë viral atë ditë, duke e bërë ditën të paharrueshme! Një nga mediat më të mëdha në Kosovë zbuloi sasinë e mbështetjes financiare që do të merrnin të mbijetuarit e dhunës seksuale. U habita! Dua të them, ne kurrë nuk e përmendëm sa do të merrnin; ky ligj nuk e përmendi shumën sepse ne nuk e dinim se sa [gra] ka, kështu që llogaritja ishte e pamundur. Por ... 200 euro [në muaj kompensim]!? Kjo ishte qesharake! Unë nuk pi duhan, por atë ditë piva një pako cigare ndërsa prisja të merrja vajzën time të vogël nga çerdhja. Isha me një të mbijetuar. Më kujtohen fjalët e saj, "Të lutem ndalo luftën. Ju nuk mund ta shtyni ariun". Isha në mendime të thella. Pasi arrita në shtëpi dhe ndava historinë me burrin tim, ai më tha pothuajse të njëjtën gjë. Por unë u përgjigja, duke thënë: "Nuk ka mbaruar akoma." Unë nuk doja ta besoja, e lëre më ta pranoja, pasi Qeveria nuk ishte takuar ende për ta miratuar atë.
>
> Gjëja e parë që bëra mëngjesin tjetër ishte caktimi i një takimi me Ministrin e atëhershëm të Financave, Bedri Hamzaj. Pastaj, shkova në zyrë dhe takova një të mbijetuar. Ajo kishte emigruar në Suedi

si dëshmitare [për dhunën seksuale] për gjykatën e Hagës, me një identitet të mbrojtur. Për herë të parë ajo foli hapur për të kaluarën e saj. Sepse me një identitet të mbrojtur, ajo nuk guxonte të tregonte historinë e saj. Sidoqoftë, kjo histori më preku aq shumë emocionalisht sa kisha emocione kur u takova me Ministrin.

Ai dhe stafi i tij po na prisnin mua dhe kolegen time me çokollata, duke menduar se shkuam atje për ta falënderuar. Unë i thashë, "Jo, kemi ardhur këtu për një çështje tjetër."

"Çfarë çështje, çfarë ndodhi?" Ai pyeti. Çuditërisht, unë thashë, "Ne nuk ramë dakord për 200 euro". E dija që kishte një limit të pagesës, duke ditur që veteranët e [UÇK-së] nga vitet nëntëdhjetë morën 250 euro dhe e dija që nuk mund të arrija atje. Kështu, unë thashë: "Po si thua për 230 ose 240 euro?"

Ai pranoi, duke zgjatur dorën dhe tha: "Dakord. 230 lë të jetë".

Kjo nuk kishte mbaruar pasi unë duhej të shkoja në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për të ndryshuar vendimin, pasi ai ishte dërguar tashmë atje. Unë pata fat, pasi në atë kohë këto ndërtesa ishin afër njëra-tjetrës… dhe unë shkova atje duke vrapuar. Mbërrita atje me kohë dhe kështu ia dolëm.[79]

Gratë tani do të merrnin pak kompensim nga qeveria, për t'i njohur ato dhe për të lehtësuar vështirësitë e tyre ekonomike. Megjithatë, aktivistet kanë theksuar prerazi se kjo nuk përbën dëmshpërblim. Siç shpjegoi Shehu:

Është progres që kjo skemë është vendosur, pasi viktimave u ofrohet [një farë] stabiliteti financiar. Sidoqoftë, dëmshpërblimet duhet të paguhen nga agresori: nga vendi që shkaktoi gjithë këtë vuajtje. Dhe Serbia, për 21 vjet tani, nuk ka paguar asgjë.[80]

Siç ra dakord Minire Begaj, Kryetare e Komisionit për Verifikimin dhe Njohjen, "Unë nuk do ta quaja atë kompensim ose ndonjë lloj dëmshpërblimi; është më shumë një pension personal".[81]

Ligji i ndryshuar parashikoi gjithashtu krijimin e një Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale të luftës, mandati i së cilit zgjati pesë vite.[82] Nën udhëheqjen e kujdesshme të Presidentes së atëhershme Jahjaga, Komisioni u krijua më 2018 në bashkëpunim të ngushtë me organizatat për të drejtat e grave me përvojë në punë me të mbijetuarit. Ata diskutuan çdo detaj për të siguruar që Komisioni do të ruante konfidencialitetin dhe trajtimin me dinjitet të grave të mbijetuara gjatë procesit të kërkimit të të drejtave të EULEX-i ka ndihmuar Komisionin me dokumentacionin përkatës të prokurorisë në lidhje me krimet e luftës që mund t'i ndihmojë gratë të njihen si të mbijetuara në mënyrë që ato të mund të kërkojnë përfitime. [83]

Sipas Begajt, që nga viti 2020, ata trajtuan gati 3,000 raste. Megjithëse ligji parashikonte një afat për dorëzimin e kërkesave që do të skadonte pas pesë vjetësh, Begaj besoi se afati duhet të zgjatet nëse ato nuk mund të zgjidhin të gjitha rastet gjatë kësaj kohe:

> Ne [Komisioni] kemi një mandat pesë-vjeçar për t'u siguruar të mbijetuarve të drejtën dhe njohjen e statusit, por nëse nuk arrijmë t'i përfundojmë të gjitha çështjet [brenda afatit të parashikuar] për arsye të ndryshme, atëherë Qeveria mund të zgjasë mandatin tonë derisa të zgjidhim [të gjitha] çështjet e mbetura.[84]

Amnesty International gjithashtu vërejti që afati kohor duhet të zgjatet për t'i dhënë grave kohë për t'u paraqitur, duke pasur parasysh natyrën shumë të ndjeshme të rasteve.[85] Për më tepër ata bënë thirrje për të zgjatur periudhën e definuar si periudhë e konfliktit të armatosur, për të mundësuar përfshirje më të mirë të grave të të gjitha etnive. Ligji aktual thotë se

konflikti përfundoi më 20 qershor 1999, kështu që gratë që u përdhunuan më pas, veçanërisht gratë serbe të Kosovës, rome, por edhe disa gra shqiptare, padrejtësisht nuk u kualifikuan për përfitime.

Nën udhëheqjen e Presidentes Jahjaga, çështja e të mbijetuarve gjithashtu mori një mbulim të rëndësishëm mediatik vendor dhe ndërkombëtar. Kjo ndihmoi për të adresuar sfidën tjetër: informimin e grave për këtë të drejtë të re dhe inkurajimin e grave që të paraqiten për të kërkuar të drejtat e tyre. Kryetarja Jahjaga foli me të mbijetuarat, dhe në media, duke inkurajuar gratë të paraqiten. Nën patronazhin e saj, në vitin 2015 artistja Alketa Xhafa Mripa bashkëpunoi me grupet e të drejtave të grave për të mbledhur mijëra fustane të dhuruara nga gratë në të gjithë Kosovën, për të përfaqësuar gratë e dhunuara; ekspozita në stadiumin e futbollit në Prishtinë fitoi vëmendjen në gjithë botën. Ndërkohë, grupet e të drejtave të grave që punojnë me të mbijetuarat punuan pa u lodhur për të informuar gratë për të drejtat e tyre të reja dhe i mbështetën ato në proceset administrative për të kërkuar këto të drejta.

Grupet e të drejtave të grave i kanë inkurajuar gratë që të paraqiten për të kërkuar të drejtat e tyre. Disa gra që dolën në publik me historitë e tyre gjithashtu dëshironin të fuqizonin gratë tjera. Sipas Rushitit, pasi Vasfije Krasniqi Goodman, u deklarua publikisht në vitin 2019, edhe Shyhrete Tahiri gjithashtu doli publikisht:

> Çdo vit u përpoqëm të dilnim me raste të reja, për të dërguar edhe një mesazh. Vasfija është konfirmuar si viktimë e përdhunimit. … Ajo u mor nga shtëpia e saj në moshën 16 vjeç. ... Në rastin e saj, familja e saj gjithashtu ishte mbështetëse dhe ne donim t'u jepnim një mesazh familjeve të të mbijetuarave të tjera.
>
> Jo të gjitha janë të gatshme t'i bëjnë publike historitë e tyre. Prandaj, [Shyhretja] tha dy fjalë para mediave dhe pastaj e paraqiti çështjen në Prokurorinë

> [e Kosovës]. Kështu, ajo dërgoi mesazhin se nëse doni të kërkoni drejtësi, duhet t'a bëni publike historinë tuaj.

Avokimi dhe mbështetja e grupeve për të drejtat e grave, së bashku me njohjen zyrtare të parashikuar me ligjin e ri, kontribuan në këtë mënyrë që më shumë gra të ndiheshin të fuqizuara për të paraqitur dhe raportuar rastet e tyre. Andeer reflektoi:

> Ishte fushata ndërgjegjësuese dhe njohja e të mbijetuarave përmes Ligjit që ndihmoi në thyerjen e tabusë. Kjo, së bashku me disa persona të përkushtuar që punonin brenda EULEX-it, [një hetuese policore e mbështetur nga Shefja e Njësisë së Krimeve të Luftës] ishin instrumentale … [dhe] ndikoi që më shumë gra të publikojnë storjen e tyre.
>
> Në atë kohë, megjithatë, ishte vendosur që EULEX-i të mos merrte asnjë rast të ri nga 15 prilli 2014, dhe të gjitha rastet e reja duhej t'i referoheshin sistemit vendor të drejtësisë penale.[86] Kjo ndodhi në një kohë të papërshtatshme. Dhe kishte të paktën dy probleme të mëdha me referimin e rasteve në sistemin vendor: së pari, mungesa e kapaciteteve duke përfshirë mungesën e përvojës dhe ekspertizës në krimet e luftës dhe fakti që ekzistonin vetëm dy prokurorë për trajtimin e të gjitha rasteve të krimeve të luftës. Dhe së dyti, mungesa e besimit të grave në sistemin lokal, veçanërisht në aftësitë e tij për të mbrojtur identitetin e viktimave. Mendoj se politika e jo-rasteve të reja mund të ishte përjashtuar për rastet e dhunës seksuale për shkak të natyrës së tyre të ndjeshme.[87]

Prandaj, edhe pse përpjekjet për ngritjen e vetëdijes dhe njohjen inkurajuan më shumë gra të paraqiten publikisht, mosbesimi në autoritetet e Kosovës për t'i trajtuar rastet me kompetencë, konfidencialitet dhe kujdes minoi qasjen e grave

në drejtësi. Koha ishte vërtet fatkeqe dhe një mundësi e humbur për të mundësuar përfundimisht qasjen në drejtësi për gratë.

Ndërkohë, fakti i thjeshtë se shteti ka njohur gjendjen e vështirë të të mbijetuarave dhe ka siguruar mbështetje ka ndikuar pozitivisht në vetëvlerësimin e të mbijetuarve, thanë aktivistët. Rushiti kujtoi një bisedë që ajo bëri me një të mbijetuar menjëherë pasi mori para në llogarinë e saj bankare për herë të parë:

> Mbaj mend një telefonatë që mora nga një e mbijetuar. Kur mora telefonin, gjëja e parë që dëgjova ishte muzika në sfond. Ajo filloi të flasë, duke më thënë se kishte blerë tre thasë të mëdhenj me miell… dhe se, për herë të parë, kishte kaq shumë para në duar. "I lashë ata thasët e mëdhenj me miell në mes të dhomës së ndenjes, për t'iu bërë të ditur të gjithëve se edhe unë mund të kontribuoj për shtëpinë tonë," tha ajo, fjalë për fjalë. Ishte shumë emocionuese!
>
> Këto nuk janë aq shumë para. [Të mbijetuarat] i përdorin ato për të blerë barna, për të ndihmuar vajzat e tyre të shkollohen. Përtej kësaj, kjo përfaqëson njohje nga institucionet. Kështu, ato nuk kanë pse të ndihen fajtore ose të turpëruara më, pasi normat shoqërore i bënë ato të ndihen [më parë] sepse tani shteti po i trajton ato me integritet dhe dinjitet të plotë. … Kështu, statusi i tyre në familje ndryshon, pasi ato u fuqizuan dhe u mbështeten.[88]

SIGURIA E GRUAS – OBJEKTIV PRIMAR PËR PAQERUAJTËSIT

"Paqja e gjithanshme dhe e qëndrueshme në situatat e pas-konfliktit nuk është e mundur nëse siguria dhe pjesëmarrja e gruas nuk është objektiv primar i paqeruajtësve."

- Zyrtar i lartë i OKB-së, takim i Këshillit të Sigurimit, 2008[89]

Ishte mëngjes i freskët pranvere në fshatin e vogël e të qetë të Krushës së Vogël. Fshati filloi të mbushet me banorë lokalë që kryenin obligimet e tyre ditore. Gratë e fshatit bartnin sfurqet derisa shkonin për të mbledhur sanë dhe për ta nisur ditën e lodhshme të radhës. Pak gra kishin burra në familjet e tyre për t'iu ndihmuar. Më 26 mars 1999, 114 burra, pra 70 për qind të burrave të fshatit, janë ndarë nga familjet e tyre dhe janë masakruar nga fqinjët e tyre serbë. Të tjerët u zhdukën pa gjurmë. Krime të tjera, si përdhunime dhe tortura, janë kryer ndaj grave dhe fëmijëve para se fqinjët e tyre serbë dhe forcat paramilitare t'i ndjekin deri te lumi Drin, ku iu është thënë: "ose mbyteni veten në lumë ose ecni deri në Shqipëri." Shtëpitë e tyre janë rrënuar për toke, bagëtia është vrarë dhe fushat janë shkatërruar.

Ndonëse këto krime kurrë nuk janë gjykuar madje as pranuar nga Qeveria e Serbisë, gratë e fshatit kanë punuar shumë për të rindërtuar jetën e tyre me ndihmën e organizatave vendore të grave. Tani ato e fitojnë vetë bukën e

gojës. Janë mësuar të ngasin traktorë, t'i sjellin mallrat vetë në treg, si dhe ta mbështesin fuqishëm njëra-tjetrën. Ngadalë, jeta fillon të normalizohej.

Më 25 maj 2006, rreth orës 9:15 të mëngjesit, diçka e pazakontë sillej në Krushë të Vogël. Dymbëdhjetë vetura të blinduara të UNMIK-ut erdhën krejt pa paralajmërim. As policia e Kosovës, as zyrtarët e zgjedhur, e as dikush nga fshati nuk ishin informuar. Veturat u ndalën dhe një polic i UNMIK-ut e pyeti një vajzë se ku mund të gjinden shtëpia e familjes Batusha. Derisa vajza bëri me shenjë se ku gjendet shtëpia, fshatarët e tjerë filluan t'i shikojnë nga afër veturat e ndalura. Ata brenda veturave vërejtën ish fqinjët e tyre serbë të cilët kishin kryer krime ndaj tyre vetëm shtatë vite më parë, e të cilët kishin shpëtuar pa kurrfarë ndëshkimi për veprat e kryera.

"Ata po kthehen!" bërtiti një grua, gjersa i ktheheshin kujtimet e asaj dite të tmerrshme të 26 marsit sikur për mallkim.

Sapo e dëgjuan atë, gratë që ishin nisur për në fushë iu afruan veturave të UNMIK-ut. Në emër të grave të fshatit, Shpresa Shehu, mësimdhënëse dhe aktiviste e të drejtave të grave, e pyeti policinë e UNMIK-ut nëse gratë mund të flisnin me udhëtarët në vetura. Gratë dëshironin t'i pyesnin se çka ka ndodhur me burrat dhe djemtë e tyre të cilët ishin zhdukur që nga lufta. Zyrtarët e UNMIK-ut refuzuan.

Të pakënaqur me përgjigjen dhe të frikësuara nga kthimi i kriminelëve të luftës, gratë u ulën në mes të rrugës dhe pamundësuan lëvizjen e veturave të UNMIK tutje drejt fshatit të tyre. Policët e UNMIK-ut u munduan t'i lëvizin gratë me dhunë, duke i kapur për krahë. Kur gratë filluan t'u kundërvihen atyre, policët filluan t'i rrahin me shkopinj kundër trazirave dhe me kondakë të armëve të tyre. Kjo gjë bëri që gratë të irritohen dhe të gjuajnë gurë në drejtim të policëve të UNMIK-ut.

Përfundimisht, policët u kthyen në veturat e tyre të blinduara. Derisa ktheheshin, ata hodhën gaz lotsjellës, madje pa kursyer as fëmijët e shkollës fillore të fshatit, në oborrin e së cilës kishin nxënësit e shkollës gjatë pushimit të madh.

Dhjetëra fëmijë u desh të shtroheshin në spitalin e Prizrenit për trajtim nga gazi lotsjellës, ndërsa gratë pësuan trauma psikologjike. Kur arritën aktivistet e të drejtave të grave nga Prishtina dhe Prizreni për t'i mbështetur ato, vërejtën se gratë dridheshin nga frika, thellësisht të shqetësuara nga kujtimet e luftës dhe me ankth se vrasësit e dashurëve të tyre do të ktheheshin prapë.

"Në fytyrat e tyre unë pashë të njëjtat shprehje sikurse atë ditë kur u'a kishin djegur shtëpitë dhe kur u'a kishin vrarë familjarët e tyre," rrëfen aktivistja për të drejtat e grave Marta Prenkpalaj nga Shoqata Motrat Qiriazi.[90] Atë natë të tmerrshme të vitit 1999, kur gratë dhe fëmijët e Krushës së Vogël u detyruan të lëshonin shtëpitë e tyre, ajo kishte marrë traktorin për t'i bartur ato matanë lumit në një vend të sigurt. "Policia e UNMIK-ut i ka ritraumatizuar."

"Policia e UNMIK-ut nuk ka informuar asnjë institucion demokratik lidhur me vizitën e tyre; ata përdorën dhunë kundër grave dhe fëmijëve; dhe ata nuk pranuan t'i lejojnë gratë të komunikojnë me njerëzit që i transportonin," thuhej në letrën e RrGK-së drejtuar Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Søren Jessen-Peterson dhe Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut Kai Vittrup. [91] Përfundimisht, kjo shkresë çoi në hetim të thellë dhe kërkimfalje publike nga ana e Jessen-Peterson.[92] Vittrup la misionin gjatë atij viti.[93]

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së i bën thirrje Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe organizatave rajonale që të krijojnë dispozita të cilat trajtojnë nevojat specifike të grave dhe vajzave në sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe mekanizmat për parandalimin e konfliktit.[94] Megjithatë, një hulumtim i Këshillit të Sigurimit i kryer pas "një dekade të përgjakshme të dështimeve në paqeruajtje, sikurse në […] ish Jugosllavi" zbuloi mungesë të vëmendjes ndaj nevojave të grave dhe vajzave. "Këshilli asnjëherë nuk kishte përmendur gratë, paqen dhe sigurinë në rezolutat e tij për situatat në ... Kosovë," përfundon raporti.[95] Përveç disa deklaratave dhe veprimeve në nivel misioni,[96] vetë Këshilli i Sigurimit të OKB-së

nuk ka ndërmarrë asnjë veprim të njohur që ka të bëjë me Rezolutën 1325 për trajtimin e nevojave të grave dhe vajzave në Kosovë.[97]

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së i bën thirrje komponentëve policorë dhe ushtarakë të misioneve paqeruajtëse që të nxjerrin direktiva të cilat përfshijnë "masa për të mbrojtur të drejtat e grave dhe vajzave."[98] Megjithatë, sikurse edhe dëshmon historia e Krushës së Vogël, jo vetëm që masat kanë qenë joadekuate, por disa veprime nga përfaqësues të UNMIK-ut në Kosovën e pasluftës kanë injoruar nevojat specifike të grave dhe vajzave, dhe madje vetëm sa i kanë lënduar ato.

"Masat janë ndërmarrë, por ato nuk kanë qenë efektive, sipas mendimit tim modest," tha Tilly Stroosnijder, Këshilltare Gjinore në Polici në UNMIK.[99] Planifikimi paraprak, vlerësimi i krimit, koordinimi, trajnimi, Procedurat Standarde Operative, si dhe politikat gjegjëse kishin shumë "boshllëqe" tha ajo. "Ne si ndërkombëtarë duhej të bashkëpunonim ngushtë me partnerët vendorë [policinë e Kosovës] për ta kuptuar kontekstin, mirëpo nuk e bëmë një gjë të tillë." Bashkëpunimi i mangët me policinë e Kosovës nënkuptonte që çështjet e sigurisë nuk janë kuptuar si duhet dhe nuk janë trajtuar sa duhet.

Masat e mirëinformuara për mbrojtjen të drejtave të grave dhe vajzave kërkojnë analizim të mirëfilltë të kontekstit të kërcënimeve specifike të sigurisë me të cilat përballen.[100] Në Kosovë nuk është bërë asnjë analizë e tillë specifike për gratë dhe vajzat nga ana e paqeruajtësve. Në vend të kësaj, institucionet theksuan se i konsideronin *të gjitha* nevojat e sigurisë të qytetarëve. "Ne nuk besojmë se UNMIK-u ka kryer vlerësime specifike të kërcënimeve ndaj grave dhe vajzave," shkruan Philippe Tissot nga UNMIK-u, "ndonëse UNMIK-u rregullisht kryente analiza të situatës së sigurisë në përgjithësi në Kosovë."

Sidoqoftë, UNMIK-u që atëherë ka ndryshuar qasjen e tij. Për dekadën e fundit, UNMIK-u ka kryer analiza kontekstuale të kërcënimeve specifike me të cilat përballen

gratë dhe vajzat në Kosovë. Analiza e fundit e tillë u krye në vitet 2019 dhe 2020 për të informuar "përgatitjen e Strategjisë Kornizë Gjinore të UNMIK-ut", sipas Thais Santa Cruz:

> Si rezultat, është zhvilluar një strategji e plotë për të adresuar shumë prej çështjeve që prekin gratë dhe vajzat, duke u përqendruar në tema si pjesëmarrja kuptimplote e grave në vendimmarrje, paqe dhe proceset e dialogut politik; pengesat për qasjen e barabartë të grave në drejtësi; adresimi i dhunës seksuale dhe me bazë gjinore; mbështetja e grave sipërmarrëse për të ndërtuar biznes nëpër komunitete; bashkëpunimi me grupet dhe partnerët e grave për të avancuar agjendën e grave, paqes dhe sigurisë; dhe, integrimi sistematik i analizës gjinore në vetë sistemin tonë të planifikimit, programimit dhe raportimit.[101]

Përpjekje të tilla sinjalizojnë përmirësim në planifikimin e UNMIK-ut për të adresuar nevojat e grave dhe vajzave, krahasuar me një dekadë më parë.

Ndërkohë, KFOR-i ka përdorur një "qasje të integruar" sipas së cilës aspekti gjinor nuk është veprim shtesë por duhet të jetë pjesë e çdo aktiviteti," sipas Këshilltarit Gjinor të KFOR-it Elisabeth Schleichere në vitin 2011:

> Vetë të kuptuarit e situatës në terren paraqet një sistem të paralajmërimit të hershëm. Kur KFOR-i analizon nevojat specifike të popullatës, ne duhet të marrim parasysh situatën në tërësi, që nënkupton nevojat e ndryshme, rolet, përgjegjësitë, si dhe rreziqet e sigurisë së burrave, grave, djemve dhe vajzave.[102]

Prandaj, analizimi i kontekstit, sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe direktivat nuk janë specifike për gratë dhe vajzat, por në fakt duhet t'i marrin parasysh nevojat e tyre si pjesë e mandatit të përgjithshëm dhe punës ditore të KFOR-it.

Në EULEX, policia fillimisht nuk kishte direktiva në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave, tha Këshilltarja Gjinore Sirpa Rautio:

> Nuk kishte udhëzime specifike të lëshuara nga komponenta e policisë. Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejta të Njeriut gjithnjë e më me ngulm kërkonte udhëzime të tilla, veçanërisht për mënyrat e trajtimit të trafikimit me qenie njerëzore. Përgjithësisht, udhëzimet që ekzistonin ishin shumë të përgjithësuara dhe ne konsideronim se policia nuk ishte tërësisht e vetëdijshme për atë se si duhet ta kryejë punën e vet. […] Policia ka nevojë për udhëzime shumë të qarta dhe në fakt nuk kishte të tilla sa i përket çështjeve gjinore.[103]

Futja e procedurave specifike operative për policinë që nga fillimi është tejet i rëndësishëm, theksuan bashkëbisedues të ndryshëm. Me kalimin e kohës, EULEX i ka zhvilluar më shumë politika, si për shembull "të ndihmohen institucionet e Kosovës në luftimin e trafikimit me qenie njerëzore,"[104] ndër protokollet e tjera.

EULEX "ndjek kornizën e politikave të zhvilluar dhe hartuar në nivelin e Brukselit," tha Tagliani. Si Këshilltar Gjinor i misionit, ajo e përdor këtë kornizë në:

> Këshillimi i udhëheqjes së misionit, menaxhmentit dhe anëtarëve të stafit jo vetëm të detyrimeve që Misioni ka në zbatimin e Agjendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë, por gjithashtu edhe për mënyrën e integrimit të një perspektive gjinore në zbatimin e Mandatit të Misionit, si në atë të brendshëm ashtu edhe në atë të komponentët e jashtëm. [Ajo gjithashtu kërkon] të transmetojë kuptimin e rëndësisë së integrimit gjinor në të gjitha veprimet për të arritur përfundimisht barazinë gjinore dhe për të përfituar në mënyrë të

> barabartë gra dhe burra, vajza dhe djem, përmes veprimeve të Misionit.[105]

Në dekadën e fundit, EULEX ka bërë disa ndryshime në raportimin e tij, veçanërisht në lidhje me trafikimin dhe dhunën me bazë gjinore, ajo vazhdoi:

> Rastet e dhunës në familje dhe dhunës seksuale u proceduan dhe gjykuan si pjesë e kompetencës plotësuese të Misionit. Në lidhje me këtë, gjykatësit e EULEX-it kanë nxjerrë aktgjykime të rëndësishme në rastet e dhunës në familje. Nga viti 2012 e tutje, Divizioni i Forcimit monitoroi dhe raportoi për rastet e dhunës me bazë gjinore, përfshirë rastet e dhunës në familje, dhe i njëjti Divizion shfrytëzoi punën e një Këshilltari në Policinë e Kosovës i cili ndoqi nga afër punën e bërë në fushën e dhunës në familje. Nën mandatin e tij të ri në vitin 2018, EULEX e ka bërë dhunën me bazë gjinore një zonë tematike specifike nën funksionet e tij të monitorimit me qëllim që të mbështesë zbatimin e ligjit dhe institucionet gjyqësore përmes gjetjeve dhe rekomandimeve specifike dhe të sigurojë ndihmë të synuar.[106]

Këto raporte që rezultojnë, të prodhuara nga EULEX në tema të ndryshme si dhuna në familje, të mbijetuarat e dhunës seksuale dhe me bazë gjinore, ose shfrytëzimi i mundësive mjeko-ligjore në pretendimet për përdhunim, ndër të tjera, më pas janë ndarë me institucionet përkatëse si Policia e Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë.

Së bashku me UN Women, Tagliani deklaroi se EULEX "ndihmoi takimet e grupeve të punës me përfaqësues të Policisë së Kosovës, Kryeprokurorit të Shtetit, Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe Agjencisë së Mjekësisë Ligjore të Kosovës për të rritur kapacitetet e institucioneve në marrjen dhe përdorimin e provave mjeko-ligjore kur hetohen

pretendimet për dhunë me bazë gjinore."[107] Ruajtja e provave biologjike të krimeve është thelbësore, Tagliani theksoi:

> Gjithashtu thelbësore është puna që është kryer në dhjetë vitet e fundit nga ekspertët e EULEX-it brenda Institutit të Mjekësisë Ligjore jo vetëm në fushën e identifikimit të personave të zhdukur, por edhe në lidhje me rastet e integritetit seksual. Në lidhje me këtë, në shtator 2019, Instituti i Mjekësisë Ligjore, në bashkëpunim me EULEX dhe Policinë e Kosovës, filluan fushatën për ngritjen e vetëdijes në internet dhe jashtë tij "Flisni me kohë" mbi rëndësinë e ruajtjes së provave biologjike në rastet e dhunës seksuale. Nxënësit nga shkollat fillore dhe të mesme në gjithë Kosovën ishin përfituesit e leksioneve rreth dhunës seksuale dhe rëndësisë së ruajtjes së provave biologjike për një ndjekje penale dhe gjykim efektiv të rasteve.[108]

Në vitet e mëvonshme EULEX gjithashtu filloi përpjekjet për të integruar një perspektivë gjinore në Shërbimin Korrektues të Kosovës gjithashtu. Që nga viti 2016, EULEX-i ka mbështetur krijimin e Shoqatës së Grave në Shërbimin Korrektues të Kosovës, e nisur në shtator 2018. Aktivitetet fuqizuan gratë oficere, duke përfshirë vizitat studimore për të shkëmbyer praktikat më të mira evropiane në integrimin gjinor dhe zhvillimin e karrierës së grave në shërbimin korrektues.

Ndërkohë, Zyra e BE-së në Kosovë ka kryer një Analizë Gjinore të Kosovës për të informuar angazhimin e saj në dialog politik me Qeverinë e Kosovës në sektorë të ndryshëm si dhe mbështetjen e saj financiare për Kosovën nga perspektiva gjinore.[109] Kryerja e analizës gjinore është me të vërtetë një kërkesë e Planit pasues të BE-së për Veprim Gjinor II, në mënyrë që të informojë angazhimin politik dhe financimin e jashtëm të BE-së.[110]

Në kuptim të sistemeve të paralajmërimit të hershëm, përveç monitorimit të vazhdueshëm të KFOR-it, UNDP-ja në

Kosovë që nga viti 2001 nxjerr Raporte të Paralajmërimit të Hershëm të cilat mund të njoftojnë paraprakisht për konflikte dhe mundësojnë veprime parandaluese duke i marrë parasysh nevojat specifike të grave dhe vajzave.[111] Megjithatë, raportet rrallëherë cekin nevojat specifike të grave dhe vajzave, e lëre më veprime për trajtimin e tyre. Tri raporte nuk kanë përmendur gratë fare. Rrallëherë brenda raporteve kishte të dhëna të ndara sipas gjinive.

Në vitin 2010, ky Sistem i Paralajmërimit të Hershëm u riformulua si "Pulsi Publik", i cili gjeneroi të dhëna për perceptimin e qytetarëve në lidhje me zhvillimet dhe situatën politike, sociale, ekonomike dhe të sigurisë dhe situatës në Kosovë.[112] Në shumicën e raporteve të Pulsit Publik të analizuar për periudhën 2013 - 2020, gjinia ishte e integruar dhe të dhënat ishin të ndara sipas gjinisë. Gjithashtu, një raport specifik u përqëndrua në "perceptimin e njerëzve mbi çështjet gjinore nga perspektiva politike, ekonomike, arsimore, sociale dhe e sigurisë" dhe "pjesëmarrjen e grave në të dy aktivitetet shoqërore dhe politike".

Në 10 vitet e fundit, UNDP ka integruar dimensionet gjinore në të gjithë sektorët dhe ka forcuar performancën e saj në ofrimin e shërbimeve për gratë dhe burrat. UNDP i referohet çështjeve gjinore në punën e saj që lidhen me qeverisjen demokratike dhe ndërtimin e paqes, zhvillimin e qëndrueshëm dhe rritjen përfshirëse, si dhe rezistencën ndaj mjedisit, klimës dhe katastrofës. [113]

Një shqyrtim i sistemeve të misioneve ndërkombëtare të paralajmërimit të hershëm, analizave të konteksteve dhe direktivave paqeruajtëse në vitin 2011 zbuloi se shumë pak prej tyre kërkonin me *saktësi* masa mbrojtëse për të drejtat e grave dhe vajzave.[114] Madje, ata thanë se nevojat e grave dhe vajzave duhet të merren parasysh më gjerësisht në kuadër të punës së misionit. Që atëherë, UNMIK, EULEX, BE dhe UNDP kanë demonstruar përmirësim duke kryer analiza më të hollësishme gjinore për të informuar punën e tyre.

Monitorimi dhe reagimi ndaj shkeljes së të drejtave

"Në mision, kurrë nuk kishte menaxhim të njohurisë. Kurrë nuk kishim një lokacion qendror apo bazë të të dhënave ku do të ruheshin të gjitha këto gjëra. […] Fatkeqësisht edhe UNMIK-u në këtë mënyrë i mbante statistikat. Për këtë arsye është pak a shumë e pamundur që të krahasohen statistikat e krimeve nga viti 2000 deri më sot. Ajo që ndodhi ishte se personi i parë përgjegjës për statistikat në policinë e UNMIK-ut ishte nga Georgia (SHBA). Kësisoj, ajo erdhi dhe bëri punën në të njëjtën mënyrë siç e bënin ata në Atlanta. Pastaj erdhi personi tjetër, ai ishte nga Hamburgu. Dhe kështu ai e ndërroi tërë sistemin sepse 'Kështu e bënim ne në Hamburg'. Tani përfunduam në një situatë ku edhe nëse i krahasojmë bazat e të dhënave që ekzistojnë edhe më tej është sikur të krahasosh molla me portokaj. Ky është një nga problemet."

- Ish punonjës i OSBE-së, 2011

"Njerëzit ishin të shokuar kur kuptuan se si Rezoluta 1325 nuk po zbatohej në Kosovë nga vetë ata që e kishin nënshkruar," tha Rogova. "Më 2008, UNIFEM dërgoi një delegacion për t'u takuar me Komisionin për të Drejta të Grave dhe Barazi Gjinore në Parlamentin e BE-së. Delegacioni përbëhej nga pjesëtare të Lobit Rajonal të Grave, Edita Tahiri, Flora Macula dhe unë. Gjatë kohës sa isha atje, mësova shumë, posaçërisht nga gratë eurodeputete." Aktivistet kosovare vendosën që të bashkëpunojnë me gratë në BE për të shtuar vetëdijen lidhur me Rezolutën 1325 dhe zbatimin e saj në Kosovë. "Ideja ishte që duhej dërguar një grup i politikaneve

kosovare dhe grave nga shoqëria civile në Parlamentin e Evropës, në mënyrë që deputetet të mund të njoftohen se sa zbatohej rezoluta," vazhdoi Rogova, "dhe arsyeja që ata nuk e dinin ishte se OKB-ja kishte thënë vetëm fjalë të mira në raportet e tyre. 'Ne kemi bërë këtë... ne e kemi bërë atë.' Të gjitha ishin gënjeshtra, jo të vërteta."[115]

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së bën thirrje për "sisteme operative të ndjeshme ndaj gjinive […] për monitorim, raportim dhe reagim ndaj shkeljeve të të drejtave të grave dhe vajzave gjatë konfliktit, armëpushimit, negociatave për paqe dhe pas konfliktit."[116] Ndoshta monitoruesi më autoritar i shkeljeve të të drejtave të grave dhe vajzave në Kosovë është dashur të jetë UNMIK-u në raportimet periodike për Këshillin e Sigurimit.[117] Pak hulumtim dhe një ekzaminim i thukët i këtyre raporteve ndërmjet 2002 dhe 2011 zbuloi se 20 nga 37 raporte (54 për qind) përmendin çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e grave dhe vajzave, me rritje të theksuar në vitet e mëvonshme.[118] Kjo do të thotë se gati gjysma e raporteve kanë heshtur për këtë çështje. Asnjëri nga raportet e UNMIK-ut nuk përfshin qasje nga perspektiva gjinore. Kjo përfshin vëmendje lidhur me atë se si konteksti dhe intervenimi i UNMIK-ut kanë pasur ndikim të ndryshëm tek gratë dhe burrat. Vetëm pjesë të ndara të shkurtra merren me gratë dhe vajzat, të cilat pastaj u treten në pjesët tjera të raporteve. Çështjet e të drejtave të njeriut të cekura përfshinin dhunën ndaj gruas, mungesën e qasjes në drejtësi për gratë, pjesëmarrjen e pamjaftueshme të grave në proceset vendimmarrëse, pabarazitë gjinore, dështimet e ligjeve për të përfshirë dispozita për barazi gjinore, konsultime të pamjaftueshme me grupet e grave dhe nevoja për ta fuqizuar Zyrën për Barazi Gjinore, paraardhësen e ABGJ-së.

Raportet e UNMIK-ut përqendroheshin në mangësitë e liderëve lokalë, duke mbetur rëndomtë të pazëshëm për veprimet vetjake të planifikuara si administrator i Kosovës. Rrallëherë ishin raportuar në hollësi masat e ndërmarra apo zbatuara nga UNMIK-u. Përjashtimet përfshinin aktivitetet e planifikuara për zbatimin e "strategjisë afatgjate për ta rritur

numrin dhe përmirësuar pozitën e grave në Institucionet e Përkohshme" në vitin 2006, [119] si dhe përpjekjet për t'i themeluar "shtatë Komisionet shtesë për Barazi Gjinore […] nëpër komuna."[120]

Në çfarë mase janë përfshirë raportet e këshilltarëve gjinorë në raportimet e UNMIK-ut për Këshillin e Sigurimit?[121] Fatkeqësisht, në vitin 2011, ish-këshilltarëve gjinorë nuk patëm mundësi t'ua drejtojmë këtë pyetje, ndërsa UNMIK-ut i mungonte kujtesa institucionale për këtë çështje. Ne arritëm ta gjejmë Tilly Stroosnijder, ish-Këshilltare Gjinore në Policinë e UNMIK-ut, e cila rrëfen se Zyra e UNMIK-ut për Çështje Gjinore "e kishte përjashtuar" atë nga sistemi i raportimit dhe takimeve të OKB-së."[122]

Kur është pyetur nëse UNMIK-u i kishte përfshirë informatat nga gratë kosovare në raportime, tema e përsëritur nga radhët e aktivisteve për të drejtat e grave ishte se ato nuk janë konsultuar fare.[123] "OKB-ja ishte kampione në shpërfilljen e organizatave," thotë Vuniqi.[124] "Zyra e UNMIK-ut për Çështje Gjinore mendon se ata do t'i humbin vendet e tyre të punës nëse raportojnë atë që bëjnë gratë e Kosovës dhe tregojnë se ne jemi të mobilizuara," vlerëson Rogova. "Ata do të duhej të mendonin se si ne mund të punojmë së bashku e jo ta marrin tërë lavdinë për vete." Aktivistet mendonin se shqetësimet e tyre dhe çështjet për të cilat kishin avokuar nuk ishin përfshirë sa duhet në raportet e UNMIK-ut për Këshillin e Sigurimit. Përjashtim ishte angazhimi i kohëve i koordinuar nga Zyra e Komisarit të Lartë për të Drejta të Njeriut (OHCHR) në Kosovë, ku në raportet e UNMIK-ut është përfshirë hulumtimi i RrGK-së për qasjen në drejtësi për viktimat e dhunës në familje.[125] Përveç këtij përjashtimi të veçuar, që kishte ndodhur pas zvogëlimit të konsiderueshëm të kompetencave administrative të UNMIK-ut, aktivistet vlerësuan se raportet e UNMIK-ut nuk ishin tërësisht të sinqerta sepse zyrtarët e UNMIK-ut kishin tendenca t'i ekzagjerojnë arritjet e tyre ndërsa injoronin zërat e grave të Kosovës. Monitoruesit kishin dështuar në monitorimin e vetvetes.

Në vitin 2020, Thais Santa Cruz, si Këshilltare Gjinore UNMIK-ut, tha që qasja e UNMIK-ut në 10 vitet e fundit ka ndryshuar:

> Stafit u kërkohet të sigurojë që të gjitha parimet e barazisë gjinore të pasqyrohen në të gjitha dokumentet strategjike, politikat dhe udhëzimet. Planet e punës së njësive të misionit duhet të përfshijnë gjininë në punën dhe aktivitetet e tyre dhe duhet të raportojnë mbi progresin në lidhje me këtë çështje. Raportet e Sekretarit të Përgjithshëm në Këshillin e Sigurimit duhet të pasqyrojnë progresin e bazuar në prova në zbatimin e barazisë gjinore dhe mandatin e Grave, Paqes dhe Sigurisë.[126]

Në të vërtetë, një rishikim i shpejtë i raporteve të UNMIK-ut për Sekretarin e Përgjithshëm zbuloi se 30 nga 30 raporte (100 përqind) përmendi çështje që lidhen me të drejtat e njeriut dhe 29 nga 30 raporte (97 përqind) theksojnë në mënyrë specifike çështjet në lidhje me barazinë gjinore. Në këtë periudhë të viteve 2012-2017, raportet adresuan çështjet në lidhje me barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut veçmas në nënkapitullin "Të Drejtat e Njeriut". Në tetor 2017, raporti shtoi një nënkapitull i ri mbi "Gratë, Paqja dhe Siguria", i cili analizoi çështjet që lidhen me barazinë gjinore, fuqizimin e grave dhe gratë, paqen dhe sigurinë më në thellësi. Në përgjithësi, çështjet në lidhje me gratë, paqen dhe sigurinë ishin të kufizuara në këto dy pjesë. Disa raporte gjithashtu përfshinin çështje në lidhje me gratë, paqen dhe sigurinë në pjesë të tjera, të tilla si sundimi i ligjit. Sidoqoftë, perspektiva gjinore nuk përfshihej sistematikisht në të gjitha raportet. Çështjet e përmendura përfshinin dhunën seksuale gjatë luftës, dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje, të drejtat e pronës së grave, Lobi Rajonal i Grave, Fushata Ndërkombëtare 16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës në baza Gjinore dhe Dita Ndërkombëtare e Grave.

Përveç UNMIK-ut, Kosova ka organe të tjera të të drejtave të njeriut të ngarkuara me monitorimin, hetimin, raportimin dhe referimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave me qëllim të zbatimit të Rezolutës 1325.[127] Ndërsa Sekretari i Përgjithshëm emëron vetëm OHCHR si organin përgjegjës të të drejtave të njeriut, në Kosovë institucione të tjera për monitorimin e të drejtave të njeriut mbase përfshijnë BE-në, EULEX-in, Avokatin e Popullit, si dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore.

Për shkak të sistemeve të dobëta të organeve për të drejtat e njeriut për mbledhjen e të dhënave, është e pamundur të shqyrtohen të dhënat e ndara sipas gjinisë, lidhur me llojet e rasteve të raportuara, referuara dhe të hetuara. Hajredini konfirmoi se vetëm Policia heton raste, dhe si rezultat Zyra e Qeverisjes së Mirë nuk ka të dhëna për rastet e raportuara të shkeljeve të të drejtave të grave dhe vajzave. Ai tha se transparenca mungon në Gjykata dhe në Sistemin Prokurorial të Kosovës: "Kur ata i bëjnë krimet publike, krimi do të parandalohet". Duke shkruar botimin e parë të këtij libri, kërkesat e RRGK-së për informata, posaçërisht nga UNMIK-u dhe EULEX-i, janë shndërruar në topa të pingpongut që goditen që katër muaj nga njëra anë në tjetrën ndërmjet stafit të tyre. Përfundimisht, askush nuk i dërgoi fare të dhënat e kërkuara. Këta monitorues gati sa na e pamundësuan që të kontrollojmë atë që kishin monitoruar dhe mënyrat e realizimit të atij monitorimi. Kishte mungesë së të dhënave dhe mekanizmave të duhur të gjurmimit.

Më tej, që nga viti 2011, konsultimet e organeve të të drejtave të njeriut me organizatat e grave ishin kryesisht ad hoc, me disa përjashtime të dukshme. Arbena Kuriu në OHCHR tha se ajo mbajti marrëdhënie të mira me organizatat e grave.[128] OHCHR, thotë ajo, "punon vazhdimisht me agjencitë tjera të OKB-së përmes Grupit Koordinues për Siguri dhe Çështje Gjinore dhe ai ka kështilluar RrGK lidhur me procedurat speciale."[129] Veprimet e OHCHR-së të vitit 2011 duket se ishin kryesisht rezultat i angazhimeve individuale të Kuriut. Aktivistet

e të drejtave të grave thanë se në dhjetë vitet para angazhimit të saj, rrallëherë ka ndodhur që OHCHR të jetë takuar apo të ketë bashkëpunuar me organizatat e grave.

Strategjia ndërkombëtare e OHCHR përfshin Rezolutën 1325 dhe zyra e saj në Kosovë e ka azhurnuar politikën e saj gjinore më 2011.[130] Ata kanë themeluar një grup punues për të drejtat e grave dhe çështjet gjinore, që përbëhej nga zyrtarë të lartë të cilët bëjnë rekomandime programatike dhe zbatojnë trajnime në baza gjinore për profesionistë, tha Kuriu:

> Është pjesë e monitorimit tonë të përgjithshëm të të drejtave të njeriut në Kosovë. Gratë janë identifikuar në Kosovë si grup i veçantë i cenueshëm, përkrah grupeve tjera të tilla. Në këtë kuptim, ne i kushtojmë vëmendje të posaçme monitorimit të çështjeve të të drejtave të gruas. Gjithashtu, ne përfshijmë perspektivën gjinore në planet e veprimit të programeve tona.[131]

Ueb faqja globale e OHCHR ofron informata kontakti për raportimin e incidenteve të dhunës me bazë gjinore. Raportet me gojë apo me shkrim hulumtohen dhe rastet potenciale referohen për procedura speciale, ndonëse niveli në të cilin gratë kosovare kanë raportuar shkeljet e të drejtave të tyre dhe që kanë kërkuar shfrytëzimin e procedurave speciale ishte i paqartë. Meqë informatat që kishin të bënin me procedurat speciale ishin të fshehta, OHCHR nuk ishte në gjendje të përcjellë se çka ndodhi me shkeljet e raportuara.

Megjithëse OHCHR mbylli zyrën e tij të pavarur në Kosovë në vitin 2015, raporti i fundit i OHCHR në vitin 2019 përmendi Rezolutën 1325 dhe aspekte të ndryshme të shkeljeve të të drejtave të njeriut të kryera ndaj grave dhe vajzave.[132] Kjo u përfshi në të gjithë raportin, duke trajtuar çështje të ndryshme si pabarazitë gjinore në kushte të punës dhe diskriminimi në punë, punësimi, papunësia, trashëgimia e pronës, dhuna në familje, përfaqësimi në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, përfshirë dialogun ndërmjet Kosovës dhe

Serbisë, dhe dobësi të tjera. Raporti gjithashtu përfshiu një pjesë specifik kushtuar personave dhe grupeve të veçanta, të tilla si të drejtat e grave, të rinjve, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transgjinorëve, queer dhe 'njerëzve në lëvizje'. Organizatat për të drejtat e grave, përfshirë RrGK dhe QKRMT kontribuuan në integrimin gjinor dhe nëshkrimin e këtij raporti.

Një organ i dytë për të drejtat e njeriut, EULEX, nuk dukej se kishte ndonjë sistem zyrtar për monitorimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave, por më tepër monitoroi çështjet në një mënyrë "ad hoc" në vitin 2011.[133] EULEX ishte zotuar të takonte dy herë në vit grupet e grave për të dëgjuar shqetësimet e tyre.[134] Dhe ndërsa kjo ndodhi për disa kohë, ajo u ndërpre me ndryshime në udhëheqje. Sidoqoftë, EULEX ka pranuar referime, si dhe është konsultuar rregullisht me organizatat e grave që ndihmojnë gratë, të drejtat e të cilave janë shkelur. Në mandatin e tij paraprak, shkeljet e pretenduara të të drejtave të grave dhe vajzave mund të raportohen, referohen dhe hetohen nga EULEX. Me kalimin e kohës, EULEX ka vazhduar të monitorojë trafikimin, dhunën në familje, dhunën seksuale dhe rastet e përdhunimit, ndër të tjera.[135] Në vitin 2011, EULEX nuk ishte në gjendje të sigurojë informacion në lidhje me numrin e rasteve që përfshijnë krime të pretenduara me bazë gjinore që ai monitoroi si pjesë e mandatit të tij.[136] Sidoqoftë, vetë rishikimi i RrGK-së i çështjeve penale të EULEX-it të marra nga gjykatësit e EULEX-it ndërmjet viteve 2009 dhe 2011 sugjeroi që vetëm 11 përfshinin gra viktima.

Sipas mandatit të tij të vitit 2018, EULEX ka një fokus të veçantë në dhunën me bazë gjinore, sipas Tagliani:

> EULEX-i gjithashtu e ka bërë dhunën me bazë gjinore në një zonë specifike tematike nën funksionet e tij të monitorimit dhe Udhëheqësi Monitorues Tematik mbi Dhunën me Bazë Gjinore ofron ekspertizë përmes monitorimit të veprimeve hetimore të kryera nga policia e Kosovës, si dhe trajtimit të rasteve të dhunës

> me bazë gjinore në sistemin prokurorial dhe gjyqësor ... Shefi dhe Zëvendës Shefi i Misionit përsëriti angazhimin e EULEX-it drejt barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës me bazë gjinore, një angazhim që Misioni e kryen duke monitoruar dhe ndihmuar në të gjithë zinxhirin e përgjigjeve institucionale dhe jo-institucionale ndaj rasteve të dhunës në familje.[137]

Fatkeqësisht, të dhënat nuk ishin në dispozicion për numrin e rasteve të monitoruara.

Meqenëse Kosova nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE-në në vitin 2015,[138] BE gjithashtu monitoron të drejtat e njeriut në Kosovë, veçanërisht përmes raporteve vjetore të progresit. Ndërsa këto raporte fillimisht përmbanin një perspektivë minimale gjinore, kjo është përmirësuar me kalimin e kohës. RrGK dhe Qendra Kosovare për Studime Gjinore kanë shkruar komente mbi raportet e progresit për disa vite, duke siguruar pasqyrë se si BE mund të integrojë më mirë gjininë në të gjitha këto raporte. Në ditët e sotme, BE konsultohet ngushtë me grupet e grave kur shkruajnë raporte vjetore të progresit dhe ka përfshirë një perspektivë gjinore në të gjitha ato, duke theksuar çështjet e të drejtave të njeriut të grave në sektorë të ndryshëm.

Një tjetër organ për të drejtat e njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, ka Njësi për Barazi Gjinore, të themeluar në mars 2005 në pajtim me Ligjin për barazi gjinor. [139] Kjo njësi sipas nevojës këshillon gjykatat në shqyrtimin e rasteve të tyre dhe më vonë i monitoron ato raste gjatë procedurave nëpër gjykatë. Mandati i saj përfshin trajtimin e "diskriminimit në baza gjinore, ndryshimin e ligjeve dhe angazhimin në zbatimin e Ligjit për barazi gjinore," shpjegon Këshilltarja Ligjore për Barazi Gjinore Luljeta Domaniku.[140]

Domaniku, tregon se njësia e saj rregullisht takohet me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, organizatën Dera e Hapur, si dhe Shoqatën e Juristeve Norma për identifikimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Megjithatë, kur janë pyetur

se "Çfarë lloje të sistemeve kanë në aplikim për monitorimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut," Kuriu dhe Domaniku treguan rezultate të dobëta.

Në vitin 2010, Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar 1,233 ankesa mirëpo nuk i ka ndarë ato sipas shkeljeve të së drejtave në baza gjinore.[141] Mbështetur në memorien e saj, Domaniku kujton katër raste të dhunës në familje në vitin 2010. Gratë nuk i kanë raportuar rastet e dhunës seksuale te Institucioni i Avokatit të Popullit. Sipas procedurave, gratë janë udhëzuar që t'i raportojnë rastet e tyre te institucioni përkatës kosovar. Megjithatë, gratë ngurronin t'i raportonin rastet te institucioni përkatës, dhe shpeshherë hiqnin dorë nga rastet, thotë ajo. Prandaj, këto raste të ndjeshme mbetnin pa u trajtuar. Në ditët e sotme, Institucioni i Avokatit të Popullit publikon raporte çdo vit, të cilat janë në dispozicion në internet. [142] Raportet përfshijnë çështje të ndryshme që shqetësojnë gratë dhe vajzat. Raportet gjithashtu ofrojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë në lidhje me numrin e ankesave të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit. Kështu, sistemet e tij janë përmirësuar ndjeshëm, ashtu si edhe marrëdhëniet e tij të punës me organizatat e të drejtave të grave për çështje të ndryshme duke filluar nga diskriminimi me bazë gjinore në punë deri te adresimi i dështimeve institucionale për të trajtuar dhunën me bazë gjinore.

Përfundimisht, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore në Zyrën e Kryeministrit, e themeluar më 2002, monitoron dhe këshillon ministritë lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Ajo poashtu koordinon Njësitë për të Drejta të Njeriut në të gjitha ministritë. Si pjesë e përgjegjësive të tyre për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për të drejtat e njeriut në Kosovë, ata kanë raportuar për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës (2009-2011), që përfshinte vlerësimin e performansës së institucioneve përgjegjëse për ruajtjen e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave.[143] Ndonëse Kosova ende nuk i është bashkuar OKB-së, përmes kësaj zyre, Qeveria e Kosovës

ka filluar raportimin ndaj disa konventave ndërkombëtare të pranuara në ligjet në fuqi të Kosovës, siç është ajo për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.[144]

TRAFIKIMI: "DJEMTË DO MBESIN DJEM. EDUKONI VAJZAT TUAJA."

"Që nga përfundimi i luftës, trafikimi seksual është përhapur e shpërndarë si sëmundja e kancerit."

- Nga filmi *The Whistleblower*

"Ishte koha menjëherë pas luftës, kah fundi i vitit 1999, në Kosovë ende nuk kishte trafikim seksual. Ne kishim biseduar në shumë takime për trafikimin dhe kishim thënë se ai do të mund të ndodhte nëse nuk do të organizoheshim," kujton Rogova. Ajo dhe aktivistet tjera të të drejtave të grave morën pjesë në disa takime me KFOR-in, UNMIK-un dhe organizata të tjera ndërkombëtare:

> Përfaqësuesit e UNMIK-ut thoshin, "Jo, jo trafikimi nuk mund të ndodhë."
>
> Organizatat e grave u thanë, "Të mblidhemi bashkë dhe të bisedojmë për këtë tani, në mënyrë që ta parandalojmë atë."
>
> Përfaqësuesit e UNMIK-ut pastaj thanë, "Si mund ta dini ju që kjo mund të ndodhë?"
>
> Ne u thamë: "Sepse në Bosnje dhe Hercegovinë trafikimi ndodhi pas luftës." Ne i'u dhamë shembuj konkret të rasteve dhe fakteve se si mund të ndodhë trafikimi.

> Dy orë më vonë një zyrtar i lartë i KFOR-it u ngrit në këmbë, e kapi fletoren e tij dhe duke u larguar i nervozuar tha: "Djemtë do mbesin djem. Ju edukoni vajzat tuaja."
>
> Me këtë veprim, KFOR-i na bëri të mendojmë se ata në fakt po thonin: "Pa marrë parasysh Rezolutën 1325, apo çfarëdo rregullore tjetër, djemtë tanë duan seks." [145]

Trafikimi seksual në Kosovën e pasluftës ishte shembulli më i qartë i dështimit të aktorëve ndërkombëtarë: ata nuk munden të parandalojnë, monitorojnë, raportojnë dhe referojnë shkeljet e të drejtave të grave dhe vajzave.[146] Që nga fillimi, shihej se trafikimi seksual nuk do të konsiderohet si krim dhe nuk kishte synime për ta ndëshkuar atë.

Prania e madhe ndërkombëtare në Kosovën e pasluftës, që kryesisht përbëhej nga burrat, ishte faktor kryesor në rritjen e kërkesës për shërbime seksuale, duke zhvilluar trafikimin e grave dhe të vajzave nga Kosova dhe nëpër Kosovë.[147] "Ky krim filloi të paraqitet kur hynë trupat," vërtetoi Këshilltarja Gjinore e Policisë në UNMIK, Stroosnijder. Ish Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Selimi pajtohet:

> Prania e ndërkombëtarëve ka ndikuar shumë në zhvillimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe trafikimin e grave. Fakti që ata nuk i kishin familjet e tyre afër vetes dhe se ishin të pasur krahasuar me vendorët, ndikoi që të rritet trafikimi dhe prostitucioni. Mekanizmi i UNMIK-ut për të kontrolluar migracionin joligjor asnjëherë nuk ishte funksional. Të gjithë hynin dhe dilnin deri kur vendorët e morën përgjegjësinë për menaxhimin e kufijve.[148]

Se ushtria dhe forcat "paqeruajtëse" kontribuuan në lulëzimin e trafikimit dëshmohet mjaft mirë nga dokumentet e monitoruesve të ndryshëm ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut.[149] Rritja e shpejtë e rasteve të raportuara në Kosovë

korrespondon me bollëkun e paqeruajtësve në Kosovë. Aktivistja për të drejtat e grave Simiq kujtoi:

> Përvoja ime e parë me ushtarët e KFOR-it ishte që ata më ngacmonin kur isha vetëm 15 vjeç. Ata ishin trupa britanikë. Kam hyrë në moshë të rritur me këto përvoja. Fillova të kuptoj se çfarë ishte trafikimi ... Linjat e kamionëve të KFOR-it para atyre ndërtesave. Asgjë nuk u bë për këtë. Këto ishin përvojat e mia të para si një vajzë e re.[150]

Kështu, disa vajza në Kosovë nuk janë ndjerë të mbrojtura nga të ashtuquajturit paqeruajtës.

"Unë isha e detyruar nga shefi që t'iu shërbej ushtarëve dhe policëve ndërkombëtarë" vërteton për Amnesty International një grua e trafikuar.[151] Raste të tëra të dokumentuara nga Amnesty International ofrojnë dëshmi të përjetimeve të grave dhe vajzave të trafikuara nga Moldavia, Bullgaria, Ukraina dhe më larg, në industrinë e seksit në Kosovë.

Kjo jo vetëm që ishte një shkelje e qartë të ligjit, por edhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së bën thirrje për "akterët ndërkombëtarë, vendorë dhe joshtetëtorë" që të jenë "më të përgjegjshëm dhe të kërkojnë llogari për çdo shkelje të të drejtave të grave dhe vajzave, në pajtim me standardet ndërkombëtare." Duhet të veprohet në çdo rast të "eksploatimit dhe abuzimit seksual që pohohet të jetë kryer nga paqeruajtës në uniformë, civilë dhe/apo punonjës humanitarë" dhe akterët e sigurisë duhet të ndërmarrin masa kujdesi drejt parandalimit të këtyre dukurive.[152]

UNMIK-u shpalli Rregulloren për Ndalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore në Kosovë në janar 2001.[153] Rregullorja penalizonte edhe trafikuesit edhe ata që me dije kishin shfrytëzuar shërbimet e grave të trafikuara. UNMIK-u ka miratuar një Plan Nacional të Veprimit për Trafikimin, që pastaj është zëvendësuar me plan të ri qeveritar në vitin 2011.[154] Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Kodi Penal i Kosovës

ndalojnë trafikimin me qenie njerëzore, ndërsa disa ligje të tjera të aplikueshme gjithashtu prekin trafikimin, siç është Ligji për luftimin dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, i mbështetur nga EULEX-i, i miratuar në vitin 2013.[155]

Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore përcakton dënim minimal të obligueshëm pesëvjeçar për ata që shpallen fajtorë për trafikim,[156] dhe Kodi Penal i Kosovës është harmonizuar me këtë.[157] Veç kësaj, korniza e BE-së ka shtuar dispozita të tjera për mbrojtjen e viktimave gra të trafikimit me të cilat përfshihet rimëkëmbja fizike, psikologjike dhe sociale. Si BE-ja ashtu dhe Kosova ofrojnë shërbime të përkthimit me shkrim dhe me gojë, këshillime ligjore, si dhe informata lidhur me të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion, sigurojnë banim, si dhe asistencë psikologjike dhe mjekësore, në pajtim me ligjet.[158] Megjithatë, në Kosovë këto përfitime vareshin nga disponueshmëria e kontributeve të donatorëve "të dhuruara saktësisht për këtë qëllim dhe të shënuara si grante të destinuara të donatorëve në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës."[159] Edhe strategjitë nacionale dhe planet e veprimit kërkonin të promovojnë shërbime afatgjate të reintegrimit për viktimat e trafikimit, që përfshinin shërbime edukative dhe të punësimit.

Policia ka ofruar trajnime të veçanta për pjesëtarët e vet dhe ka themeluar një njësi speciale kundër trafikimit në vitin 2004, që ka rezultuar në mbylljen e disa lokaleve të përfshira në prostitucion.[160] Pjesëtarët e sistemit të drejtësisë gjithashtu i kanë ndjekur disa trajnime të ngjashme. Kosova ka themeluar trupin nacional për koordinim të luftës kundër trafikimit për të "koordinuar, monitoruar dhe raportuar për zbatimin e politikave kundër trafikimit me qenie njerëzore," një sekretariat për ta mbështetur trupin koordinues, një grup punues ndërministror, si dhe institucione të tjera të ngarkuara me përgjegjësi për trajtimin e trafikimit dhe pasojave të tij.[161]

Një përpjekje në parandalim ishte edhe lista e lokaleve të ndaluara, e krijuar në janar 2011.[162] Me kalimin e kohës, 75 baret dhe lokalet fillimisht të listuar si "të ndaluara" për stafin

e UNMIK-ut, KFOR-it dhe OSBE-së u rritën në rreth 200 lokacione që pohohej se ishin të përfshirë në prostitucion. Shumica e institucioneve kanë staf të trajnuar dhe kode të mirësjelljes të cilat nuk miratojnë shfrytëzimin e shërbimeve seksuale. Nuk është e sigurt nëse këto përpjekje për parandalim arritën efektin e pritur apo jo. Kuriu nga OHCHR mendon se përpjekjet parandaluese kishin sukses:

> Reagimi i profilit të lartë në kuptim të parandalimit të trafikimit pas konfliktit në Kosovë ishte reagim shumë i mirë dhe i koordinuar nga akterët ndërkombëtarë. Kishte fonde që lidheshin me luftimin e trafikimit dhe ato tregonin rezultate të shkëlqyeshme. Në fillim raportohej shumë se bashkësia ndërkombëtare përbënte kërkesën më të madhe për shërbime të trafikimit, por kjo pastaj shënoi rënie të madhe për shkak të politikave të suksesshme të vëna nga UNMIK-u dhe KFOR-i.[163]

Pjesëmarrës të tjerë nuk ishin aq të bindur se përpjekjet parandaluese ndryshuan sjelljet ekzistuese. "Njerëzit kanë mundur të shkojnë apo të mos shkojnë," tha një pjesëmarrëse. "Askush nuk i kontrollonte."[164] Tek pas vitit 2002 disa punonjës mund ta kenë marrë listën "lokaleve të ndaluara" seriozisht, shton një ish punonjës i OSBE-së:

> Unë gjithsesi nuk kisha informatën për njerëz që i frekuentonin baret e ndaluara, por kjo ishte në kohën kur ekzistonte një vakum i paqartësisë, sikurse lista e lokaleve të ndaluara të ishte një diçka joformale. Dhe kështu ishte situata deri kur u bë një deklarim shumë i qartë: "Shikoni, këto janë të ndaluara dhe nëse ju shkoni atje kontrata juaj do të ndërpritet." Pasi që lista u bë çështje më serioze, unë vërtetë nuk e dëgjoja asnjë njeri që i frekuentonte. Edhe pse kjo nuk do të thotë se nuk kanë shkuar, por vetëm se unë nuk dëgjoja për raste të tilla.[165]

Ai ndjente se disa "molla të kalbura" do të angazhoheshin në prostitucion dhe sjellje të tjera të mjerueshme pavarësisht masave parandaluese institucionale. Disa "njerëz margjinalë të cilët angazhohen në veprime joligjore i bëjnë ato qoftë kur gjykimin e kanë të dobësuar apo nëse gjejnë një moment oportunist." Ata që mund të binden të marrin pjesë në veprime joligjore nga të tilla "molla të kalbura" mund të përmbahen nga to nëse ka politika në fuqi.

Përvojat e drejtpërdrejta të aktivisteve për të drejtat e njeriut si Rogova dëshmonin se përpjekjet e parandalimit, vetëm sa nxisin zhvillimin e trafikimit nëntokë apo në një lokacion tjetër:

> Në vitin 2002 ushtria amerikane organizonte udhëtime speciale me autobusë për ushtarët e vet nëpër vendet tjera. Pra ata largoheshin nga Kosova duke mos u përfshi në trafikim në vend, mirëpo në të vërtetë ata e kryenin atë që "duhej ta bënin" në një shtet tjetër fqinj. I kam parë vetë me sytë e mi organizime të udhëtimeve seksuale të ushtrisë amerikane për në Sofje të Bullgarisë, ku shkarkoheshin nëpër hotele ku i prisnin gratë e reja. Gjithçka ishte e organizuar. Unë kam pasur informata se edhe ushtarët gjermanë frekuentonin Tetovën si dhe qytetet tjera të Maqedonisë. Krejt këto veprime i bënin jashtë vendit, ngase në Kosovë u bëhej shumë presion në rast të përfshirjes në trafikim. Atyre u thoshin: "Mos e bëni këtë, se do të ndëshkoheni!" Kështu që ata vazhdonin "punën e tyre." Do të thotë: djemtë do mbesin djem, edhe sot e kësaj dite.[166]

Një zyrtar i UNMIK-ut u pajtua; "Kur u bënë përpjekje për të rregulluar gjendjen, kërkesa zhvendosej në shtetet fqinje."

Në vitin 2011 nuk duket se institucionet ndërkombëtare kanë një listë të tillë të lokaleve të ndaluara.

EULEX-i nuk e kishte pranuar listën që e shfrytëzonte UNMIK-u. Përpjekjet e tyre të parandalimit përbëheshin nga trajnimet për stafin lidhur trafikimin dhe futjen e një "Kodi të rreptë të Mirësjelljes" që ndalonte blerjen e shërbimeve seksuale.[167]

Në atë kohë, stafi i EULEX-it besonte se "forca policore është shumë profesionale" dhe se nuk përfshihej në aktivitete të tilla. Megjithatë, një ish-pjesëtare e EULEX-it nuk ishte tërësisht e bindur. "Është vështirë për mua që të shoh se sa efektive do të jenë Kodi i Mirësjelljes apo trajnimet," thotë Rautio. "Unë mendoj se njerëzit e arsyeshëm e kuptojnë ligjëratën; ata e kuptojnë politikën. Por për ata që nuk sillen si duhet nuk e di se në çfarë mase do të mund të ndihmojnë ligjëratat apo politikat." Vetëm "llogaridhënia e vërtetë funksionon", shton ajo, "duke treguar se jeni seriozë duke i shfrytëzuar dënimet në dispozicion për misionin," përfundon Rautio.

Në vitin 2020, stafit të EULEX-it iu kërkua ende të ndjekin Kodin e Mirësjelljes së Misionit, si dhe Procedurat e tjera të Brendshme Standarde të Operacionit, të tilla si ngacmimet seksuale. Ekzistojnë procedura për të hetuar dhe gjykuar si duhet çdo dështim për t'i ndjekur këto.[168]

Fillimisht rregullorja e UNMIK-ut, dhe pastaj kodi penal, lejonin hetime, bastisje dhe kontrolle të bareve. Një nga hetimet e para për trafikimin në Kosovë u krye në korrik të vitit 2001. UNMIK-u lansoi një hetim në lidhje me pohimet se një grua rumune dhe dy policë amerikanë të UNMIK-ut ishin duke bashkëpunuar me një pronar të një shtëpie publike në Mitrovicë në trafikimin e grave. Raporti i brendshëm i kreut të policisë rajonale paralajmëronte, se "rrezikohej e tërë besueshmëria e Policisë së Misionit të OKB-së në Kosovë." [169] Raporti pretendonte se një zyrtar amerikan i priste gratë e trafikuara në kufirin e Kosovës me Serbinë, teksa ishte në uniformë dhe voziste veturën e UNMIK-ut. Polici tjetër amerikan pohohej se e paralajmëronte pronarin nëse kishte hetim të policisë ndaj tij dhe jepte informata të policisë për operacionet e mëhershme të trafikimit dhe prostitucionit.

Sa paqeruajtës në uniformë dhe civilë janë akuzuar për eksploatim dhe abuzim seksual në Kosovë dhe çka ndodhi me ta? Prej vitit 2002 dhe prillit 2004 Njësia policore e UNMIK-ut e Trafikimit me Qenie Njerëzore gjeti se:

> 52 ushtarë të KFOR-it, 3 policë ndërkombëtarë dhe 8 zyrtarë civilë ndërkombëtarë nga agjenci të ndryshme ishin zënë në lokalet "nga lista e ndaluar". Ushtarët e KFOR-it janë dorëzuar te Policia Ushtarake dhe stafi civil te departamentet përkatëse për hetime të mëtejme dhe masa përkatëse disiplinore. Në pajtim me Rregulloret e Policisë së UNMIK-ut, policët ndërkombëtarë janë riatdhesuar në shtetet e tyre të prejardhjes.[170]

Në vitin 2003 dhjetë policë janë riatdhesuar apo shkarkuar për shkak të pohimeve lidhur me trafikimin dhe 22 deri në 27 ushtarë të KFOR-it janë dyshuar se kanë kryer vepra të trafikimit.[171] Se çka ndodhi me ta më vonë ende nuk dihet.

UNMIK-u në vitin 2006 themeloi një Njësi për Mirësjellje dhe Disiplinë, mekanizëm për ankesa përgjegjës për zbatimin e politikës "zero tolerancë." Ndërmjet periudhës 2006 dhe 2011, UNMIK-u regjistroi vetëm dy raste të keqsjelljes që përfshinin eksploatim seksual.[172] Që të dy rastet u referuan dhe hetuan, mirëpo për shkak të provave të pamjaftueshme pretendimet i konsideruan si të "pabazuara."

Kur pyetëm UNMIK-un se çfarë do të ndodhte në situatën hipotetike që një anëtar i personelit të akuzohej për përdorimin e shërbimeve të prostitucionit ose sulmin ndaj një gruaje, Thais Santa Cruz u përgjigj:

> Hapat do të ndryshonin në varësi të kategorisë së personelit të përfshirë (d.m.th., personel civil ose me uniformë), por përgjithësisht do të përfshinte një vlerësim të pretendimit; një detyrë për hetim; dhe, masat e përkohshme. Nëse pretendimi vërtetohet, ka sanksione administrative dhe disiplinore të marra nga

Kombet e Bashkuara kundër subjektit të përfshirë, ose nga Shteti Anëtar nëse subjekti i pretenduar është një personel i uniformuar. Kombet e Bashkuara mund të riatdhesojnë individët e caktuar për arsye disiplinore dhe t'i ndalojnë ata nga pjesëmarrja në të ardhmen në operacionet paqeruajtëse. Sanksionet disiplinore dhe çdo veprim tjetër gjyqësor, të cilat mund të përfshijnë përgjegjësi penale ose përgjegjësi civile në lidhje me mbështetjen e fëmijëve, mbeten përgjegjësi e juridiksionit të brendshëm të individit të përfshirë. Shteteve anëtare u kërkohet të mbajnë të informuar Sekretariatin për progresin dhe rezultatin e hetimeve, si dhe për çdo veprim disiplinor ose administrativ të ndërmarrë në nivelin e brendshëm.[173]

Midis viteve 2010 dhe 2020, asnjë rast që përfshinte personel të uniformuar nuk ishte regjistruar nga UNMIK. Megjithatë, ka pasur dy raste që kanë të bëjnë me personel civil në vitin 2013. Të dy rastet janë hetuar. Një rast u shpall i pabazuar dhe për këtë arsye u mbyll. Rasti i dytë, i vërtetuar rezultoi në përjashtimin e individit nga OKB, me një gjobë dhe burgim në vendlindje të personit.[174]

Përveç politikës së tij të tolerancës zero, UNMIK gjithashtu ka miratuar masa të tjera parandaluese, të tilla si trajnime të detyrueshme në internet për të gjitha kategoritë e personelit të UNMIK-ut mbi parandalimin e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit, trajnime fillestare të ofruara për të gjithë personelin e sapoardhur në mision, dhe shpërndarjen e material me detaje për raportimin e akuzave për shfrytëzim dhe abuzim seksual.

Për sa i përket paqeruajtësve dhe punonjësve tjerë humanitarë, [175] KFOR-i nuk iu përgjigj kërkesës sonë për informata nga vitet 2010 ose 2011 në lidhje me nëse kishin pasur ndonjë nga rastet e pretenduara të eksploatimit seksual. Në vitin 2020, ata thanë, "Kjo pyetje nuk vlen, kështu që ne nuk mund t'ju japim një përgjigje".

As EULEX-i nuk ofronte informata nëse stafi i tyre është akuzuar për prostitucion apo trafikim meqë këto informata ishin "konfidenciale". Rastet e përfshirjes së pretenduar të punonjësve në keqsjellje seksuale janë raportuar në media, siç ishte aktakuza ndaj zyrtarit të UNCHR-së Rashidoon Khan më 2005 me akuza të "eksploatimit seksual të të miturve nën moshën 16 vjeçe dhe trafikimit me qenie njerëzore." [176] Megjithatë, në përgjithësi, qasja e pamjaftueshme në të dhëna dhe ndoshta praktikat e dobëta të disa institucioneve në mbledhjen e të dhënave e vështirësuan përcaktimin e sasisë së rasteve të referuara dhe të shqyrtuara.[177]

Përfundimisht duket se paqeruajtësit të cilët kanë përdorur shërbime të prostitucionit apo që kanë ofruar shërbime të tilla, duke përfshirë të tjerët në trafikim, rrallëherë janë ndjekur. Policia e Kosovës i kishte duart e lidhura sepse edhe paqeruajtësit civilë edhe ata ushtarakë gëzonin imunitet diplomatik. Sipas definicionit, "personi i një agjenti diplomatik është i pandëshkueshëm. Ai nuk i nënshtrohet asnjë forme të arrestimit apo paraburgimit."[178] "Ai," nuk mund të gjykohet për krimet që pretendohen se janë kryer në Kosovë edhe pas skadimit të mandatit të "tij". Prandaj, stafi i KFOR-it dhe UNMIK-ut mbeten imunë nga çdo formë e arrestimit apo paraburgimit nga çdo shtet tjetër përveç shtetit që e ka dërguar në mision. Ky përjashtim vazhdon edhe pas skadimit dhe pasi që pjesëtarët e stafit më nuk janë të punësuar në KFOR apo UNMIK. [179] Fakti se akterët e sigurisë janë të kontraktuar, bashkuar me imunitetin e tyre diplomatik, ka bërë që llogaridhënia të jetë e vështirë, tha një ish zyrtar i OSBE-së:

> Ja ku është problemi i shfrytëzimit të kontraktuesve për t'i sjellë policët. Sipas meje ky është një problem i madh, shumë i madh. Filmi *The Whistleblower* ishte shumë i saktë. Kontraktuesit i mbyllën të gjitha kontratat për policët dhe OSBE-në. Ata janë kontraktues të Departamentit të Mbrojtjes dhe Departamenti i Shtetit i SHBA-së vendosi se nuk dëshiron të krijojë marrëdhënie kontraktuese me

> amerikanët që shkojnë në këto misione. Prandaj ata e angazhuan CPI, Civilian Police International, apo e angazhuan DynCorp apo një kompani tjetër të tillë që të jetë ndërmjetëse ashtu që ata të mos kenë nevojë për t'i krijuar marrëdhëniet e tilla. Ajo që rezultoi në fund është se ju angazhoheshit nga një kompani, por megjithatë, ju punoni për dikë tjetër, jo vetëm që keni besnikëri të përzier, por kë do ta dëgjoni? A e dëgjoni personin që ua nënshkruan pagën, apo personin që thuhet vetëm në letër se duhet t'i jepni llogari?[180]

Përkundër përgjegjësive të tij për zbatimin e Rezolutës 1325,[181] Departamenti i OKB-së për Operacione Paqeruajtëse (DPKO) duket se ka qenë ngurrues në heqjen e imunitetit diplomati të paqeruajtësve civilë dhe ushtarakë. DPKO frikësohet se shtetet mund t'i tërheqin financimet apo trupat nga misionet paqeruajtëse, komentoi një ish zyrtar i OKB-së që kishte informata të dorës së parë:

> Verën e vitit 2001, Nënkomisioni për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut u mundua ta miratojë një rezolutë në OKB e cila do të obligonte sekretariatin që ta shqyrtojë çështjen,[182] dhe se paku të futet në kontratat e punës se, "Edhe nëse keni imunitet, shteti amë pajtohet që të ju ndjekë penalisht." Me kujtohet se njerëzit në DPKO thanë, "S'ka gjasa." Pse? Sepse ata kanë pasur presion të madh nga shtetet anëtare. DPKO dhe OKB në përgjithësi duhet të jenë mjaft të kujdesshme lidhur me atë se në çfarë mase i shtyjnë çështjet e llogaridhënies përpara sepse natyrisht edhe ata kanë nevojë për shtete që kontribuojnë me trupa. Për krizën e radhës, qoftë nëse është e tëra humanitare apo nëse është ushtarake, ata do të kenë nevojë për njerëz që do të shkojnë në këto zona për t'i kryer këto funksione dhe nëse shtetet thonë "s'ka gjasa," atëherë paqeruajtja mbaroi.

Kështu, për zbatimin e Rezolutës 1325, shtetet anëtare duhet ta luajnë një rol më të madh në trajtimin e pandëshkueshmërisë. Këshilltarja Gjinore e Policisë në UNMIK, Stroosnijder pajtohet:

> Politikat dhe direktivat janë miratuar dhe është zbatuar një zero [tolerancë] politikë, por do të doja të shihja një vazhdimësi të mirëfilltë dhe transparencë kur të ndodhin rastet. Tani kryerësit janë larguar nga misioni, por ata janë në misione tjera. Kjo nuk do të duhej të ndodhte ... Edhe më tej kemi nevojë për përmirësime në nivel të DPKO në bashkëpunim me shtetet anëtare ashtu që këta zyrtarë të mos jenë të gatshëm t'iu bashkohen misioneve tjera më, dhe ata duhet të dënohen sipas ligjeve të vendeve të tyre.

Ne kemi bërë përpjekje që të mësojmë se çka ka ndodhur me dhjetëra paqeruajtës dhe punonjës humanitarë që pretendohet se kanë qenë të përfshirë në eksploatime dhe abuzime seksuale në Kosovë, kemi hulumtuar gazeta e burime të internetit dhe raporte. Ishte vështirë të thuhet se çka ndodhë pas riatdhesimit. Imuniteti diplomatik i lejonte paqeruajtësit e shteteve të caktuara që të marrin më pak se një "shuplakë në duar" pas kryerjes së disa krimeve, na tregoi një burim i brendshëm. Sipas këtij burimi, UNMIK-u shpeshherë e mbyllte njërin sy në raste të tilla, posaçërisht nëse kryerësi nuk ishte më pjesëtar i stafit të tyre.

Në vitin 2011, në vetëm dy raste të identifikueshme është ndarë ndonjë formë e drejtësisë. Njëri rast përfshinte zyrtarin e UNHCR-së Rashidoon Khan, të dënuar për keqtrajtim seksual të vajzave të mitura në Kosovë, trafikim me qenie njerëzore, si dhe shitje të narkotikëve në vitin 2005.[183] Ky ishte rasti i parë i tillë i trajtuar në Kosovë, mirëpo ai ishte dënuar me vetëm tri vjet burgim në Kosovë. Rasti i dytë ishte rasti famëkeq i Toger Frank J. Ronghi. Ronghi ishte paqeruajtës amerikan që shërbente në Kosovë. Ai ishte hetuar, gjykuar dhe shpallur fajtor për "kryerjen e veprave të turpshme" dhe

vrasjen e një vajze 11 vjeçe. "Është lehtë t'i ikësh llogaridhënies për këtë gjë në një shtet të botës së tretë, i kishte thënë ai dëshmitarit Rreshterit Michael J. Stegemolloer. "Ai e dinte këtë sepse e kishte bërë më parë në shkretëtirë."[184] Në të vërtetë, raste kur punonjësit humanitarë dhe paqeruajtësit kanë eksploatuar seksualisht gra dhe vajza ekzistojnë në Sudan, Breg të Fildishtë, Haiti, Liberi, Republikën Demokratike të Kongos, Kamboxhia dhe Eritre, mes tjerash.[185] Ky rasti ishte shembull i mirë, tha një ish zyrtar i OSBE-së:

> Ky është një shembull i mirë i asaj se si duhet të funksionojë sistemi, në kuptim të asaj se ky ushtar kishte imunitet. Ky ushtar kurrsesi nuk do të ndiqej penalisht në Kosovë. Ushtria amerikane bëri atë që quhet dëgjim sipas nenit 32, që është në fakt një juri e cila përcakton nëse ka apo jo prova të mjaftueshme *prima facie* për të pasur gjykim. Ky dëgjim u mbajt këtu në Kosovë, në Kampin Bondsteel. Kam dëgjuar se ata thjeshtë kishin ftuar oficerë në detyrë që të ulën në këtë dëgjim. Ata konstatuan se, "Po, ka prova të mjaftueshme për ta çuar këtë rast në Gjyq Ushtarak." Kështu, ata e dërguan këtë person në Gjermani dhe mbajtën gjykim të plotë ushtarak. Ai u dënua dhe tani është duke e vuajtur dënimin e burgimit të përjetshëm pa të drejtë në lirim me kusht në Fort Leavenworth, Kansas.[186]
>
> Ky është një lloj shembulli i asaj se si do të duhet të punonte edhe OKB-ja. Në rregull, ne e kuptojmë se në disa shtete as personi që ka kryer krimin as shteti i tyre nuk dëshiron që ata të gjykohen në një shtet ku ka probleme të shumta ligjore. Mund të ketë njëanshmëri të mëdha në sistemin ligjor ndaj ndërkombëtarëve. Por në anën tjetër, ju si shtet, keni përgjegjësi që t'i ndiqni penalisht shtetasit tuaj. Prandaj, OKB-ja duhet të bashkëpunojë me prokurorë në shtetin amë dhe të ndihmojë në grumbullimin e

informatave që iu duhen për të kryer një gjykim të mirëfilltë.

Veprimi i përmendur i UNMIK-ut për të siguruar ndëshkimin tregon gjithashtu njëfarë përparimi.

Për rastet e trafikimit të gjykuara në Kosovë, duket se ekziston një trend i shqiptimit të dënimeve të lehta. "Hapi i parë drejt parandalimit është ngritja e vetëdijes se institucioneve ligjore për një ndëshkueshmëri më të ashpër," tha Naime Sherifi, e cila ka udhëheqë më herët një strehimore për gratë. "Tre persona janë dënuar me pesë vjet burgim për trafikim me qenie njerëzore dhe prapëseprapë gjykatësi jonë nuk i ka futur në burg." Sherifi ishte dëshmitare e dënimeve të lehta edhe në raste të tjera që kanë të bëjnë me trafikimin me qenie njerëzore. "Pse duhet që dikush të dënohet vetëm me dy vite burgim pasi që kanë shitur një qenie njerëzore për para?"

Përkundër të gjitha këtyre bisedave lidhur me përpjekjet e EULEX-it për t'i hetuar dhe ndjekur rastet e trafikimit, [187] sipas përmbledhjeve penale të gjykatave në dispozicion, EULEX-i ka përfunduar vetëm tri raste që përfshinin akuza të trafikimit.[188] Në një rast, tre burra janë dënuar për përdhunim, trafikim dhe lejim të prostitucionit të një vajze 15 vjeçe dhe një tjetre 17 vjeçe. Dënimet e tyre të përbashkëta për këto krime ishin përkatësisht dymbëdhjetë, dhjetë dhe dymbëdhjetë vite burgim.[189]

Mund të përmbyllim se dëshmi të shumta sugjerojnë se në vitin 1999 Kosova ka shënuar rritje të konsiderueshme të prostitucionit të organizuar, që shoqërohet me arritjen e mijëra trupave, kryesisht burra, të KFOR-it dhe stafit të UNMIK-ut. Kontrolli jo i fortë i kufijve nga UNMIK-u dhe KFOR-i dhe mekanizmat e pamjaftueshëm të mbrojtjes menjëherë pas luftës kanë krijuar një mjedis që lejonte trafikimin. Gjersa përpjekjet parandaluese siç janë trajnimet dhe lista e lokaleve të ndaluara i kanë shkurajuar disa persona nga frekuentimi i këtyre lokaleve, pjesëmarrësit në hulumtim mendojnë se ka të tjerë që sidoqoftë mund t'i shfrytëzojnë shërbimet seksuale. Akoma, në vitin 2020, është e pamundur të matet numri i

rasteve të pohuara për shkak të grumbullimit të mangët të të dhënave, mungesës së kujtesës institucionale dhe "konfidencialitetit". Ndërsa ekzistojnë disa përmirësime, drejtësia mund të vjen rrallëherë, duke pasur parasysh imunitetin diplomatik dhe ngadalësinë e shumicës së shteteve anëtare të OKB-së për t'i ndjekur penalisht.

"KUJT I INTERESONTE PËR DHUNËN NË FAMILJE?"

"Kush e qante kokën për dhunën në familje? Kishte aq shumë prioritete në atë kohë... si të themelohen institucionet e reja, qeverisja e mirë, të drejtat politike… dhe dhuna në familje nuk konsiderohej prioritet. Megjithatë, kur flasim për sigurinë e gjysmës së popullatës në jetët private, natyrisht se kjo duhet të jetë prioritet."

- Ariana Qosaj-Mustafa, ish-pikë qendrore gjinore në OSBE-së, 2011

Sakibe Doli ishte duke punuar në orët e vona të ndërrimit të natës në strehimoren e grave. Deri në ato momente nata kishte qenë e qetë. Gratë dhe fëmijët të cilët kishin vuajtur dhunë në familje flinin në qetësi në strehimore, duke u ndjerë se ishin të mbrojtur nga kryerësit e mëhershëm të dhunës. Lokacioni i strehimores supozohej se ishte i fshehtë, mirëpo në qytetin e vogël të Gjakovës fjalët shpërndaheshin me shpejtësi dhe pas pak kohe edhe taksitë e dinin si t'a gjenin shtëpinë në fjalë. Kjo qetësi e veçantë e natës e kaploi strehimoren, por papritur u thye nga zhurma e muzikës së lartë. Sakibeja shikoi prapa perdeve. Ishte njëri nga burrat e grave që ajo i mbronte. Përderisa vetura e tij afrohej, muzika bëhej edhe më e zëshme. Fqinjët iu afruan dritareve dhe filluan t'i telefonojnë Sakibes për ta pyetur se çka po ndodhte?"

Ajo e thirri policinë dhe ata reaguan shpejtë. Vetura policore me qetësi u ndal prapa veturës së burrit, me drita të

ndalura, për të provuar që atë ta zënë në befasi. Vetura e policisë i ndezi dritat, me ç'rast u ndrit vetura e burrit. Ai u kap. Policia e arrestoi me akuza të prishjes së rendit dhe thyerjes së urdhrit për mbrojtje. Gjersa ai shoqërohej për në veturën e policisë, një buzëqeshje e vetëkënaqësisë e kaploi atë. Ai e dinte se pasojat e veprimeve të tij do të ishin minimale. Gjykata më vonë e shpalli atë fajtor dhe e dënoi me burgim.

Megjithatë, pas pak kohe, ai u rishfaq në strehimore dhe vazhdoi t'a kërcënojë stafin e strehimores, përfshirë edhe Sakiben.[190] "Ne në strehimore frikësohemi kur përballemi me një dhunues," tha ajo në vitin 2007. "Gjatë pesë viteve të para policia ka reaguar shumë shpejtë kur i kemi thirrur ata. Nuk kishim nevojë të shqetësohemi, 'A po vijnë ata apo jo?' Por tani është ndryshe. Ndodhi që një dhunues kishte lidhje me dikë brenda Policisë së Kosovës dhe ata nuk vinin fare." Një hetim i mëvonshëm çoi në shkarkimin e komandantit të policisë. "Me hierarkinë e re në policinë e Gjakovës, bashkëpunimi është shumë i mirë. Pas asaj që ndodhi në të kaluarën, çdo gjë tani shkon si duhet," thekson Sakibja më 2011.[191]

Sikurse në çdo vend në botë, dhuna në familje ka vazhduar të kërcënojë sigurinë fizike dhe psikologjike të grave dhe vajzave. Dhuna në familje ka mbetur e vazhdueshme dhe e përhapur në Kosovën e pasluftës.[192] Në vazhdimësi, gratë kanë pësuar dhunë më shumë sesa burrat.[193] Ndërsa kryerësit e dhunës në familje ishin më së shpeshti burra[194].

Vepra penale e dhunës në familje kërkon reagime komplekse, meqë siguria e gruas është e ndërthurur me sigurinë e komuniteteve të tyre. Mbrojtja e grave nga dhuna dhe parandalimi i dhunës në të ardhmen varen nga besimi i grave në polici; trajnimet e mjaftueshme të policisë' posedimi më i rrallë i armëve të lehta nga personat privat; zbatimi i ligjeve; shërbime në dispozicion të përqendruara në rehabilitimin e viktimave; ndarje e burimeve adekuate; dhe sistemi efektiv i drejtësisë. Strehimoret janë tejet të rëndësishme për ofrimin e mbrojtjes së përkohshme për gratë, por ato kanë nevojë për resurse për jetesë të pavarur.

Kush i mbronë gratë?

Nëse identifikojmë një rast të dhunës në familje, arrestimi i shkelësit është pjesë e obligimit tonë, por neve na duhet të gjejmë një mënyrë për ta zgjidhur rastin. Në një rast, gruaja që ka raportuar abuzim të vazhdueshëm gjashtëvjeçar pyet, "Çka më ofroni mua? Si mund të më ndihmoni nëse unë e raportoj dhunën?"

"Ne kemi ligje dhe dispozita për ofrim të strehimores."

"Por për sa kohë mund të qëndroj unë në strehimore?"

"Gjashtë muaj dhe keni kushte të mira."

"Çka do të bëjë gjykata? Nëse fëmijët mbesin me mua, çfarë do të më ofrohet? Kush do të përkujdeset për fëmijët e mi? Unë nuk punoj. A do të më ofrohet një punë?"

Ne si Polici e Kosovës konsiderojmë së zbatimi nga ana jonë është i vështirë. Është vështirë të arrihet barazia sepse gruaja dëshiron të jetë e pavarur nga burri, por ne nuk mund tu ofrojmë këtë.[195]

- Togere Tahire Haxholli, 2011

Në vitin 2008 një anketë gjithpërfshirëse gjeti se gati 40 për qind të pjesëmarrësve në hulumtimve që kishin vuajtur dhunë nuk i kanë treguar askujt. Kjo pësoi rënie në 7 përqind në vitin 2015.[196] Ndërsa është përmirësuar me kalimin e kohës, mosraportimi e vështirëson vlerësimin e saktë të shkallës së dhunës në familje në Kosovë.[197] Në shikim të parë, ky krim dukej se po pësonte rënie në vitin 2010 (shih Grafikonin 2). Kjo nuk ishte e vërtetë, dhe të dhënat e policisë sygjerojnë një rritje të qartë të raportimit në vitet e fundit.

Numri i rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës u rrit në qiell në vitin 2020. Mes pandemisë COVID-19, gratë u izoluan së bashku me kryesit e dhunës. Zyrtari Shala reflektoi: "Dhuna u rrit dukshëm këto ditë. Jo se nuk ekzistonte më herët, por tani [numri i rasteve] ishte i madh. Karantina ishte si një bombë dhe nuk u desh shumë [që raportimi] të shpërthente."[198]



Është shqetësues fakti se, në mes të viteve 2000 dhe 2020, 44 gra dyshohet se janë vrarë si pasojë e dhunës në familje, sipas Policisë së Kosovës.[199]

Për më tepër, statistikat e policisë kurrë nuk japin pasqyrën e plotë, pasi njerëzit nuk e raportojnë gjithmonë dhunën në institucione. Në vitin 2008, po kjo anketë gjithpërfshirëse tregon se 43 për qind të kosovarëve kanë përjetuar një formë të dhunës në familje në jetën e tyre (46 për qind të grave dhe gati 40 të burrave).[200] Njëra nga arsyet për mosraportim, që nuk është e veçantë për Kosovën, është

se njerëzit historikisht e konsideronin se dhuna në familje ishte çështje private dhe ndiheshin të turpëruar të flisnin haptas për të (82 përqind).[201] Gratë ngurronin nga raportimi i dhunës në familje nga shqetësimi i turpërimit publik, stigmatizimi, apo për shkak se gabimisht mendonin se ajo dhunë ishte bërë me fajin e tyre. Konkretisht, gratë frikësohen edhe nga revanshi i kryerësit apo nga humbja e kujdestarisë së fëmijëve të tyre. Ato shpeshherë janë detyruar nga pabarazia ekonomike që të jenë të varura nga bashkëshortët e tyre për të mbijetuar dhe për t'u kujdesur për fëmijët, një nënshtrim që i parandalon ato nga largimi prej situatave të dhunshme në shtëpi. Në vitet e mëparshme, ato nuk e dinin se kishte ligje që i mbrojnë ato dhe shpeshherë nuk ishin në dijeni për të drejtat të tyre.

Me përpjekje të mëdha për informim nga institucionet e Kosovës, aktorët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile, pikëpamjet e tilla kanë filluar të zbehen. Deri në vitin 2015, perceptimi se dhuna në familje është çështje private kishte filluar të ndryshonte, megjithëse ekzistonte ende midis 31 përqind të pjesëmarrësve në hulumtim.[202] Ndërsa ishte përmirësuar kur krahasohej me vitin 2008, sondazhi i OSBE-së i vitit 2019 sugjeroi që 48 përqind e grave ende besonin se dhuna në familje ishte një çështje private. Në të vërtetë, kur dhuna u krye nga partneri i tyre aktual, 87 përqind nuk e raportuan atë në polici ose ndonjë organizatë tjetër.[203]

Ndërkohë, kur u pyetën për përvojat e tyre me dhunën në familje, në vitin 2015, 68 përqind e grave dhe 56 përqind e burrave deklaruan se kishin përjetuar dhunë në familje gjatë jetës së tyre. Kjo rritje krahasuar me vitin 2008 mund t'i atribuohet vetëdijësimit më të mirë të formave të ndryshme të dhunës në familje dhe më shumë gatishmërisë për të folur në lidhje me këtë temë.[204] Megjithëse nuk ishin plotësisht të krahasueshme, në vitin 2019, 57 përqind e grave thanë se kishin përjetuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale nga duart e një partneri intim ose jo partneri që nga mosha 15 vjeç.[205]

Kosova tani ka një kornizë ligjore mjaft gjithëpërfshirëse për adresimin e dhunës në familje. Kushtetuta

e Republikës së Kosovës ka adaptuar standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në ligjin për dhunën në familje. Më 2020, u ndryshua për t'iu referuar Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e njohur si Konventa e Stambollit. Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje përkufizon dhunën në familje dhe përcakton shfrytëzimin e urdhrave për mbrojtje, përgjegjësitë e zbatimit të ligjit, veprat penale dhe procedurat.[206] Më parë, Kodi Penal i cekte krimet e kryera në marrëdhënie familjare në formë të dëmtimit të lehtë apo të rëndë trupor, shtrëngimit, kërcënimit, privimit të paligjshëm të lirisë, sulmit seksual dhe përdhunimit.[207] Ato trajtoheshin si krime pavarësisht nëse ndodhnin në marrëdhënie familjare apo jashtë saj. Kështu, në vitin 2019, Kodi Penal u ndryshua për të përfshirë dhunën në familje si një vepër të veçantë penale. Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit kundër Dhunës në Familje është miratuar në vitin 2011, dhe një strategji tjetër e Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit (2016-2020) e ndoqi atë. Përmes një procesi konsultativ të udhëhequr nga ABGJ, institucionet dhe institucionet e tjera përkatëse bashkëpunuan për krijimin e Procedurave Standarde të Operacionit për asistimin e rasteve të dhunës në familje. Që nga viti 2013, këto Procedura Standarde të Operacionit kanë ndihmuar në përmirësimin e përgjigjes institucionale dhe koordinimit ndërinstitucional.

"Kur nuk keni një dokument, është e vështirë të veprosh", reflektoi togerja Haxholli. "Këto kanë ndihmuar shumë."[208] Disa komuna dhe rajone gjithashtu kanë krijuar mekanizma koordinimi ndërinstitucional për të mbështetur rastet, megjithëse roli i tyre nuk është ende i ligjësuar qartë dhe kështu performanca e tyre mbetet e përzier.[209]

Ndërsa në vitet e mëparshme Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ofroi vetëm financim të pjesshëm institucional për strehimoret e grave, kjo gjithashtu u përmirësua me kalimin e kohës pas lobimit nga grupet e të drejtave të grave, mbështetur nga Grupi i Sigurisë Gjinore, i cili hapi rrugën për një linjë të caktuar buxhetore për strehimoret

në vitet 2019 dhe 2020. Përgjithësisht, legjislacioni i Kosovës që ka të bëjë me dhunën në familje është kryesisht në pajtim me standardet ndërkombëtare, sipas kërkesave të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.[210] Sidoqoftë, disa përmirësime mund ta harmonizojnë atë më tej me Konventën e Stambollit, veçanërisht në lidhje me shërbimet e rehabilitimit dhe ri-integrimit.[211]

Krijimi dhe rregullimi i kornizës ligjore për trajtimin e pandëshkueshmërisë dhe parandalimit të dhunës në baza gjinore ishte ndoshta një nga arritjet më të mëdha në dy dekadat e fundit për ruajtjen e sigurisë së grave, në pajtim me Rezolutën 1325. Qosaj-Mustafa ka bashkëpunuar me disa institucione në hartimin e Rregullores fillestare të UNMIK-ut për mbrojtjen nga dhuna në familje gjatë kohës sa ishte në OSBE. Ajo kujton ndryshimet vendimtare që ligji i kishte sjellë pas miratimit dhe hyrjes në fuqi më 2003:

> Është histori suksesi sepse më kujtohet kur më thirrën dy policë ndërkombëtarë të cilët duhej të merreshin me raste të dhunës në familje. Për shembull, nëse një grua është strehuar, burri i saj do të vinte në strehimore dhe bënte çka do që dëshironte sepse nuk kishte urdhra për mbrojtje. Ata nuk mund të zbatonin asnjë mekanizëm mbrojtës deri në momentin që ajo e kalonte procesin e shkurorëzimit dhe kujdestarisë. Kur ishte viktimë e menjëhershme e dhunës në familje, nuk kishte shumëçka për t'u bërë.
>
> Pasi që ligji u nënshkrua nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, thirrja e parë që e pranuam menjëherë ditën e nesërme ishte nga këta policë ndërkombëtarë. Ishte një person i cili i kishte bezdisur ata me muaj të tërë. Sapo që policia ikte, ai kthehej dhe e ngacmonte viktimën. Ishte një rast shumë i rëndë i dhunës në familje. Ajo ishte në strehimore me fëmijët dhe ata ishin të tmerruar sa herë që e shihnin veturën dhe babanë e tyre gjersa sillej përreth strehimores.

> Policët më kishin thirrur tërë kohën duke më pyetur, "Çka ndodhi me Rregulloren? A mund t'i marrim këta urdhra mbrojtës?"
>
> "Jo, ende është në formë draft,," përgjigjesha.
>
> Me siguri se qëndroi për disa muaj në sirtarët e ndonjë Këshilltari ligjor të OKB-së, por pas katër muajve ai u nënshkrua. Kjo grua menjëherë kërkoi urdhër për mbrojtje. Ai person u informua se kishte urdhër mbrojtës kundër tij, por ai e kishte shkelur atë meqë ishte person i dhunshëm. Ai shkoi përsëri përreth strehimores, por këtë herë ai e kishte një masë të përkohshme për të mos iu afruar viktimës brenda 150 metrave, përndryshe do të arrestohej.
>
> Këto ishin hapa të vegjël por mund ta ndjenim se disa gjëra po ndryshonin ngadalë. Fillimisht pak gjyqtarë ishin të njohur me ligjin, por pas ca kohe kishte qindra urdhra të tillë mbrojtës që lëshoheshin.[212] Ai është një lloj mbrojtje.[213]

Me miratimin e këtij ligji, hapi i radhës ishte ofrimi i trajnimeve për sektorin e sigurisë dhe stafin e drejtësisë lidhur me atë se si të trajtohet dhuna në familje.[214] Gratë duhet të jenë në gjendje t'i besojnë policisë dhe gjykatës për të kërkuar mbrojtje. Policia dhe gjykatat duhet ta kuptojnë retiçencën, frikën dhe cenueshmërinë e grave viktima. Nga sektori i drejtësisë, në vitin 2011, Enver Peci, Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, tha se "trajnimet ofrohen sipas nevojës":

> Në fillim të vitit, temat e trajnimeve përzgjidhen dhe ndahen me gjyqtarët. Kushdo që është i interesuar në një trajnim të posaçëm aplikon për të. Trajnimet janë të obligueshme. Nëse gjyqtarët nuk e praktikojnë apo respektojnë atë që e kanë mësuar gjatë trajnimeve, prokurori disiplinor do ta ndjek rastin.[215]

Prandaj, trajnimet e gjyqtarëve lidhur me dhunën në baza gjinore duket të kishin qenë më shumë *ad hoc* e jo i

obligueshëm, ndonëse kjo ka qenë temë "prioritare" gjatë viteve të fundit, tha ajo. Kjo përfshin trajnimet për legjislacionin për dhunën në familje. Ndërsa gjyqtarët e specializuar në trajtimin e rasteve të dhunës në familje u emëruan dhe ofruan më shumë trajnime, disa gjyqtarë ende nuk kishin njohuri sepse trajnimi ishte opsional e jo i detyrueshëm.

Policia e Kosovës ndan shtatë nga 40 orë të trajnimeve të obligueshme vjetore për barazi gjinore, si dhe trajnimi dymujor për Toger përfshin katër deri pesë ditë në këtë temë. Trajnimet merren me Ligjin për barazi gjinore; strategjia e policisë për të drejtat e grave si të drejta të njeriut; trafikimi; trajtimi i rasteve të dhunës në familje; dhe Rezoluta 1325.[216] "Rezoluta përbën një përqindje të caktuar të trajnimit tonë," tha Shala. "Nëse trajnimi zgjat më shumë, edhe trajnimi për Rezolutën do të zgjatet."[217] Njësitë e specializuara në dhunën në familje dhe trafikim pranojnë trajnime të obligueshme shtesë. "Kursi për abuzimet brenda familjeve është specifik për hetuesit të cilët punojnë me abuzime në familje," tha Togerja Haxholli.

Veç kësaj, policia në komunitet është menduar që do ta parandalojë dhunën në familje, thotë ish-Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Selimi:

> Është rutinë që të shkojmë dhe të marrim informata për një familje e cila ka probleme, dhe njësitë tona shkojnë dhe bisedojnë jo si zyrtarë policorë, por si "burri me burrin." Ky është thelbi i shërbimit të ri policor në Kosovë. Ne nuk jemi polici që mbi të gjitha përdorim forcë, por në fakt ne përdorim mekanizma të tjerë për t'i zgjidhur problemet. Kjo dikur ishte koncept absurd për policinë. Më parë, ata thjeshtë shkonin dhe bënin arrestimin. Por tani kemi metoda tjera.[218]

Hetimet policore të krimeve të pohuara, politikat dhe mekanizmat, ndoshta kanë pasur efekt dëbues të dhunës së ardhshme të mundshme. Akterët e sigurisë kanë bërë hapa të mëdhenj në mbrojtjen e grave, duke kontribuar jo vetëm në

zbatimin e Rezolutës 1325, por edhe në përmirësimin e sigurisë së komunitetit në përgjithësi, tha Osnat Lubrani, ish Përfaqësuese rezidente e UNDP-së:

> Angazhimi ndërmjet avokueseve të barazisë gjinore dhe akterëve të sigurisë, qoftë në Policinë e Kosovës, Trupat Mbrojtëse të Kosovës, apo themelimi i shërbimeve të sigurisë në komunitet në nivel komunal, kanë çuar në shtim të vetëdijes së shqetësimeve të sigurisë për gratë. Ne kemi parë më shumë trajnime për t'i bërë stafin e agjencive të zbatimit të ligjit më të ndjeshëm për çështjet gjinore dhe për të siguruar reagimin e duhur ndaj dhunës në familje, duke përfshirë përmes kontrollit më të mirë të posedimit të armëve të zjarrit. Gjithashtu, miratimi i politikave dhe strategjive për barazi gjinore nga ana e institucioneve të sigurisë, dhe krijimi i njësive gjinore për ta mbështetur dhe monitoruar zbatimin e tyre, paraqesin zhvillime tejet pozitive.[219]

Është specifike për Kosovën një histori e gjatë e mosbesimit tek institucionet shtetërore dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, duke filluar nga Perandoria Osmane e deri te shtypja nën regjimin serb.[220] Historikisht, kosovarët janë mbështetur më shumë në familje sesa te shteti për mbrojtje prandaj dhe ngurrojnë t'i humbin armët që i posedojnë për mbrojtje të familjes. Është ironike se këto armë i bëjnë gratë më të cenueshme ndaj dhunës në familje dhe dhunës përmes armëve të zjarrit.[221] Çdo vit, armët përdoren për të kryer krime në marrëdhënie familjare. [222] Megjithatë, sistemet e pamjaftueshme të grumbullimit të të dhënave e vështirësojnë vlerësimin e saktë të ndërlidhjes ndërmjet dhunës ndaj grave dhe armëve të paligjshme.[223] Meqë "armët e vogla dhe të lehta mund të shtohen dhe shpeshherë përdoren për t'i kërcënuar gratë" në rajone të pas-konflikteve, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së bën thirrje për mekanizma nacionalë që i kontrollojnë këto arme me qëllim të rritjes së sigurisë për gratë.[224]

Ndërmjet vitit 2007 dhe 2010, Nisma e UNDP-së në Kosovë për Kontrollin e Armëve të Vogla mblodhi në një vend institucionet me qëllim të hartimit të një plani të veprimit për zbatimin e Strategjisë Kosovare për Kontrollin e Armëve të Vogla.[225] Si pjesë e kësaj strategjie, Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për hulumtimin përmes një anketimi të përhapjes së armëve të vogla në Kosovë dhe pastaj krahasimit të tij me statistikat e krimeve nga Policia e Kosovës.[226]

Që atëherë, UNDP ka vazhduar të mbështesë Policinë e Kosovës për të trajtuar më mirë trafikimin e armëve të zjarrit duke siguruar materiale dhe trajnime. Sipas Marta Gazideda nga UNDP:

> [Kjo iniciativë] mbështeti institucionet e Kosovës për të kontrolluar posedimin dhe qarkullimin e gjerë të armëve të vogla dhe të lehta në përputhje me standardet e OKB-së, OSBE-së dhe BE-së, ndikimin e saj në dhunën në familje me ndërhyrje në nivelin institucional dhe të komunitetit dhe zhvillimin e kornizës përkatëse ligjore, strategjive dhe planeve të veprimit, për të rritur sigurinë publike. Ajo forcoi institucionet e Kosovës dhe akterët e tjerë përkatës në lidhje me parandalimin e krimit, sigurinë në komunitet dhe përfshirjen e praktikave dhe politikave të ndjeshme ndaj gjinisë në ndërhyrjet e kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta.[227]

Kjo ka përfshirë mbështetjen e zhvillimit të Udhëzimeve të Prokurorëve për Luftimin e Dhunës me Armë, Raportin e Vlerësimit të Gjurmimit dhe Procedurat Standarde të Operacionit për gjurmimin e armëve të zjarrit, duke përfshirë krijimin e një pike qendrore për armët e zjarrit, e cila është bërë një praktikë më e mirë për rajonin dhe më gjerë. Kjo përfshin lidhjen e disa bazave kryesore të të dhënave të lidhura me armët e zjarrit dhe hartimin e strukturës së trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit.[228]

Në vitin 2016, UNDP zhvilloi një studim mbi Armët e Vogla dhe Armët e Lehta në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë "aspektet e diferencuara gjinore të armëve të zjarrit dhe lidhjen midis gjinisë dhe dhunës së armatosur në Kosovë".[229] Ai zbuloi se nga viti 2012 deri në vitin 2015, burrat kryen 97 përqind të incidenteve që përfshinin armë zjarri. Nga të gjitha vrasjet që përfshinin një armë zjarri, 44 përqind kishin viktima burra; dhe 37 përqind e rasteve të femicideve u shkaktuan nga armët e zjarrit dhe "63 përqind e të gjitha sulmeve të armatosura ndaj grave ndodhën në shtëpinë ose oborrin e tyre". Për më tepër, "44 përqind e vrasjeve kanë ndodhur brenda kontekstit shtëpiak dhe 75 përqind e këtyre vrasjeve janë kryer duke përdorur një armë zjarri".[230]

Ishte planifikuar hulumtim shtesë, specifik i Kosovës për këtë çështje, siç shpjegoi Gusia:

> Shqetësuese për jetën e burrave dhe grave në Kosovë është prania e armëve. Çdo muaj, ka një rast kur përdoren armë të vogla. Jo vetëm gratë, por edhe burrat, preken njësoj nga prania e armëve. Ne i bëmë një kërkesë UNDP-së që të kryejë një hulumtim në të gjithë Kosovën për këtë çështje, pasi jemi të shqetësuar për faktin se ka kaq shumë armë në Kosovë.[231]

Hulumtimi i planifikuar për vitin 2020, u shty për shkak të COVID-19.

Ndërkohë, Policia e Kosovës ka krijuar gjithashtu njësi të trajnuara të dhunës në familje në secilën komunë për të trajtuar specifikisht dhunën në familje. "Kjo përfshin politikën sipas së cilës në çdo stacion policie duhet të jetë një grua dhe një burrë," tha Haxholli.[232] Policet e kualifikuara intervistojnë gra dhe fëmijë viktima të cilët mund ta kenë më të lehtë të "komunikojnë me një grua sesa me një burrë," tha Shala. Policet kryejnë intervista, bëjnë fotografime të lëndimeve, si dhe ndihmojnë gratë të cilat kanë pësuar dhunë.

"Gratë e kanë më të lehtë që të bisedojnë me gratë e tjera për problemet dhe shqetësimet e tyre sesa me burra," tha Selimi. Fushatat sensibilizuese të organizatave të grave, institucioneve, mediave dhe akterëve ndërkombëtarë për edukimin e popullatës për të drejtat e tyre gjithashtu mund të kenë pasur ndikim në raportim." Unë mendoj se raportimet kanë të bëjnë me besimin, ato vepra raportohen falë besimit që njerëzit e kanë tek ne." Ai vazhdoi:

> Unë mendoj se shoqëria jonë ka shtuar nivelin e vetëdijesimit dhe qytetarët po raportojnë gjithnjë e më shumë raste. … Unë besoj se këto raste kanë ekzistuar edhe më herët, por ato nuk janë raportuar. Prandaj, unë nuk mund të them se ka rritje të rasteve, por se ka rritje të informimit dhe raportimit.

Më shumë gra në polici, angazhimet sensibilizuese të policisë, mbulimi medial i kësaj çështjeje, asistenca e strehimoreve e ofruar për viktimat, si dhe trajnimet kanë kontribuar në raportim të shtuar.

Ndërsa raportimi u rrit midis viteve 2003 dhe 2006, ai pësoi rënie të madhe pas vitit 2006. Aktivistet e të drejtave të grave ia atribuuan këtë jo rënies së numrit të rasteve të dhunës në familje por humbjes të besimit në sistemin e drejtësisë. "Gratë raportonin dhunën në familje, por atëherë humbën besimin në institucione kur ato nuk i ndërmorën veprimet e duhura," tha Rogova. Hetimet policore kanë ndikim të kufizuar nëse sistemi i drejtësisë nuk shqipton dënime të ashpra për kryerësit. Fakti që raportimi është rritur në vitet e fundit, mund të sinjalizojë rritjen e vetëdijes dhe besimit tek institucionet. Sidoqoftë, raportimi mbetet i ulët krahasuar me përhapjen. Mosbesimi në institucione, mungesa e pavarësisë financiare, reagimi i ngadaltë i institucioneve të drejtësisë dhe dënimi i ulët mund t'i pengojë gratë të kërkojnë ndihmë. Këtu policia dhe gjyqësori akoma kanë shumëçka për të bërë në "luftimin e pandëshkueshmërisë dhe krijimin e një efekti dëbues," në pajtim me udhëzimet e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.[233]

"Drejtësia është larg"

"Nuk mendoj se ka shumë progres në luftimin e dhunës ndaj grave, posaçërisht dhunës në familje. Shumë raste nuk janë ndjekur."

- Arbena Kuriu, OHCHR, 2011

Më 18 maj 2011, 27 vjeçarja Diana Kastrati ishte nisur për të vijuar ligjëratat në Universitetin e Prishtinës.[234] Vitet e fundit kishin qenë të vështira për të, por falë kurajos dhe mbështetjes së familjes së saj, ajo e kishte braktisur burrin e saj abuzues. Policia e Kosovës e ndihmoi atë në parashtrimin e kërkesës për urdhër të mbrojtjes nga ai dhe tani ajo vetëm priste që gjyqtari t'a aprovojë atë. Gjyqtari ishte vonuar; ditët kishin kaluar që nga afati i duhur për miratim, mirëpo Diana kishte pasur shpresa të mëdha se shpejti do t'i garantohet siguria. Beteja për kujdestarinë e vajzës së saj tetëvjeçare mund të zgjaste më shumë meqë ajo duhej të dëshmonte se do të ishte në gjendje të mirë financiare për të rritur një fëmijë. Arsimimi universitar do t'i hapte dyer, mendonte ajo gjersa ecte pranë pompës së benzinës afër shtëpisë së saj atë mëngjes. Papritur u dëgjuan të shtëna. Diana vdiq në vend. Burri i saj u zhduk.

Vdekja tragjike e Dianës vuri në pah faktin se mbrojtja për gratë është ende joadekuate. Ligji për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje nuk ishte në gjendje të parandalojë dhunën dhe t'ia shpëtojë asaj jetën, meqë gjyqtari dështoi të sigurojë mbrojtje në kohë. Mbrojtja e grave dhe parandalimi i dhunës në të ardhmen ngërthen sigurimin e qasjes në drejtësi në rast të shkeljes së të drejtave të gruas.[235] Megjithatë, ka dominuar tendenca e gjyqtarëve për të falur burrat në rastet e sjelljes së dhunshme.[236] Për shembull, kur një kryerës tha se "martesa do

të përfundojë mu këtu për shkak se gruaja e tij e kishte raportuar", përgjigja e gjyqtarit ishte:

> Policia nuk është dashur ta arrestojnë [kryerësin]; ata nuk kanë menduar se çka do të bëhet me çiftin. Tani u shkurorëzuan. Ne duhet ta respektojnë faktin se ne jemi në shoqëri patriarkale. Policia nuk është dashur ta arrestojë atë ndonëse gruaja e ka akuzuar atë. Ata të dy duhet të mbahen së bashku në stacion të policisë dhe të mos arrestohet burri apo diçka e ngjashme, gjë që do të mund të ndikonte në martesën e tyre dhe të çonte në shkurorëzim.[237]

Kësisoj gjyqtari nuk ia kishte njohur viktimës të drejtat dhe nevojat e sigurisë, duke preferuar në vend të kësaj ta ruajë bashkësinë familjare. Mundësia e gjykimeve jo të drejta zhbind gratë nga parashtrimi i rasteve apo dhënia e dëshmive,[238] si dhe kontribuon në një mungesë të përgjithshme të besimit në institucione.[239]" Shumë nga viktimat kanë hequr dorë nga rastet sepse ndihen të tradhtuara, të pambrojtura dhe thjeshtë të pasigurta," tha Naime Sherifi, e cila drejtonte një strehimore për gratë.

Gjithashtu, gratë frikësohen nga humbja e kujdestarisë së fëmijëve të tyre. Në rast të shkurorëzimit, kujdestaria, kujdesi dhe edukimi i fëmijëve vendoset në gjykatë.[240] Gjykata heton të gjitha rrethanat përkatëse dhe vendos nëse kujdestaria do t'i jepet njërit prind, do të ndahet, apo do t'i jepet një pale të tretë.[241] Fakti që gratë janë më pak të punësuara krahasuar me burrat ndikon në numrin e rasteve në të cilat gjykatat u japin kujdestarinë grave. Gjyqtarët kanë tendenca që kujdestaria e fëmijëve t'iu jepet burrave si kujdestarë financiarisht më të "përshtatshëm", disa herë edhe përkundër historisë së dhunshme. Për më tepër, urdhrat e gjykatave për burrat që të paguajnë për mbështetje të fëmijëve janë të rralla dhe rrallëherë zbatohen.[242] Vuniqi tha:

> Problemet me pagesat për mbështetje të fëmijëve gjithmonë kanë ekzistuar. Ka pasur raste në të cilat nëna do të zgjidhte me qëllim që të qëndrojë në martesë vetëm për shkak se kujdestaria e vetme për fëmijën do t'i ishte dhënë babait pas shkurorëzimit. Burrat gjejnë më shumë punë dhe kanë më shumë autoritet ekonomik, që është edhe arsyeja pse atyre më shpesh u jepet kujdestaria e fëmijëve.[243]

Ndonëse ajo mendonte se situata ngadalë po ndryshon, varshmëria financiare e grave nga anëtarët e familjes burra ka vazhduar të pengojë gratë nga kërkimi i drejtësisë. Sipas Haxhollit:

> 80 përqind e grave që kanë përjetuar dhunë janë të varura ekonomikisht dhe nuk kanë profesion, gjë që është një problem i madh. Shumica e rasteve të raportuara janë familje që jetojnë me ndihmën e ndihmës sociale. Edhe pas caktimit të ushqimisë, kryesi i veprës [në këto raste] nuk ka një pagë mujore prej nga t'i tërhiqet ushqimia. Si mund të mbijetojë viktima? Shteti nuk ofron asnjë ndihmë ose ... punë dhe kjo vazhdon të jetë një problem i madh.[244]

Për gratë që e raportojnë dhunën, e ardhmja është shpeshherë e zymtë meqë programet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e dëshmitarëve ende nuk funksionojnë si duhet.[245] Dënimet e ulëta gjithashtu nuk ndihmojnë në parandalimin e dhunës së përsëritur, pohon Sherifi:

> Këta njerëz duhet të marrin dënime më të larta. Ne e kishim një rast kur një burrë e kishte nxehur një kaçavidë dhe e kishte djegur dhe torturuar gruan e tij në mënyrë tejet sadiste. Ai i kishte djegur gjenitalet e saj me instrumente tjera. Gruas me të cilën i kishte kaluar 18 vite! Dhe ai është dënuar me vetëm nëntë vjet burgim? Kjo nuk mjafton!

Vlerësimi sasior i qasjes së grave në drejtësi vazhdon të jetë sfidues duke marrë parasysh sistemet e pamjaftueshme të grumbullimit të të dhënave.[246] Nuk ekziston asnjë regjistër nacional i rasteve i qasshëm nga publiku për sistemin e drejtësisë, prandaj shqyrtimi i rasteve gjatë procedimit të tyre nga policia deri te prokuroria e gjykatat nuk është i mundur. Gjithashtu nuk ishte e lehtë të vlerësohen praktikat e ndëshkimit nga gjyqtarët, veçanërisht për krimet që kanë të bëjnë me dhunën në baza gjinore. Sistemet e grumbullimit të të dhënave brenda sistemit të drejtësisë janë joadekuate, posaçërisht kur flasim për grumbullimin e të dhënave të ndara sipas gjinive që janë të rëndësishme për krime të ndryshme që përfshijnë dhunën në baza gjinore.

Sistemet e mbajtjes së regjistrave të EULEX-it për krimet në baza gjinore nuk janë në gjendje më të mirë që nga viti 2011. Nëse ata mbajnë të dhëna të tilla, atëherë përfaqësuesit e EULEX-it nuk ishin në gjendje të na përgjigjen në kohë në kërkesat tona për informata. Prandaj, RRGK manualisht ka numëruar rastet e postuara në faqen e internetit të EULEX-it. Nga 189 përmbledhje të lëndëve penale të publikuara në internet, të pranuara nga gjyqtarët e EULEX-it ndërmjet viteve 2009 dhe 2011, vetëm 11 përfshinin viktima të gjinisë femërore. Tri nga këto përfshin dhunë në familje ku burrat kishin vrarë gratë e tyre.[247] Dënimet e tyre ishin tri vjet e gjysmë, dhjetë vjet, përkatësisht 15 vjet burgim.[248] Rastet relativisht të pakta të krimeve të dhunës në familje mund të jenë pjesërisht si rrjedhojë e faktit që vetëm një nga 2,500 policët fillestarë të EULEX-it kanë trajtuar në mënyrë specifike raste të dhunës në familje, në kohën kur EULEX-i kishte kompetenca ekzekutive në vitin 2011.[249] Në gjykata civile ku edhe lëshohen urdhrat për mbrojtje, asnjë nga 117 rastet e monitoruara nga EULEX-i nuk ishin të lidhur me gra, nuk kanë cekur gratë dhe nuk kanë përfshirë gra deri më 2011.[250]

Pas ndryshimit të lartpërmendur në mandatin e EULEX-it, veprat penale që përfshijnë dhunën në familje nuk bien në kompetencën ekskluzive të Misionit, por vetëm në

kompetencën plotësuese. Si të tillë, ata kishin nevojë për një kërkesë nga palët e përfshira që gjyqtarët e EULEX-it t'i merrnin rastet. E njëjta gjë vlen edhe për çështjet civile. Kështu, EULEX-i kishte tendencë të mos trajtonte rastet civile që përfshinin dhunën në familje as në vitet e mëvonshme.

Ndërsa është arritur progres i jashtëzakonshëm gjatë njëzetë viteve të fundit në krijimin e një kornize legjislative dhe mekanizmave institucionalë për mbrojtje të grave, institucionet duhet tani ta zbatojnë atë. "Pandëshkueshmëria" ishte tema e përsëritur nga pjesëmarrësit në hulumtim. Në raste të shumta zyrtarët e zbatimit të ligjit, gjyqtarët dhe prokurorët kanë ngurruar kur janë thirrur të intervenojnë në raste të dhunës në familje.[251] Ndërsa prioritarizimi i rasteve të dhunës në familje si shkeljet e të drejtave të njeriut e ka përmirësuar përpunimin me kohë të rasteve, e drejta zakonore, "fajësimi i viktimës", rastet pazgjidhura, gjyqtarët paragjyqësor, mos sigurimi i ndjekjes automatike të veprave penale që ndodhin brenda marrëdhënieve familjare, nepotizmi, korrupsioni dhe dënimi i ulët kanë mbetur që të gjitha shkaqe për qasjen e pamjaftueshme të grave në drejtësi. [252] Për më tepër, dështimet e qeverisë për të ndarë mjetet e duhura për programet e rehabilitimit dhe ri-integrimit si për viktimat ashtu edhe për autorët e veprave do të thotë që gratë kanë mbrojtje jo të duhur dhe mbështetje të dobët për shërim.

NJË KUPTIM MË GJITHËPËRFSHIRËS I SIGURISË

"Në Kosovë, e drejta zakonore vazhdon të funksionojë mbi ligjin; vajza dhe djali nuk lindin të barabartë."

- Donika Kadaj, deputete, 2011

Fshati i largët i Brodit gjendet në një luginë rrethuar nga malet e larta që kufizohen me Shqipërinë dhe Maqedoninë Veriore.[253] Gratë e fshatit dhe përfaqësues të OKB-së që kishin ardhur në vizitë nga Prishtina u futën në një klasë të vogël të shkollës fillore. Ata flisnin për çështje të rëndësishme: të ardhmen e fshatit, papunësinë, dhunën në familje, qasjen në arsim.

"Për sa i përket arsimit, gratë në sallë na treguan se asnjë grua në Brod nuk e ka të përfunduar shkollën e mesme," tregoi Luciano Calestini, zëvendësshef i atëhershëm i UNICEF-it, i cili ishte shokuar nga ky lajm. "Po aq shqetësues ishte çështja e dhunës në familje," vazhdoi ai. Kur stafi i OKB-së pyeti diçka lidhur me këtë temë tabu, një grua u përgjigj, "Ky nuk është problem këtu!" Por gjatë bisedës, një grua qartësoi, "Kjo nuk paraqet problem këtu: burrat nuk na godasin, vetëm nëse ne themi 'Jo' ata ashpërsohen." Dhuna dukej se ishte reagim aq normal ndaj pavarësisë së grave sa që më nuk konsiderohej fare si problem.

Pas takimit, ekipi i OKB-së bëri një pauzë për kafe në një kafene në një fshat tjetër. Dy djem të moshës adoleshente i ngulnin sytë në grupin e madh të vizitorëve anglishtfolës, që

për ta ishte pamje e rrallë. Ata u ftuan që t'i bashkohen grupit. Një djalosh 17 vjeç po martohej javën që vinte me një vajzë 16 vjeçe.[254] "Gjasat janë të mëdha se deri vitin e ardhshëm ky çift i ri veçse do të jenë me foshnje," tha Calestini. "Ajo foshnje do të rritet nga ky çift dhe familja e tyre, sigurisht me të njëjtat sjellje dhe praktika të gjeneratave të shkuara që kanë parandaluar këtë nuse të re që të mos vijojë mësimin në shkollë. Mund të shihet që tani se cikli i mohimit do të vazhdojë në jetën e një foshnje që ende nuk ka lindur."

"Prandaj, Rezoluta 1325 është shumë larg vendeve si Dragashi," përfundoi ai. "Është tri orë rrugë larg Prishtinës, por është qindra vite prapa."

Vizita ishte pjesë e projektit të mbështetur nga UNDP-ja që kishte për synim integrimin e Komunës së Dragashit, një vendi malor madhështor ku njerëzit ende jetojnë në izolim dhe varfëri, i cili gjendet në vazhdim të Parkut Nacional Malet e Sharrit. Përfaqësuesja Rezidente e UNDP-së Lubrani tha se ata kanë bërë "përpjekje të veçanta proaktive për të komunikuar me gratë dhe për të siguruar përfshirjen e mendimeve dhe këndvështrimeve të tyre."[255]

Shumë gjëra kanë ndryshuar në Dragashin rural në dekadën e fundit, të mbështetur nga agjencitë e OKB-së, agjencitë ndërkombëtare të zhvillimit si Agjencia Austriake e Zhvillimit, zyrtarë lokalë dhe grupe të të drejtave të grave. Shoqata lokale e Iniciativës së Grave ka punuar me Kryetarin e Komunës dhe Zyrtarin për Barazi Gjinore për të angazhuar më shumë gra në proceset e vendimmarrjes, duke përfshirë edhe në proceset e buxhetit komunal; ka mundësuar qasje në arsim dhe punësim përmes përmirësimit të transportit publik; dhe ka adresuar dhunën në familje duke krijuar mekanizma komunalë që funksionojnë më mirë. Aktorët lokalë gjithashtu punuan me bizneset lokale, duke siguruar punësim për shumë gra në atë zonë, me qëllim të krijimi të autonomisë së tyre ekonomike.

Përderisa legjislacioni që mbron sigurinë e grave dhe të drejtat e njeriut është përgjithësisht në pajtim me standardet ndërkombëtare,[256] gratë mund të mos ndihen të mbrojtura dhe të sigurta gjithmonë. Sidomos në margjina dhe mes grupeve të

margjinalizuara siç janë pakicat etnike dhe personat me aftësi të kufizuar, gratë ballafaqohen me pasiguri të shumta.

Në vitin 2020, vajzat theksuan disa fusha në të cilat ndiheshin të pasigurta.[257] Ato e përkufizuan sigurinë gjerësisht, në përputhje me përkufizimet e sigurisë njerëzore [258], duke marrë parasysh mirëqenien e tyre të përgjithshme. Ngacmimet seksuale mbeten të përhapura, me ndriçim të pamjaftueshëm të rrugëve, transport të dobët dhe reagim të dobët të policisë. "Ne nuk kemi as drita në rrugë. Është terr burg edhe kur shkojmë në shkollë dhe kur kthehemi nga shkolla", tha një grua e re.[259] Atyre u mungon liria e lëvizjes, përfshirë qasjen në mundësitë për të mësuar jashtë vendit për shkak të kufizimeve të vazhdueshme të vizave. Ato ishin të shqetësuar për shëndetin e tyre për shkak të emigrimit të punonjësve të kujdesit shëndetësor. "Shkalla e lartë e papunësisë dhe fakti që njerëzit po largohen nga Kosova më bëjnë të pyes veten nëse do të kemi mjekë pas 30 vjetëve. Kjo më bën të ndihem e pasigurt," tha një vajzë rome nga Prizreni.[260]

Gratë nga pakicat etnike përballen me shumë prej të njëjtave vështirësive të grave shqiptare, por situata e tyre është përkeqësuar për shkak të margjinalitetit të dyfishtë. Gratë serbe janë ndjerë të pasigurta, por edhe të izoluara pa transport adekuat publik që do t'i lidhte komunat serbe me pjesët tjera të Kosovës, një çështje kjo që vazhdon edhe në vitin 2020.[261]

Gratë gorane që jetojnë në rajonet rurale në Brod dhe përreth tij janë të cenueshme për shkak të mungesës së qasjes në arsim dhe martesave të hershme. Gratë rome, egjiptiane dhe ashkali përballen me sfida të ngjashme. Agushi, nga RROGRAEK pohoi:

> Gratë rome përfaqësohen shumë pak dhe atë në nivel shumë diskriminues. Serbët e Kosovës gjithmonë ceken si pakica primare. Komunitetet tona përmenden vetëm kur donatorët e kërkojnë një gjë të tillë nga institucionet. Përndryshe ne nuk merremi parasysh. Ndërkombëtarët duhet të na shohin si të barabartë, por

> përbrenda pakicave tjera, ata harrojnë që ne ekzistojmë.[262]

Me vite, UNMIK-u duket se kishte harruar qindra romë që jetonin në vendbanime të kontaminuara me plumb, në cep të Kosovës veriore, në një rajon të prekur nga konflikti ndëretnik, paligjshmëria dhe lënia pas dore. "Një raport i UNMIK-ut i vitit 2000 rekomandonte zhvendosjen e kampit për shkak të kësaj, por në këtë drejtim nuk është ndërmarrë asnjë veprim," raporton BBC më 2005.[263] Në vitin 2007, përfaqësuesit e UNDP elaboruan lidhur me këtë "histori e gjatë":

> Vendbanimet kishin mbeturina të kontaminuara me metale të rënda, veçanërisht plumb, që ka ndikim degjenerues posaçërisht tek fëmijët. Dhe UNMIK-u nuk ka bërë shumë në lidhje me këtë; ata nuk e kanë parë si problematike këtë çështje dhe është e qartë sa shumë e kanë nënvlerësuar këtë problem. [… Mendoj se UNMIK-u më vonë e kishte kuptuar sfidën, por me vonesë prej disa viteve.[264]

Situata ekstreme mjedisore në këto vendbanime ka pasur ndikim të veçantë tek gratë. Shoqëria për Njerëzit e Kërcënuar ka raportuar se, "Shumica e grave që mbesin shtatzënë në kampe përfundojnë me abortime. Nuk ka rëndësi nëse ishte fëmija i parë apo i dhjetë, gjasat janë të larta se do të abortojnë."[265] Gratë frikësoheshin se fëmijët e tyre do të sëmuren dhe do të vdesin. Ato vërenin se si fëmijët e tyre "zemëroheshin dhe ishin të dhunshëm për gjëra të imëta. Ata humbnin dëgjimin [dhe] orientimin gjatë ecjes. Me përkeqësimin e situatës ata e humbin kujtesën dhe vjellin çdo ditë." Ndonëse është nder i madh për gratë të mbesin shtatzëna, gratë kanë abortuar vetë nga frika e mirëqenies së fëmijëve të tyre të ardhshëm.[266] Tek në vitin 2010 akterët ndërkombëtarë filluan t'i mbyllin kampet dhe të mbështesin zhvendosjen e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve të cilët

kishin jetuar në kushte të mjerueshme për një dekadë të tërë.[267]

Përgjithësisht, gjersa disa programe kanë pasur për cak nevojat specifike të grave dhe vajzave në Kosovën e pas-konfliktit, shumë prej tyre mbesin të cenueshme dhe të margjinalizuara.[268] Siguria e tyre "nuk është në nivel të kënaqshëm në të gjitha fushat e jetës," tha Agushi.[269]

Sigurimi i edukimit

"Në ditët e sotme nuk ka diskutime nëse vajzat e reja duhet të vazhdojnë shkollimin e lartë. Tani diskutimi është se si të gjenden mënyra për t'i ndihmuar ato financiarisht dhe për t'i mbështetur përmes universitetit."

- Marta Prenkpalaj, drejtore e shkollës, Has, 2007, cituar në "Histori është edhe tregimi i saj", Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Çdo natë, para se të flinte, ajo në mendjen e saj fantazonte për gjëra të ndryshme. Këto nuk ishin fantazira normale të një pesëmbëdhjetëvjeçareje. Ajo nuk ëndërronte për veshjet e reja që do t'i vishte apo djemtë simpatikë në kafene. Në vend të kësaj ajo ëndërronte për përfundimin e shkollës së mesme dhe fillimin e një biznesi të saj. Gjasat për këtë ishin të pakta meqë familja e saj kishte vendosur që të mos e dërgonte atë në shkollë të mesme. Ajo e adhuronte shkollën dhe i luste ata që të mos i'a ndalnin edukimin, por ky ishte opsioni i vetëm që e kishin. Ata nuk mund ta përballonin koston e arsimimit të saj dhe të dy vëllezërve në të njëjtën kohë; kostot e udhëtimit dhe të jeteve shkollore kushtonin shumë. Vajza nuk do t'i mbështeste ata në moshën e tyre të shtyrë; ajo do të martohej dhe do t'i bashkohej një familjeje tjetër. Pra ja ku ishte ajo, në shtëpi, duke ëndërruar për shkollim. Për sa i përket fillimit të biznesit të saj, kur ia tregoi nënës këtë dëshirë, atë e kaploi e qeshura. "Pse kam lindur vajzë që jeton në ëndrra," kishte thënë ajo. "Pse s'mund ta gjej një djalë të mirë për t'u martuar?"

Në vitin 2004, rreth 65 për qind të vajzave të Kosovës nuk e kishin përfunduar shkollimin e mesëm, krahasuar me 41 për qind të djemve. Mesatarisht, gratë kishin vetëm 8.45 vite

të shkollimit krahasuar me 10.35 të burrave.[270] Fakti që vajzat e ndërprisnin shkollimin e tyre para djemve i atribuohej pjesërisht normave sociale të bazuara në kulturë. Ndërsa nuk kishte dallim ndërmjet shkollimit të vajzave dhe djemve në qytete në vitin 2011, në viset rurale kushtet strukturore si ekonomia e dobët e familjeve dhe mungesa e ndërtesave të shkollave, i mbanin traditat gjallë. Pa një rrjet të sigurisë, njerëzit e moshuar ende mbështeten të pjesëtarët më të rinj për mbijetesën e tyre, dhe djemtë shpesh e përmbushin këtë detyrë. Ata kanë perspektivë më të mirë të punësimit dhe përgjegjësi historike sociale për të ofruar siguri financiare për prindërit e tyre më të moshuar në jetën e tyre të mëvonshme. Prandaj, historikisht, në rastet kur duhej të merreshin vendime financiare, janë djemtë ata që dërgoheshin në shkollë në vend të vajzave.[271]

Shpeshherë, vajzat në viset rurale duhet të ecin vetëm me kilometra të tëra përgjatë rrugëve të ngarkuara nacionale për të shkuar në shkollë, itinerar ky të cilin prindërit nuk e preferonin për vajzat e tyre. "Nuk mund të ecni lirshëm në rrugë pa u ngacmuar", i tha RrGK-së një grua e re në vitin 2020.[272] Sikurse gratë e tjera dhe prindërit e tyre, ajo frikësohej se do të përballeshin me një kakofoni të ngacmimeve nga makinat dhe burrat që kalonin rrugës për në dhe gjatë kthimit nga shkolla; kjo i bëri ato të ndjehen të pasigurta.[273]

Vajzat nga disa grupe të caktuara etnike kanë pasur qasje edhe më të keqe në arsim, siç janë vajzat rome, ashkali, egjiptiane dhe gorane. Normat sociale siç janë martesat e hershme dhe gjendja e dobët e ekonomike ua kanë pamundësuar atyre vijimin e shkollimit të mesëm.[274] "Unë kisha frikë t'i tregoja babait tim për këtë [ngacmimin] pasi ai kurrë nuk do të më linte të dilja përsëri. Dhe kjo ndodhte gjatë ditës."[275] Edhe në vitin 2020, vajzat rome thanë se situata të tilla, mund të kontribuojnë në martesën e hershme në përpjekje për t'i "mbrojtur" vajzat, të cilat iroikishin mund t'i pengojnë vajzat të kenë qasje në nivelet më të larta të arsimit. Në të vërtetë, vajzat rome, ashkalike dhe egjiptiane ishin të nënpërfaqësuara në arsimin e mesëm të lartë, ku ato përbënin

më pak se 42 përqind të nxënësve romë, ashkali dhe egjiptianë.[276]

Fakti nëse gratë dhe vajzat kanë qasje në shërbimet publike, përfshirë arsimin, mund të jep indikacion të "nivelit të trajtimit të nevojave specifike të grave dhe vajzave në hartimin, financimin dhe ofrimin e shërbimeve themelore," sipas Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.[277] Qasja e pabarabartë e grave në arsim për shkak të kushteve sociale më të gjera i të ato në pozitë të pafavorshme kur më vonë në jetën e tyre kërkojnë të hyjnë në treg të punës. Pa siguri ekonomike, gratë përpiqen ta mbrojnë veten nga situatat e dhunshme në familje, dhe të jenë më të pavarura në përgjithësi.

Fatmirësisht, situata në Kosovë ka filluar të ndryshojë të paktën sa i përket qasjes në arsim. Avokimi i palodhshëm i aktivisteve për të drejtat e grave i ka mbajtur të hapura shkollat në viset rurale dhe ka kontribuar në hapjen e shkollave të reja të mesme në viset rurale, duke mundësuar kështu qasje më të lehtë të grave të reja në arsim. Tani, si rezultat i kësaj, vajzat (49 përqind) dhe djemtë (51 përqind) e përfundojnë arsimin e mesëm të lartë pothuajse në mënyrë të barabartë.[278] Në vitit 2020, më shumë vajza sesa djem vijuan universitetet publike, duke përbërë 60 përqind të studentëve të programeve baçelor, 64 përqind të studentëve në master dhe 68 përqind në doktoraturë.

Si përfundim, edhe pse disa grupe të pakicave dhe gratë nga viset rurale ende përballen me disa sfida, në përgjithësi, si aktiviste e të drejtave të grave dhe një nga drejtoreshat e para gra nga rajoni rural i Hasit, Marta Prenkpalaj në vitin 2007 theksoi, "Në ditët e sotme nuk ka diskutime nëse vajzat e reja duhet të vazhdojnë shkollimin e lartë. Tani diskutimi është se si të gjenden mënyra për t'i ndihmuar ato financiarisht dhe për t'i mbështetur përmes universitetit."[279]

"Vrimë e zezë" për shëndetin

"Pjesa më e vështirë e të jetuarit në vise rurale, sidomos për gratë, është se vendbanimi në këto vise është i ndërthurur me nivelin e arsimimit të grave dhe statusin e tyre socio-ekonomik. Shumica e tyre nuk gjenerojnë të hyra dhe nuk janë të pavarura."

- Dr. Skender Syla, Udhëheqës i Zyrës,
Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2011

Para konfliktit, shteti i Jugosllavisë kishte në pronësi të gjitha objektet shëndetësore. Gjatë viteve të nëntëdhjeta, politikat diskriminuese të Qeverisë së Serbisë nënkuptuan që shqiptarët e Kosovës nuk kishin qasje në shërbimet e kujdesit shëndetësor publik. Pas përjashtimit të mjekëve shqiptarë nga klinikat shëndetësore publike, shqiptarët nuk u besonin më mjekëve serbë.[280] Përmes taksave vullnetare shqiptarët e Kosovës vetëfinancuan shërbimet e veta të kufizuara shëndetësore si pjesë e Shoqatës Joqeveritare Nëna Terezë për afro një dekade.[281]

Pastaj, lufta e vitit 1999 në Kosovë shënoi një zmbrapsje të radhës sa i përket qasjes në kujdes shëndetësor. Dhuna e trupave serbe ndaj grave dhe vajzave shkaktoi dëme të rënda afatgjate shëndetësore.[282] Bllokadat serbe i lanë gratë e rajoneve siç është Drenica të izoluara nga qasja në kujdes mjekësor dhe furnizime sanitare.[283] Për shembull, një grua kujtoi se ajo "ka lindur binjakë në male" pasi që është dëbuar nga shtëpia me dhunë nga ushtria serbe.[284] Gratë tjera kanë abortuar apo kanë lindur para kohe si pasojë e traumës. Historitë e grave dhe dokumentimi i pavarur nga hulumtues të huaj tregojnë se gjatë luftës nuk janë përmbushur nevojat shëndetësore riprodhuese të grave dhe vajzave.[285]

Pas luftës, sektori shëndetësor në përgjithësi mbeti i pa zhvilluar.[286] Nuk ka fare sigurime publike shëndetësore. Ligji për shëndetësinë në Kosovë i vitit 2004, lejonte që grupe speciale të kenë qasje të kufizuar në lloje të caktuara të shërbimeve publike shëndetësore pa pagesë.[287] Dispozitat e këtij ligji për gratë kanë të bëjnë me maternitetin, duke injoruar shërbimet tjera të rëndësishme siç janë kujdesi gjinekologjik, terapia dhe ekzaminimet rutinore. "Kosova është vrimë e zezë në Evropë kur flasim për kujdesin shëndetësor riprodhues," tha Visare Gorani Gashi, ish-udhëheqëse e ABGJ.[288]

Rezoluta 1325 bën thirrje që të përmbushen "nevojat specifike riprodhuese të grave dhe vajzave në situata të konfliktit dhe pas konfliktit," sipas Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së. Kosova duhet të instalojë politika të cilat përmirësojnë qasjen në kujdes cilësor të shëndetit riprodhues për shtetasit e saj. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së propozon që shkalla e vdekshmërisë së ëmave të shërbejë si indikator përfaqësues i "cilësisë së shërbimeve publike që i ofrohen grave dhe vajzave."[289]

Institucionet publike të Kosovës nuk i janë përmbajtur kësaj këshille që nga 2011. Ata madje nuk e kanë të njohur as natyrën dhe shtrirjen e problemeve të kujdesit shëndetësor për shkak se mbajtja e regjistrave të tyre ishte shumë e mangët. Sistemet e dobëta të menaxhimit të të dhënave paraqitnin që në vitin 2009 është regjistruar vetëm një vdekje maternale për 100,000 lindje (dhe asnjë e tillë në vitet 2008 dhe 2007)[290], statistikë veçanërisht e pabesueshme duke marrë parasysh se në shtetet si Gjermania, ku kujdesi shëndetësor është shumë më cilësor, vdekshmëria e ëmave është tetë në 100,000 lindje.[291] Në vitin 2012, raporti i vdekshmërisë së nënave për 100,000 lindje të gjalla ishte 10.5, dhe të dhënat gjatë viteve në vijim ishin të paqarta.[292] Një strategji qeveritare deklaroi se raporti i vdekshmërisë së ëmave ishte 3.7 gjatë periudhës 2011-2015, por më vonë u tha se nuk kishte raste të raportuara nga viti 2013 deri në 2016.[293] Prandaj, të dhënat mbi vdekshmërinë e nënave mbeten mjaft konfuze. Sipas *Prishtina Insight*, institucionet shëndetësore jo gjithmonë regjistrojnë

me saktësi vdekshmërinë e ëmave sepse, siç tha Merita Vuthaj, Shefe e Divizionit të Shëndetit të Nënës dhe Fëmijëve në Ministrinë e Shëndetësisë:

> Le të marrim një shembull: nëse gjatë ndërlikimeve [pas lindjes] një grua mbetet në koma, dhe transferohet në departamentin e neurologjisë, ajo qëndron atje dy deri në tre muaj - dhe pas kësaj, ajo vdes. Vdekja e saj nuk do të regjistrohet si vdekshmëri e ëmës, por si vdekje nga humbja e gjakut.[294]

Edhe në vitin 2020, aktivistët për të drejtat e grave shprehën shqetësimin se Kosovës i mungon mbajtja e saktë e të dhënave lidhur me vdekshmërinë e ëmave.[295] "Ne kemi një sistem shëndetësor shumë të gjymtë," tha aktivistja Demolli. "Sëmundja nuk regjistrohet dhe nuk ka asnjë sistem të digjitalizuar. Kështu, ne nuk i dimë shkaqet e vdekjes së grave shtatzëna."

Ndërmjet viteve 2005 dhe 2010, autoritetet e Kosovës regjistruan 335 vdekje të foshnjave, përfshirë foshnjet që vdiqën ndërmjet 24 orëve dhe 11 muajve pas lindjes së tyre.[296] Kjo tregon një mesatare prej 67 vdekjesh foshnjore në vit. Të dhënat nuk ishin të ndara sipas gjinisë ose moshës. Viti 2012 duket se ka qenë i jashtëzakonshëm, me 316 vdekje foshnjore të regjistruara.[297] Ndërsa, në vitin 2020, autoritetet regjistruan 65 vdekje të foshnjave; 44.6 përqind ishin femra dhe 55.4 përqind ishin meshkuj.[298] Kjo tregon se me kalimin e kohës pak ka ndryshuar dhe shqetësimet për saktësinë e këtyre të dhënave kanë vazhduar.

"Një sfidë e konsiderueshme është edhe mungesa e mekanizmave të llogaridhënies në sektorin e shëndetësisë, siç është mungesa e auditimeve të vdekjeve të ëmave dhe foshnjave," tha Doina Bologna përsëri në 2011, kur e udhëhiqte UNFPA-n[299]. Ajo besonte se në Kosovë kishte mosraportim të konsiderueshëm. Dr. Syla u pajtua: "Për shembull, ne nuk kemi regjistër të mirëfilltë të kancerit në Kosovë përmes së cilit do të dinim se sa gra vuajnë nga kanceri i gjirit apo mitrës. Ne nuk

kemi sistem funksional të informimit tha ai.[300] Një gjë e tillë ndikoi në politikat dhe reagimin ndaj sëmundjeve.

Në vitin 2020, Magbule Elezi nga Shoqata e Mamive të Kosovës ia atribuoi çështjet e vazhdueshme me vdekshmërinë e ëmave dhe të foshnjave mbylljes së materniteteve në disa komuna. Qeveria mbylli maternitetet nën pretendimin se mjekët e përgjithshëm të familjes mund të ofronin këto shërbime gjinekologjike:

> Ne kemi ngritur shqetësimin tonë për mungesën e spitaleve të lindjes. Në qytete, ka Qendra të Mjekësisë Familjare dhe spitale, por komunat tjera [rurale] nuk kanë shërbime gjinekologjike. Ne kemi qenë në kontakt me RRGK gjatë gjithë kohës dhe kemi shtyrë përpara çështjen që paraqet mbyllja e spitaleve të lindjes. Nuk jam dakord që mjekët e familjes duhet të kryejnë ekzaminime gjinekologjike të grave. Mjekët e familjes kontrollojnë pacientët, por janë të kufizuar në masën në të cilën ata mund ta kryejnë këtë ekzaminim. Spitalet e lindjes në Kosovë nuk duhet të ishin mbyllur, por për më tepër të hapeshin në çdo komunë, në mënyrë që gratë të mund të merrnin shërbime kudo që të ishin. Por meqenëse disa janë mbyllur në Kosovë, gratë janë të detyruara të shkojnë ose në spitale private ose në spitale [në qytete të largëta].[301]

Elezi theksoi rolin e rëndësishëm që mund të luajnë mamitë, posaçërisht në zonat rurale:

> Në disa komuna, mamitë… kanë ndihmuar gratë të lindin gjatë luftës ose tani, pa gjinekolog. Për shembull, kemi Komunën e Suharekës, ku mamitë punojnë 24 orë. Ato i presin gratë, dhe i ndihmojnë gjatë lindjes, dhe vetëm në raste të ndërlikimeve gratë shkojnë në Prishtinë. Jo aq shumë lindje regjistrohen në komunat e tjera sepse të gjitha ato janë përqendruar në Prishtinë [për shkak të shërbimeve në dispozicion atje].

> Shembulli i Suharekës duhet të ndiqet nga komunat e tjera. Vetëm në rast të ndërlikimeve ata duhet të thërrasin një gjinekolog. Gratë do të shkonin më parë në spitalin e lindjes [në komunën e tyre] sesa në një spital në një qytet tjetër.[302]

Provat sugjerojnë se gratë nuk kanë qasje në kujdes cilësor shëndetësor, sikurse pjesa tjetër e popullatës.[303] Banorët e varfër dhe ruralë të Kosovës përballen me sfida të shtuara për qasjen në kujdes shëndetësor.[304] Mbi të gjitha, Kosova ka spitale dhe pajisje publike joadekuate. "Ne ende nuk kemi shërbime shëndetësore të cilat janë të një rangu të gjerë dhe specifike," tha Dr. Syla. Ndarjet buxhetore për kujdesin publik shëndetësor dhe spitalet kanë qenë të ulëta. Sistemi publik i shëndetësisë është raportuar të përbënte vetëm 9.2 për qind të Buxhetit të Kosovës apo 35 euro për kokë banori në vit në vitin 2009.[305] Pa sigurim shëndetësor, njerëzit duhet ta paguajnë vetë koston e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë blerjen e medikamenteve të tyre, një çështje që mbeti e pazgjidhur edhe në vitin 2020 pasi ende nuk kishte kaluar asnjë ligj për sigurim shëndetësor. Me një shkallë të ulët punësimi, në mesin e grave, faturat e kujdesit shëndetësor kanë vazhduar të jenë përtej mundësive financiare të shumë njerëzve.[306]

Paaftësia e sistemit për të ofruar kujdes shëndetësor më afër grave rurale nënkuptonte që ato kanë mungesë të qasjes në lloje të caktuara të kujdesit shëndetësor. Për shembull, "testimi i kancerit të gjirit apo kancerit të mitrës është specifik dhe nuk mund të ofrohet në të gjitha vendet ku jetojnë gratë," tha Dr. Syla. Ndonëse "sallat e emergjencës dhe spitalet gjenden kudo në Kosovë, edhe në vendet më të largëta, "ai tha se ekziston një dallim i theksuar ndërmjet viseve urbane dhe rurale për sa i përket qasjes në kujdes shëndetësor. Kushtet e dobëta të jetës dhe largësitë e gjata ndërmjet shtëpive rurale dhe qendrave shëndetësore kufizojnë qasjen e banorëve ruralë. Mungesa e pavarësisë financiare vazhdon t'i parandalojë gratë që jetojnë në viset rurale nga udhëtimi për në klinikë apo nga pagesa e mjekut.[307] "Meqë shumica e tyre

nuk gjenerojnë të hyra, ato nuk janë gra të pavarura," tha Dr. Syla. Ato varen nga mëshira e familjeve të tyre për qasjen në kujdes shëndetësor. Siç tha aktivistja Demolli, "Nëse do të kishte një gjinekolog në Opojë ose Dragash [zonat rurale], gratë do të shkonin për kontroll. Në vend të kësaj, ato duhet të shkojnë me vjehrrën e tyre në Prizren".[308] Sipas kulturës, veçanërisht gratë rurale, duke pasur një anëtar të tillë të familjes që "t'i shoqëronte" ato te mjeku bëhej nën pretendimin e garantimit të sigurisë së tyre. Megjithatë, duke pasur parasysh natyrën ende mjaft private të shëndetit gjinekologjik dhe riprodhues, gratë shumë lehtë mund të hezitojnë të shkojnë te një mjek, duke dashur të ruajnë konfidencialitetin nga anëtarët e tjerë të familjes.

Për më tepër, disa gra shprehën shqetësimet e tyre në lidhje me vizitën e mjekëve burra; ato preferonin që vetëm gratë punëtore të kujdesit shëndetësor t'i kontrollonin ato. Këto çështje mund të parandalojnë gratë nga qasja në shërbimet e nevojshme të kujdesit shëndetësor, duke pasur parasysh sa rrallë ekzistojnë mjeket gra, veçanërisht në zonat rurale. Pa marrë kujdesin e duhur shëndetësor riprodhues, veçanërisht kujdesin shëndetësor parandalues, rreziqet e grave për komplikime mund të rriten, një çështje jo vetëm që prek gratë shtatzëna, por të gjitha gratë.

Edhe pse gratë serbe kanë pasur tendencë të kenë qasje më të mirë në kujdesin shëndetësor sesa gratë e etnive të tjera, sipas statistikave,[309] ato ende përballeshin me disa sfida në lidhje me shëndetin e tyre riprodhues. Aktivistja Simić, e cila punon në zonat rurale përreth Mitrovicës, theksoi:

> Gratë në zonat rurale që janë 50 deri në 60 vjeç nuk kanë bërë kurrë një pap test. Atyre u mungojnë gjërat elementare. Ato kanë shkuar vetëm tek[obstetri ose gjinekologu] kur kanë lindur fëmijët. Ato nuk ishin arsimuar për rëndësinë [e kontrolleve të rregullta] dhe mungesës së qasjes. Kur bëhet fjalë për popullatën urbane, nuk ka edukim seksual në shkolla, kështu që kjo është tabu. Ato kanë qasje në informata në internet

> dhe përfshihen në aktivitete seksuale, por nuk kanë udhëzime. Ato nuk kanë kontracepsion... u është lënë atyre që të vetë të bëjnë zgjidhjen. Ka qasje të rregulluar në abort, por vajzat nuk ka të ngjarë të kërkojnë ato shërbime këtu për shkak të stigmës. Ato do të shkojnë në klinikat përtej kufirit. Situata nuk ka ndryshuar në dhjetë vitet e fundit. Prezervativët falas janë kudo, por jo kontrolli falas i lindjeve [kështu] barra e seksit dhe të pasurit fëmijë u vihet këtyre vajzave të reja. Ka shumë pak mbështetje në dispozicion.[310]

Disa nga këto çështje vazhduan ose madje u intensifikuan për gratë e të gjitha etnive gjatë pandemisë COVID-19. Në vitin 2020 gratë kanë hasur vështirësi në qasjen në kujdesin shëndetësor për veten dhe fëmijët e tyre për shkak të vështirësive financiare të shkaktuara nga papunësia, ndërprerjes periodike të transportit publik dhe kufizimeve të lëvizjes.[311]

Disa gra nga minoritetet përballen me sfida të shtuara në qasjen në kujdesin shëndetësor, veçanërisht gratë rome, ashkali, egjiptiane, boshnjake, turke dhe gorane.[312] Agushi tha se gratë rome, ashkali dhe egjiptiane përballen me diskriminim për shkak të ngjyrës së lëkurës, veshjeve dhe gjuhës. "Asgjë nuk ka ndryshuar", tha ajo.[313] Aktivistja Rahmani tha se gratë me aftësi të kufizuara gjithashtu përballen me sfida të shtuara në qasjen në kujdesin shëndetësor:

> Gratë duhet të bëjnë kontrolle të rregullta gjinekologjike, jo vetëm kur janë shtatzënë. Por nuk mund të shkojmë vetëm te gjinekologu. Unë pranoj shumë ankesa nga gratë me aftësi të kufizuara pasi ato nuk mund të bëjnë një kontroll në një karrige gjinekologjike normale; karrigia ose tavolina duhet të jenë hidraulike. Një grua që shkoi për një kontroll në Prizren, ku kishte një tryezë normale. Ajo as që u ndihmua nga mjeku dhe infermierët. Për më tepër, ata ishin aq të vrazhdë me të, duke i thënë: "Uluni atje,

> nëse mundeni". Sigurisht që ajo nuk mundi, kështu që nuk mund të bënte as kontrollin! Edhe unë kisha të njëjtin rast, por me ashensorin. Njësia e Gjinekologjisë ishte në katin e tretë dhe ashensori nuk po punonte. Edhe nëse do të ishte duke funksionuar, unë nuk do të isha në gjendje të ulesha në karrige vetë[314]

Çështje të tilla të qasjes parandalojnë gratë me aftësi të kufizuara, të kenë qasje në kujdesin shëndetësor, veçanërisht ato nga zonat rurale, tha ajo. "Ato duhet të shkojnë te gjinekologu me një shoqëruese, për t'i ndihmuar të zhvishen. Asgjë nuk është bërë për të përmirësuar qasjen e tyre në kujdesin shëndetësor," tha ajo.

Kosovarët gjithashtu kanë ende mungesë të të kuptuarit të rëndësisë së kontrolleve rutinore mjekësore dhe të faktit se vizitat e rregullta te mjeku mund të parandalojnë shumë sëmundje.[315] "Ne e kemi një mënyrë të caktuar të të menduarit," tha Dr. Syla. "Ne fillojmë të mendojmë për shëndetin vetëm kur të sëmuremi."

Injorimi themelor i mjekësisë parandaluese kontribuon në mospërfilljen e nevojave të grave të shëndetit riprodhues, të cilat kuptohen gabimisht se janë të lidhur vetëm me seksin. Gratë e pamartuara, të shkurorëzuara apo të veja në veçanti përballen me stigma sociale të shoqëruara me vizitat te gjinekologu. "Pas vdekjes së burrit tim më është dashur të shkoj te gjinekologu, por për shkak të fjalëve të gojës nga njerëzit dhe se ata mund të mendonin se jam shtatzënë, nuk vajta në kontroll."[316] Një tjetër femër e re tha për RRGK, "Unë isha e re dhe kur iu thashë se kisha dhimbje, vjehrra ime më tha, 'E njëjta gjë më ka ndodhur mua, por kjo do të kalojë dhe mos i thuaj askujt për këtë sepse është e turpshme.'" Familjet u thonë grave që ta "përballojnë" dhimbjen e të mos kërkojnë kontroll mjekësor. "Ai nuk ishte i interesuar në shëndetin tim," tha një grua tjetër, duke iu referuar burrit të saj. "Disa herë, ai nuk më besonte se unë isha e sëmurë. Ai më tha se nuk mund të shkojë të mjeku për secilën dhimbje."

Normat që i kanë rrënjët në historinë e posaçme të Shqiptarëve të Kosovës gjithashtu kanë ndaluar qasjen e grave në shëndetësi, posaçërisht për shëndetin riprodhues. Për një popull i cili luftën për mbijetesë dhe rezistencë nga shtypjet e ka narrativë dominuese nacionale, për disa pjesëtarë të popullatës gratë përfaqësojnë krijueset e luftëtarëve të ardhshëm. Aktivistja Shehu kujton një bisede ilustruese me fqinjin e saj mjek:

> Ne po mundoheshim të shpërndajmë prezervativë dhe kontraceptivë dhe mjeku im më fajësonte për këtë. Ai me tha, "Pse po i shpërndan këto gjëra për gratë? A nuk e di ti se ne shqiptarët kemi nevojë për ushtarë?"
>
> I thashë, "Unë e kam një djalë, por prapë shpresoj se nuk ka më luftë. A nuk mendon se gratë kanë të drejtë të zgjedhjes personale? Ne dëshirojmë të kemi fëmijë dhe të planifikojmë familjen në mënyrën që dëshirojmë. Ne gjithmonë u themi grave ta ruajnë shëndetin e tyre. Ne nuk po ju themi që të kenë një, dy apo të mos kenë fare fëmijë." Unë kam më shumë fëmijë se mjeku im dhe i thashë, "Ti je personi i fundit që do duhej të flasë për këtë të drejtë patriotike."[317]

Elvanda Gojani rikujtoi në mënyrë të ngjashme kur infermierët po shpërndanin kontraceptivë në zonat rurale për ato që nuk kishin qasje: "Një infermiere më e vjetër që ishte afër pensionit refuzoi t'i shpërndajë ato. 'Ju po përpiqeni të ulni natalitetin në Kosovë', tha ajo".[318] Në mesin e disa zyrtarëve qeveritarë dhe praktikuesve të kujdesit shëndetësor, pikëpamja se shqiptarët nga Kosova kishin nevojë për të rritur shkallën e natalitetit për arsye nacionaliste, mbeti e pranishme në vitin 2020, duke penguar potencialisht të drejtat e riprodhimit të grave, por edhe të drejtat e tyre të punës dhe qasjen e barabartë në punësim.[319]

"Mentaliteti tradicional' i mjekëve dhe familjarëve ishte temë e përsëritur në intervista. "Shërbimi mjekësor nuk është vetëm qasje fizike. Është edhe aspekti i komunikimit ndërmjet

një gruaje dhe stafit mjekësor," tha Dr. Syla. "Stafi mjekësor shpeshherë i trajton gratë si objekte e jo subjekte. "Gratë janë ankuar edhe për praktikat e konfidencialitetit të mjekëve, një trend që vazhdoi me kalimin e kohës."[320]

Ngjashëm me shëndetin fizik, mirëqenia psikologjike e grave dhe burrave ka mbetur kryesisht e patrajtuar. Në një vend të shkretuar nga konflikti i fundit, "nuk ka pasur përfshirje koherente në ndihmën për viktimat, tha Doina Bologa."[321] Vetëm mendimi për të kërkuar ndihmë psikologjike është përgjithësisht i papranuar. Në lidhje me këtë, Sebahate Pacolli nga QKRMT tha:

> Menjëherë pas luftës, raportimi për të tjerët se dikush po shkonte te psikologu apo psikiatri ishte tabu. Njerëzit mendonin se vetëm personat e marrë apo psikotikë shkojnë te psikiatri. Kështu, ne duhet që të punojmë në ngritjen e vetëdijes.[322]

"Gjëja më e vështirë është kur keni nevojë për një psikiatër apo një gjinekolog," tha një grua. "Pjesa më e vështirë është që ato të vizitohen pa e kuptuar të tjerët. Për pjesën tjetër të mjekëve është më lehtë, por psikiatrit dhe gjinekologët na duhen më së shumti."[323] Muharrem Xhemajli nga Organizata e Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës tha se "do të kishte qenë mirë nëse institucionet shtetërore dhe shteti i Kosovës të kishin sajuar programe speciale të rehabilitimit për pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe posaçërisht për gratë":

> Menjëherë pas luftës ne nuk i kemi ndjerë këto pasoja psikologjike sepse kishim probleme tjera si sigurimi i shtëpive tona, por tani njerëzit kanë kohë të ndalen dhe të mendojnë. Të gjithë kanë filluar t'i ndiejnë problemet psikologjike tani. Është e pamundur të kalojmë nëpër luftë pa pësuar dëme psikologjike. Ne mund të mendojmë se jemi në rregull, por është e pamundur. Ne kurrë më parë nuk jemi përballë me trauma të tilla. Gjashtëmbëdhjetë veteranë kanë kryer

> vetëvrasje. Askush nuk i di arsyet, por ne jemi të sigurt se ka të bëjë me traumën që e kanë përjetuar gjatë luftës. Askush nuk po merret më këto çështje.[324]

Ofrimi i këshillave psikologjike për gratë dhe burrat, ish-ushtarë dhe civilë, është i rëndësishëm, tha Rogova. Ajo dha një shembull në të cilën ishte e përfshirë, në një rajon të izoluar, malor pas luftës:

> [Shoqata] Motrat Qiriazi punonte me burrat e rajonit të Hasit. Ne i ftonim burrat nga jashtë vendit që kishin përjetuar dhunë dhe ata vinin për të folur me burrat në Has. Çfarë dallimi, nëse e krahasojmë rajonin e Hasit në kuptim të [aftësinë e njerëzve për t'i përballuar] dhunës me rajonet tjera. Ne i kemi ndihmuar burrat aty, mirëpo në rajonet tjera, askush, *askush* nuk bëri asgjë.

Organizatat si Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Motrat Qiriazi, QKRMT, Një me Një, Medica Kosova dhe Medica Gjakova ofronin pas luftës asistencë *ad hoc*. Megjithatë, mungesa e këshillimeve të institucionalizuara psikologjike për çrregullimet pastraumatike të stresit mund të kenë kontribuuar në depresion dhe dhunë në familje, theksuan pjesëmarrësit në hulumtim. Ndërsa qendrat e shëndetit mendor ofruan më shumë shërbime në vitin 2020 sesa në vitet e mëparshme, stigmatizimi dhe vështirësitë ekonomike ende parandaluan shumë njerëz që t'i shfrytëzojnë këto shërbime.

Përkundër mangësive të shumta për qasjen e grave në kujdesin shëndetësor, disa pjesëmarrës në hulumtim kanë parë përmirësime gjatë njëzet viteve të fundit. "Në vitin 1999 nuk mund të flisnim për planifikimin familjar,"[325] tha Visare Mujko-Nimani nga UNFPA. "Njerëzit mendonin se kjo nënkuptonte se po mundohemi ta zvogëlojmë numrin e shqiptarëve, posaçërisht në viset rurale. Tani kjo ka ndryshuar në masë të madhe. Tani edhe burrat blejnë prezervativë. "Tani ka një kornizë më të mirë legjislative.[326] UNFPA, UNICEF, Organizata

Botërore e Shëndetësisë (OBSH), dhe OJQ-të vendore kanë bashkëpunuar për të mbështetur hartimin e politikave të kujdesit shëndetësor, trajnimin e ofruesve të shërbimeve, ofrimin e fushatave sensibilizuese lidhur me çështje të ndryshme shëndetësore dhe ofrimin e prezervativëve pa pagesë përmes sistemit shëndetësor. "OBSH ka vlerësuar repartet kosovare të maternitetit, ka zhvilluar plane programore për trajnimin e stafit në të gjitha nivelet, ka instaluar sistem të mjekut familjar dhe ka ndihmuar në konsolidimin e Ministrisë së Shëndetësisë," shtoi Dr. Syla.

Në dhjetor 2010 u hap më në fund Instituti i Onkologjisë pas viteve të avokimit në emër të aktivisteve për të drejtat e grave; ai ofron ekzaminime pa pagesë të identifikimit të kancerit në faza të hershme. Kontrolli i kancerit të gjirit gjithashtu është bërë më i disponueshëm në zonat rurale, pas avokimit nga gratë parlamentare dhe aktivistët e të drejtave të grave, dhe fushatat vjetore kanë rritur vetëdijesimin në lidhje me rëndësinë e kontrolleve të rregullta.

Si përmbledhje, ndërsa disa shërbime të kujdesit shëndetësor janë më shumë në dispozicion për gratë në dekadën e fundit dhe vetëdijesimi duket se është rritur në lidhje me rëndësinë e kujdesit shëndetësor parandalues, shumë gra ende nuk kanë qasje në kujdes shëndetësor cilësor, veçanërisht ato në zonat rurale dhe me aftësi të kufizuara.

Sigurimi i jetesës së grave

"Në traditën tonë gratë nuk trashëgojnë nga pasuria familjare dhe proceset e shkurorëzimit janë shumë të gjata. Ekzistojnë një varg pengesash në ndarjen e pronave dhe trashëgimisë familjare. Disa herë mendoj se është shumë keq që vazhdimisht duhet tu themi grave, 'Ju keni shumë mundësi në jetën tuaj,' sepse këta mekanizma nuk po funksionojmë mirë. Askush nuk mendon të krijojë apo ofrojë strategji afatgjate për të siguruar prosperitet të grave dhe mundësi të tjera."

- Violeta (Krasniqi) Rexha, Institucioni i Avokatit të Popullit, 2007

"Sot e pata një rast të një gruaje vërtetë shumë të fortë," tha Qosaj-Mustafa gjersa punonte për OSBE-në në vitin 2007:

> Ajo po lufton me vjehrrin e saj i cili i kërcënohej dhe unë i thashë asaj, "A do të kërkosh të drejtat tua pronësore?"
>
> Dhe ajo tha, "Po."
>
> "A je e sigurtë?" e pyeta sepse nuk dija çfarë t'i them më. Unë mund t'ia rrezikoj asaj jetën nëse do i thosha se duhet t'i kërkojë të drejtat e saj pronësore sepse vjehrri i saj mund ta vrasë atë. E dini, një grua që mund të vritet sepse kërkon ndarje të pronës në emrin e saj. Sepse ajo kërkon që t'i njihet kjo e drejtë. Por, ju nuk jeni edhe aq krenarë që e keni nxitur të kërkojë drejtësi sepse e dini se sjellja e dhunshme e burrave arsyetohet nga shoqëria. Gjykata dhe sistemi i drejtësisë janë shumë larg të qenit të vëmendshëm

> ndaj të drejtave të grave dhe të ndjeshëm ndaj të drejtave të grave.[327]

Në teori, gratë duhet të kenë të drejta të barabarta në punësim dhe asete familjare. Në praktikë kjo nuk ndodh. Një sistem kompleks shoqëror i normave, kushteve strukturore dhe ligjeve me zbatim të dobët i bëjnë gratë e Kosovës më të cenueshme nga varfëria dhe pafuqia e veprimit. Është e rëndomtë që prona i përket burrave dhe nuk mund të bartet apo të trashëgohet nga gratë. Gratë nuk kanë hipotekë për të aplikuar për kredi.

Mungesa e shkollimit dhe qasjes në tregun e punës, siç është diskutuar më herët, rritë shkallën e papunësisë në radhët e grave: 59.6 për qind, krahasuar me 42.7 për qind nga radhët e burrave që nga viti 2009.[328] Deri në vitin 2020, papunësia ishte ulur, por pabarazitë gjinore vazhduan (33.1 për qind në mesin e grave krahasuar me 21.5 për qind te burrat); për më tepër, nivelet e pasivitetit të grave mbetën dukshëm më të larta se te burrat, me vetëm afërsisht dy në dhjetë gra të punësuara. [329] Disa nga pabarazitë e njëjta strukturore vazhduan.

T'a shtjellojmë çështjen e pronës. Disa ligje përcaktojnë të drejtat e barabarta të gruas në pronë, por ka probleme me zbatimin, tha Valbona Salihu, juriste:

> Ligji përcakton se pasuria e përbashkët e bashkëshortëve duhet të regjistrohet në emrat e të dyve. Nëse njëri nga ta nuk e bën këtë, gjobat janë të larta. Por nuk cek se cili institucion duhet ta zbatojë këtë, apo përmes cilit mekanizëm mund të parashtrohen ankesa. Ky është një vakum ligjor.[330]

Ligji për Trashëgimi i Kosovës respekton standardet ndërkombëtare ashtu që prona e trashëgimtarit të vdekur duhet të ndahet në mënyrë të barabartë nga trashëgimtarët.[331] Ligji e saktëson barazinë në kuptim të "vëllezërve dhe motrave" dhe në shumicën e pjesëve të tij ka qasje të ndjeshme

gjinore.[332] Pabarazitë shfaqen gjatë procesit të parashtrimit të kërkesës si trashëgimtar. Procedurat e trashëgimisë duhet të parashtrohen nga trashëgimtari(ët). Përderisa ligji i jep të drejtë trashëgimtareve gra që të parashtrojnë kërkesa njëlloj sikurse burrave, normat kulturore sugjerojnë se trashëgimtarja grua me rast të parashtrimit të kërkesës "i merr hise" vëllezërve dhe burrave të tjerë të afërm.[333] Vuniqi nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore ka hulumtuar këtë çështje:

> Ne i kemi pyetur gratë pse ato heqin dorë nga trashëgimitë e tyre familjare? Arritëm në përfundim se shumë prej tyre e bëjnë këtë për shkak të presionit social që shfaqet nga ligjet e pashkruara apo, të themi, nga zakonet tona kulturore. Ato do të thonin, "Kjo është mënyra se si duhet të jetë. Mua nuk më duhet trashëgimia e familjes sime. Ia kam lënë vëllait."

Siç vërejti një hulumtuese e RrGK-së në rajonin malor të Deçanit, ndërsa në vitin 2020 diskutonte me vajzat për nocionin e "sigurisë":

> Rreth njëzet vajza u mblodhën në sallën e Gjimnazit. Ishte shumë e vështirë për t'i inkurajuar ato të flasin. Ishin shumë të ndrojtura, por edhe të pamësuara të pyeteshin për paqen ose sigurinë. Përfundimisht, një vajzë pështpëriti në heshtje se e drejta e pronës do t'ia ofronte asaj siguri. Papritmas salla gumëzhiti nga vajzat e tjera që e kundërshtonin atë. Fjalën e mori Kryesuesja e Këshillit të Nxënësve. "Kurrë, kurrë nuk do të merrja pasurinë dhe trashëgiminë e vëllezërve të mi. Ajo u takon atyre dhe jo mua!" Ajo foli me krenari dhe vetëbesim, ndërsa vajzat e tjera pohonin me kokë në shenjë pajtimi.

Në të vërtetë, burrat ende përbëjnë shumicën e atyre që kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre në trashëgimi.[334] Në vitin 2016, vetëm 18 për qind e pronave të paluajtshme ishin në pronësi

të grave.[335] Edhe pse gjykatat duhet të kërkojnë praninë e grave gjatë procedurës, gratë vazhdojnë t'i nënshtrohen presionit për të mos parashtruar kërkesë. Edhe nga radhët e rasteve pronësore të monitoruara nga EULEX-i nuk është asnjë rast i vetëm që merrej me të drejtat e gruas në pronë, përkundër asaj që EULEX-i e ka ngritur zërin për këtë çështje.[336]

Në vitin 2020, Osmani Sadriu shpjegoi se normat shoqërore patriarkale ende pengonin zbatimin e kornizës ligjore:

> Në Kosovë, të drejtat e barabarta të grave në përgjithësi, si dhe në trashëgimi, garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Procedurën Jokontestimore, Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe Ligjin për Trashëgiminë. Edhe pse, ne kemi një kornizë të duhur ligjore, traditat dhe zakonet historike vazhdojnë të ndikojnë në ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve në Kosovë. Ligji ende lejon hapësirë, duke u dhënë mundësi palëve të bien dakord dhe duke u mundësuar heqjen dorë nga trashëgimia. Kjo rezulton në ndarjen e trashëgimisë kryesisht për trashëgimtarët burra, në përputhje me mentalitetin dominues patriarkal në shoqërinë tonë. Kjo konfirmohet me faktin se përafërsisht vetëm 16 për qind e pronave të regjistruara në Kosovë janë në pronësi të grave. Marrja minimale e trashëgimisë nga gratë gjithashtu rezulton nga mosnjohja e tyre e ligjit dhe kjo është pika në të cilën ne duhet të punojmë si institucione, së bashku me organizatat e shoqërisë civile, mediet dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm.[337]

Në të vërtetë, ka pasur një mori përpjekjesh në këtë drejtim me institucionet, organizatat për të drejtat e grave dhe aktorët ndërkombëtarë që organizojnë media, media sociale dhe fushata derë më derë, si dhe teatër forum dhe ndihmë

juridike falas për të rritur vetëdijesimin në lidhje me të drejtat e pronës dhe trashëgimisë të grave dhe për të ndihmuar gratë të pretendojnë këto të drejta. ABGJ, mbështetur nga avokimi i grupeve të të drejtave të grave, gjithashtu ka vendosur dhe ripërtërirë një Udhëzim Administrativ mbi Regjistrimin e Përbashkët të Pronave, i cili ka inkurajuar bashkëshortët të regjistrojnë bashkërisht pasurinë e tyre duke hequr dorë nga taksat dhe tarifat e lidhura me qeverinë. Disa aktorë gjithashtu kanë punuar me noterë dhe gjykata. Përkundër këtyre përpjekjeve të shumta, statistikat dhe tregimet nga vendet si Deçani ilustrojnë se pronësia e barabartë dhe të drejtat e trashëgimisë për gratë mbeten një ëndërr e largët.

Gratë që kanë humbur familjarë gjatë luftës, apo të cilët ende janë të zhdukur, janë përballur me probleme shtesë në kërkimin e të drejtave të tyre në pronë. Veprore Shehu nga organizata Medica Kosova e cila mbështetë gratë me burra të zhdukur për të kërkuar pronën e tyre, theksoi se "ekzistojnë disa procedura që duhet t'i ndjekin para se të t'i gëzojnë këto të drejta. Ato është dashur t'i raportojnë burrat e tyre si të vdekur." Procedura e shpalljes së bashkëshortit të vdekur jo vetëm që është psikologjikisht e dhimbshme, por shpeshherë edhe nuk pranohet mirë nga familja e bashkëshortit. Pa pronë dhe shpeshherë pa punësim, gratë mbështeten te këta familjarë për të mbijetuar. Kundërshtimi i dëshirave të tyre mund t'ua prishë këtyre grave atë siguri të pakët të jetesës që e kanë.

Pozita e pafavorshme ekonomike e grave mund të kontribuojë në dhunë ekonomike, ku abuzuesi shfrytëzon mjetet monetare për të kontrolluar një familjar.[338] Banorët e papunë të viseve rurale me shkollim të ulët kanë pasur më shumë gjasë të përjetojnë dhunë ekonomike.[339] Duke mos pasur askënd për t'u mbështetur, ato më së shumti kanë nevojë për shërbime mbështetëse për jetesë, sipas përkufizimit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, siç janë punësimi i përkohshëm i grave "në kontekst të programeve të hershme të rimëkëmbjes ekonomike."[340] Mbështetja nga agjencitë e OKB-së është menduar t'i mbrojë gratë dhe vajzat nga një rrezik i

caktuar. Kur janë pyetur se çfarë proporcioni të buxheteve të tyre është ndarë për çështje të barazisë gjinore, organizatat e shoqërisë civile, respektivisht nga Fondet e Mirëbesimit të Donatorëve për çështje të barazisë gjinore, sipas treguesve të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, agjencitë e OKB-së në Kosovë nuk kanë pasur informata të sakta në dispozicion.

Ndërsa shpenzimet e sakta nuk mund të gjurmohen, siç u diskutua më vonë, një mori programesh ekonomike të rimëkëmbjes me vëmendje ndaj grave kanë ekzistuar në Kosovë, të mbështetur nga agjencitë e OKB-së, BE-së, vendeve anëtare të BE-së dhe qeverisë së SHBA, ndër të tjera. Në vitet e fundit, Qeveria e Kosovës ka filluar ngadalë të caktojë disa fonde për adresimin e nevojave ekonomike të grave gjithashtu. Organizatat e grave që punojnë në zonat rurale kanë shënuar një rritje të subvencioneve shtetërore për gratë në bujqësi dhe tregti.[341] Edhe pse gratë akoma marrin më pak subvencione shtetërore sesa burrat, pjesërisht sepse ato zotërojnë më pak biznese, mund të vërehet një progres i lehtë.

Sekretari i përgjithshëm i OKB-së sugjeron monitorimin e ndarjeve financuese të rimëkëmbjes dhe ndërtimit të paqes për të vlerësuar "prioritetin relativ të dhënë për fuqizimin e gruas dhe barazinë gjinore." Ai ka prezantuar një varg masash sasiore për të treguar nivelin në të cilin "nevojat e grave dhe vajzave, posaçërisht të grupeve të cenueshme (personave të zhvendosur brenda vendit, viktimave të dhunës seksuale apo dhunës në familje, ish luftëtarëve, refugjatëve, të kthyerve) janë trajtuar në programet e asistencës, rimëkëmbjes së hershme dhe rimëkëmbjes ekonomike."[342]

Qysh në vitin 2011, përfaqësues të agjencive të ndryshme të OKB-së ia atribuuan mungesën e të dhënave për këta tregues një numri faktorësh. Pikësëpari, treguesit e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së ishin të rinj atëherë dhe agjencitë nuk kishin mbajtur të dhëna të ndara sipas gjinive gjatë dekadës së fundit. Së dyti, ata nuk kanë pasur tendencë të kenë programe apo projekte specifike lidhur me çështjet e barazisë gjinore. Në vend të kësaj, ata kanë shfrytëzuar "perspektivën gjinore", integrimin e aspektit gjinor në

programet e tyre. "Fakti se nuk mund të themi me saktësi sa shpenzojmë në programimin gjinor është shenjë positive sepse nënkupton se e kemi integruar atë në të gjithë programimin," tha Calestini në UNICEF në vitin 2011.

Edhe me perspektivë të tillë gjinore, grumbullimi i të dhënave të ndara sipas gjinive është i rëndësishëm për të kuptuar se në çfarë mënyre të ndryshme këto programe kanë ndikim te gratë dhe burrat. Gjurmimi i agjencisë së OKB-së për shpenzimet në gratë dhe vajzat në Kosovë ka qenë po ashtu i vështirë sepse Përfaqësuesi Rezident i OKB-së nuk ka pasur mandat t'i gjurmojë të gjitha sistemet financiare të agjencive të OKB-së.[343] "Ne i kemi 21 agjenci të OKB-së aktive në Kosovë me mandate të ndryshme, [dhe] të gjitha me mekanizma vetjake të raportimit," tha Këshilltarja Gjinore e UNDP-së, Talbot. Mbajtja e llogarive duket se është përmirësuar në vitin 2011, pas futjes së sistemit të markerëve gjinorë në 2010 në UNDP. Talbot shpjegoi se markerët gjinorë nuk mund të matin saktësisht buxhetin, por ato mund të tregojnë progresin. Markeri gjinor, i obligueshëm për të gjithë projektet e UNDP-së, tregon se në çfarë niveli janë integruar dimensionet gjinore në të gjitha fazat e një projekti të caktuar. Markeri sugjeron se UNDP ka përmirësuar performancën e saj në integrimin e dimensioneve gjinore në projektet e saj.[344] UNDP-ja në Kosovë monitoron edhe buxhetin vjetor për të siguruar se fondet ndahen për rezultate të barazisë gjinore, tha Talbot.

Ndërmjet viteve 1999 dhe 2019, UNDP Kosova raportoi se kishte shpenzuar 8.2 milion në programe që përqendroheshin në barazinë gjinore. [345] Siç shpjeguan përfaqësuesit e UNDP-së në një intervistë në vitin 2020, "Byroja e Ndërtimit dhe Rimëkëmbjes së Paqes (BCPR) nën UNDP rekomandon ose kërkon që të gjitha zyrat e vendit të ndajnë 15 për qind të shpenzimeve për integrimin gjinor". Në të vërtetë, qëllimi strategjik i UNDP është:

> që përfundimisht të arrihet caktimi i 15 për qind të të gjitha buxheteve të programeve dhe projekteve të vendit për avancimin e barazisë gjinore dhe/ose

> fuqizimin e grave [ku] barazia gjinore dhe fuqizimi i grave është [një] objektiv kryesor.[346]

Kjo sygjeron keqkuptime të vazhdueshme në lidhje me ndryshimin midis programeve specifike gjinore dhe ato të integruara gjinore dhe rëndësinë e caktimit të fondeve për këtë të fundit, sipas qëllimeve strategjike të vetë UNDP-së.

Përkundër njohjes në rritje të rëndësisë dhe zotimeve për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor nga OKB-ja[347], ndër të tjera, praktika e programeve të integrimit gjinor ka vazhduar të turbullojë shpenzimet aktuale për gratë, vajzat dhe barazinë gjinore, duke pasur parasysh mungesën e sistemeve të menaxhimit adekuat të të dhënave për përcjelljen e këtyre shpenzimeve. Ndërsa sistemi i përmirësuar i markerit gjinor i agjencive të OKB-së mundëson gjurmimin e financimit për programe të përqendruara posaçërisht në avancimin e barazisë gjinore, ai nuk gjurmon shpenzimet e sakta në programet ku gjinia ka qenë e integruar, e cila përbën pjesën më të madhe të këtij programi. Kështu, edhe në vitin 2020, nuk ka ekzistuar asnjë llogari e saktë e shpenzimeve në lidhje me treguesit e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.

Disa programe të UNDP-së janë përqendruar vetëm në çështje të barazisë gjinore. "Nisma e Sigurisë së Gruas bëhet 100 për qind në baza gjinore," tha Nazlie Bala e cila ka menaxhuar këtë nismë.[348] Ky program ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe organizatave të grave në hulumtimin e dhunës në familje, hartimin e politikave të bazuara në dëshmi, krijimin e planprogramit trajnues për policë dhe gjyqtarë për dhunën në familje, si dhe mbyllja e vakumeve të financimit të strehimoreve. Agjencitë e OKB-së kishin programe të përbashkëta vijuese për të adresuar dhunën me bazë gjinore duke vazhduar t'i ndihmojë kapacitetet institucionale për adresimin e dhunës, përfshirë përmes krijimit të mekanizmave koordinues në komunat e synuara.

Programet si "Ushqimi për Punë" nuk janë ofruar në Kosovë dhe ne jemi munduar të identifikojmë programe që

ofrojnë punësim të përkohshëm për gratë.[349] Megjithatë, ka pasur disa projekte që synonin përmirësimin e gjendjes së vështirë ekonomike të gruas.[350] Për shembull, projekti i financuar nga BE-ja, Kosova e Bukur, në vitin 2010 ka ndarë pesë milionë euro për uljen e varfërisë dhe luftimin e papunësisë te grupet e margjinalizuara, duke përfshirë gratë, më 2010.[351] Në mungesë të një qeverie për shpërndarjen e ndihmave, Banka Botërore mbështeti Fondin për Zhvillim të Komunitetit (CDF), një OJQ lokale, ka shpërndarë fonde për organizatat dhe projektet e grave, por kjo përbënte vetëm pesë për qind të fondeve të CDF-së gjatë 1999 dhe 2002.[352]

Në dekadën e fundit, UNDP në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës ka përmirësuar synimin e saj ndaj grave përmes programeve të saj aktive të tregut të punës. Siç u përmend, disa programe të tjera të mbështetura ndërkombëtarisht kanë kërkuar të përmirësojnë pozitën ekonomike të grave.

Në vitin 2011, BE-ja nuk kishte pasur programe specifike gjinore. Kjo gjë ka ndryshuar. Programet e BE-së që nga atëherë kanë kërkuar që të ndihmojnë angazhimin e grave në politikë, të fuqizojnë gratë në shoqërinë civile, të adresojnë dhunën me bazë gjinore dhe të rrisin të drejtat e njeriut të grave. Posaçërisht që nga miratimi i Planit të BE-së për Veprim Gjinor II në vitin 2015, BE ka rritur përpjekjet e saj për të siguruar që të gjitha programet e saj janë orientuar nga gjinia, drejt përmbushjes së synimit të BE-së që 85 për qind e programeve të saj të kontribuojnë në barazinë gjinore. Përmes një numri të madh të programeve arsimore dhe ekonomike, BE-ja ka kërkuar të sigurojë që gratë të përfitojnë dhe ka marrë disa masa afirmative për të adresuar pabarazitë ekzistuese gjinore. Fatkeqësisht, sistemet e gjurmimit të të dhënave të BE-së në mënyrë të ngjashme nuk mundësojnë kontrollimin e shpenzimeve precize për programet që përfshijnë integrimin gjinor.

Disa aktorë të tjerë, veçanërisht ShBA-të dhe vendet anëtare të BE-së, gjithashtu kanë rritur përpjekjet e tyre për përfshirjen gjinore dhe programimin e përqendruar në gjini,

duke kërkuar madje që kontraktuesit të përfshijnë objektiva drejt barazisë gjinore në programet e tyre. Rogova vërejti:

> Shikoni shembullin e donatorëve të tjerë të mëdhenj në Kosovë si Agjencia Austriake e Zhvillimit dhe Agjencia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar. Ata po… shtyjnë të tjerët që nuk janë organizata për të drejtat e grave për të zbatuar gjininë në programet e tyre. Për mua, ky është një ndryshim Shumë *i madh*, për të parë se si tani kemi organizata që kurrë nuk kanë punuar në lidhje me gjininë që tani duhet të përfshijnë gjininë në programet e tyre. Për mua, ky është një ndryshim i madh dhe një dallim i madh.[353]

Për më tepër, financues si Agjencia Austriake për Zhvillim dhe BE-ja kanë njohur ekspertizën që posedojnë organizatat për të drejtat e grave, duke i kontraktuar ato për të mbështetur integrimin e një perspektive gjinore dhe qasje të mëtejshme transformuese gjinore në programet e tyre, si dhe ato të kontraktuesve të tyre. Kjo ka pasur vlerën e shtuar të institucionalizimit të angazhimit të grupeve për të drejtat e grave në programimin e zhvillimit, siç parashikohet me Rezoluta 1325 dhe Planin II të BE-së për Veprim Gjinor. Për më tepër, ajo ka mbështetur financiarisht grupet shpesh të nën-financuara për të drejtat e grave, duke i kompensuar ato për ekspertizën e tyre.

BE-ja, UN Women, Fondacioni Kvinna till Kvinna, Rrjeti STAR i Mësimit Botëror dhe qeveri të ndryshme të huaja kanë mbështetur organizatat e grave financiarisht gjatë dy dekadave të fundit. Ndoshta fondi më i madh që kishte gratë për cak në Kosovën e pasluftës së menjëhershme ishte Nisma e Grave të Kosovës (KWI), projekt i drejtuar nga UNHCR dhe i financuar nga SHBA-të, që ndihmonte gratë e prekura nga lufta.[354] Ai ishte modeluar pas projekteve të ngjashme në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Ruandë, tha aktivistja Ahmeti:

> 10 milionë dollarë janë dhënë për organizatat e grave. Një herë ishte Nisma e Grave të Ruandës, dhe tani AWI në Afganistan. Kush i shpenzoi ato para? Ishin organizatat ndërkombëtare, jo organizatat e grave. Ato shkuan në kurse të rrobaqepësisë, floktarisë dhe kompjuterëve, paga të ulëta dhe asnjë vend të punës. Sepse nëse jeni ekonomikisht të pavarur, jeni të lirë.[355]

Aktivistet e të drejtave të grave theksuan se sasia më e madhe e parave shkonte tek organizatat ndërkombëtare të kontraktuara nga UNHCR për drejtimin e programit, jo te gratë kosovare. Ahmeti, mes tjerash, tha se organizatat ndërkombëtare kishin tendenca t'i homogjenizojnë gratë në ndihmën e tyre, duke dështuar të përkujdesen për nevojat e ndryshme të grave apo të pranojnë se Kosova ka lidere gra të arsimuara e të afta.

Aktivistet gjithashtu shprehën shqetësime se grantet e vogla të KWI-së për organizatat e grave, sikurse shumë projekte të financuar nga donatorët në Kosovë, nxitën gratë që të merren me aktivitete shërbyese si qepja dhe floktaria, ku kishte treg minimal për produktet e tyre dhe shumë pak fitim për ta përmirësuar gjendjen e tyre të varfërisë. Në të vërtetë vlerësimi i jashtëm i KWI si një nga projektet me "gjenerimin më të madh të të hyrave" që kishte për cak gratë gjeti se "proporcioni i projekteve profitabile (apo madje ato nuk kishin humbje) projektet e gjenerimit të të hyrave të KWI-së pësuan rënie nën 30 për qind."[356] Hulumtimet e mëvonshme gjetën se disa nga këto biznese ende ekzistonin, ndonëse ata kishin siguruar disa të ardhura për disa gra dhe familjet e tyre në kontekst të pasluftës së menjëhershme.[357] Financimi i KWI u pakësua shpejtë nga 400,000 dollarë në vitin 2001 në më pak se 28,000 dollarë në vitin 2004. "Kjo rënie ndodhi në të njëjtën kohë kur ulja e burimeve tjera të financimit nuk ishte e baraspeshuar me rritje të fondeve për OJQ-të nga buxheti i Kosovës," sipas UNDP-së.[358]

Financimi në dispozicion menjëherë pas luftës u pakësua me kalimin e kohës dhe u bë gjithnjë e më i vështirë

për t'u siguruar nga grupet e grave. "Kishte gjithnjë e më pak fonde për gratë," tha Macula nga UN Women në vitin 2011. Pjesëmarrësit e tjerë në hulumtim, si Qosaj-Mustafa më 2011, thanë se mbrojtja e të drejtave të grave thjeshtë nuk është prioritet për donatorët:

> Shoqëria civile vazhdimisht është duke humbur mbështetje financiare. Ka gjithnjë e më pak fonde për gra. Fondet për të drejtat e grave janë në fund të listës së prioriteteve të donatorëve. Nëse bisedoni me donatorët, ata deklarojnë se nuk e konsiderojnë këtë detyrë të rëndësishme.[359]

Konkurrenca për fonde dhe ndryshimi i sistemeve nënkuptonte se disa gra ishin të "suksesshme" në aplikim ndërsa disa të tjera nuk ishin. Kur janë pyetur në vitin 2011 nëse aftësia e grave për të aplikuar për fonde ka ndryshuar me kalimin e kohës,[360] Macula pohoi:

> Po, natyrisht. Krahasuar me fillimin, ju lutem... Formularët dhe metodologjitë po ndryshojnë. Tani çdo qeveri, apo donator, kërkon rezultat të bazuar në menaxhim. Më parë ishte më ndryshe. Në rastin tonë ne jemi munduar t'i ngrinim kapacitetet e atyre që janë më të dobët, siç janë organizatat serbe dhe organizatat nga qytetet e vogla, duke ofruar trajnime për rezultate në bazë të menaxhimit. Megjithatë, sigurimi i fondeve të BE-së është shumë, shumë i vështirë. Njerëzit thonë se është sikur të shkruash një disertacion. Prandaj, nuk mendoj se donatorët janë duke iu përgjigjur kapacitetit të grave, posaçërisht organizatave më të vogla.[361]

Organizatat më të avancuara të grave i janë përshtatur klimës së ndryshuar të donatorëve dhe janë më të suksesshëm në aplikim për financim, tha ajo, por financimi po pëson rënie të shpejtë dhe është i pamjaftueshëm.

Rrymat filluan të ndërrojnë drejtimin në vitet e fundit, me organizatat për të drejtat e grave që raportuan një rritje në financim, me të ardhurat mesatare vjetore që u rritën nga 1,630 euro në 2010 në 5,000 euro në vitin 2018.[362] Një zhvillim i rëndësishëm ishte themelimi i RrGK-së i Fondit të Grave të Kosovës në vitin 2012, i cili në mënyrë eksplicite u përpoq të adresonte fondet e sipërpërmendura të tkurrjes në dispozicion të grupeve për të drejtat e grave dhe të fuqizonte grupet që nuk mund të merrnin fonde më të mëdha. Ajo i ka dhënë përparësi financimit të personave më të rrezikuar dhe të margjinalizuar, përfshirë grupet që punojnë me të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, gratë rurale dhe të mbijetuarit e dhunës. Qasja unike e Fondit ka bashkuar financimin me zhvillimin e përshtatur të kapaciteteve për organizatat në mbledhjen e fondeve, shkrimin e propozimeve të projekteve, menaxhimin organizativ, menaxhimin financiar transparent dhe marrëdhëniet me publikun, duke transferuar aftësi të reja që u kanë mundësuar organizatave të sigurojnë fonde nga burime të tjera, përfshirë Qeverinë. Ndërmjet viteve 2012 dhe 2019, Fondi ka dhënë 197 grante për 107 organizata për të drejtat e grave, që arritën shumën më shumë se një milion euro.[363] Ndërsa disa organizata janë ende duke luftuar për të mbijetuar, ekzistojnë mundësi që ato të kenë qasje në fonde dhe mbështetje.

KONKLUZIONET

"Shefi i ri i EULEX-it Xavier Bout de Marnhac ka premtuar se do të sigurojë zbatimin e Rezolutës 1325. Shpresoj se ky premtim do të realizohet. Po, EULEX-i është këtu për t'a monitoruar qeverinë tonë, ndërsa ne jemi këtu për t'a monitoruar EULEX-in."

- Igballe Rogova, fjalimi në përvjetorin e Rezolutës 1325, 31 tetor 2010

"Deri në ç'masë mendoni se është zbatuar Rezoluta 1325 në Kosovë këto dhjetë vitet e fundit?", ishte pyetja që e parashtruam në vitin 2011. Konsensusi i përgjithshëm në atë kohë ishte i qartë: pak nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e Rezolutës 1325 e kanë bërë këtë. "Madje as ndërkombëtarët nuk kanë arritur ta zbatojnë rezolutën, lëre më Kosovarët," pohoi aktivistja Muharremi.

Përderisa organizatat ndërkombëtare jo gjithmonë mund ta kenë zbatuar Rezolutën vetë, prania dhe ndonjëherë presioni i tyre ka pasur një ndikim pozitiv në institucionet e Kosovës. "Mjedisi socio-politik në Kosovë me praninë e tij të madhe ndërkombëtare në kombinim me dëshirën kosovare për t'u provuar ndërkombëtarëve se ne jemi të aftë si shtet kanë qenë motivues të shkëlqyeshëm në lidhje me zbatimin e vitit 1325," tha ish-Drejtori i Policisë Selimi. Shqipe Krasniqi, ish-drejtuese në detyrë e ABGJ-së, u pajtua se nuk ishin ndërkombëtarët, por shpresat e kosovarëve për integrim në BE dhe OKB ato që inkurajuan institucionet vendase të ndërmarrin hapa drejt zbatimit të Rezolutës

Korniza ligjore e Kosovës, që kryesisht është në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare, paraqet bazën për integrimin e barazisë gjinore, në kuptim të zbatimit të

Rezolutës 1325. Kushtetuta përfshin edhe konventën CEDAW dhe tani edhe Konventën e Stambollit. Kuvendi e ka miratuar Kodin Penal, Ligjin kundër Diskriminimit, Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Ligjin për Barazinë Gjinore, që parashikon barazinë në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Kodi Penal është ndryshuar për të trajtuar më shumë forma të dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje si një vepër e veçantë penale. Gratë që pësuan dhunë gjatë luftës janë njohur ligjërisht dhe tani marrin përfitime. Procedurat standarde të funksionimit kanë përmirësuar koordinimin ndërinstitucional në adresimin e dhunës në familje dhe trafikimit seksual. Masat afirmative kanë kërkuar të rrisin pronësinë e grave në pronë dhe disa organe qeveritare kanë ndërmarrë disa përpjekje, megjithëse ende të pamjaftueshme, për të mbështetur fuqizimin ekonomik të grave.

Në mesin e këtyre arritjeve, edhe sot, "zbatimi i ligjeve është më problematik se sa miratimi i tyre," siç tha zyrtari Kajtazi në vitin 2011. Normat shoqërore, traditat, kushtet e dobëta ekonomike, alokimet e pamjaftueshme buxhetore dhe institucionet e dobëta, kushtëzojnë zbatimin sistematik të legjislacionit ekzistues, të ilustruar nga qasja e kufizuar e grave në pronë, hezitimi për të kërkuar të drejtën në trashëgimi, lufta për të kërkuar kujdestarinë e fëmijëve, mbrojtja e pamjaftueshme nga dhuna në familje dhe qasja joadekuate në drejtësi për krimet e kryera. Qëndrueshmëria e dhunës në familje, pabarazia ekonomike midis grave dhe burrave dhe nën-përfaqësimi i vazhdueshëm i grave në vendimmarrjen politike në të gjitha nivelet janë dëshmi se Rezoluta 1325 është larg zbatimit të plotë.

Në fund, zbatimi i Rezolutës 1325 kërkon një ndryshim në pikëpamjet e njerëzve dhe institucioneve. "Vështirësitë lindin nga mentaliteti këtu, në të cilin burri është gjithmonë dominues dhe profesionet që kanë të bëjnë me forcën fizike shihen si profesione tipike të burrave," tha Selimi. "Ky mentalitet ekziston gjithashtu në botën perëndimore por ata kanë frikë t'a tregojnë atë hapur." Ndërsa qëndrimet e tilla kishin filluar të ndryshonin një dekadë më vonë, patriarkati

mbeti pengesë për pjesëmarrjen e barabartë të grave në politikë, në forcat e sigurisë, në adresimin adekuat të dhunës në baza gjinore dhe në sigurinë e grave, duke minuar kështu zbatimin e Rezolutës 1325.

Megjithëse është bërë një përparim i konsiderueshëm drejt zbatimit të Rezolutës 1325, më shumë mbetet për t'u bërë, ishte konkludim i përsëritur gjatë vitit 2020. Përmbledhja e Këshiltares Gjinore, Thais Santa Cruz, ishte ilustruese:

> Agjenda 1325 ka fituar gjithnjë e më shumë mbështetje nga bashkësia ndërkombëtare si dhe nga vendet individuale, dhe kjo është reflektuar në zbatimin e saj të përgjithshëm. … Sipas mendimit tim, ishin të nevojshme përpjekje të vazhdueshme për të arritur dhe siguruar zbatimin e plotë të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së në të gjithë botën, dhe Kosova nuk është përjashtim. Ka pasur shumë përpjekje nga sektorë të ndryshëm të shoqërisë për ta çuar përpara zbatimin e saj, duke përfshirë, për shembull, kërkime dhe analiza të shumta që hedhin dritë në sfidat me të cilat përballen gratë në realizimin e plotë të të drejtave të tyre dhe në zbatimin e Agjendës së Grave, Paqes dhe e Sigurisë, si dhe legjislacioni i vendosur për adresimin e këtyre çështjeve. Por prapë është çështja e zbatimit. Sepse, pavarësisht nga të gjitha studimet që pasqyrojnë fushat specifike në të cilat kërkohen përpjekje, dhe pavarësisht nga të gjitha legjislacionet dhe politikat në fuqi për të përparuar të drejtat e grave, nuk ka asnjë ndryshim të vërtetë nëse nuk ka një angazhim në nivelet më të larta dhe vullnet politik për të ndryshuar gjërat . Edhe pse ka pasur progres në këtë fushë, mbetet ende një rrugë e gjatë për t'u bërë.

"Në Bullgari e kemi një proverbë që thotë: 'Pesë gjyshe e fëmija i sëmurë', që do të thotë se mund të jemi të shumtë në numër, por pa koordinim të mirëfilltë dhe pa ndarje

adekuate të punëve, disa çështje mund të harrohen," theksoi Krumova, ish-pikë qendrore gjinore. "Tradicionalisht, gjyshet janë ato që kujdesën për fëmijët, por kur ka tepër gjyshe kjo mund të jetë kundër-produktive. Dikush mund të mendojë 'Në rregull është se katër gjyshet tjera do të kujdesen për të." Fakti se në Kosovë kemi disa 'gjyshe', që nga UNMIK-u, EULEX-i e deri tek institucionet e Kosovës dhe KFOR-i...mund të bëjë që askush të mos merr përgjegjësinë për zbatimin e Rezolutës 1325. Në disa raste, përgjegjësitë janë thënë se 'janë mandat i dikujt tjetër', ndërsa në raste tjera ka pasur konkurrencë dhe dyfishim të punës lidhur me 'pronësinë' mbi disa aktivitete të caktuara. Një aktiviste reflektoi:

> Koordinimi është gjithmonë sfidë ... Unë kam vërejtur kur kjo funksionon mirë dhe kur jo. Ka pasur një bashkëpunim më të mirë midis organizatave ndërkombëtare, Qeverisë dhe shoqërisë civile. Unë e shoh këtë si një trend, dhe ka ndryshuar për të mirë. Shumë njerëz e kanë parë [zbatimin e Rezolutës] si një projekt të përbashkët. Një shembull konkret… puna për të drejtat e të mbijetuarve 'me të vërtetë kërkoi përpjekje të përbashkët nga të gjithë: autoritetet lokale, shoqëria civile dhe aktorët ndërkombëtarë. Asgjë nuk do të kishte ndodhur pa atë mbështetje të gjerë. Gjithashtu, ndryshimi i kodit penal dhe futja e dhunës në familje si një vepër penale ishte një shembull i një përpjekjeje të përbashkët ku të gjithë bashkuan burimet e tyre dhe arritën ta ndryshonin atë. Kjo zhvendos dinamikën e energjisë. … Ju duhet të krijoni një masë kritike për ndryshim, dhe kjo funksionoi.

"Trekëndëshat" e tillë të bashkëpunimit midis aktorëve ndërkombëtarë, shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare u përmendën në mënyrë të përsëritur si një faktor kryesor që kontribuon në ndryshim. Ndërtimi i aleancave të forta mund të krijojë një "masë kritike" të aftë të sfidojë edhe normat më të

gdhendura gjinore, dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në zbatimin e Rezolutës 1325. Për shembull, UNICEF bashkëpunoi me organizatat e grave dhe Qeverinë për të përmirësuar qasjen e vajzave dhe grave në arsim. UNFPA punoi me organizatat dhe institucionet e grave për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje, shëndetin e mëtejshëm riprodhues dhe trajnimin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor. UNIFEM (më vonë UN Women), UNDP dhe Policia e UNMIK-ut u bashkuan me aktivistët e të drejtave të grave për të mbështetur policinë dhe forcat e sigurisë në institucionalizimin e barazisë gjinore, këshilltarja për çështje gjinore e policisë Stroosnijder tha: "Kam kërkuar bashkëpunim të ngushtë me rrjetin lokal të grave dhe UN Women në Kosovë. Pa ata, asgjë nuk do të kishte ecur përpara ose nuk do të ishte mbështetur! " Më shumë gra në zbatimin e ligjit dhe trajnime më të mira e kanë bërë policinë dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës të ndjeshme ndaj parimeve të Rezolutës 1325. UNDP, ABGJ-ja dhe RrGK-ja bashkëpunuan për hulumtime thelbësore bazë mbi dhunën në familje në vitin 2008; bazuar në këtë, ato u bashkuan me institucione të ndryshme, aktorë të shoqërisë civile dhe financues për të hartuar ligje dhe strategji për të adresuar dhunën dhe më pas monitoruan vazhdimisht zbatimin e tyre me kalimin e kohës. Ndonëse ishin ende të kufizuara, të drejtat e pronës së grave janë rritur falë bashkëpunimit midis ABGJ-së, grupeve të të drejtave të grave dhe financuesve të ndryshëm ndërkombëtarë.

Progresi i lidhur ngushtë, shpesh ka ndodhur të jetë rrjedhojë e avokimit të grave. "Shumë gjëra nuk janë zbatuar, por shumë janë zbatuar dhe shumica prej tyre kanë qenë rrjedhojë e punës së shoqërisë civile," thotë ish-këshilltarja për çështje gjinore Hutchinson në vitin 2007. "Për asnjë moment nuk kam qenë e mendimit se zyra jonë është duke ndryshuar shoqërinë në Kosovë. Unë mendoj se shoqëria civile ka arritur ndryshime." "RRGK paraqet një shembull të mirë të kësaj," pohoi Krasniqi nga ABGJ. "Ato e krijuan sloganin për Rezolutën 1325 i cili u shndërrua në një slogan tejet i fuqishëm." Dhjetë vjet më vonë, Thais Santa Cruz pranoi: "meritë e veçantë i

takon avokimit dhe veprimeve konkrete të shoqërisë civile dhe organizatave të grave, të cilat kanë udhëhequr të gjitha përparimet në disa fusha". Siç vërejti Lina Andeer:

> Kosova është shembull se si organizatat për të drejtat e grave kanë përfituar nga ky dokument politikash. Ju keni një rrjet të gjerë të aktivisteve për të drejtat e grave dhe kjo ishte e dukshme. Kur shkuat në një fshat dhe njerëzit atje flasin për 1325, kjo do të thotë se ka pasur një informim dhe mobilizim jashtëzakonisht të gjerë. … Ka mijëra rezoluta të OKB-së, por arsyeja pse Rezoluta 1325 u bë e njohur dhe e dobishme është *sepse* ajo u përdor nga aktivistet. Kosova është një shembull shumë i mirë i kësaj në atë që kishte një masë kritike të organizatave të grave që e përdorin atë dhe avokojnë ndryshimin. Kosova është një rast i veçantë.

Me të vërtetë, aktivistet për të drejtat e grave përdorën Rezolutën në avokimin për ndryshimet ligjore, strategjitë drejt barazisë gjinore krijimin e Agjencisë për Barazi Gjinore në nivelin më të lartë, angazhimin e grave në politikë, dhe për pjesëmarrjen e grave në negociata për statusin politik të Kosovës dhe me Serbinë. Pasi që gratë nuk u përfshinë në negociata, Koalicioni Paqësor i Grave dhe Lobi Rajonal i Grave kërkuan që zërat e grave të dëgjohen. Pas avokimit të fuqishëm të tyre, deri në vitin 2011 Edita Tahiri udhëhoqi ekipin e Kosovës në Dialogun me Serbinë dhe Atifete Jahjaga u zgjodh Presidente e Republikës. Megjithatë, edhe me gratë udhëheqëse kaq të forta në krye, të shoqëruara me avokimin e organizatave për të drejtat e grave, zërat dhe nevojat e grave kanë pasur përfaqësim jashtëzakonisht të kufizuar në negociatat e paqes.

"Është faktori njeri," deklaroi Macula nga UN Women. "Kur keni një person të gabuar në pozitë të gabuar dhe në kohë të gabuar – kjo kushton shumë." Udhëheqja adekuate e bëri ndryshimin, dëgjonim vazhdimisht. Më herët, Lesley Abdela

kërkoi pjesëmarrjen e grave kosovare në vendimet që janë marrë nga UNMIK-u dhe OSBE-ja; Ambasadori Chowdhury, Ambasadori Zhbogar, Papadopoulou, Lunacek dhe von Cramon ndërmorën iniciativën për t'u takuar rregullisht me gratë udhëheqëse; Behar Selimi, Atifete Jahjaga, Hysni Shala, dhe Tahire Haxholli avokuan për integriming e çështjeve gjinore dhe sistemet e përmirësuara në polici; ndërsa Besim M. Kajtazi, Drejtor i Departamentit për Drejta të Njeriut, shqyrtoi me kujdes tërë legjislacionin: "Perspektiva gjinore nuk është prioritet në shoqërinë tonë, por, për mua ajo ishte tejet interesante," tha ai, "unë ndihesha i obliguar që t'i hartoj aktet ligjore që kanë të bëjnë me barazinë gjinore."

Në të vërtetë, "shpesh ndodh që burrat të jenë më bindës në kërkimin e barazisë gjinore," shtoi Lubrani, "posaçërisht para burrave të tjerë, sepse dinë t'i anashkalojnë barrierat dhe të shpjegojnë se nuk flitet për gratë kundër burrave, por për status të barabartë të grave me burrat, me qëllim të arritjes së një situate më të mirë për tërë shoqërinë, përfshirë edhe burrat. Ne kemi sot dëshmi se përkrahja e barazisë gjinore përshpejton agjendën zhvillimore të çdo vendi. " Rogova pajtohet me këtë, "ne gratë nuk mund të shtyjmë vetë agjendën gjinore. Për këtë arsye, ne punojmë me burrat. Kjo ka rezultuar me ndryshime në Kosovë." Udhëheqja e përbashkët e burrave dhe grave mund të rezultojë me anashkalimin e shumë pengesave të mëdha për zbatimin: mungesës së koordinimit, burokracisë hierarkike dhe faktit se barazia gjinore ende nuk është institucionalizuar tërësisht, ashtu siç kërkohet me Rezolutën 1325 dhe me ligjet e Kosovës.

Thais Santa Cruz shtoi:

> Duke thënë këtë, kontributi më i madh ka ardhur nga vetë gratë. Gratë janë bashkuar nga dhe brenda sektorëve të ndryshëm të shoqërisë për të çuar përpara një agjendë që është shumë e vështirë për t'u zbatuar. Atifete Jahjaga nuk ishte vetëm Presidentja e parë femër e Kosovës, por ajo punoi vazhdimisht për të vizualizuar dhunën seksuale lidhur me konfliktin dhe

> për të mbështetur të mbijetuarit; Edita Tahiri ishte negociatorja kryesore e Kosovës në dialogun e Brukselit nga viti 2014 deri në vitin 2017 dhe ishte në gjendje të siguronte disa marrëveshje; Vasfije Krasniqi Goodman iu drejtua Kuvendit të Kosovës dhe foli për përvojën e saj si një e mbijetuar e dhunimit; Vjosa Osmani Sadriu është Kryetarja e parë grua në Kuvendin e Kosovësi; Luljeta Aliu paditi Policinë e Kosovës për diskriminim të bazuar në gjini. Lista është e pafund!!

Mirënjohja ndaj këtyre heroinave dhe heronjve të tjerë që kanë kontribuar në zbatimin e Rezolutës 1325 është shumë e rëndësishme, dhe në mesin e arsyeve që ne kemi shkruar këto fakte dhe fabula. Rogova shprehu shqetësimin e saj se shumë shpesh historitë dhe kontributet e grave janë harruar:

> Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së kishte një zyrë të veçantë për 1325, dhe ne [aktivistet] morëm pjesë në studimin e tij global për të parë se ku jemi tani me zbatimin e 1325. Megjithatë, unë duhej të shtyja *fort* sepse ata [autorët e studimit] nuk po e njihnin punën e bërë, veçanërisht në këtë rajon, dhe unë isha atje duke përfaqësuar të gjithë Ballkanin Perëndimor. Ata refuzonin të përmendnin punën e bërë këtu. Përmendën vetëm UNIFEM-in. Vetëm pasi kërcënuam të jepnim dorëheqje dhe siguruam mbështetje nga gratë udhëheqëse të tjera në grupin këshillues, si Madeleine Rees, ata përfshinë përmendjen e punës së zyrtarëve lokalë për të drejtat e grave në rajon.

Njohja e punës së organizatave dhe aktivistëve për të drejtat e grave për të kontribuar në zbatimin e Rezolutës 1325 në Kosovë, dhe globalisht, është e rëndësishme. Aty ku qeveritë vijnë dhe shkojnë, fondet e donatorëve rriten dhe bien, aktivistët e përkushtuar për të drejtat e grave, organizatat dhe rrjetet janë ndër të paktët që i rezistojnë stuhisë dhe vazhdojnë

të bëjnë presion për zbatimin e Rezolutës. Ata "japin frymë jete" në atë që përndryshe është thjesht një copë "letër pa dhëmbë". Njohja dhe dokumentimi i kontributeve të tyre, duke treguar rrëfimet e tyre, rrëfimet tona, jo vetëm që i fuqizon aktivistët për të vazhduar, por gjithashtu lejon ndarjen e njohurive përtej kufijve lidhur me strategjitë për zbatimin më të mirë të Rezolutës, drejt mbrojtjes dhe promovimit më të mirë të të drejtave të grave në shoqëritë në konflikt dhe pas konfliktit.

PUNIMET E CITUARA

Abdela, Lesley. *"Men with a Mission – No Women"* ["Misionet me burra, pa gra"]. 2 mars 2000.

Agence France-Presse. *"Kosovo: UN employee indicted on sexual harassment, human trafficking charges"* ["Kosovë: Punonjësi i OKB-së i akuzuar për ngacmim seksual, trafikim me qenie njerëzore"]. 26 maj 2005.

Amnesty International, *Kosovo (Serbia and Montenegro): "So does it mean that we have the rights?" Protecting the human rights of women and girls trafficked for forced prostitution in Kosovo* [*Kosova (Serbia dhe Mali i Zi): "Pra, a do të thotë kjo se ne kemi të drejta?" Mbrojtja e të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave të trafikuara për prostitucion të detyruar në Kosovë*]. EUR 70/010/2004. 5 maj 2004.

_____. *"Plagë që të djegin shpirtin": Kompensim për të Mbijetuarit e Përdhunimit gjatë Luftës, por Drejtësi s'ka Akoma.* 2017. Në: https://www.amnesty.org/en/wp-content/uploads/2021/05/EUR7075582017ALBANIAN.pdf.

Ashton, Catherine. Letër. 2014. Në: https://womensnetwork.org/sq/baronesha-catherine-ashton-u-pergjigjet-aktivisteve/

Baker, Jock dhe Hilde Haug. *Final Report: External Evaluation of the Kosovo Women's Initiative* [*Raporti final: Vlerësimi i jashtëm i Iniciativës së Grave të Kosovës*]. Gjenevë: Njësia e UNHCR për Vlerësim dhe Analiza Politike. 2002.

Balkan Insight. *"Pa shpërblim për gratë e luftës në Kosovë".* 2013. Në: https://balkaninsight.com/2013/12/18/no-rewards-for-kosovo-s-women-of-war/.

BE. *"Beautiful Kosovo Programme: Guidelines for Municipalities and Selection Criteria".* ["Programi Kosova e bukur: Udhëzues për komunat dhe kriteret e përzgjedhjes"].

_____. Këshilli i Bashkimit Evropian. "U nënshkrua Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës". 2015. Në: https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/27/kosovo-eu-stabilisation-association-agreement/.

_____. Këshilli i Bashkimit Evropian. Vendimi 2014/349/CFSP i datës 12 qershor 2014 për ndryshimin e Veprimit të Përbashkët 2008/124/CFSP për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë. Në: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/GA/TXT/?uri=CELEX:32014D0349.

_____. Këshilli i Bashkimit Evropian. Vendimi (CFSP) 2018/856 i datës 8 qershor 2018 për ndryshimin e Veprimit të Përbashkët 2008/124/CFSP për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë. 2018. Në: https://eur-lex.europa.eu/eli/dec/2018/856/oj.

_____. Këshilli i Bashkimit Evropian. Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë. EULEX Kosovë. Në: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX:32008E0124.

_____. Këshilli i Bashkimit Evropian. Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/5928/CFSP i Bashkimit Evropian.

_____. Këshilli i Bashkimit Evropian. "Zbatimi i Rezolutës 1325 në kontekst të PPSM". Bruksel: 29 shtator 2005.

_____. Këshilli i Bashkimit Evropian. "Zbatimi i Rezolutës 1325 e përforcuar nga Rezoluta 1820 ne kontekst të PPSM". Bruksel: 3 dhjetor 2008. Në: https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-15782-2008-REV-3/en/pdf.

_____. Këshilli i Bashkimit Evropian. "Zbatimi i RKSKB për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në kontekst të misioneve dhe operacioneve të PPSM-it". Bruksel: 6 mars 2012. Në: https://www.lse.ac.uk/women-peace-security/assets/documents/NAPS-Website/6.Policy/2012-Implementation-of-UNSCRs-on-Women-Peace-and-Security-in-the-Context-of-CSDP-Missions-and-Operations-CEU-2012.pdf.

_____. Komisioni Evropian. "Kosova sipas Rezolutës 1244/99 të Raportit të Progresit 2009". 14 tetor 2009.

_____. Komisioni Evropian. "Plani i Veprimit Gjinor 2016-2020 II – Barazia Gjinore dhe Fuqizimi i Grave: Transformimi i Jetës së Vajzave dhe Grave përmes Marrëdhënieve të Jashtme të BE-së 2016-2020".

_____. Komisioni Evropian. "Plani i Veprimit Gjinor i BE-së III - Një Agjendë Ambicioze për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Veprimin e Jashtëm të BE-së". SWD (2020) 284 finale. Bruksel: 25 nëntor 2020. Në:

https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_20_2184.
_____. Parlamenti Evropian. "Politika e Përbashkët Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes". Në: https://www.europarl.europa.eu/ftu/pdf/en/FTU_5.1.2.pdf.
_____. Parlamenti Evropian. Rezoluta për të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor (2018/2710(RSP)). 2018. Në: https://www.europarl.europa.eu/meetdocs/2014_2019/plmrep/COMMITTEES/FEMM/DV/2019/01-23/1163876ENDdraftmotionforresolutionWomensrightinWesternBalkans_EN.
BBC News. *"Kosovo UN Troops 'Fuel Sex Trade'"*. ["Trupat e OKB-së në Kosovë 'Nxisin tregtinë seksuale"]. 6 maj 2004. Në: http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/3686173.stm.
BIRN. "Raporti për Sistemin Shëndetësor të Kosovës". Prishtinë: BIRN, 2009.
Bota Sot. "Rrëfim Ekzkluziv i Gëzim Kastratit, babait të Dianës, e cila u vra nga bashkëshorti i saj". 19 maj 2011.
Causevic, Jasna dhe Stefan Liebing (ed.) për Shoqëria për njerëzit e kërcënuar. "Niveli më i lartë i plumbit në mostrat e flokëve të njeriut: Nën sytë e UNMIK-ut: 560 refugjatë romë të ekspozuar ndaj metaleve të rënda vdekjeprurëse që nga viti 1999". Dhjetor 2005.
Chinkin, C. *"Women, Peace and Security in International Law"* ["Gratë, Paqja dhe Siguria në të Drejtën Ndërkombëtare"] në Women, Peace and Security and International Law (Hersch Lauterpacht Memorial Lectures, ff. 38-70). Cambridge: Cambridge University Press, 2022. Në: doi:10.1017/9781108692076.002.
Clark, Howard. *Civil Resistance in Kosovo* [*Rezistenca Civile në Kosovë*]. Londër: Pluto Press, 2000.
Cohen, Roger. *"U.S. Sergeant Gets Life in Murder of Kosovo Girl, 11"* ["Rreshteri amerikan dënohet përjetë për vrasje të vajzës kosovare, 11"]. New York Times. 2 gusht 2000.
Corrin, Chris. "Post-conflict Situation in Kosovo" [Situata e pas-konfliktit në Kosovë]" në *If Not Now, When?* [*Nëse jo tani, kur?*]. 2001.
Daily News. "Pakistani sentenced for molesting minor in Kosovo". [Pakistanezi dënohet për keqtrajtimin e të miturit në Kosovë]. 2 nëntor 2005.

De Hert, P. dhe Korenica, F. "The New Kosovo Constitution and its Relationship with the European Convention on Human Rights: Constitutionalization 'Without' Ratification in Post-Conflict Societies" ["Kushtetuta e re e Kosovës dhe marrëdhënia e saj me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut: Kushtetutëzimi 'Pa' Ratifikimin në Shoqëritë Pas Konfliktit"]. ZaöRV 76(1). 2016.

Di Lellio, Anna për UNDP, *Community Safety* [Siguria në Komunitet]. Prishtinë: UNDP, 2009.

Durance, John dhe Pauline Menthonnex Gacaferri (ed.) për UNDP. "Informator: A KPC Resettlement Programme" ["Informatori: Programi i rivendosjes së TMK-së"]. Kosovë: UNDP, korrik 2011.

Erlanger, Steven. "The Ugliest American" ["Amerikani më i shëmtuar"]. Revista New York Times. 2 prill 2000. Në: http://www.nytimes.com/2000/04/02/magazine/the-ugliest-american.html?src=pm.

EULEX. Aktgjykimet e Gjykatës, Procedurat Penale, Gjykata Supreme e Kosovës. Ap.-Kz Nr. 106/2007, PnlKr 165/2009. Në: https://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/judgments/criminal-proceedings/SupremeC/SC%20Judgment%20-%20Vladimir%20Ukaj%20et%20alia%20-%20E.pdf.

_____. Aktgjykimet e Gjykatës, Procedurat Penale, Gjykata Supreme e Kosovës. Ap-Kz-108/2010. 25 nëntor 2010. Në: https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/104606-Ap.Kz._108_2010_Alb_Redacted.pdf.

_____. Aktgjykimet e Gjykatës, Procedurat Penale, Gjykata Supreme e Kosovës. Ap.-Kz Nr.128/2010.

_____. Aktgjykimet e Gjykatës, Procedurat Penale, Gjykata Supreme e Kosovës. AP.-Kz Nr.192/2010. Në: https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/48362-Ap_Ki_192_2010_Alb.pdf.

_____. Gjykimet e Gjykatës, Procedurat Civile. Në: https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,38,72.

_____. Faqja zyrtare. "*Informacione për stafin e EULEX-it*", në: http://www.eulex-kosovo.eu/en/info/StaffInfo.php.

_____. Faqja zyrtare. "Divizioni Ekzekutiv". Në: https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,2.

_____. "Fletë informuese mbi Misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë".

_____. "Koha që gratë e Kosovës të trashëgojnë pronë!". 10 mars 2011.

_____. Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve. "Raporti Përfundimtar Kosova 2019". 2019. Në:

https://www.europarl.europa.eu/cmsdata/212456/Kosovo_early-legislative-elections_6-October-2019_final-report.pdf.
_____. "Raporti Vjetor 2010 mbi Aktivitetet Gjyqësore të EULEX-it". 2010.
_____. Shefi i Misionit. Fjalimi në "Dita e Hapur: 10 vjet të Rezolutës 1325". 3 nëntor 2010.
Fitamant, D. Serrano për UNFPA. "Raport vlerësimi për dhunën seksuale në Kosovë". Shqipëri: 28 maj 1999.
Fjalori Online Merriam Webster. Në: http://www.merriam-webster.com/dictionary/fables.
Freedom House. "Harta e lirisë në botë". Kosovë: Freedom House, 2010.
Gjocaj, Shqipe. "Vdekjet e nënave të humbura në sistem". Kallxo.com. 2020. Në: https://kallxo.com/gjate/hulumtim/vdekjet-maternale-qe-humbin-ne-sistem/.
Human Rights Watch. *A Week of Terror in Drenica: Humanitarian Law Violations in Kosovo* [*Java e terrorit në Drenicë: Shkeljet e ligjeve humanitare në Kosovë*]. Shtetet e Bashkuara të Amerikës: shkurt 1999.
_____. "Lead-Contaminated Roma Camps in Kosovo Shut Down". ["Mbyllen kampet e romëve të kontaminuar me plumb në Kosovë"]. 9 dhjetor 2010. Në: http://www.hrw.org/news/2010/11/24/lead-contaminated-roma-camps-kosovo-shut-down.
_____. "Serb Gang-Rapes in Kosovo Exposed" ["Ekspozohen përdhunimet grupore të serbëve në Kosovë"]. 20 mars 2000. Në: http://www.hrw.org/news/2000/03/20/serb-gang-rapes-kosovo-exposed.
Hynes, Michelle dhe Barbara Lopes Cardozo. "Sexual Violence against Women in Refugee Settings" ["Dhuna seksuale ndaj grave në mjediset e refugjatëve"]. *Journal of Women's Health and Gender-Based Medicine* [*Gazeta e Shëndetit të Grave dhe Mjekësisë me Bazë Gjinore*] 9, nr. 8. 2000. Fq. 819-824.
Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS). "Rrugës për në BE: Mundësitë zhvillimore në bazë të rajoneve". Prishtinë: IKS, 2011.
Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D). *Zbërthimi i trendeve zgjedhore* 2000-2010. Prishtinë: D4D. 2011.
IOL News. "UN official held over alleged child abuse" ["Një zyrtar i OKB-së arrestohet mbi abuzimin e dyshuar ndaj fëmijëve"]. 3

shkurt 2005. Në: http://www.iol.co.za/news/world/un-official-held-over-alleged-child-abuse-1.233105.
IOM, "Gender Equality Policy 2015-2019" ["Politika e Barazisë Gjinore 2015-2019"]. Në: https://www.iom.int/sites/g/files/tmzbdl486/files/2018-07/C-106-INF-8-Rev.1-IOM-Gender-Equality-Policy-2015-2019.pdf.
_____. "Socio-economic and demographic profiles of former KLA Combatants Registered by IOM, Vol. 1". ["Profilet socio-ekonomike dhe demografike të ish-luftëtarëve të UÇK-së të regjistruar nga IOM, vëll. 1"]. Prishtinë: IOM, janar 2000.
Këshilli i Europës. Konventa për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Varshavë, 16.V.2005.
_____. Analiza gjinore e ndërthurur e arsimit parauniversitar. 2020. Në: https://rm.coe.int/raporti-gender-eng-final/1680a0b187.
Khakee, Anna dhe Nicolas Florquin. *Kosova dhe armët: Vlerësim bazë i armëve të vogla dhe të lehta në Kosovë*. Raport Special. Gjenevë: UNDP dhe Anketa e armëve të vogla, 2003.
Koha Net. "Gratë deputete: Diskriminim, asnjë grua ambasadore". 11 nëntor 2011.
_____. "Veteranët në grevë nëse nuk zbatohet ligji i premtuar nga Thaqi". 15 nëntor 2011.
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. "Trendet Zgjedhore në Republikën e Kosovës 2009-2019". 2021.
Kusari-Lila, Mimoza. Fjalim në takimin e Lobit të Kosovës për Barazi Gjinore "Gratë dhe Zgjedhjet Lokale". Prishtinë: shkurt 2021.
Mertus, Julie. "When Adding Women Matters: Women's Participation in the International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia" ["Kur përfshirja e grave ka rëndësi: Pjesëmarrja e grave në gjykatën penale ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë"]. *Seton Hall Law Review*. Vol. 38:1297. 2008.
Misioni i OSBE-së në Kosovë, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Komuniteteve. "Gjykimet e krimeve të luftës në Kosovë: Vlerësim pas dhjetë viteve 1999-2009". Maj 2010. Në: https://www.osce.org/files/f/documents/c/e/68570.pdf.
_____ dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). "Përgjigjja ndaj Incidenteve të Dhunës në Familje: Manual për Oficerët e Shërbimeve Sociale". Prishtinë: Janar 2006.
NATO. Dhoma e Lajmeve. "Ngritja e vetëdijesimit gjinor në KFOR". 17 maj 2011. Në: http://www.nato.int/cps/en/natolive/news_74396.htm.

_____. "Marrëveshja Ushtarako-Teknike". 9 qershor 1999. Në: http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm.
_____. "NATO emëron diplomaten norvegjeze si Përfaqësuese Speciale për Gratë, Paqen dhe Sigurinë". 2012. Në: https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_89583.htm.
_____. Uebfaqja e KFOR-it. "KFOR mbajti ditën e perspektivës gjinore 2017". Në: https://jfcnaples.nato.int/kfor/media-center/archive/news/2017/kfor-held-gender-perspective-day-2017.
OHCHR. "Plani i Menaxhimit Strategjik të Komisionerit të Lartë 2010-2011". Në: http://www.ohchr.org/Documents/Press/SMP2010-2011.pdf.
_____. "*Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë* 2019". 2020. Në: https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Press/kosovo_cso_2019_human_rights_report_alb.pdf.
OKB. "Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development". ["Transformimi i botës sonë: Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm"]. Në: https://sdgs.un.org/2030agenda.
_____. Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike e 1961.
_____. Statuti i Romës.
_____. Departamenti për Çështjet e Çarmatimit. "Veprimi Koordinues për Armët e Vogla: Politika e Kombeve të Bashkuara". 1998.
_____. Departamenti i Informimit Publik. "Press Conference on Security Council fact-finding mission to Belgrade and Kosovo". ["Konferenca për shtyp për misionin faktmbledhës të Këshillit të Sigurimit në Beograd dhe Kosovë"]. 24 Prill 2007. Në: http://reliefweb.int/node/231508.
_____. Takimi i Grupit të Ekspertëve për Migrimin dhe Zhvillimin Ndërkombëtar. Divizioni i Popullsisë, Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale. Sekretariati i Kombeve të Bashkuara. Nju Jork. 6-8 korrik 2005.
_____. Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen e Personave Përgjegjës për Shkeljet e Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare të kryera në Territorin e Ish-Jugosllavisë që nga viti 1991 (ICTY). Faqja zyrtare. "Programi i komunikimit".
_____. ICTY. Fletë informative e rastit. "Vlastimir Gjorgjeviq". IT-05-87/1.
_____. ICTY. "Përmbledhja e aktgjykimit." Hagë: 23 shkurt 2011. Në:

http://www.icty.org/x/cases/djordjevic/tjug/en/110223_summary.pdf.
_____. ICTY. "Procedurat inovative". Në: http://www.icty.org/sid/10313.
_____. ICTY. Prokurori k. Millutinoviq et al. Rasti Nr. IT-05-87-T. 26 shkurt 2009. Vëll. 3 [785]. Në: https://www.icty.org/x/cases/milutinovic/tjug/en/jud090226-e3of4.pdf.
_____. ICTY. Prokurori k. Shainoviq et al. Rasti Nr. IT-05-87-A. 23 janar 2014. Në: https://www.icty.org/x/cases/milutinovic/acjug/en/140123.pdf.
_____. ICTY. Prokurori k. Vllastimir Gjorgjeviq. Çështja nr IT-05-87/1-A. 27 janar 2014. Në: https://www.icty.org/x/cases/djordjevic/acjug/sq/140127.pdf.
_____. ICTY. *Raporti vjetor 2017*. Në: https://www.icty.org/x/file/About/Reports%20and%20Publications/AnnualReports/annual_report_2017_en.pdf.
_____. ICTY. "Statuti i përditësuar i Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë". Shtator 2009. Në: https://www.icty.org/x/file/Legal%20Library/Statute/statute_sept09_sq.pdf.
_____. ICTY. "Vlerësimi dhe raporti i gjyqtarit Carmel Agius, President i Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, dhënë Këshillit të Sigurimit në përputhje me paragrafin 6 të rezolutës 1534 (2004) të Këshillit të Sigurimit". 2017. Në: https://www.icty.org/x/file/About/Reports%20and%20Publications/CompletionStrategy/171129-completion-strategy-report-icty.pdf.
_____. Qendra e Lajmeve. "Gratë, jetike për paqen në zonat e pas konfliktit, mbledhja e Këshillit të Sigurimit".
_____. Sekretariati. "Buletini i Sekretarit të Përgjithshëm: Pikat qendrore të departamenteve për gratë në Sekretariat". ST/SGB/2008/12. 1 gusht 2008.
_____. Sekretari i përgjithshëm. "Fjalimi në Mbledhjen e Këshillit të Sigurimit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë". Nju Jork: 19 qershor 2008.
_____. Këshilli i Sigurimit. "Gratë paqja dhe siguria: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm". S/2010/173, 6 prill 2010.
_____. Këshilli i Sigurimit. "Letra e datës 7 tetor 2005 nga Sekretari i Përgjithshëm drejtuar Presidentit të Këshillit të Sigurimit".

S/2005/63. 7 tetor 2005. Në: http://www.ico-kos.org/pdf/KaiEidereport.pdf.
_____. Këshilli i Sigurimit. "Letra e datës 26 mars 2007 nga Sekretari i Përgjithshëm drejtuar Presidentit të Këshillit të Sigurimit: Propozimi Gjithëpërfshirës i Shtojcës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës". S/2007/168/Add.1. 26 mars 2007.
_____. Këshilli i Sigurimit. "Raporti i Misionit të Këshillit të Sigurimit në Kosovë dhe Beograd, Republika Federale e Jugosllavisë". S2002/1376. 19 dhjetor 2002. Në: http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/kos%20S2002%201376.pdf.
_____. Këshilli i Sigurimit. "Raporti i ndërthurur nr. 2 Gratë, Paqja dhe Siguria". 1 tetor 2010.
_____. Këshilli i Sigurimit. Rezoluta 1244.
_____. Këshilli i Sigurimit. Rezoluta 1325. 2000. Në: https://www.undocs.org/en/S/RES/1325(2000).
_____. Këshilli i Sigurimit. Rezoluta 2467. 23 prill 2019.
_____. Sekretari i përgjithshëm. "Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë". S/2009/149. 17 mars 2009.
_____. Sekretari i përgjithshëm. "Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë". S/2009/497. 30 shtator 2009.
OSBE. Anketë për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë. Prishtinë: OSBE, 2019. Në: https://www.osce.org/files/f/documents/e/4/439790.pdf.
Osmani Sadriu, Vjosa. Fjalim. Instituti Kombëtar Demokratik (IDK). "Konferenca e Javës së Grave 2020".
Prodger, Matt për BBC. "Toxic Camp angers Kosovo Roma" ["Kampet toksike zemërojnë romët e Kosovës"]. 13 qershor 2005. Në: http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/4080048.stm.
Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMGF). *Harta sociale e grave në Kosovë: 1995-2000*, Interpretimi sociologjik, Prishtinë: QMGF, 2004.
_____. *Vjetari 2003*. Prishtinë: QMGF, 2004.
QKSGJ. *Historia është edhe tregimi i saj: Historia e grave në shoqërinë civile në Kosovë 1980-2004*. Prishtinë: QKSGJ, 2008.
_____. *Indeksi i Sigurisë së Grave 2010: Raporti i Kosovës*. Prishtinë: QKSGJ, 2011.

Qosaj Mustafa, Ariana, për KIPRED. "*Fuqizimi i shtetësisë së grave në kontekstin e* e shtetndërtimit". Prishtinë: KIPRED, 2010.
Raka, Lul. "Raporti Historik Kombëtar i Kërkimit Shëndetësor për Kosovën (sipas RKSKB 1244)". Prishtinë: 2009.
Republika e Kosovës, Dhomat e Specializuara dhe Prokuroria e Specializuar. Faqja zyrtare. Në: https://www.scp-ks.org/sq.
_____. Gjykata Supreme e Kosovës. Ap-Kz-108/2010. 25 nëntor 2010. Në: https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/104606-Ap.Kz._108_2010_Alb_Redacted.pdf.
_____. Gjykata Supreme e Kosovës. Faqja zyrtare. Në: https://supreme.gjyqesori-rks.org/miresevini-ne-gjykaten-supreme/gjyqtaret/.
_____. Institucioni i Avokatit të Popullit. Faqja zyrtare. "Raportet vjetore". Në: https://oik-rks.org/raportet/raportet-vjetore/.
_____. Kuvendi i Kosovës. Kodi Nr. 06/L-074, Kodi Penal i Republikës së Kosovës.
_____. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
_____. Ligji Nr. 02/L-2 Për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës.
_____. Ligji Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës.
_____. Ligji Nr. 03/L-045 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës.
_____. Ligjit Nr. 03/L-052 Për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës
_____. Ligji Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.
_____. Ligji Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.
_____. Ligji Nr. 03/L-142 Ligji për Rendin dhe Qetësinë Publike.
_____. Ligji Nr. 03/L-143 për Armët.
_____. Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.
_____. Ligji Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre.
_____. Ligji Nr. 04/L-261 Për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
_____. Ligji Nr. 04/L-172 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-054 Për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve,

Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre. 2014. Në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9436.
_____. Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore në Kosovë. Në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923.
_____. Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
_____. Ligji Nr. 2004/2 Për Barazinë Gjinore në Kosovë. Në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2457.
_____. Ligji Nr. 2004/4 për Shëndetësi.
_____. Ligji Nr. 2004/32 për Familjen.
_____. Qeveria. "Draft Strategjia e Sigurisë së Republikës së Kosovës 2021-2025". 2020. Në: https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40992.
_____. Qeveria. ESK. Anketë e Fuqisë Punëtore në Kosovë. Prishtinë: ESK, 2009.
_____. Qeveria. ESK. "Shkalla e papunësisë". 11 dhjetor 2008
_____. Qeveria. ESK. "Gratë dhe Burrat". Prishtinë: ESK, mars 2009.
_____. Qeveria. Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019/2020. 2020. Në: https://ask.rks-gov.net/media/5636/arsimi-201920120-shqip.pdf.
_____. Qeveria. Ministria e Financave. Anketa e Fuqisë Punëtore TM3 2020. 2020. Në: https://ask.rks-gov.net/media/5826/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-afp-tm3-2020.pdf.
_____. Qeveria. Ministria e Financave. Agjencia e Statistikave të Kosovës. "Statistikat e Mirëqenies Sociale TM3 2020". 2020. Në: https://ask.rks-gov.net/media/5777/statistikat-e-mir%C3%ABqenies-sociale-tm3-2020.pdf.
_____. Qeveria. Ministria e Financave. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Gratë dhe Burrat në Kosovë 2018-2019. 2020. Në: https://ask.rks-gov.net/media/5800/grat%C3%AB-dhe-burrat-n%C3%AB-kosov%C3%AB-2018-2019.pdf.
_____. Qeveria. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Agjencia e Statistikave të Kosovës. "Statistikat e Vdekjeve 2020". 2021. Në: https://ask.rks-gov.net/media/6588/vdekjet-2020.pdf.
_____. Qeveria. Ministria e FSK-së. "Strategjia e Sigurisë". 2010.

_____. Qeveria. Ministria e FSK-së dhe FSK. "Plani i Veprimit për Zbatimin e Politikave të të Drejtave të Njeriut dhe Barazisë Gjinore në MFSK dhe FSK".
_____. Qeveria. Ministria e FSK-së dhe FSK. "Politika e të Drejtave të Njeriut dhe Barazisë Gjinore në MFSK dhe FSK". 2011.
_____. Qeveria. Ministria e Mbrojtjes dhe FSK. "Politika për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës". 2019.
